

KITÁB-I-AQDAS

KITÁB-I-AQDAS

**LIBRI
MË
I SHENJTË**

BAHÁ'U'LLÁH



QENDRA BOTËRORE BAHÁ'Í
HAIFA

Original Title:

The Kitáb-i-Aqdas – The Most Holy Book

published by The Universal House of Justice 1992

Text: Albanian

Përkthyer e botuar nën kujdesin e

Komitetit të botimeve bahá'í

© Asambleja Shpirtërore Kombëtare

e Bahá'í-ve të Shqipërisë

Rruga e Dibrës 59 - Tiranë

Botimi i parë 2004 - 161 E.B.

Rishikuar: Gusht 2010

PËRMBAJTJE

	<i>Page</i>
PARATHËNIE	vii
HYRJE	1
NJË PËRSHKRIM I KITÁB-I-AQDAS 'T NGA SHOGHI EFFENDI 'U	12
KITÁB-I-AQDAS	17
DISA TEKSTE SHTOJÇË	89
PYETJE DHE PËRGJIGJE	103
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E KODIFIKIMI I LIGJEVE DHE I POROSIVE TË KITÁB-I-AQDAS 'T	141
SHËNIME	165
GLOSAR	252
ÇELËS PËR PASAZHET NGA KITÁB-I-AQDAS 'I TË PËRKTHYERA NGA SHOGHI EFFENDI 'U	255
PASQYRË TEMATIKE	258

PARATHËNIE

NË VITIN 1953 Shoghi Effendi u, Ruajtësi i Besimit Bahá'í, përfshiu si një ndër qëllimet e Planit të tij Dhjetëvjeçar përgatitjen e një Pasqyre Përmbledhëse e Kodifikimi të ligjeve e të porosive të Kitáb-i-Aqdas it, si një parakusht thelbësor për përkthimin e tij. Ai punoi vetë për kodifikimin, por ende nuk e kishte përfunduar kur vdiq në vitin 1957. Kjo detyrë u vazhdua mbi bazën e punës së bërë prej tij dhe vëllimi që u përgatit doli në vitin 1973. Ai botim përmbante, veç vetë Pasqyrës Përmbledhëse e Kodifikimit, si dhe shënimeve shpjeguese, një përmbledhje pasazhesh nga Kitáb-i-Aqdas i që ishin përkthyer më parë nga Shoghi Effendi u dhe ishin botuar në libra të ndryshëm. Pasqyra Përmbledhëse e Kodifikimi përfshinte jo vetëm tekstin e Kitáb-i-Aqdas it, por edhe Pyetjet e Përgjigjet, që përbëjnë një shtojcë të Aqdas it. Në vitin 1986 Shtëpia Universale e Drejtësisë arriti në përfundimin se kishte ardhur koha kur përgatitja e një përkthimi anglisht të tekstit të plotë të Librit Më të Shenjtë ishte jo vetëm e mundur por edhe e domosdoshme, prandaj e përfshiu përmbushjen e kësaj detyre midis synimeve të Planit Gjashtëvjeçar 1986-1992. Botimi i tij në anglisht do të pasohet nga botime në gjuhë të tjera.

Është pranuar se Kitáb-i-Aqdas i, duke qenë Shkrim i Shenjtë, duhet paraqitur në një formë që të lexohet me lehtësi e frymëzim, pa e ngatërruar me shënime e numra indeksi, që janë të zakonshëm në tekstet studimore. Megjithatë, për t'i ardhur në ndihmë lexuesit që të ndjekë rrjedhën e tekstit dhe temat e tij që ndryshojnë, ai është ndarë në paragrafe – ndarje të tilla nuk janë zakon në vepra të literaturës arabe – dhe këto paragrafe janë pajisur me numra për të lehtësuar gjetjen dhe indeksimin, si dhe

për referime të njëlojta në të gjitha gjuhët në të cilat kjo vepër do të botohet.

Teksti i Aqdas it pasohet nga një përmbledhje e shkurtër Shkrimesh të Bahá'u'lláh ut, të cilat janë shtojcë e Librit Më të Shenjtë, si dhe nga Pyetje dhe Përgjigje, që botohet këtu për herë të parë.

Shoghi Effendi u ka thënë se përkthimi anglisht i Aqdas it duhet “të pajiset me shënime të shumta”. Metoda e ndjekur në përgatitjen e shënimeve ka qenë përqëndrimi në ato pika që një lexuesi joarabfolës mund t’i duken të errëta ose të cilat, për arsye të ndryshme, kërkojnë sqarim ose informacion mbështetës. Atë synojnë të plotësojnë këto kërkesa themelore dhe jo të jenë një koment i tërësishëm i tekstit.

Shënimet, të cilat janë vendosur pas Pasqyrës Përmbledhëse e Kodifikimit, janë të pajisura me numra sipas radhës. Çdo shënim paraprihet nga një citim i pasazhit të cilit i referohet dhe tregon numrin e paragrafit në të cilin ky pasazh përfshihet. Kjo lehtëson referimin midis tekstit e shënimeve dhe u jep mundësinë lexuesve të studiojnë shënimet pa iu kthyer vazhdimisht tekstit, në qoftë se parapëlqejnë kështu. Shpresohet se në këtë mënyrë u dilet përpara nevojave të lexuesve shumë të ndryshëm nga prejardhja e interesat.

Indeksi jep një orientim për temat në të gjitha pjesët e vëllimit.

Domethënia dhe karakteri i Kitáb-i-Aqdas it dhe larmia e temave që ai përmban përshkruhen në mënyrë të gjallë nga Shoghi Effendi u në historinë e tij për shekullin e parë Bahá’í, të titulluar *Perëndia kalon pranë*. Për t’i ardhur në ndihmë lexuesit, këto pasazhe janë vendosur në pjesën që vjen menjëherë pas hyrjes. Pasqyra Përmbledhëse e Kodifikimit, që përfshihet në këtë vëllim, shërben si një ndihmë tjetër për të pasur një vështrim të përgjithshëm të Librit.

HYRJE

KY VII, i 149-ti i epokës Bahá'í, shënon Qindvjetorin e Ngjitjes në qiell të Bahá'u'lláh ut, Bartësit të Revelacionit universal të Perëndisë, të paracaktuar ta udhëheqë njerëzimin në arritjen e pjekurisë kolektive. Që kjo ngjarje kremtohet nga një komunitet besimtarësh që përfaqëson një koleksion të mbarë gjinisë njerëzore dhe që, gjatë një shekulli e gjysmë, është vendosur deri në skajet më të largëta të rruzullit, kjo është një shenjë e forcës bashkuese të çliruar nga ardhja e Bahá'u'lláh ut. Një dëshmi e mëtejshme e veprimit pikërisht të këtyre forcave mund të shihet në shkallën që vizioni i Bahá'u'lláh ut ka parashëmbëllyer në shumë aspekte të saj përvojën e sotme njerëzore. Momenti është i favorshëm për botimin e këtij përkthimi të parë anglisht të autorizuar të Librit Mëmë të Revelacionit të Tij, të “Librit Më të Shenjtë” të Tij, të Librit në të cilin ai shtjellon Ligjet e Perëndisë për një Dispensacion të paracaktuar të vazhdojë jo më pak se një mijë vjet.

Nga më se të njëqind vëllimet që përfshijnë Shkrimet e shenjta të Bahá'u'lláh ut, Kitáb-i-Aqdas i është i një rëndësie të pashoqe. *“Të ndërtojme sërish gjithë botën”* është kërkesa e sfida e Mesazhit të Tij dhe Kitáb-i-Aqdas i është Karta e qytetërimit të ardhshëm botëror që Bahá'u'lláh u ka ardhur për ta ngritur. Masat e parashikuara në të mbështeten drejtpërsëdrejti në themelin e hapur nga fetë e së kaluarës, sepse, sipas fjalëve të Bahá'u'lláh ut, *“Ky është Besimi i pandryshuar i Perëndisë, i përjetsbëm në të shkuarën, i përjetsbëm në të ardhmen”*. Në këtë Revelacion konceptet e së kaluarës janë ngritur në një nivel të ri të kuptuari dhe ligjet shoqërore janë ndryshuar për t'iu përshtatur epokës që tani po agon, janë të paracaktuara ta çojnë përpara njerëzimin

drejt një qytetërimi botëror, shkëlqimet e të cilit është ende vështirë të përfytyrohen.

Duke pohuar vlefshmërinë e feve të mëdha të së kaluarës, Kitáb-i-Aqdas i ripohon të vërtetat e përjetshme që janë shpallur nga të gjithë Lajmëtarët Hyjnorë: unitetin e Perëndisë, dashurinë për tjetrin dhe qëllimin moral të jetës tokësore. Në të njëjtën kohë, ai heq ato elemente të kodeve të kaluara fetare që sot përbëjnë një pengesë për bashkimin e botës që po spikat dhe për rindërtimin e shoqërisë njerëzore.

Ligji i Perëndisë për këtë Dispensacion u përgjigjet nevojave të mbarë familjes njerëzore. Në Kitáb-i-Aqdas ka ligje që u drejtohen në radhë të parë pjesëtarëve të një sektori të posaçëm të njerëzimit dhe mund të kuptohen menjëherë prej tyre, por të cilat në një lexim të parë mund të jenë të errëta për njerëz të një kulture të ndryshme. I tillë është, për shembull, ligji që ndalon rrëfimin e mëkateve një qenieje tjetër njerëzore, i cili edhe pse i kuptueshëm për njerëzit me prejardhje të krishterë, mund të hutojë disa të tjerë. Shumë ligje u referohen Dispensacioneve të mëparshme, veçanërisht atyre dy të fundit, të Muhametit e të Báb-it, të mishëruara në Kuranin e në Bayán-in. Megjithatë, edhe pse disa porosi të Aqdas-it kanë një referencë të tillë të përcaktuar, ato kanë gjithashtu implikime universale. Me Ligjin e Tij, Bahá'u'lláh u zbulon gradualisht domethënien e niveleve të reja të dijes e të sjelljes, për të cilat u bëhet thirrje popujve të botës. Ai i fut porosinë e Tij në kontekstin e një komenti shpirtëror, që lexuesi të ketë kurdoherë parasysh parimin që këto ligje, pavarësisht nga çështja që trajtojnë, u shërbejnë qëllimeve të shumanshme: t'i sjellin qetësi shoqërisë njerëzore, të ngrenë nivelin e sjelljes njerëzore, të zgjerojnë kufijtë e kuptimit njerëzor dhe të shpirtëzojnë jetën e të gjithëve. Gjithmonë qëllimi përfundimtar i ligjeve të fesë është lidhja e shpirtit individual me Perëndinë dhe përmbushja e fatit të tij shpirtëror. *“Mos mendoni”*, është pohimi i vetë Bahá'u'lláh-ut, *“se Ne ju kemi zbuluar thjesht një kod ligjesh. Jo, përkundrazi, me gishtat e fuqisë e të pushtetit Ne kemi*

HYRJE

bapur Verën e zgjedhur”. Libri i Tij i Ligjeve është “*dëshmia më me peshë e Tij për të gjithë popujt dhe prova e Mëshirëplotit për të gjithë ata që janë në qiell dhe ata që janë mbi tokë*”.

Një hyrje në gjithësinë shpirtërore që zbulohet në Kitáb-i-Aqdas nuk do t’ia arrinte qëllimit, në qoftë se nuk do ta njihte lexuesin me institucionet interpretuese e ligjvënese, që Bahá’u’lláh u i ka lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me sistemin e ligjeve që Ai ka zbuluar. Në themel të këtij udhërrëfimi qëndron roli i pashoq që Shkrimet e Bahá’u’lláh ut – në fakt vetë teksti i Kitáb-i-Aqdas it – i japin djalit të Tij të madh, ‘Abdu’l-Bahá it. Kjo figurë e pashoqe është, në të njëjtën kohë, Shembulli i modelit të jetës që mësonte Ati i Tij, Interpretuesi i frymëzuar hyjnisht e me autoritet i Mësimeve të Tij dhe Qendra e Strumbullari i Besëlidhjes që Autori i Revelacionit Bahá’í ka bërë me të gjithë ata që e njohin Atë. Njëzet e nëntë vjetët e detyrës së ‘Abdu’l-Bahá it e pajisën botën Bahá’í me një masë të shkëlqyer komentesh, që hapin horizonte të shumta për kuptimin e qëllimit të Atit të Tij.

Në Vullnetin e Testamentin e Tij, ‘Abdu’l-Bahá i ia veshi rrobën e Ruajtësit të Kauzës e të Interpretuesit të pagabueshëm të mësimeve të saj nipit të Tij më të madh, Shoghi Effendi ut, dhe konfirmoi autoritetin e garancinë e udhëheqjes hyjnore të dekretuar nga Bahá’u’lláh u për Shtëpinë Universale të Drejtësisë lidhur me të gjitha çështjet “*që nuk janë zbuluar shprehimisht në Librin*”. Kështu Ruajtësia dhe Shtëpia Universale e Drejtësisë mund të shihen, sipas fjalëve të Shoghi Effendi ut, si “Pasardhësit Binjakë” të Bahá’u’lláh ut e të ‘Abdu’l-Bahá it. Ato janë institucionet më të larta të Rendit Administrativ të themeluar e të paralizuar në Kitáb-i-Aqdas dhe të përpunuar nga ‘Abdu’l-Bahá i në Testamentin e Tij.

Gjatë detyrës së tij 36-vjeçare, Shoghi Effendi u ngriti strukturën e Asambleve Shpirtërore të zgjedhura – Shtëpitë e Drejtësisë që përmenden në Kitáb-i-Aqdas, të cilat sot janë në fazën embrionale – dhe me bashkëpunimin e tyre nisi zbatimin

sistematik të Planit Hyjnor që ‘Abdu’l-Bahá i pat hartuar për përhapjen e Besimit në mbarë botën. Duke u mbështetur në strukturën e shëndoshë administrative që ishte ngritur, Ai vuri gjithashtu në lëvizje proceset që përbënin një përgatitje thelbësore për zgjedhjen e Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Ky organ, i cili u krijua në prill të vitit 1963, zgjidhet me votim të fshehtë e me shumicë votash në një proces zgjedhor me tri faza nga Bahá’í të në moshë të rritur anembanë botës. Fjala e revealuar e Bahá’u’lláh ut, bashkë me interpretimet e parashtrimet e Qendrës së Besëlidhjes e të Ruajtësit të Kauzës, përbëjnë kushtet e detyrueshme të referencës të Shtëpisë Universale të Drejtësisë dhe janë themeli i shëndoshë i saj.

Përsa u përket vetë ligjeve, një shqyrtim i vëmendshëm tregon se ato përfshijnë tri fusha: marrëdhëniet individuale me Perëndinë, çështje materiale e shpirtërore që i sjellin dobi individit drejtpërsëdrejti dhe marrëdhëniet midis individëve, si dhe midis individit e shoqërisë. Ato mund të grupohen sipas titujve që vijnë: lutja dhe agjërimi; ligje të statusit personal, që përfshijnë martesën, shkurorëzimin dhe trashëgiminë; një varg ligjesh, porosish e ndalimesh të tjera, si dhe këshillash; dhe shfuqizimi i ligjeve e i porosive të veçanta të Dispensacioneve të mëparshme. Një tipar i spikatur është shkurtësia e tyre. Ato përbëjnë thelbin e një sistemi të gjerë ligjesh që do të dalin në shekujt e ardhshëm. Ky përpunim i ligjit do të kryhet nga Shtëpia Universale e Drejtësisë me autoritetin që i ka dhënë asaj Vetë Bahá’u’lláh u. Në një prej Tabelave të Tij ‘Abdu’l-Bahá i sqaron këtë parim:

Çështjet më të rëndësishme, që përbëjnë themelin e Ligjit të Perëndisë, shtjellohen shprehimisht në Tekstin, por ligjet ndihmëse i janë lënë Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Urtia e kësaj është se koha nuk mbetet kurrë e njëjta, sepse ndryshimi është një veti e nevojshme e një atribut thelbësor i kësaj bote dhe i kohës e i

HJRJE

hapësisë. Pra, Shtëpia Universale e Drejtësisë do të veprojë në përshtatje me këtë...

Me pak fjalë, kjo është urtia që ligjet e shoqërisë i janë lënë Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Në fenë e Islamit, po kështu, nuk është reveluar shprehimisht çdo porosi; jo, as një e dhjeta e një të dhjetës nuk është përfshirë në Tekstin; edhe pse të gjitha çështjet më të rëndësishme janë përmendur në mënyrë të posaçme, ka pasur padyshim mijëra ligje që nuk janë përmendur. Këto janë formuluar nga teologët e një kohe të mëvonshme në pajtim me ligjet e jurisprudencës islamike, dhe teologë individualë nga porositë origjinale të reveluara kanë bërë deduksione që janë në kundërshtim me njëritjetrin. Të gjitha këto u bënë të detyrueshme. Sot ky proces i deduktimit është e drejtë e organit të Shtëpisë Universale të Drejtësisë dhe deduksionet e konkluzionet e njerëzve të ditur individualë nuk kanë autoritet, veçse po të mbështeten nga Shtëpia e Drejtësisë. Ndryshimi është pikërisht që nga konkluzionet e mbështetjet e organit të Shtëpisë së Drejtësisë, anëtarët e së cilës janë të zgjedhur e të njohur nga komuniteti mbarëbotëror Bahá'í, nuk do të lindin kurfarë divergjencash; ndërsa konkluzionet e teologëve e të studiuesve individualë do të çonin me siguri në divergjencë dhe, si rezultat, do të lindnin përçarje, ndarje e shpërbërje. Njëshmëria e Fjalës do të shkatërrohej, uniteti i Besimit do të zhbukej dhe godina e Besimit të Perëndisë do të lëkundej.

Megjithëse Shtëpia Universale e Drejtësisë është shprehimisht e autorizuar të ndryshojë ose të shfuqizojë legjislacionin e vet me ndryshimin e gjendjes, duke e pajisur kështu ligjin Bahá'í me një element thelbësor lakueshmërie, ajo nuk mund të shfuqizojë ose të ndryshojë asnjë prej ligjeve që janë formuluar shprehimisht në Tekstin e shenjtë.

Ajo shoqëri për të cilën janë paracaktuar disa prej ligjeve të Aqdas-it do të krijohet vetëm gradualisht dhe Bahá'u'lláh u ka parashikuar zbatimin e shkallëzuar të ligjit Bahá'í:

KITÁB-I-AQDAS

Me të vërtetë, ligjet e Perëndisë janë si oqeani dhe bijtë e njerëzve si peshqit, sikur ta dinin këtë. Sidoqoftë, në zbatimin e tyre duhet ushtruar takt e urti... Derisa shumë njerëz janë të dobët e larg qëllimit të Perëndisë, atëherë në çdo rrethanë duhet përdorur takt e maturi, në mënyrë që të mos ndodhë asgjë që mund të shkaktojë trazim e mosmarrëveshje ose të ngjallë zhurmë midis të shkujdesurve. Me të vërtetë, bujaria e Tij ka përshtuar tërë gjithësinë dhe dhuntitë e Tij kanë përfshirë çdo gjë që jeton mbi tokë. Duhet udhëhequr njerëzimi drejt oqeanit të të kuptuarit të vërtetë në frymën e dashurisë e të tolerancës. Vetë Kitáb-i-Aqdas i është një dëshmi kuptimplote e provanisë dashamirëse të Perëndisë.

Parimi që rregullon këtë zbatim të shkallëzuar është shpallur në një letër të shkruar në emër të Shoghi Effendi 'ut, drejtuar një Asambleje Shpirtërore Kombëtare në vitin 1935:

Ligjet e reveluara nga Bahá'u'lláh u në Aqdas in janë krejt të detyrueshme për çdo besimtar ose institucion Bahá'í në Lindje a Perëndim qoftë, sa herë janë të zbatueshme dhe nuk vijnë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin Civil të vendit. Disa... ligje duhen parë nga të gjithë besimtarët si universale e jetësore për t'u zbatuar në kohën e tanishme. Disa të tjera janë formuluar në parashikim të një shoqërie të paracaktuar të lindë nga kushtet kaotike që mbisundojnë sot... Ato që nuk janë formuluar në Aqdas, krahas çështjeve që kanë të bëjnë me hollësi e që janë të një rëndësie dytësore, të cilat dalin nga zbatimi i ligjeve të formuluar më parë nga Bahá'u'lláh u, duhet të vendosen nga Shtëpia Universale e Drejtësisë. Ky organ mund të bëjë shtesa, por kurrë të shfuqizojë ose ndryshojë qoftë edhe një fije atë që është formuluar tashmë nga Bahá'u'lláh u. As Ruajtësi nuk ka kurrfarë të drejte të zvogëlojë efektin detyrues, aq më pak të shfuqizojë, tezat e një Libri kaq të qenësishëm e të shenjtë.

HYRJE

Numri i ligjeve të detyrueshme për Bahá'í të nuk rritet nga botimi i këtij përkthimi. Kur të gjykohet se ka ardhur koha, komuniteti Bahá'í do të njoftohet se ç'ligje të tjera bëhen të detyrueshme për besimtarët, dhe çdo orientim ose legjislacion shtesë i nevojshëm për zbatimin e tyre do të sigurohet.

Në përgjithësi, ligjet e Kitáb-i-Aqdas it janë shtjelluar në mënyrë të ngjeshur. Një shembull i kësaj ngjeshjeje mund të shihet në faktin që shumë prej tyre janë shprehur vetëm në zbatimin lidhur me burrin, por nga shkrimet e Ruajtësit duket sheshit se atje ku Bahá'u'lláh u jep një ligj midis burrit e gruas, ai vlen edhe *mutatis mutandis* midis gruas e burrit, veç në qoftë se konteksti e bën këtë të pamundur. Për shembull, teksti i Kitáb-i-Aqdas it ia ndalon një burri të martohet me të shoqen e të atit (dmth me njerikën e vet), dhe Ruajtësi ka vënë në dukje se edhe një gruaje i ndalohet të martohet me njerikun e saj. Ky kuptim i atyre që nënkupton Ligji ka efekte shumë të gjera në dritën e parimit themelor Bahá'í të barazisë së sekseve dhe duhet mbajtur parasysh kur studiohet Teksti i shenjtë. Që burrat dhe gratë ndryshojnë midis tyre në disa karakteristika e funksione, ky është një fakt i pamohueshëm i cili bën të mundur rolet e tyre, që plotësojnë njëri-tjetrin në disa sfera të jetës së shoqërisë; por është kuptimplotë që 'Abdu'l-Bahá i ka thënë se në këtë Dispensacion "*Barazia e burrave dhe grave, me përjashtim të disa rasteve të papërfillshme, është shpallur plotësisht e në mënyrë kategorike*".

Kemi përmendur më lart lidhjen e ngushtë midis Kitáb-i-Aqdas it dhe Librave të Shenjtë të Dispensacioneve të mëparshme. Veçanërisht e ngushtë është lidhja me Bayán in, Librin e Ligjeve të reveluara nga Báb i. Kjo lidhje sqarohet në pasazhet e mëposhtme nga letra të shkruara në emër të Ruajtësit:

Shoghi Effendi u është i mendimit se uniteti i Revelacionit Bahá'í si një e tërë që përfshin edhe Besimin e Báb it duhet të theksohet... Besimi i Báb it nuk duhet ndarë nga ai i Bahá'u'lláh ut. Edhe pse mësimet e Bayán it

janë shfuqizuar e zëvendësuar nga ligjet e Aqdas it, por duke qenë se Báb i e konsideronte Vetën si Pararendësin e Bahá'u'lláh ut, ne duhet ta shohim Dispensacionin e Tij bashkë me atë të Bahá'u'lláh ut si të tilla që formojnë një të tërë, duke qenë i pari si hyrje për ardhjen e këtij të fundit.

Báb i thotë se ligjet e Tij janë të përkohshme dhe varen nga miratimi i Manifestimit të ardhshëm. Ja përse në Librin e Aqdas it Bahá'u'lláh u sanksionon disa prej ligjeve që gjenden në Bayán in, ndryshon disa të tjera dhe lë mënjanë shumë prej tyre.

Ashtu si Bayán i u revelua nga Báb i rreth mesit të Misionit të Tij, edhe Bahá'u'lláh u e reveloi Kitáb-i-Aqdas in aty nga viti 1873, ndonja njëzet vjet pasi pat marrë, në Síyáh-Chál in e Tíhránit, urdhërin për Revelacionin e Tij. Në një prej Tabelave të Veta, Ai vë në dukje se edhe pas revelimit të tij, Aqdas i u mbajt prej Tij për njëfarë kohe para se t'u dërgohej miqve në Iran. Prandaj, siç e rrëfen Shoghi Effendi u:

Formulimi i ligjeve themelore të Dispensacionit të Tij në Kitáb-i-Aqdas u pasua, ndërsa Misioni i Tij po i afrohej fundit, nga shpallja e disa porosive e parimeve që përbëjnë vetë palcën e Besimit të Tij, duke ripohuar të vërteta që Ai kishte shpallur më parë, duke përpunuar e ndriçuar disa prej ligjeve që tashmë i kishte hartuar, duke reveluar profeci e paralajmërime të mëtejshme dhe duke dhënë porosi shtesë të caktuara për të plotësuar tezat e Librit të Tij Më të Shenjtë. Këto përmbahen në Tabela të panumërta, që Ai vazhdoi të revelonte deri në ditët e fundit të jetës tokësore të Tij...

Midis veprave të tilla janë Pyetje dhe Përgjigje, një përmbledhje e bërë nga Zaynu'l-Muqarrabín, më i shquari ndër kopjuesit e Shkrimeve të Bahá'u'lláh ut. E përbërë prej

HYRJE

përgjigjesh të reveluara nga Bahá'u'lláh u për pyetje që i kishin bërë Atij besimtarë të ndryshëm, kjo përmbledhje është një shtojcë e paçmuar e Kitáb-i-Aqdas it. Në vitin 1978, Tabelat e tjera të kësaj natyre që meritojnë më shumë vëmendje u botuan në anglisht si një përmbledhje me titull *Tabela të Bahá'u'lláh ut të reveluara pas Kitáb-i-Aqdas it*.

Disa vjet pas revelimit të Kitáb-i-Aqdas it, Bahá'u'lláh u u dërgoi kopje në dorëshkrim Bahá'í-ve në Iran dhe në vitin 1308 A.H. (1890-91 A.D.), aty nga fundi i jetës së Tij, bëri botimin e tekstit origjinal arabisht të Librit në Bombej.

Duhet thënë diçka lidhur me stilin e gjuhës në të cilin është dhënë në anglisht Kitáb-i-Aqdas i. Bahá'u'lláh u zotëronte në mënyrë madhështore arabishten dhe parapëlqente ta përdorte atë në ato Tabela e Shkrime të tjera ku saktësia e saj në shprehjen e kuptimit ishte veçanërisht e përshtatshme për shtjellimin e ndonjë parimi bazë. Por veç vetë zgjedhjes së gjuhës, stili i përdorur është i lartë e prekës, tepër rrëmbenjës, sidomos për ata që e njohin traditën e madhe letrare nga e cila ai ka dalë. Duke marrë përsipër detyrën e përkthimit, Shoghi Effendi u përballoi sfidën e gjetjes së një stili anglisht i cili jo vetëm të përçonte besnikërisht kuptimin e saktë të tekstit, por edhe të ngjallte te lexuesi frymën e respektit përsiatës, që është një tipar dallues i efektit të shkaktuar prej origjinalit. Forma e të shprehurit që ai zgjodhi, e cila të kujton stilin e përdorur prej përkthyesve të Biblës të shekullit të shtatëmbëdhjetë, jep formën e lartë të arabishtes së Bahá'u'lláh ut, duke mbetur ndërkohë e kapshme për lexuesin bashkëkohor. Përkthimet e tij, për më tepër, janë të ndriçuara nga kuptimi i tij i pashoq i frymëzuar i domethënies e i nënkuptimeve të origjinalit.

Edhe pse si arabishtja dhe anglishtja janë gjuhë me fjalor të pasur e mënyra të larmishme shprehjeje, format e tyre ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Arabishtja e Kitáb-i-Aqdas it dallohet për një përqëndrim e ngjeshje intensive shprehjeje. Është karakteristikë e këtij stili që në qoftë se diçka nënkuptohet

qartë, ajo nuk thuhet shprehimisht. Kjo krijon problem për një lexues, prejardhja kulturore, fetare e letrare e të cilit është krejt e ndryshme nga ajo e arabishtes. Përkthimi fjalë për fjalë i një pasazhi që është i qartë në arabisht, mund të jetë i errët në anglisht. Bëhet, pra, e nevojshme që në përkthimin anglisht të pasazheve të tilla të futet ai element i fjalisë arabisht i cili në origjinal nënkuptohet qartë. Në të njëjtën kohë, është jetësore të shmanget çuarja e këtij procesi deri në atë pikë sa t'i bëhen origjinalit shtesa të pajustificuara ose të kufizohet kuptimi i tij. Gjetja e një baraspeshe të drejtë midis bukurisë e qartësisë së shprehjes, nga njëra anë, dhe saktësisë, nga ana tjetër, është një nga çështjet kryesore, me të cilën janë ndeshur përkthyesit dhe e cila është bërë shkak për rishikimin e përkthimit të disa pasazheve. Një çështje tjetër e rëndësishme është nënkuptimi i përligjur i disa termave arabisht, të cilat kanë një varg kuptimesh të ndryshme nga termat e ngjashëm në anglisht.

Shkrimet e Shenjta është e qartë që kërkojnë kujdes e besnikëri të posaçme në përkthim. Kjo është tepër e rëndësishme në rastin e një Libri Ligjesh, ku është jetësore që lexuesi të mos çorientohet ose të mos futet në debate të pafrytshme. Siç ishte parashikuar, përkthimi i Librit Më të Shenjtë ka qenë një punë e pleksur me vështirësitë më të mëdha, e cila kërkonte këshillim me ekspertë në shumë vende. Meqenëse rreth një e treta e tekstit që përkthyer tashmë nga Shoghi Effendi u, ishte e nevojshme të bëheshin përpjekje për të arritur tri cilësi në përkthimin e pasazheve që mbeteshin: saktësi në kuptim, bukuria të anglishtes dhe përshtatje të stilit me atë të përdorur nga Shoghi Effendi u.

Tani ne jemi të kënaqur që përkthimi ka arritur një pikë kur ai përfaqëson një interpretim të pranueshëm të origjinalit. Megjithatë, ai me siguri do të bëjë që të dalin pyetje e sugjerime, të cilat mund të hedhin dritë të mëtejshme mbi përmbajtjen e tij. Ne jemi thëllësisht mirënjohës për punën këmbëngulëse e me merak të anëtarëve të Komiteteve që kishim ngarkuar të përgatisnin e rishikonin këtë përkthim të Aqdasit dhe të

HYRJE

hartonin shënimet. Kemi besim se ky botim i parë anglisht i autorizuar i Kitáb-i-Aqdas it do t'u japë mundësi lexuesve të tij të fitojnë të paktën një ide për madhësitë e Librit Mëmë të Dispensacionit Bahá'í.

Bota jonë ka hyrë në zemrën e errët të një epoke ndryshimesh rrënjësore, që shkojnë tej çdo gjëje që ajo ka përjetuar gjatë historisë së saj të trazuar. Popujt e saj, të çdo race, kombi a feje qofshin, ndodhen përballë sfidës që t'ia nënshtrojnë të gjitha besnikëritë më të vogla dhe njëjtësitë kufizuese njëshmërisë së tyre si qytetarë të një atdheu të vetëm planetar. Siç ka thënë Bahá'u'lláh u: *“mirëqenia e njerëzimit, paqja dhe siguria e tij nuk mund të arriben, sakobë e derisa uniteti i tij të mos jetë vendosur në mënyrë të qëndrueshme”*. Dhëntë botimi i këtij përkthimi të Kitáb-i-Aqdas it një shtytje të re për përmbushjen e këtij vizioni universal, që hap horizonte për një ripërtëritje mbarëbotërore.

SHTËPIA UNIVERSALE E DREJTËSISË

NJË PËRSHKRIM I KITÁB-I-AQDAS IT NGA SHOGHI EFFENDI U

MARRË NGA *PERËNDIA KALON PRANË*,
HISTORIA E TIJ E SHEKULLIT TË PARË BAHÁ'Í

SADO i pashoq e i mahnitshëm që ky Proklamim, u provua se ai s'ishte veçse preludi i një revelacioni edhe më të fuqishëm të forcës krijuese të Autorit të Tij dhe i asaj që mund të renditet si vepra më e shquar e misionit të Tij – i shpalljes së Kitáb-i-Aqdas it. I lënë të nënkuptohet në Kitáb-i-Íqán, bartësin kryesor të atij Ligji, të cilin Profeti Isaia e kishte parashikuar dhe që autori i Apokalipsit e pati cilësuar si “*qielli i ri*” dhe “*toka e re*”, si “*faltorja e Perëndisë*”, si “*Qyteti i Shenjtë*”, si “*Nusja*”, “*Jerusalemi i Ri i zbritur nga Perëndia*”, ky “*Libër Më i Shenjtë*”, porosinë e të cilit duhet të mbeten të paprekura për jo më pak se një mijë vjet dhe sistemi i të cilit do të përfshijë mbarë planetin, mund të shihet si rrezatimi më i ndritshëm i mendjes së Bahá'u'lláh ut, si Libri Mëmë i Dispensacionit të Tij dhe si Karta e Rendit të Ri Botëror të Tij.

I reveluar pak kohë pasi Bahá'u'lláh u ishte transferuar në shtëpinë e 'Údí Khammár-it (rreth vitit 1873), në një periudhë kur Ai ishte ende i rrethuar nga mundimet që i ishin shkaktuar prej veprimeve të armiqve të Tij dhe të të ashtuquajturve pasues të Besimit të Tij, ky Libër, ky thesar që përmban margaritarët e paçmuar të Revelacionit të Tij, falë parimeve që ngulit, institucioneve administrative që vendos dhe funksionit që i vesh Pasardhësit të caktuar të Autorit të Tij, spikat si i pashoq e i pakrahasueshëm midis Shkrimeve të shenjta të botës. Sepse, ndryshe nga Dhiata e Vjetër dhe nga Librat e Shenjtë që i kanë

paraprirë, në të cilat mungojnë porositë e vërteta të folura nga Vetë Profeti; ndryshe nga Ungjijt, në të cilët ato pak thënie që i atribuohen Jesu Krishtit nuk japin një drejtim të qartë lidhur me qeverisjen e ardhshme të punëve të Besimit të Tij; ndryshe madje edhe nga Kurani, i cili, edhe pse i qartë përsa u përket ligjeve e porosive të formuluar nga Apostulli i Perëndisë, hesht për çështjen tepër të rëndësishme të trashëgimisë, Kitáb-i-Aqdas i, i rrethuar fund e krye nga Vetë Autori i Dispensacionit, jo vetëm ruan për brezat e mëvonshëm ligjet e porositë bazë mbi të cilat duhet të mbështetet struktura e Rendit Botëror të ardhshëm të Tij, por edhe vendos, veç funksionit të interpretimit që ia ngarkon Pasardhësit të Tij, institucionet e nevojshme, vetëm përmes të të cilave mund të ruhen paprekshmëria dhe uniteti i Besimit të Tij.

Në këtë Kartë të qytetërimit të ardhshëm botëror, Autori i Tij – në të njëjtën kohë Gjykatësi, Ligjvënësi, Bashkuesi e Shëlbuesi i njerëzimit – u njofton mbretërve të tokës shpalljen e *“Ligjit Më të Madh”*; u thotë atyre se ata janë vasalë të Tij; e shpall Vetën *“Mbret të Mbretërve”*; mohon çdo synim për të vënë dorë mbi mbretëritë e tyre; i rezervon Vetes të drejtën për të *“pushtuar e zotëruar zemrat e njerëzve”*; paralajmëron prijësit kishtarë të botës të mos e gjykojnë *“Librin e Perëndisë”* sipas kriterëve të zakonshme ndër ta; dhe pohon se vetë Libri është *“Peshorja e pagabueshme”* e vendosur midis njerëzve. Në të Ai urdhëron shprehimisht krijimin e *“Shtëpisë së Drejtësisë”*, përcakton funksionet e saj, fikson të ardhurat e saj dhe i cilëson anëtarët e saj si *“Njerëzit e Drejtësisë”*, *“të Dërguarit e Perëndisë”*, *“të Besuarit e Mëshirëplotit”*; bën aluzion për Qendrën e ardhshme të Besëlidhjes së Tij dhe i ngarkon Atij të drejtën e interpretimit të Shkrimeve të Shenjta të Tij; parashikon në një mënyrë që vetëkuptohe krijimin e Ruajtësisë; vërteton efektin revolucionarizues të Rendit Botëror të Tij; shpall doktrinën e *“Pagabueshmërisë Më të Madhe”* të Manifestimit të Perëndisë; pohon se kjo pagabueshmëri është e drejta e natyrishtme vetëm e Profetit; dhe përjashton mundësinë e

shfaqjes së një Manifestimi tjetër para se të kenë kaluar të paktën një mijë vjet.

Në këtë Libër Ai, për më tepër, urdhëron lutjet e detyrueshme; cakton kohën dhe periudhën e agjërimit; ndalon lutjen kolektive, me përjashtim të lutjes për të vdekurit; përcakton Qiblenë krijon *Huqúqu'lláh un* (të Drejtën e Perëndisë); formulon ligjin e trashëgimisë; urdhëron ngritjen e *Mashriqu'l-Adhkar* it; vendos Festën e Nëntëmbëdhjetë Ditëve, festat Bahá'í dhe Ditët e Shtuara; anulon institucionin e priftërisë; ndalon skllavërinë, asketizmin, lypësinë, murgërinë, rrëfimin, përdorimin e amvonave dhe puthjen e dorës; urdhëron monogaminë; dënon sjelljen e pashpirt ndaj kafshëve, përtacinë e plogështinë, përgojimin e shpifjen; qorton shkurorëzimin; ndalon kumarin, përdorimin e opiumit, të verës dhe të pijeve të tjera dehëse; përcakton dënimet për vrasje, zjarrvënie, marrëdhënie intime jashtë kurore e vjedhje; thekson rëndësinë e martesës dhe dikton kushtet thelbësore të saj; urdhëron detyrimin për t'u marrë me ndonjë tregti ose zeje dhe e ngre një punë të tillë në rangun e adhurimit; nënvizon nevojën e sigurimit të mjeteve për arsimimin e fëmijëve; dhe i ngarkon çdo personi detyrën që të shkruajë një testament dhe t'i bindet rreptësisht qeverisë së vet.

Veç këtyre porosive, Bahá'u'lláh u i këshillon pasuesit e vet të shoqërohen, miqësisht e pa diskriminime, me ithtarët e të gjitha feve; i paralajmëron ata të ruhen nga fanatizmi, rebelimi, krenaria, grindjet e kundërvëniet; ngulit në ta pastërti të papërlyer, vërtetësi të plotë, dëlirësi të panjollë, besueshmëri, mikpritje, besnikëri, mirësjellje, vetëpërmbajtje, drejtësi e ndershmëri; i këshillon ata të jenë *“si gishtërinjtë e një dore dhe gjymtyrët e një trupi”*; i fton të ngrihen e të vihen në shërbim të Kauzës së Tij; dhe i siguron për ndihmën e Tij të padyshimtë. Ai ndalet më tej me hollësi rreth paqëndrueshmërisë së punëve njerëzore; deklaron se liria e vërtetë qëndron në nënshtrimin e njeriut ndaj porosive të Tij; i paralajmëron ata të mos bëjnë lëshime në zbatimin e ligjeve të Tij; shtron detyrat e pandashme

binjake të njohjes së *“Agimit të Revelacionit të Perëndisë”* dhe të zbatimit të të gjitha porosive të reveluara prej Tij, asnjëra prej të cilave, thotë Ai, nuk është e pranueshme pa tjetrën.

Thirrjet domethënëse që u drejtohen presidentëve të republikave të kontinentit amerikan që të shfrytëzojnë rastin në Ditën e Perëndisë për të mbështetur çështjen e drejtësisë; porosia dhënë anëtarëve të parlamenteve anembanë botës, duke i nxitur të adoptojnë një shkrim e një gjuhë universale; paralajmërimet e Tij bërë Wilhelm it I, ngadhënjimtarit mbi Napoleon in III; qortimi që Ai i bën Franc Jozef it, Perandorit të Austrisë; referimi i Tij *“vajtimeve të Berlinit”* në apostrofën e Tij *“brigjeve të Rinit”*; dënimi prej Tij i *“fronit të tiranisë”* të vendosur në Konstantinopojë dhe parashikimi i Tij për shuarjen e *“shkëlqimit të jashtëm”* të saj dhe për fatkeqësitë e paracaktuara t’u bien mbi kokë banorëve të saj; fjalët e inkurajimit e të ngushëllimit që Ai i drejton qytetit të Tij të lindjes, duke e siguruar se Perëndia e ka zgjedhur të jetë *“burim gëzimi për mbarë njerëzimin”*; profecia e Tij se *“zëri i heronjve të Kburásán-it”* do të ngrihet për t’i thurur lavdi Zotit të tyre; pohimi i Tij se njerëz *“të pajisur me guxim të fuqishëm”* do të ngrihen në Kirmán dhe do ta përmendin Atë; dhe më në fund sigurimi i Tij zemërgjerë dhënë një vëllai të pabesë që i kishte shkaktuar Atij një ankth të madh, se Perëndia *“gjithmonëfalës, bujariplotë”* do t’ia falte atij poshtërsitë mjafton që ai të pendohej – të gjitha këto pasurojnë përmbajtjen e një Libri të cilësuar nga Autori i tij si *“gurra e lumturisë së vërtetë”*, si *“Peshorja e Pagabueshme”*, si *“Shtegu i Drejtë”* dhe si *“gjallëruesi i njerëzimit”*.

Ligjet e porositë që përbëjnë temën kryesore të këtij Libri, Bahá’u’lláh u i ka karakterizuar, veç kësaj, si *“frymë të jetës në të gjitha gjërat e krijuara”*, si *“kështjellën më të fuqishme”*, si *“frytet”* e *“Pemës”* së Tij, si *“mjetet supreme për ruajtjen e rendit në botë dhe për sigurinë e popujve të saj”*, si *“llambën e urtisë e të dashamirësisë së Tij”*, si *“aromën e këndshme të rrobës së Tij”* dhe si *“çelësat”* e *“mëshirës”* së Tij për krijesat e Veta. *“Ky Libër”*, dëshmon Ai Vetë, *“është një qiell që Ne e kemi stolisur me yjet e porosive e të ndalimeve Tona”*. *“Lum njeriu”*,

thotë veç kësaj Ai, “që do ta lexojë atë dhe do t’i peshojë vargjet që ka dërguar në të Perëndia, Zoti i Forcës, Fuqiploti. Thoni, o njerëz! Mbahuni pas tij me dorën e nënshtimit ... Për jetën Time! Ai ju është dërguar në një mënyrë që i habit mendjet e njerëzve. Me të vërtetë, ai është dëshmia Ime më me peshë për të gjithë njerëzit dhe prova e Mëshirëplotit për të gjithë ata që janë në qiell e ata që janë mbi tokë”. Dhe më tej: “Lum qiellëza që shijon ëmbëlsinë e tij, dhe syri depërtues që nje thesarin e fshehur aty, dhe zemra e pajisur me gjykim që i kap nënkuptimet e misteret e tij. Për Perëndi! Kaq e madhërishtme është ajo që reuelohet në të dhe kaq i fuqishëm reuelimi i nënkuptimeve të fshehura, saqë kryqet e fjalës lëkunden kur përpigën t’i përshkruejnë”. Dhe më në fund: “Kitáb-i-Aqdas i është reueluar në mënyrë të tillë, që tërbeq e përfshin të gjitha Dispensacionet hyjnisht të urdhëruara. Lum ata që e lexojnë atë me vëmendje! Lum ata që e kuptojnë atë! Lum ata që përsiatin mbi të! Lum ata që e peshojnë domethënien e tij! Kaq i gjerë është kufiri i tij, saqë ka përfshirë të gjithë njerëzit para se ata ta dinë këtë. Së shpejti pushteti i tij sovran, ndikimi i tij depërtues dhe madhështia e fuqisë së tij do të shfaqen mbi tokë”.

KITÁB-I-AQDAS

NË EMËR TË ATIJ
QË ËSHTË SUNDUESI SUPREM
MBI ÇDO GJË QË KA QENË
DHE MBI ÇDO GJË QË DO TË JETË

DETYRA E PARË që Perëndia u ka caktuar 1
shërbëtorëve të Vet është të njohin Atë Që është
Agimi i Revelacionit të Tij dhe Gurra e ligjeve të Tij, që
përfaqëson Hyjninë si në Mbretërinë e Kauzës së Tij
dhe në botën e krijimit. Kushdo që e kryen këtë detyrë
ka arritur gjithë të mirat; dhe kushdo që është i privuar
nga kjo ka humbur rrugën, edhe sikur të ketë kryer
veprat më të denja. Është detyrë e cilitdo që arrin këtë
pozitë kaq sublime, këtë majë lavdie të përkryer, të
zbatojë çdo porosi të Atij Që është Dëshira e botës.
Këto detyra binjake janë të pandara. Asnjëra nuk është e
pranueshme pa tjetrën. Kështu ka dekretuar Ai Që është
Burimi i frymëzimit Hyjnor.

Ata që Perëndia i ka pajisur me intuitë do ta 2
pranojnë me lehtësi se porositë e dhëna nga Perëndia
përbëjnë mjetet supreme për ruajtjen e rendit në botë
dhe për sigurinë e popujve të saj. Ai që u kthen shpinën
atyre është mjeran e i marrë. Me të vërtetë, Ne ju kemi
urdhëruar të flakni diktatin e pasioneve të liga e të
dëshirave të mbrapshta dhe të mos i kapërceni caqet që
Penda e Më të Lartit ka caktuar, sepse ato janë fryma e
jetës për të gjitha gjërat e krijuara. Detet e urtisë Hyjnore

e të fjalës Hyjnore janë fryrë nga flladi i Mëshirëplotit. Nxitoni të pini plot kupën, o njerëz me mend! Ata që kanë shkelur Besëlidhjen e Perëndisë, duke dhunuar porositë e Tij, dhe janë kthyer mprapsht, kanë gabuar rëndë në sytë e Perëndisë, Gjithëzotëruesit, Më të Lartit.

3 O ju popuj të botës! Dijeni me siguri se porositë e Mia janë llambat e provanisë Sime dashamirëse midis shërbëtorëve të Mi dhe çelësat e mëshirës Sime për krijesat e Mia. Kjo është dërguar nga qielli i Vullnetit të Zotit tuaj, Zotit të Revelacionit. Sikur ndokush të shijonte ëmbëlsinë e fjalëve që buzët e Mëshirëplotit kanë dashur të shqiptojnë, ai, edhe po të zotëronte të gjitha thesaret e tokës, do të hiqte dorë nga të gjitha këto për të provuar vërtetësinë qoftë edhe të njërës prej porosive të Tij, që shkëlqejnë mbi Agimet e kujdesit bujar e të dashamirësisë së Tij.

4 Thuaj: Nga ligjet e Mia nuhatet aroma e këndshme e rrobës Sime dhe me ndihmën e tyre flamujt e fitores do të ngulen në majat më të larta. Gjuha e pushtetit Tim i ka drejtuar nga qielli i lavdisë Sime fuqiptotë krijimit Tim këto fjalë: “Zbato porositë e Mia, për hir të bukurisë Sime”. Lum dashuruesi që ka thithur aromën hyjnore të të Shumëdashurit të tij prej këtyre fjalëve të mbushura me kundërmimin e një mirësie që asnjë gjuhë s’e përshkruan dot. Për jetën Time! Ai që ka pirë verën e zgjedhur të drejtësisë nga duart e mirëdashjes Sime bujare, do të sillte rreth porosive të Mia, që shkëlqejnë përmbi Agimin e krijimit Tim.

Mos mendoni se Ne ju kemi reveluar thjesht një kod ligjesh. Jo, madje me gishtat e fuqisë e të pushtetit,

Ne kemi hapur Verën e zgjedhur. Për këtë dëshmon ajo që ka reveluar Penda e Revelacionit. Përsiateni këtë, o njerëz me intuitë!

Ne ju kemi urdhëruar lutjen e detyrueshme, me nëntë rak‘ah ë, që i duhet drejtuar Perëndisë, Reveluesit të Vargjeve, në mesditë, në mëngjes e në mbrëmje. Ne ju kemi liruar nga një numër më i madh, si një porosi në Librin e Perëndisë. Ai, me të vërtetë, është Urdhëruesi, i Gjithëfuqishmi, i Papërmbajtshmi. Kur doni të thoni këtë lutje, kthejeni fytyrën ndaj Oborrit të Pranisë Sime Më të Shenjtë, këtij Vendi të Shenjtëruar që Perëndia e ka bërë Qendrën rreth së cilës sillen Tubimi Qiellor e që Ai e ka caktuar të jetë Pika e Adhurimit për banorët e Qyteteve të Përjetësisë dhe Burimi i Urdhërave për të gjithë ata që janë në qiell e mbi tokë; dhe kur Dielli i së Vërtetës e i Fjalës të ketë perënduar, kthejeni fytyrën ndaj Vendit që ju kemi urdhëruar. Ai, me të vërtetë, është Fuqiplotë e i Gjithëdijshëm.

Çdo gjë që ekziston ka ardhur në jetë përmes urdhërit të Tij të pakundërshtueshëm. Sa herë që ligjet e Mia dalin si dielli në qiellin e thënieve të Mia, ato duhet të zbatohen besnikërisht nga të gjithë, edhe në qoftë urdhëri Im i tillë që të çajë më dysh qiellin e çdo feje. Ai bën ç’i pëlqen. Ai zgjedh, dhe askush nuk mund ta vërë në pikëpyetje zgjedhjen e Tij. Çdo gjë që Ai, i Shumëdashuri, urdhëron, vetë kjo gjë është, me të vërtetë, e shumëdashur. Për këtë Më është dëshmitar Ai që është Zoti i çdo krijimi. Kushdo që ka nuhatur aromën e këndshme të Mëshirëplotit dhe ka njohur Burimin e kësaj thënieje, do t’i mirëpresë me vetë sytë e tij shigjetat e armikut, për të përhapur të vërtetën e ligjeve të

Perëndisë midis njerëzve. Lum ai që është kthyer ndaj tyre dhe e ka kuptuar domethënien e urdhërit të Tij vendimtar.

I kemi shtjelluar hollësitë e lutjes së detyrueshme në një Tabelë tjetër. Lum kush vë re atë që i është urdhëruar prej Atij Që sundon mbi gjithë njerëzimin. Në Lutjen për të Vdekurit ju janë dërguar gjasthtë pasazhe të posaçme nga Perëndia, Reveluesi i Vargjeve. Kush është në gjendje të lexojë, le të recitojë atë që është reveluar për t'u paraprirë këtyre pasazheve; ndërsa atë që nuk është në gjendje, Perëndia e ka liruar nga kjo kërkesë. Ai, me të vërtetë, është i Fuqishmi, Falësi.

Flokët (qimet) nuk e shvleftësojnë lutjen tuaj, as ndonjë gjë tjetër nga e cila shpirti është larguar, siç janë kockat e të tjera si këto. Jeni të lirë të mbani lëkurë kunadheje, si dhe kastori, ketri ose kafshësh të tjera; ndalimi i përdorimit të tyre nuk rrjedh nga Kurani, por nga keqkuptimet e teologëve. Ai, me të vërtetë, është Lavdiploti, i Gjithëdijshmi.

Ju kemi porositur të luteni e të agjëroni që kur fillon moshja e pjekurisë; këtë e ka urdhëruar Perëndia, Zoti juaj dhe Zoti i stërgjyshërve tuaj. Ai ka përjashtuar nga kjo ata që janë të dobët për shkak sëmundjeje ose moshe, në shenjë bujarie të Pranisë së Tij, dhe Ai është Falësi, Fisniku. Perëndia ju ka lejuar të përkuleni deri në tokë mbi çdo sipërfaqe të pastër, sepse Ne kemi hequr lidhur me këtë kufizimet e shënuara në Librin; Perëndia, me të vërtetë, është në dijeni të gjërave për të cilat ju nuk dini asgjë. Kush nuk gjen ujë për të marrë avdes, le të përsërisë pesë herë fjalët “Në emër të Perëndisë, Më

LIBRI MË I SHËNJTË

të Dëlirit, Më të Dëlirit” dhe pastaj të bëjë lutjen. Ky është urdhëri i Zotit të të gjitha botëve. Në rajone ku dita dhe nata zgjaten, le të maten kohët e lutjes me sahatë e me mjete të tjera që tregojnë kalimin e orëve. Ai është, me të vërtetë, Shpjeguesi, i Urti.

Ne ju kemi liruar nga kërkesa e kryerjes së Lutjes së Shenjave. Kur shfaqen ngjarje natyrore të frikshme, sillni ndërmend fuqinë e madhështinë e Zotit tuaj, të Atij Që dëgjon e sheh çdo gjë, dhe thoni “Sundimi i përket Perëndisë, Zotit të së dukshmes e të së padukshmes, Zotit të krijimit”.

Është urdhëruar që lutja e detyrueshme të kryhet nga secili prej jush individualisht. Me përjashtim të Lutjes për të Vdekurit, praktika e lutjes kolektive është hequr. Ai, me të vërtetë, është Urdhëruesi, Urtiploti.

Perëndia i ka përjashtuar nga lutja e detyrueshme dhe agjërimi gratë që janë me zakonet e përmuajshme. Në vend të kësaj, ato, pasi marrin avdes, le të lavdërojnë Perëndinë, duke përsëritur nëntëdhjetë e pesë herë nga mesdita deri të nesërmen në mesditë fjalët “Lëvduar qoftë Perëndia, Zoti i Shkëlqimit e i Bukurisë”. Kështu është dekretuar në Librin, në qofshi ndër ata që kuptojnë.

Kur jeni në udhëtim, në qoftë se ndaleni e pushoni në ndonjë vend të sigurt, bëni – gra e burra njëloj – një përkulje deri në tokë në vend të çdo Lutjeje të Detyrueshme të pathënë, dhe ndërsa përkuleni thoni “Lëvduar qoftë Perëndia, Zoti i Fuqisë e i Madhësisë, i Mirëdashjes e i Bujarisë”. Kush nuk është në gjendje ta bëjë këtë, le të thotë vetëm “Lëvduar qoftë Perëndia”;

kjo me siguri do të jetë e mjaftueshme për të. Ai është, me të vërtetë, Perëndia i gjithëmjaftueshëm, i përherë-pranishëm, falës, zemërdhembshur. Pasi t'i plotësoni përkuljet, uluni këmbëkryq – burra e gra njëloj – dhe përsëritni tetëmbëdhjetë herë “Lëvduar qoftë Perëndia, Zoti i mbretërive të tokës e të qiellit”. Kështu Zoti i sheshon rrugët e së vërtetës e të udhërrëfimit, rrugë që çojnë në një rrugë të vetme, që është Shtegu i Drejtë. Falënderoni Perëndinë për këtë mirësi kaq të hirshme; lavdërojeni Atë për këtë bujari që ka përfshirë qiejt dhe tokën; ngrijini lavde Atij për këtë mëshirë që ka përshkuar gjithë krijimin.

Thuj: Perëndia e ka bërë dashurinë Time të fshehur çelësin e Thesarit; sikur të mund ta shquanit këtë! Po të mos ishte çelësi, Thesari do të mbetej përjetë i fshehur; sikur të mund ta besonit këtë! Thuj: Ky është Burimi i Revelacionit, Vendagimi i Shkëlqimit, vezullimi i të Cilit ka ndriçuar horizontet e botës. Sikur të mund ta kuptonit këtë! Ky është, me të vërtetë, Dekreti i paracaktuar, përmes të cilit çdo dekret i pakundërshtueshëm është vendosur.

O Pendë e Më të Lartit! Thuj: O popuj të botës! Ne jua kemi bërë të detyrueshëm agjërimin për një periudhë të shkurtër dhe në përfundim të tij ju kemi caktuar Novruzin si festë. Kështu ka ndriçuar Dielli i Fjalës mbi horizontin e Librit, siç e ka dekretuar Ai Që është Zoti i fillimit e i fundit. Le të vendosen ditët e tepërta të muajve para muajit të agjërimit. Ne kemi urdhëruar që këto, midis të gjitha netëve e ditëve, të jenë manifestimet e shkronjës Há, dhe kështu ato nuk do të jenë të kufizuara brenda caqeve të vitit e të muajve të tij.

LIBRI MË I SHËNJTË

U ka hije njerëzve të Bahá-it që, gjatë gjithë këtyre ditëve, të gostiten mirë bashkë me të afërmit e vet dhe, veç tyre, të gostisin të varfërit e nevojtarët, dhe me gëzim e hare të përshëndesin e lëvdojnë Zotin e tyre, t'i këndojnë lavde e të madhërojnë Emrin e Tij; dhe kur të përfundojnë – ditët e dhurimit që i paraprijnë periudhës së kufizimit – le të hyjnë në Agjërim. Kështu ka urdhëruar Ai Që është Zoti i gjithë njerëzimit. Udhëtarët, të sëmuret, gratë shtatzëna ose me foshnje gjiri, nuk e kanë të detyrueshëm Agjërimin; ata janë përjashtuar nga Perëndia, si shenjë e mirësisë së Tij. Ai, me të vërtetë, është Fuqiploti, Më Fisniku.

Këto janë porositë e Perëndisë, që janë shkruar në Librat e Tabelat nga Penda e Tij Më e Lartësuar. Përmbajuni fort ligjeve e porosive të Tij dhe mos jini ndër ata që, duke rendur pas fantazive të padobishme e imagjinatave të tyre të kota, janë kapur pas kriterëve të caktuara prej atyre vetë dhe kanë hedhur pas kurrizit kriteret e hartuara nga Perëndia. Përmbahuni nga ushqimi e të pirët që nga lindja deri në perëndim të diellit, dhe kini mendjen që dëshira të mos ju privojë nga mirësia e përcaktuar në Librin.

Është urdhëruar që çdo besimtar në Perëndinë, Zotin e Gjykimit, duhet çdo ditë, pasi të ketë larë duart e pastaj fytyrën, të ulet dhe, duke iu drejtuar Perëndisë, të përsërisë nëntëdhjetë e pesë herë “Alláh-u-Abhá”. I tillë ishte urdhëri i Artuesit të Qiejve kur, me madhështi e fuqi, Ai u vendos në fronet e Emrave të Tij. Merrni edhe ju avdes për Lutjen e Detyrueshme; ky është urdhëri i Perëndisë, të Pakrahasueshmit, të Papërmbajtshmit.

Ju është ndaluar të kryeni vrasje ose marrëdhënie intime jashtë kurore, ose të merreni me përgojim ose shpifje; shmangeni, pra, atë që është e ndaluar në Librat e Tabelat e shenjta.

Ne e kemi ndarë trashëgiminë në shtatë kategori: fëmijëve u kemi caktuar nëntë pjesë me pesëqind e dyzet njësi; bashkëshortes tetë pjesë me katërqind e tetëdhjetë njësi; babait shtatë pjesë me katërqind e njëzet njësi; nënës gjashtë pjesë me treqind e gjashtëdhjetë njësi; vëllezërve pesë pjesë ose treqind njësi; motrave katër pjesë ose dyqind e dyzet njësi; dhe mësuesve tre pjesë ose njëqind e tetëdhjetë njësi. Kjo ishte porosia e pararendësit Tim, e Atij Që lartësoi Emrin Tim në errësirën e natës e në agim të ditës. Kur dëgjuam britmën e fëmijëve ende të palindur, Ne e dyfishuam pjesën e tyre dhe e pakësuam atë të të tjerëve. Ai, me të vërtetë, ka pushtet të urdhërojë çdo gjë që dëshiron dhe bën atë që i pëlqen, falë fuqisë së Tij sovrane.

Po qe se i ndjeri nuk lë fëmijë, pjesa që do t'u takonte atyre i kalon Shtëpisë së Drejtësisë, që të shpenzohet nga të Besuarit e Mëshirëplotit për jetimët e të vejat dhe për çdo gjë që u sjell dobi të gjithë njerëzve, në mënyrë që të gjithë të falënderojnë Zotin e tyre, të Gjithëmëshirshmin, Falësin.

Po qe se i ndjeri lë fëmijë, por nuk lë asnjë nga të kategorive të tjera të trashëgimtarëve që janë përcaktuar në Librin, ata (fëmijët) do të marrin dy të tretat e trashëgimit, ndërsa një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë. E tillë është porosia e dhënë, me

LIBRI MË I SHËNJTË

madhështi e lavdi, nga Ai Që është Gjithëzotëruesi, Më i Larti.

Në rast se i ndjeri nuk lë trashëgimtarë nga ata që janë përcaktuar, por ka midis farefisit nipa e mbesa, qoftë nga ana e vëllezërve ose e motrave të tij, dy të tretat e trashëgimit u kalojnë atyre; ose, në mungesë të tyre, ungjërve e tetove si nga ana e babait dhe e nënës së tij dhe pas tyre djemve e vajzave të tyre. Një e treta e trashëgimit që mbetet i kalon, në çdo rast, Selisë së Drejtësisë. Kështu është shkruar në Librin nga Ai Që sundon mbi të gjithë njerëzit.

Në rast se pas të ndjerit nuk jeton asnjë prej atyre që janë regjistruar nga Penda e Më të Lartit, gjithë malli i tij i kalon Selisë së lartpërmendur, që të shpenzohet për atë që ka porositur Perëndia. Ai, me të vërtetë, është Urdhëruesi, i Gjithëfuqishmi.

Ne ua kemi caktuar banesën dhe rrobat personale të të ndjerit trashëgimtarëve meshkuj, e jo femra, dhe as trashëgimtarëve të tjerë. Ai, me të vërtetë, është Dorëhapuri, Bujariploti.

Në rast se i biri i të ndjerit ka ndërruar jetë gjatë kohës që i ati jetonte dhe ka lënë fëmijë, ata trashëgojnë pjesën e atit të tyre, siç përshkruhet në Librin e Perëndisë. Ndajeni me drejtësi të plotë midis tyre pjesën që u takon. Kështu janë ngritur valët e Oqeanit të Fjalës, duke nxjerrë në breg margaritarët e ligjeve të dekretuara nga Zoti i gjithë njerëzimit.

Në qoftë se i ndjeri lë fëmijë që janë të mitur, pjesa e tyre e trashëgimit duhet t'i lihet në kujdestari një personi të besueshëm, ose një shoqërie, që të investohet

në emër të tyre në tregti ose veprimtari të tjera, derisa ata të arrijnë moshën e pjekur. Kujdestarit i duhet caktuar një pjesë e fitimit të shtuar si rezultat i këtij përdorimi.

Ndarja e pronës duhet bërë vetëm pasi të jetë paguar *Huqúqu'lláh-u*, të jenë rregulluar borxhet, të jenë paguar shpenzimet e funeralit e të varrimit dhe të jenë marrë masat që i ndjeri të çohet në vendprehjen e tij me dinjitet e nder. Kështu ka porositur Ai Që është Zoti i fillimit e i fundit.

Thuaj: Kjo është ajo dije e fshehur e cila kurrë nuk do të ndryshojë, sepse fillon me nëntën, simbolin që nënkupton të fshehurën e të dukshmen, Emrin e lartësuar të pacënueshëm e të paarritshëm. Përsa i takon asaj që Ne u kemi caktuar fëmijëve, kjo është një dhuratë bujare që u është dhënë atyre nga Perëndia, që ata të falënderojnë Zotin e tyre, Zemërdhembshurin, të Mëshirshmin. Këto janë, me të vërtetë, Ligjet e Perëndisë; mos i shkelni ato nga tundimi i dëshirave tuaja të ulëta e egoiste. Zbatoni urdhërat që ju ka ngarkuar Ai Që është Vendagimi i Fjalës. Të sinqertët ndër shërbëtorët e Tij do t'i shohin porositë e shtjelluara nga Perëndia si Ujin e Jetës për pasuesit e çdo feje dhe si Llambën e urtisë e të provanisë dashamirëse për të gjithë banorët e tokës e të qiellit.

Zoti ka urdhëruar që në çdo qytet të ngrihet një Shtëpi e Drejtësisë, ku të mblidhen këshilltarë sipas numrit të Bahá-it, dhe në qoftë se ky numër kapërcehet kjo nuk ka rëndësi. Ata duhet ta konsiderojnë veten sikur hyjnë në Oborrin e pranisë së Perëndisë, të

LIBRI MË I SHËNJTË

Lartësuarit, Më të Lartit, dhe shohin Atë Që është i Padukshmi. Ata duhet të jenë të besuarit e të Mëshirshmit midis njerëzve dhe ta shohin veten e tyre si ruajtësit e caktuar nga Perëndia për të gjithë ata që banojnë mbi tokë. Atyre u takon të këshillohen së bashku dhe të kujdesen për interesat e shërbëtorëve të Perëndisë, për hir të Tij, ashtu siç kujdesen për interesat e veta, dhe të zgjedhin atë që është e përshtatshme dhe e hijshme. Kështu ju ka urdhëruar Zoti Perëndia juaj. Kini mendjen të mos lini pasdore atë që është zbuluar qartë në Tabelën e Tij. Druajuni Perëndisë, o ju që kuptoni.

O njerëz të botës! Ndërtoni shtëpi adhurimi në të gjitha tokat në emër të Atij Që është Zoti i të gjitha feve. I bëni ato sa më të përkryera në botën e qenies dhe stolisini me atë që u përshtatet, e jo me figura e shëmbëlltyra. Pastaj, me ngazëllim e gëzim, i thurni në to lavde Zotit tuaj, Më Zemërdhembshurit. Me të vërtetë, duke kujtuar Atë, syri gëzohet dhe zemra mbushet me dritë.

Zoti ka porositur që ata ndër ju që janë në gjendje le të bëjnë haxhillëk në Shtëpinë e Shenjtë, dhe nga kjo ka përjashtuar gratë si shenjë mëshire nga ana e Tij. Ai, me të vërtetë, është Bujariploti, Më Fisniku.

O njerëz të Bahá-it! Është e detyrueshme që secili prej jush të merret me ndonjë punë, si me ndonjë zeje, me tregti ose me diçka të ngjashme. Ne e kemi lartësuar angazhimin tuaj në punë të tilla në rangun e adhurimit të të vetmit Perëndi të vërtetë. Mendoni, o njerëz, për hirin e bekimet e Zotit tuaj dhe falënderojeni Atë nga mbrëmja në mëngjes. Mos e humbni kohën në përtaci e

ngathtësi, por merruni me atë që do t'ju sjellë përfitim juve dhe të tjerëve. Kështu është dekretuar në këtë Tabelë, nga horizonti i së cilës ka ndriçuar dielli i urtisë e i fjalës. Më të përçmuarit ndër njerëzit në sytë e Perëndisë janë ata që rrinë e lypin. Mbahuni fort pas litarit të mjeteve të jetesës dhe mbështeteni besimin te Perëndia, Dhuruesi i të gjitha mjeteve.

Puthja e dorës është e ndaluar në Librin. Ky zakon është ndaluar nga Perëndia, Zoti i lavdisë e i urdhërit. Askujt nuk i lejohet të kërkojë falje të mëkateve nga një shpirt tjetër; le të jetë pendesa midis vetë jush dhe Perëndisë. Ai, me të vërtetë, është Falësi, Bujari, Mëshiruesi, Ai Që fal të penduarin.

O ju shërbëtorë të të Mëshirshmit! Ngrihuni për t'i shërbyer Kauzës së Perëndisë, që hallet e hidhërimet e shkaktuara prej atyre që nuk kanë besuar në Agimin e Shenjave të Perëndisë të mos ju brengosin. Në kohën që Premtimi u përmbush dhe i Premtuari u shfaq, midis fiseve të botës u dukën dallime dhe çdo popull ndoqi fantazinë e imagjinatat e veta të kota.

Midis njerëzve është ai që ulet midis sandaleve te dera, ndërsa në zemër fsheh zilinë për vendin e nderit. Thuaj: Ç'loj njeriu je ti, o shpirt i kotë e i shkujdesur, që kërkon të dukesh ndryshe nga ç'je? Dhe midis njerëzve është ai që pretendon për dije të brendshme dhe për një njohuri akoma më të thellë të fshehur brenda kësaj dije. Thuaj: Ti thua të rremen! Për Perëndi! Ajo që zotëron ti s'është veçse byk që Ne të kemi lënë siç u lihen kockat qenve. Për drejtësinë e të vetmit Perëndi të vërtetë! Sikur ndonjëri t'i lante këmbët gjithë njerëzimit, dhe

LIBRI MË I SHËNJTË

sikur ai të adhuronte Perëndinë në pyje, lugina e male, mbi kodra të pjerrëta e në maja të larta, sikur të mos mbetej shkëmb ose dru, asnjë plis dheu që të mos ishte dëshmitar i adhurimit të tij – megjithatë, sikur prej tij të mos përhapej aroma e pëlqimit Tim, mundimet e tij kurrë nuk do të ishin të pranueshme nga Perëndia. Kështu është dekretuar nga Ai Që është Zoti i të gjithëve. Sa njerëz e kanë mbyllur veten në klimat e Indisë, i kanë mohuar vetes gjërat që Perëndia i ka dekretuar si të ligjshme, i kanë imponuar vetes një regjim të rreptë e mundime trupore, por nuk janë kujtuar nga Perëndia, Reveluesi i Vargjeve. Mos i bëni veprat tuaja si gracka për të kapur objektin e lakmisë suaj, dhe mos e privoni veten nga ky Objektiv Përfundimtar, të cilin e kanë dëshiruar gjithmonë me zjarr ata që janë qasur pranë Perëndisë. Thuaj: Vetë jeta e të gjitha bëmave është pëlqimi Im dhe të gjitha gjërat varen nga pranimi Im. Lexojini Tabelat, që të dini ç'qëllime ka në Librat e Perëndisë, Lavdiplotit, Gjithmonëbujarit. Ai që fiton dashurinë Time ka të drejtën për një fron të artë, ku të rrijë me nderim mbi gjithë botën; ai që është i privuar nga kjo edhe po të rrinte mbi pluhur, ky pluhur do të kërkonte strehë te Perëndia, Zoti i të gjitha Feve.

Kushdo që del me pretendimin për një Revelacion të drejtpërdrejtë nga Perëndia para se të kenë kaluar plot njëmijë vjet, një njeri i tillë është mashtrues e gënjeshtar. Ne i lutemi Perëndisë ta ndihmojë me dashamirësi atë që ta tërheqë e ta hedhë poshtë një pretendim të tillë. Po qe se pendohet, Perëndia, padyshim, do ta falë. Por po qe se ai ngul këmbë në gabimin e tij, Perëndia, me siguri,

do të dërgojë dikë që do të sillet pa mëshirë me të. I tmerrshëm, me të vërtetë, është Perëndia kur ndëshkon! Kushdo që e interpreton këtë varg ndryshe nga domethënia e tij e qartë, atij do t'i mohohet Fryma e Perëndisë dhe mëshira e Tij, që përfshin të gjitha gjërat e krijuara. Rrini në frikë të Perëndisë dhe mos shkoni pas fantazive tuaja të kota. Përkundrazi, ndiqni porosinë e Zotit tuaj, të Gjithëfuqishmit, Urtiplotit. Së shpejti zëra të bujshëm do të ngrihen në shumë vende. Shmangini ato, o njerëzit e Mi, dhe mos shkoni pas të padrejtëve e zemërligjive. Për këtë ju kemi paralajmëruar kur ishim në Irak, dhe më pas, kur ndodheshim në Tokën e Misterit, dhe tani nga ky Vend i Shndritshëm.

Mos u tronditni, o popuj të botës, kur ylli i ditës i bukurisë Sime të ketë perënduar dhe qielli i faltores Sime të jetë fshehur prej syve tuaj. Ngrihuni për të ndjekur Kauzën Time dhe për të lartësuar Fjalën Time midis njerëzve. Ne do të jemi gjithnjë me ju dhe do t'ju forcojmë me fuqinë e së vërtetës. Ne jemi me të vërtetë të plotfuqishëm. Kush më ka njohur Mua, do të ngrihet e do të Më shërbejë me vendosmëri të tillë, sa fuqitë e tokës e të qiellit nuk do të jenë në gjendje ta mposhtin qëllimin e tij.

Popujt e botës janë në gjumë të thellë. Sikur të zgjoheshin nga letargjia, ata do të nxitonin me vrull te Perëndia, i Gjithëdijshti, Urtiploti. Ata do të flaknin gjithçka zotërojnë, qofshin edhe të gjitha thesaret e tokës, që Zoti i tyre t'i kujtojë qoftë edhe duke u drejtuar atyre vetëm një fjalë. E tillë është porosia e Atij që bart dijet e gjërave të fshehura në një Tabelë, të cilën syri i krijimit nuk e ka parë dhe e cila nuk i është

LIBRI MË I SHËNJTË

reveluar askujt, veç Atij Vetë, Mbrojtësit të gjithëfuqishëm të të gjitha botëve. Kaq të hutuar janë ata në dehjen e dëshirave të tyre të mbrapshta, saqë s'janë në gjendje të njohin Zotin e të gjitha qenieve, zëri i të Cilit kumbon nga çdo drejtim: "Nuk ka tjetër Perëndi, veç Meje, të Fuqishmit, Urtiplotit".

Thuaj: Mos iu gëzoni gjërave që zotëroni; sonte ato janë tuajat, nesër do t'i kenë të tjerë. Kështu ju paralajmëron Ai që është i Gjithëdijshmi, i Gjithinformuari. Thuaj: A mund të pretendoni se ajo që zotëroni është e qëndrueshme dhe e sigurt? Jo! Për kokën Time, të Mëshirëplotit. Ditët e jetës suaj fluturojnë si fllad ere dhe gjithë salltaneti e lavdia juaj do të marrin fund ashtu siç kanë marrë fund salltaneti e lavdia e të tjerëve që kanë shkuar para jush. Vriteni mendjen, o njerëz! Ç'ka ndodhur me ditët tuaja të shkuara, me shekujt tuaj të humbur? Të lumtura kanë qenë ditët që i janë kushtuar të kujtuarit të Perëndisë dhe të bekuara orët që janë harxhuar për të lëvduar Atë Që është Urtiploti. Për jetën Time! As salltaneti i të fuqishmëve, as begatia e të pasurve, madje as sundimi i të pafeve, nuk do të zgjasin. Të gjitha do të zhduken vetëm me një fjalë të Tij. Ai, me të vërtetë, është i Gjithëfuqishmi, Gjithëdetyruesi, i Gjithëpushtetshmi. Ç'përfitim ka prej gjërave tokësore që zotërojnë njerëzit? Ata e kanë lënë krejtësisht pasdore atë që do t'u sillte përfitim. Së shpejti ata do të zgjohen nga gjumi dhe do ta gjejnë veten të pafuqishëm të fitojnë atë që kanë lënë t'u shpëtojë në ditët e Zotit të tyre, të Gjithëfuqishmit, të Shumëlëvduarit. Veç po ta dinin këtë, ata do të hiqnin dorë nga të gjitha, që emrat e tyre

të përmendeshin para fronit të Tij. Ata, me të vërtetë, duhen numëruar midis të vdekurve.

Midis njerëzve është ai që dituria i ka rritur mendjen, duke e penguar të njohë Emrin Tim, të Vetëqenëshmit; ai që kur dëgjon pas shpine hapin e sandaleve e ndien veten e tij më të madh se Nimrodi. Thuaj: O i padenjël! Ku është tani banesa e tij? Për Perëndi, në zjarrin më të thellë. Thuaj: O turmë teologësh! A nuk e dëgjoni ju zërin depërtues të Pendës Sime Më të Lartësuar? A nuk e shihni këtë Diell që ndriçon me shkëlqim vezullues mbi Horizontin Lavdiplotë? Sa kohë do të adhuroni ju idhujt e pasioneve tuaja të liga? Hiqni dorë nga imagjinatat tuaja të kota dhe kthejeni fytyrën ndaj Perëndisë, Zotit tuaj të Përjetshëm.

Dhurimet kushtuar bamirësisë i kthehen Perëndisë, Reveluesit të Shenjave. Askush nuk ka të drejtë t'i përdorë ato pa lejen e Atij Që është Vendagimi i Revelacionit. Pas Tij, kjo e drejtë do t'u kalojë Aghsán-ëve dhe pas tyre Shtëpisë së Drejtësisë – në qoftë se do të jetë vendosur në botë në atë kohë – që ata t'i përdorin këto dhurime në dobi të Vendndodhjeve që janë lartësuar në këtë Kauzë dhe për çdo gjë që u është urdhëruar atyre prej Atij Që është Perëndia i fuqisë e i pushtetit. Përndryshe, dhurimet do t'u kalojnë njerëzve të Bahá-it, të cilët nuk flasin veçse me lejen e Tij dhe nuk gjykojnë veçse në pajtim me atë që Perëndia ka urdhëruar në këtë Tabelë – ja, ata janë luftëtarët e fitores ndërmjet qiellit e tokës – që t'i përdorin ato në mënyrën e shtjelluar në Librin e Perëndisë, të Fuqishmit, Zemërgjerit.

LIBRI MË I SHËNJTË

Mos u qani në orët tuaja të sprovës dhe as mos u gëzoni; kërkoni Rrugën e Mesme, që është të Më kujtoni Mua në hidhërimet tuaja dhe të përsiatni për atë që mund t'ju ndodhë në të ardhmen. Kështu ju njofton Ai Që është i Gjithëdijsmi, Ai Që është i vetëdijsëm.

Mos e rruani kokën; Perëndia e ka stolisur atë me flokë, dhe në këtë ka shenja nga ana e Zotit të krijimit për ata që përsiatin rreth kërkesave të natyrës. Ai, me të vërtetë, është Perëndia i forcës e i urtisë. Megjithatë, nuk është e hijshme t'i lësh flokët të kalojnë kufirin e veshëve. Kështu është dekretuar nga Ai Që është Zoti i të gjitha botëve.

Për hajdutët janë dekretuar syrgjynosja e burgimi dhe, në shkeljen e tretë, i vini një shenjë në ballë, në mënyrë që, duke e njohur, të mos e pranojnë në qytetet e në vendet e Perëndisë. Kini mendjen që për mëshirë të mos lini pasdore zbatimin e ligjeve të fesë së Perëndisë; bëni ashtu siç jeni urdhëruar nga Ai Që është zemërdhembshur e i mëshirshëm. Ne ju mësojmë me shkopin e urtisë e të ligjeve, ashtu si babai që edukon djalin e tij, dhe kjo vetëm e vetëm për t'ju ruajtur ju vetë dhe për lartësimin e pozitës suaj. Për jetën Time, po të zbulonit se ç'kemi dashur për ju duke reveluar ligjet Tona të shenjta, ju do të jepnit edhe shpirtin për këtë Besim të shënjtë, të fuqishëm e kaq të lartësuar.

Kush dëshiron të përdorë orendi argjendi e ari është i lirë ta bëjë. Kini mendjen që kur hani të mos futni duart në tasa e tabaka. Merrni zakone sa më të hijshme. Ai, me të vërtetë, dëshiron të shohë tek ju sjelljet e banorëve të Parajsës në Mbretërinë e Tij të

fuqishme e më të madhërishme. Përmbajuni në të gjitha rrethanat asaj që është e hijshme, që sytë tuaj të mos shohin atë që është e neveritshme si për veten tuaj dhe për banorët e Parajsës. Po iu largua dikush kësaj, veprat e tij që nga ai çast janë të kota; por po pati një arsye të fortë, Perëndia do t'ia falë. Ai, me të vërtetë, është Shpirtmiri, Më Zemërgjeri.

Ai që është Vendagimi i Kauzës së Perëndisë nuk ka shoq në Pagabueshmërinë Më të Madhe. Është Ai Manifestimi i “Ai bën ç’i pëlqen” në mbretërinë e krijimit. Perëndia e ka ruajtur për Vetën e Tij këtë shquarsë dhe nuk i ka caktuar askujt pjesë në një pozitë të tillë kaq sublime e të lartësuar. Ky është dekreti i Perëndisë, i fshehur deri më sot pas perdes së një misterit të padepërtueshëm. Ne e kemi nxjerrë atë në dritë në këtë Revelacion dhe kështu kemi çarë më dysh perdet e atyre që nuk kanë njohur atë që ka shtjelluar Libri i Perëndisë dhe që janë numëruar ndër të shkujdesurit.

Çdo ati i është urdhëruar të mësojë djalin e vajzën e tij në artin e shkrim-leximit dhe në të gjitha ato që janë shtjelluar në Tabelën e Shenjtë. Prej atij që lë pasdore ç’i është urdhëruar, të Besuarit duhet të marrin atë që kërkohet për arsimimin e tyre, në qoftë se është i pasur; në qoftë se jo, çështja i kalon Shtëpisë së Drejtësisë. Me të vërtetë, këtë Ne e kemi bërë strehë për të varfërit e nevojtarët. Kush edukon djalin e vet ose djalin e një tjetri, është njëlloj sikur ka edukuar një djalë Timin; mbi të qofshin lavdia Ime, dashamirësia Ime, mëshira Ime, që kanë përfshirë botën.

LIBRI MË I SHËNJTË

Perëndia ka ngarkuar çdo shkelës dhe çdo shkelëse të kurorës me një gjobë, e cila duhet t'i paguhet Shtëpisë së Drejtësisë: nëntë mithqalë ar, që dyfishohen në qoftë se faji përsëritet. Ky është ndëshkimi që Ai Që është Zoti i Emrave ka caktuar për ta në këtë botë; dhe në botën e ardhme ka urdhëruar për ta një mundim poshtërues. Në qoftë se dikush është prekur nga ndonjë mëkat, ai duhet të pendohet për këtë dhe të kthehet te Zoti i tij. Ai, me të vërtetë i dhuron ndjesë cilitdo Që dëshiron dhe askush nuk mund të verë në pikëpyetje atë që Atij i pëlqen të urdhërojë. Ai është, me të vërtetë, Gjithmonëfalësi, Fuqiploti, i Shumëlëvduari.

Kini mendjen se mos perdet e lavdisë ju pengojnë të pini nga ujërat e kristalta të kësaj Gurre të gjallë. Rrëmbeni kupën e shëlbimit në këtë kohë agimi në emër të Atij Që bën të lindë dita dhe pijeni në përlehtëzim të Atij Që është Lavdiploti, i Pakrahasueshmi.

Ne jua kemi bërë të ligjshme të dëgjoni muzikë e këngë. Por kini mendjen që të dëgjuarit e tyre të mos ju bëjë të kapërceni kufijtë e sjelljes së hijshme e të dinjitetit. Le të jetë gëzimi juaj gëzim i lindur nga Emri Im Më i Madh, një emër që rrëmben zemrën dhe çon në ekstazë mendjet e të gjithë atyre që janë qasur pranë Perëndisë. Ne, me të vërtetë, e kemi bërë muzikën si një shkallë për shpirtat tuaj, një mjet me anën e të cilit ata të mund të ngjiten në mbretërinë qiellore; mos e bëni, pra, atë krahë për egon e pasionin. Me të vërtetë, nuk Na pëlqen t'ju shohim të renditur ndër të marrët.

Ne kemi dekretuar që një e treta e të gjitha gjobave t'i kalojë Selisë së Drejtësisë dhe i paralajmërojmë

njerëzit e saj t'i përmbahen drejtësisë së kulluar, në mënyrë që ta shpenzojnë atë që është grumbulluar për ato qëllime që u janë urdhëruar nga Ai Që është i Gjithëdijshmi, Urtiploti. O ju njerëz të drejtësisë! Jini në mbretërinë e Perëndisë barinj të grigjës së Tij dhe e ruani atë nga ujquit e uritur që kanë ardhur tebdil, ashtu siç do të mbronit vetë bijtë tuaj. Kështu ju këshillon Këshilluesi, Besniku.

Po lindën midis jush mosmarrëveshje për ndonjë çështje, ia parashtroni ato Perëndisë ndërkohë që dielli ende ndriçon mbi horizontin e këtij Qielli dhe, kur ai të ketë perënduar, referojuni çdo gjëje që është dërguar prej Tij. Kjo, me të vërtetë, është e mjaftueshme për popujt e botës. Thuaj: Le të mos shqetësohen zemrat tuaja, o njerëz, kur lavdia e Pranisë Sime të jetë tërhequr dhe oqeani i thënieve të Mia të jetë fashitur. Në praninë Time midis jush ka një urti dhe në mungesën Time ka përsëri një tjetër, që është e padukshme për të gjithë veç Perëndisë, të Pakrahasueshmit, të Gjithëdijshmit. Me të vërtetë, Ne ju vështrojmë nga mbretëria Jonë e lavdisë dhe cilindo që do të ngrihet për triumfin e Kauzës Sonë do ta ndihmojmë me turmat e legjioneve qiellore dhe me një aradhe të engjëjve Tanë më të dashur.

O popuj të botës! Perëndia, e Vërteta e Përjetshme, Më është dëshmitar që rrëke ujërash të freskët që rrjedhin qetë kanë buruar nga shkëmbinjtë falë ëmbëlsisë së fjalëve të shqiptuara nga Zoti juaj, i Padetyruari; dhe ju ende flini. Flakeni tej atë që zotëroni dhe me krahët e shkëputjes ngrihuni më lart se të gjitha gjërat e krijuara. Kështu ju urdhëron Zoti i krijimit,

LIBRI MË I SHËNJTË

lëvizja e Pendës së të Cilit ka revolucionarizuar shpirtin e njerëzimit.

A e dini nga ç'lartësi Zoti juaj, Lavdiploti, po ju thërret? A mendoni se e keni njohur Pendën me të cilën Zoti juaj, Zoti i të gjithë emrave, ju komandon? Jo, për jetën Time! Po ta dinit këtë, do të hiqnit dorë nga bota dhe do të nxitonit me gjithë zemër në praninë e të Shumëdashurit. Shpirtrat tuaj do të rrëmbeheshin aq shumë nga Fjala e Tij, saqë do të tronditnin Botën Më të Madhe, aq më tepër këtë botë të vogël e të ngushtë! Kështu kanë vërshuar nga qielli i dashamirësisë Sime shirat e bujarisë Sime, si shenjë e mirësisë Sime; që ju të jeni ndër mirënjohësit.

Ndëshkimet për plagosje ose goditje të një personi varen nga shkalla e dëmtimit; për çdo shkallë Zoti i Gjykitimit ka caktuar njëfarë zhdëmtimi. Ai është, me të vërtetë, Urdhëruesi, i Fuqishmi, Më i Lartësuar. Ne, në qoftë Vullneti Ynë, do të njoftojmë masën e drejtë të këtyre pagesave – ky është një premtim nga ana Jonë, dhe Ai, me të vërtetë, është Mbajtësi i zotimit të Tij, Njohësi i të gjitha gjërave.

Me të vërtetë, juve ju është kërkuar të bëni një festë një herë në muaj, edhe sikur aty të shërbehet vetëm ujë; sepse Perëndia ka për qëllim t'i lidhë zemrat bashkë, si me mjete tokësore dhe me mjete qiellore.

Kini mendjen që dëshirat trupore e të ndonjë prirjeje të zvetënuar të mos shkaktojnë përçarje në mes jush. Jini si gishtat e një dore, si organet e një trupi. Kështu ju këshillon Penda e Revelacionit, në qofshi ndër ata që besojnë.

KITÁB-I-AQDAS

Mendoni mëshirën e Perëndisë dhe dhuratat e Tij. Edhe pse Vetë mund të bëjë fare mirë pa të gjitha krijesat, Ai ju urdhëron atë që do t'ju sjellë juve përfitim. Veprat tuaja të këqija kurrë nuk Na bëjnë dot keq Neve, dhe as veprat tuaja të hijshme nuk Na sjellin përfitim. Ne ju bëjmë thirrje krejtësisht për hir të Perëndisë. Për këtë do të dëshmojë çdo njeri që kupton e që ka intuitë.

Në qoftë se gjuani me kafshë ose shpendë grabitqarë, përmendni Emrin e Perëndisë kur i lëshoni ato për të ndjekur gjahun; sepse atëherë çdo gjë që të kapin do të jetë e ligjshme për ju, edhe sikur ta gjeni të ngordhur. Por kini mendjen mos e teproni në gjueti. Ndiqni shtegun e drejtësisë e të ndershmerisë në të gjitha gjërat. Kështu ju urdhëron Ai Që është Vendagimi i Revelacionit, po të mund ta kuptoni këtë.

Perëndia ju ka urdhëruar të tregoni përzemërsi ndaj fisit Tim, por nuk u ka dhënë atyre të drejta mbi pronën e të tjerëve. Ai, me të vërtetë, është i vetëmjaftueshëm mbi çdo nevojë të krijesave të Tij.

Në qoftë se dikush në mënyrë të qëllimtë shkatërron një shtëpi duke i vënë zjarrin, ju edhe atë do ta digjni; në qoftë se dikush në mënyrë të qëllimtë i merr jetën një tjetri, ju edhe atë do ta vrisni. Përmbajuni porosive të Perëndisë me të gjitha forcat e fuqinë dhe hiqni dorë nga rrugët e injorantëve. Në qoftë se e dënoni zjarrvënësin e vrasësin me burgim të përjetshëm, kjo do të jetë e pranueshme sipas porosive të Librit. Ai, me të vërtetë, ka pushtet të urdhërojë ç'i pëlqen.

Perëndia ju ka porositur të martoheni. Kini mendjen mos merrni më shumë se dy gra. Kush kënaqet

LIBRI MË I SHËNJTË

me një shoqe të vetme ndër shërbëtoret e Perëndisë, ai dhe ajo që të dy do të jetojnë në paqe. Dhe kush dëshiron të marrë në shërbim një shërbëtores, mund ta bëjë këtë në mënyrë të përshtatshme. Kjo është porosia, e cila, me të vërtetë e drejtësi, është shkruar nga Penda e Revelacionit. Lidhni martesë, o njerëz, që të mund të lindni një që do të Më përmendë Mua midis shërbëtorëve të Mi. Ky është urdhëri Im për ju; përmbajuni fort atij që të ndihmoni vetveten.

O njerëz të botës! Mos shkoni pas tundimeve të egos, sepse ajo ju fton me këmbëngulje në ligësi e epsh; përkundrazi, shkoni pas Atij Që është Zotëruesi i të gjitha gjërave të krijuara, Që ju urdhëron të tregoni devotshmëri e druajtje të Perëndisë. Ai, me të vërtetë, është i pavarur nga të gjitha krijesat e Tij. Kini mendjen mos nxisni ngatërresa mbi tokë pasi është vendosur rregull në të. Ai që vepron në këtë mënyrë nuk është nga Tanët dhe Ne e heqim qafe atë. I tillë është urdhëri që, përmes fuqisë së të vërtetës, është shfaqur nga qielli i Revelacionit.

Në Bayán është shkruar se martesat varet nga pëlqimi i të dyja palëve. Duke dashur të vendosim dashuri, unitet e harmoni midis shërbëtorëve Tanë, kur dëshira e çiftit dihet Ne e kemi kushtëzuar martesën me lejën e prindërve të tyre, që midis tyre të mos lindë armiqësi e mllef. Dhe për këtë Ne kemi edhe synime të tjera. Kjo është porosia Jonë që kemi urdhëruar.

Asnjë martesë nuk mund të lidhet pa pagesën e një prike¹, e cila është caktuar në nëntëmbëdhjetë mithqálë ar të pastër për banorët e qyteteve dhe në të njëjtën sasi argjendi për banorët e fshatrave. Atij që dëshiron ta rrisë këtë shumë, i ndalohet të kapërcejë kufirin e nëntëdhjetë e pesë mithqálëve. Kjo është porosia e shkruar me madhështi e pushtet. Por në qoftë se ai kënaqet me shifrën më të ulët, për të do të jetë më mirë t'i përmbahet asaj që thuhet në Librin. Perëndia, me të vërtetë, pasuron cilindo që i pëlqen si me mjete qiellore dhe me mjete tokësore; dhe me të vërtetë Ai ka pushtet mbi të gjitha gjërat.

Nga Perëndia është dekretuar që, në qoftë se dikush prej shërbëtorëve të Tij ka ndërmend të bëjë një udhëtim, ai duhet të caktojë për të shoqen kohën se kur do të kthehet në shtëpi. Në qoftë se kthehet në kohën e premtuar, atëherë do t'i jetë bindur detyrimit të ngarkuar nga Zoti i tij dhe do të renditet ndër të drejtët nga Penda e urdhërit të Tij; përndryshe, në qoftë se ka arsye të shëndoshë për vonesën, duhet të njoftojë të shoqen dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për t'u kthyer pranë saj. Po qe se asnjëra prej këtyre mundësive nuk ndodh, asaj i takon të presë për një periudhë prej nëntë muajsh, pas së cilës nuk ka ndonjë pengesë që ajo të marrë burrë tjetër; por po qe se ajo pret më gjatë, Perëndia, me të

¹ Në Kitáb-i-Aqdas, në përputhje me zakonet e vendeve të Lindjes, me termin “prikë” nënkuptohet pagesa që dhëndri ose pala e dhëndrit i bën nuses ose palës së nuses për martesën, dhe jo pasuria e patundshme ose shuma e të hollave që i japin dhëndrit prindërit e vajzës, siç ka qenë zakoni në Shqipëri. – Shën. i përkth.

LIBRI MË I SHËNJTË

vërtetë, i do ata burra e gra që tregohen të duruar. Bindjuni porosive të Mia dhe mos shkoni pas të pafeve, atyre që janë quajtur mëkatarë në Tabelën e Shenjtë të Perëndisë. Në qoftë se gjatë periudhës së pritjes i vjen lajm për burrin, ajo duhet të zgjedhë atë mënyrë veprimi që është e lavdërueshme. Ai, me të vërtetë, dëshiron që shërbëtorët dhe shërbëtoret e Tij të jenë në paqe me njëri-tjetrin; kini mendjen të mos bëni asgjë që mund të shkaktojë papajtueshmëri midis jush. Kështu përcaktohet në dekretin dhe premtimi është mbajtur. Por, në rast se i vjen lajm për vdekjen ose vrasjen e të shoqit dhe kjo vërtetohet nga opinioni i përgjithshëm ose nga dëshmia e dy dëshmitarëve të drejtë, asaj i takon të mbetet vetëm; pastaj, kur të jetë plotësuar numri i caktuar i muajve, është e lirë të veprojë siç ka vendosur. I tillë është urdhëri i Atij që është i fuqishëm e i pushtetshëm në komandën e Tij.

Në qoftë se midis burrit e gruas lind mëri e antipati, ai nuk duhet ta ndajë atë, por të presë me durim plot një vit se mos aroma e dashurisë përtërihet midis tyre. Në qoftë se pas plotësimit të kësaj periudhe dashuria e tyre nuk është rikthyer, është e lejueshme të bëhet ndarja. Urtia e Perëndisë, me të vërtetë, ka përfshirë të gjitha gjërat. Zoti, në një Tabelë të shkruar nga Penda e komandës së Tij, e ka ndaluar zakonet që ju ndiqnit më parë kur e ndanit tri herë një grua. Këtë Ai e ka bërë si një favor ndaj jush nga ana e Tij, që ju të renditeni ndër mirënjohësit. Ai që ka ndarë gruan mund të vendosë, me kalimin e çdo muaji, të rimartohet me të kur ka dashuri e pëlqim të ndërsjellë, sakohë ajo nuk ka marrë një burrë tjetër. Në rast se ajo është martuar

KITÁB-I-AQDAS

përsëri, atëherë me këtë bashkim tjetër ndarja është konfirmuar dhe çështja është mbyllur, veç po që se gjendja e saj ndryshon në mënyrë të qartë. Kështu është shkruar me madhështi dekreti në këtë Tabelë të lavdishme nga Ai Që është Vendagimi i Bukurisë.

Në qoftë se gruaja e shoqëron burrin e saj në një udhëtim dhe gjatë rrugës midis tyre linden mosmarrëveshje, ai ka për detyrë t'i sigurojë asaj shpenzimet për një vit të tërë dhe o ta kthejë nga kishte ardhur ose t'ia besojë, bashkë me të gjitha gjërat e nevojshme për udhëtimin, një personi të besueshëm që ta shoqërojë deri në shtëpi. Zoti, me të vërtetë, urdhëron ashtu siç i pëlqen, falë sovranitetit që shtrihet mbi popujt e botës.

Po që se një grua e ndan burri si rrjedhojë e një veprimi të provuar të shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, ajo nuk merr mbështetje me mjete jetese gjatë periudhës së pritjes. Kështu ka ndriçuar me shkëlqim dielli i porosisë Sonë nga qielli i drejtësisë. Me të vërtetë, Zoti i do bashkimin e harmoninë dhe i urren ndarjen e shkurorëzimin. Jetoni me njëri-tjetrin, o njerëz, në dashuri e gëzim. Për jetën Time! Çdo gjë që është mbi tokë do të zhduket dhe vetëm veprat e mira do të mbeten; Vetë Perëndia është dëshmitar për vërtetësinë e fjalëve të Mia. Ndreçni mosmarrëveshjet tuaja, o shërbëtorë të Mi; pastaj vijini veshin këshillës së Pendës Sonë të Lavdisë dhe mos shkoni pas arrogantëve e kokëfortëve.

Kini mendjen që bota të mos ju mashtrtojë, siç ka mashtruar njerëzit që kanë shkuar para jush! Zbatoni

LIBRI MË I SHËNJTË

ligjet e porositë e Zotit tuaj dhe ecni me ndershmeri e vërtetësi në Rrugën që është shtruar para jush. Ata që i shmangen padrejtësisë e gabimit dhe që i përmbahen virtytit, janë në sytë e të vetmit Perëndi të vërtetë ndër të zgjedhurit e krijesave të Tij; emrat e tyre lartësohen nga Tubimi i mbretërive qiellore e nga ata që banojnë në këtë Faltore që është ngritur në emër të Perëndisë.

Ju ndalohet të bëni tregti skllëvërish, burra a gra qofshin. Nuk i takon atij që është vetë shërbëtor të blejë një shërbëtor tjetër të Perëndisë, dhe kjo është ndaluar në Tabelën e Tij të Shenjtë. Kështu, për hir të mëshirës së Tij, është shkruar kjo porosi nga Penda e drejtësisë. Askush të mos lartësojë veten mbi të tjerët; të gjithë s'janë veçse skllëvër para Zotit dhe të gjithë dëshmojnë të vërtetën se nuk ka Perëndi tjetër veç Tij. Ai, me të vërtetë, është i Gjithëdijshmi, urtia e të Cilit përfshin të gjitha gjërat.

Stolisuni me petkun e veprave të hijshme. Ai, veprat e të cilit kanë pëlqimin e Perëndisë, është me siguri nga njerëzit e Bahá-it dhe përmendet para fronit të Tij. Ndhimojeni Zotin e të gjithë krijimit me vepra prej njeriu të drejtë, si dhe me urti e fjalë. Në të vërtetë kështu ju ka porositur në shumë prej Tabelave Ai Që është Mëshirëploti. Ai, me të vërtetë, është në dijeni të asaj që them Unë. Askush të mos grindet me ndonjë tjetër dhe asnjë shpirt të mos vrasë një tjetër; kjo, me të vërtetë, ju ishte ndaluar juve në një Libër që qëndronte i fshehur brenda Faltorës së lavdisë. Si! A do të vrisnit ju atë që Perëndia e ka sjellë në jetë, atë që Ai i ka dhënë shpirt me një frymë të Tij? I rëndë, pra, do të jetë mëkati juaj para fronit të Tij! Druajuni Perëndisë dhe mos

ngrini dorën e padrejtësisë e të shtypjes për të shkatërruar atë që Ai Vetë ka ndërtuar; jo, ecni në rrugën e Perëndisë, të Vërtetit. Sapo ushtria e dijes së vërtetë u duk, duke mbajtur flamujt e fjalës Hyjnore, fiset e feve ua mbathën këmbëve, me përjashtim vetëm të atyre që donin të pinin nga gurra e jetës së pasosur në një Parajsë të krijuar nga fryma e Lavdiplotit.

Perëndia ka dekretuar, si shenjë të mëshirës së Tij për krijesat e Veta, që fara nuk është e papastër. Falënderojeni Atë me gëzim e rëzëllim dhe mos shkoni pas atyre që janë larg Vendagimit të afrisë së Tij. Në çdo rrethanë ngrihuni për t'i shërbyer Kauzës, sepse Perëndia me siguri do t'ju ndihmojë me fuqinë e sovranitetit të Tij që mbulon me hijen e vet botët. Mbahuni pas litarit të sqimës me aq këmbëngulje sa të mos lejoni që asnjë shenjë papastërtie të duket në rrobat tuaja. I tillë është urdhëri i Atij Që është i kulluar mbi çdo sqimë. Ai që e lë mangut këtë normë për një arsye të shëndoshë, nuk do të ngarkohet me faj. Perëndia, me të vërtetë, është Falësi, i Mëshirshmi. Lajeni çdo gjë të ndotur me ujë që nuk ka pësuar ndryshime në asnjërin prej tre aspekteve; kini kujdes mos përdorni ujë që është ndryshuar përmes lënies nën veprimin e ajrit ose të ndonjë elementi tjetër. Jini thelbi vetë i pastërtisë midis njerëzimit. Kjo është, me të vërtetë, ajo që Zoti juaj, i Pakrahësueshmi, Urtiploti, dëshiron për ju.

Perëndia po kështu ka shfuqizuar, si shenjë bujarie e pranisë së Tij, konceptin e “papastërtisë”, për shkak të të cilit shumë gjëra e njerëz janë konsideruar si të papastër. Ai, me siguri, është Gjithmonëfalësi, Më Fisniku. Me të vërtetë, të gjitha gjërat e krijuara u zhytën

LIBRI MË I SHËNJTË

në detin e dëlirjes kur, në atë ditë të parë të Ridvánit, Ne përhapëm mbi gjithë krijimin shkëlqimet e Emrave Tanë më të përsosur e të Atributeve Tona më të lartësuar. Kjo është, me të vërtetë, shenjë e provanisë Sime dashamirëse, e cila ka përfshirë të gjitha botët. Shoqërohuni, pra, me pasuesit e të gjitha feve, dhe shpallni Kauzën e Zotit tuaj, Më Zemërdhembshurit; kjo është vetë kurora e bëmave, në qofshi ndër ata që kuptojnë.

Perëndia ju ka urdhëruar të mbani pastërtinë më të madhe, deri në atë shkallë sa të lani atë që është e ndotur me pluhur, pa përmendur atë me pisllëk të ngurtësuar e fëlliqësi të tjera si këto. Druajuni Atij dhe jini ndër ata që janë të dëlirë. Në qoftë se rrobat e cilitdo janë të ndotura në mënyrë të dukshme, lutjet e tij nuk do të arrijnë te Perëndia dhe Tubimi qiellor do t'i kthejë shpinën atij. Përdorni ujë trëndafil dhe parfum të kulluar; kjo është, me të vërtetë, ajo që Perëndia ka dashur që nga fillimi që s'ka fillim, në mënyrë që nga ju të përhapet ajo që dëshiron Zoti juaj, i Pakrahasueshmi, Urtiploti.

Perëndia ju ka liruar nga porosia e shkruar në Bayán përsa i përket zhdukjes së librave. Ne ju kemi lejuar të lexoni ato shkenca që janë të dobishme për ju, dhe jo të tilla që përfundojnë në polemika të kota; kjo është më mirë për ju, në qofshi ndër ata që kuptojnë.

O mbretër të tokës! Ai Që është Zoti sovran i çdo gjëje ka ardhur. Mbretëria është e Perëndisë, Mbrojtësit të gjithëfuqishëm, të Vetëqenëshmit. Mos adhuronit asgjë veç Perëndisë dhe, me zemra rrëzëllyese, ngrini lart

KITÁB-I-AQDAS

fytyrat nga Zoti juaj, Zoti i të gjithë emrave. Ky është një Revelacion, me të cilin nuk mund të krahasohet kurrë çdo gjë që zotëroni, sikur ta dinit këtë.

Ju shohim të gëzoheni për atë që keni grumbulluar për të tjerët dhe t'i mbyllni vetes rrugën për në botët, të cilat asgjë veç Tabelës Sime të ruajtur nuk mund t'i numërojë. Thesaret që keni vënë mënjanë ju kanë larguar së tepërmi nga synimi juaj përfundimtar. Kjo ju përshtatet keq juve, sikur ta kuptonit këtë. Pastroni nga zemrat tuaja çdo ndotje tokësore dhe shpejtoni të hyni në Mbretërinë e Zotit tuaj, Krijuesit të tokës e të qiellit, i Cili bëri të lëkundet toka dhe të gjithë popujt e saj të vajtojnë, me përjashtim të atyre që kanë hequr dorë prej çdo gjëje dhe mbahen pas asaj që ka urdhëruar Tabela e Fshehur.

Kjo është Dita në të cilën Ai Që ka biseduar me Perëndinë ka arritur dritën e të Lashtit të Kohëve dhe ka pirë nga ujërat e kulluara të ribashkimit, me këtë Kupë që i ka bërë detrat të fryhen. Thuaj: Për Perëndinë e vërtetë Që është Një! Sinai sillet rreth Burimit të Revelacionit, ndërsa nga lartësitë e Mbretërisë Zëri i Frymës së Perëndisë dëgjohet të shpallë: “Shkunduni, o ju krenarët e tokës, dhe nxitoni tek Ai”. Në këtë Ditë, Karmeli ka shpejtuar me adhurim të zjarrtë të arrijë oborrin e Tij, ndërkohë që nga zemra e Sionit vjen thirrja: “Premtimi u përmbush. Ajo që ishte njoftuar në Shkrimin e shenjtë të Perëndisë, Më të Lartësuarit, Fuqplotit, Më të Shumëdashurit, u shfaq”.

O mbretër të tokës! Ligji Më i Madh është reveluar në këtë Vend, në këtë skenë të shkëlqimit transhendent.

LIBRI MË I SHËNJTË

Çdo gjë e fshehur është nxjerrë në dritë falë Vullnetit të Urdhëruesit Suprem, të Atij Që ka sjellë Orën e Fundit dhe përmes të Cilit Hëna është çarë e çdo dekret i pakundërshtueshëm është shtjelluar.

Ju s'jeni veçse vasalë, o mbretër të tokës! Ai Që është Mbreti i Mbretërve është shfaqur, i veshur me lavdinë e Tij më të mahnitshme, dhe ju thërret ju pranë Vetes, Ndihma në Rrezik, i Vetëqenëshmi. Kini mendjen që krenaria të mos ju pengojë të njihni Burimin e Revelacionit, që gjërat e kësaj bote të mos ju ndajnë si një perde nga Ai Që është Krijuesi i qiellit. Ngrihuni dhe vihuni në shërbim të Atij Që është Dëshira e të gjitha kombeve, Që ju ka krijuar me një fjalë të Vetën dhe ju ka urdhëruar të jeni përgjithmonë emblemat e sovranitetit të Tij.

Për drejtësinë e Perëndisë! Nuk është dëshira jonë të vëmë dorë mbi mbretëritë tuaja. Misioni Ynë është të pushtojmë e të zotërojmë zemrat e njerëzve. Mbi to janë mbërthyer sytë e Bahá-it. Për këtë dëshmon Mbretëria e Emrave, po ta kuptonit këtë. Kush shkon pas Zotit të tij heq dorë nga bota e nga çdo gjë që ndodhet në të; sa më e madhe është, pra, shkëputja e Atij Që ka një pozitë kaq të madhërishtme! Braktisni pallatet tuaja dhe shpejtoni të fitoni hyrjen në Mbretërinë e Tij. Kjo, me të vërtetë, do t'ju vlejë si në këtë botë dhe në tjetrën. Për këtë dëshmon Zoti i mbretërisë qiellore, veç ta dinit këtë.

Ç'bekim i madh e pret mbretin që do të ngrihet për të mbrojtur Kauzën Time në Mbretërinë Time, që do të shkëputet nga çdo gjë tjetër veç Meje! Një mbret i tillë

KITÁB-I-AQDAS

numërohet ndër shokët e Arkës Kërmëz, të Arkës që Perëndia ka përgatitur për njerëzit e Bahá-it. Të gjithë duhet t'i thurin lavdi emrit të tij, të nderojnë pozitën e tij dhe ta ndihmojnë atë të hapë qytetet me çelësat e Emrit Tim, Mbrojtësit të gjithëfuqishëm të të gjithë atyre që banojnë në mbretëritë e dukshme e të padukshme. Një mbret i tillë është syri i njerëzimit, stolia e ndritshme në ballin e krijimit, burimi i bekimeve mbi mbarë botën. Jepni, o njerëz të Bahá-it, pasurinë tuaj, madje vetë jetët tuaja, për ta ndihmuar.

O Perandor i Austrisë! Ai Që është Agimi i Dritës së Perëndisë ndodhej në burgun e 'Akká-së në kohën që ti u nise për të vizituar Xhaminë Al-Aqsa. Ti kalove pranë Tij dhe nuk pyete për Atë, falë të Cilit çdo shtëpi është lartësuar dhe çdo portë e lartë është hapur. Ne, me të vërtetë, e kemi bërë atë një vend ndaj të cilit duhet të kthehet bota, që ata të më kujtojnë Mua, e megjithatë ti e ke mohuar Atë Që është Objekti i këtij kujtimi, kur Ai u shfaq me Mbretërinë e Perëndisë, Zotit tënd dhe Zotit të botëve. Ne kemi qenë gjithmonë me ty dhe të kemi parë të mbahesh pas Degës e të jesh moskokëçarës për Rrënjën. Zoti yt, me të vërtetë, është dëshmitar për këtë që them. Ne u brengosëm duke të parë të vish rrotull Emrit Tonë, ndërsa ishe i pavetëdijshëm për Ne, edhe pse Ne ishim para fytyrës sate. Hapi sytë, që të mund të shohësh këtë Pamje të lavdishme e të njohësh Atë Që ke thirrur ditë e natë, dhe të sodisësh Dritën që shkëlqen mbi këtë Horizont të shndritshëm.

Thuaj: O Mbret i Berlinit! Vëri veshin Zërit që nga ky tempull i dukshëm thërret: "Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, të Përjetshmit, të Pashoqit, të

LIBRI MË I SHËNJTË

Lashtit të Kohëve². Ki mendjen që krenaria të mos të të pengojë të njohësh Agimin e Revelacionit Hyjnor, që dëshirat tokësore të mos të të ndajnë, si me perde, nga Zoti i Fronit atje lart dhe të tokës këtu poshtë. Kështu të këshillon Penda e Më të Lartit. Ai, me të vërtetë, është Më i Mëshirshmi, Bujariploti. A të kujtohet ai², pushteti i të cilit ia kalonte pushtetit tënd dhe pozita e të cilit ishte më e lartë se jotja? Ku ndodhet ai? Ku kanë shkuar ato që ai zotëronte? Mbaj parasysh paralajmërimin dhe mos ji ndër ata që bëjnë gjumë të thellë. Ishte ai që flaku pas shpine Tabelën e Perëndisë, kur Ne i bëmë të njohur se çfarë vuajtjesh Na shkaktuan hordhitë e tiranisë. Prandaj fatkeqësitë e sulmuan atë nga të gjitha anët dhe ai u përmbys në pluhur në vështirësi të madhe. Mendo thellë, O Mbret, lidhur me të dhe lidhur me ata që, ashtu si ti, kanë pushtuar qytete e kanë sunduar mbi njerëzit. I Gjithëmëshirshmi i ka rrëzuar ata nga pallatet në varret e tyre. Ki mendjen, ji ndër ata që përsiatin.

Ne nuk kemi kërkuar asgjë prej jush. Ne, me të vërtetë, ju këshillojmë për hir të Perëndisë dhe do të jemi të duruar, siç kemi qenë të duruar për atë që Na ka rënë mbi krye prej duarve tuaja, o turmë mbretërisht!

O Sundimtarë të Amerikës e Presidentë të Republikave të atjeshme, dëgjoni atë që këndon Pëllumbi mbi Degën e Përjetësisë: “Nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, të Përherëpranishmit, Falësit, Bujariplotit”. Stolisini tëmthat e sundimit me stolinë e drejtësisë e të druajtjes së Perëndisë dhe kokën e tij me

² Napoleoni III.

KITÁB-I-AQDAS

kurorën e kujtimit të Zotit tuaj, Krijuesit të qiejve. Kështu ju këshillon Ai Që është Agimi i Emrave, siç e urdhëron Ai Që është i Gjithëdijshmi, Urtiploti. I Premtuari është shfaqur në këtë Pozitë të lartësuar, e për këtë të gjitha gjërat, të dukshme e të padukshme, janë gëzuar. Përfitoni nga Dita e Perëndisë. Me të vërtetë, të takoni Atë për ju është më e mirë se çdo gjë mbi të cilën ndriçon dielli, sikur ta dinit këtë. O turmë sunduesish! Vëri veshin asaj që është shqiptuar nga Agimi i Madhështisë: “Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, Zotit të Fjalës, të Gjithëdijshmit”. Atë që është thyer ngjiteni me duart e drejtësisë dhe shtypësin që lulëzon dërrmojeni me shkopin e porosive të Zotit tuaj, Urdhëruesit, Urtiploti.

O popull i Konstantinopojës! Ja, midis jush dëgjojmë klithmën ogurzezë të kukuvajkës. Mos vallë ju ka mbërthyer dehja e pasionit, apo jeni zhytur në moskokëçarje? O vend që ndodhesh në brigjet e dy deteve! Me të vërtetë, froni i tiranisë është vendosur mbi ty dhe flaka e urrejtjes është ndezur në gjoksin tënd, aq sa Tubimi qiellor dhe ata që sillen qark Fronit të Lartësuar kanë qarë e vajtuar. Ne shohim tek ti të marrin të sundojë mbi të urtin dhe errësirën të mburret kundër dritës. Ti je me të vërtetë e fryrë nga krenaria. Mos vallë shkëlqimi yt i jashtëm të ka rritur mendjen? Për Atë Që është Zoti i njerëzimit! Kjo së shpejti do të marrë fund dhe bijat e vejushat tuaja dhe të gjitha fiset që jetojnë brenda teje do të vajtojnë. Kështu të njofton i Gjithëdijshmi, Urtiploti.

O brigje të Rinit! Ju kemi parë të mbuluara me gjak, sepse shpatat e shpagimit janë nxjerrë kundër jush;

LIBRI MË I SHËNJTË

dhe juve do t'ju vijë radha edhe një herë tjetër. Dhe dëgjojmë vajtimin e Berlinit, edhe pse sot ai është në lavdi të dukshme.

Mos u brengos për asgjë, o tokë e Tã-së³, sepse Perëndia të ka zgjedhur të jesh burim i gëzimit të mbarë njerëzimit. Ai, në qoftë ky Vullneti i Tij, ka për ta bekuar fronin tënd me dikë që do të sundojë me drejtësi dhe do të mbledhë grigjën e Perëndisë, që ujqit e kanë shpërndarë. Ai sundimtar do ta kthejë me gëzim e hare shikimin nga njerëzit e Bahá-it dhe do të shtrijë mbi ta favorët e tij. Ai me të vërtetë konsiderohet në sytë e Perëndisë si një gur i çmuar midis njerëzve. Mbi të qëndroftë përjetë lavdia e Perëndisë dhe lavdia e të gjithë atyre që banojnë në mbretërinë e Revelacionit të Tij.

Gëzohu me hare të madhe, sepse Perëndia të bëri ty “Agimin e dritës së Vet”, përderisa brenda teje lindi Manifestimi i Lavdisë së Tij. Ji e gëzuar për këtë emër që të është dhënë, një emër, përmes të cilit Ylli i Ditës i Mirësisë ka lëshuar shkëlqimin e vet dhe tokë e qiell janë ndriçuar.

Së shpejti gjendja e punëve brenda teje do të ndryshojë dhe frerët e pushtetit do të bien në duart e popullit. Me të vërtetë, Zoti yt është i Gjithëdijshmi. Pushteti i Tij përfshin të gjitha gjërat. Të jesh e sigurt për favorin dashamirës të Zotit tënd. Syri i mirëdashjes së Tij do të drejtohet përgjithmonë tek ti. Po afron dita kur trazimi yt do të shndërrohet në paqe e qetësi të

³ Tíhrán.

plotë. Kështu është dekretuar në Librin e mrekullueshëm.

O tokë e Khá sè!⁴ Dëgjojmë nga ti zëra heronjsh, që janë ngritur për t'i thurur lavde Zotit tënd, Gjithëzotëruesit, Më të Lartësuarit. Bekuar qoftë dita në të cilën flamujt e Emrave hyjnorë do të ngrihen në mbretërinë e krijimit në emrin 'Tim, Lavdiplotit. Atë ditë besnikët do të gëzojnë në fitoren e Perëndisë dhe mosbesimtarët do të vajtojnë.

Askush nuk duhet t'u kundërvihet atyre që kanë pushtet mbi popullin; leruni atyre atë që është e tyrja dhe drejtojeni vëmendjen tuaj te zemrat e njerëzve.

O Oqean Shumë i Fuqishëm! Spërkat mbi kombet atë që Të ka ngarkuar Ai Që është Sovrani i Përjetësisë dhe stolisi tempujt e të gjithë atyre që banojnë mbi tokë me veshjen e ligjeve të Tij, falë të cilave të gjitha zemrat do të gëzojnë dhe të gjithë sytë do të shndrisin.

Po qe se dikush fiton njëqind mithqálë ar, nëntëmbëdhjetë mithqálë prej tyre janë të Perëndisë, Artuesit të tokës e të qiellit, dhe duhet t'i jepen Atij. Kini mendjen, o njerëz, mos i mohoni vetes një bujari kaq të madhe. Këtë ju kemi urdhëruar, megjithëse jemi në gjendje të bëjmë pa ju dhe pa gjithçka që është në qiejt e mbi tokë; në këtë ka përfitime e urti që shkojnë tej njohurive të cilitdo veç Perëndisë, të Gjithëdijshtit, të Gjithinformuarit. Thuaj: Ai ka dashur kështu të dëlirë atë që zotëroni dhe t'ju bëjë të aftë të qaseni pranë pozitave të tilla që askush nuk i kupton veç atyre që ka

⁴ Horasani [Khurásán].

LIBRI MË I SHËNJTË

dashur Perëndia. Ai, me të vërtetë, është Mirëbërësi, Mëshiruesi, Zemërgjeri. O njerëz! Mos veproni në mënyrë të pabesë me të Drejtën e Perëndisë dhe as mos e përdorni atë sipas qejfit pa lejën e Tij. Kështu është vendosur porosia e Tij në Tabelat e shenjta dhe në këtë Libër të lavdëruar. Ai që vepron me të pabesë me Perëndinë, me të drejtë do të ndeshet edhe vetë me pabesinë; por ai që vepron në pajtim me urdhërin e Perëndisë do të marrë një bekim nga qielli i bujarisë i Zotit të tij, të Mëshirshmit, Dhuruesit, Fisnikut, të Lashtit të Kohëve. Ai, me të vërtetë, ka dashur për ju atë që është tej dijes suaj, por që do t'ju bëhet e njohur atëherë kur, pas kësaj jete kalimtare, shpirtrat tuaj do të fluturojnë drejt qiellit dhe shkëlqimet e gëzimeve tuaja tokësore do të mbarojnë. Kështu ju këshillon Ai Që zotëron Tabelën e Ruajtur.

Peticione të ndryshme kanë ardhur para fronit Tonë nga besimtarët lidhur me ligje të Perëndisë, Zotit të së dukshmes e të së padukshmes, Zotit të të gjitha botëve. Ne, për rrjedhojë, kemi reveluar këtë Tabelë të Shenjtë dhe e kemi stolitur atë me rrobën e Ligjit të Tij, që ndoshta njerëzit t'u përmbahen porosive të Zotit të tyre. Kërkesa të ngjashme Na janë bërë gjatë disa viteve të mëparshme, por, me urtinë Tonë, Ne e përmbajtëm Pendën, derisa kohët e fundit arritën letra nga një numër miqsh dhe Ne atëherë u përgjigjëm, me fuqinë e së vërtetës, me atë që do të gjallërojë zemrat e njerëzve.

Thuaj: O udhëheqës të fesë! Mos e gjykoni Librin e Perëndisë sipas atyre modeleve e shkencave që përdoren ndër ju, sepse vetë Libri është peshorja e pagabueshme e vendosur midis njerëzve. Në këtë peshore kaq të

KITÁB-I-AQDAS

përsosur duhet të peshohet gjithçka zotërojnë popujt dhe fiset e tokës, kurse masa e peshës së saj duhet të matet sipas vetë modelit të saj, veç ta kuptonit këtë.

Syri i dashamirësisë Sime qan me dënësë për ju, sepse nuk njohët Atë që e keni thirrur ditë e natë, çdo mbrëmje e mëngjes. O njerëz, shkoni përpara, me fytyra të bardha borë e me zemra të gëzuara, për në Vendin e bekuar kërmëz, prej nga Sadratu'l Muntahá i thërret: “Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, Mbrojtësit të Gjithëfuqishëm, të Vetëqenëshmit!”

O ju udhëheqës të fesë! Cili prej jush mund të matet me Mua në përfytyrim ose largpamësi? Ku është ai që guxon të pretendojë se është i barabartë me Mua në fjalë ose urti? Jo, për Zotin Tim, Mëshirëplotin! Gjithçka në botë do të zhduket; e kjo është fytyra e Zotit tuaj, Fuqiplotit, të Shumëdashurit.

Ne kemi dekretuar, o njerëz, që qëllimi më i lartë e i fundit i çdo diturie të jetë njohja e Atij Që është Objekti i çdo dije; e megjithatë, shih sesi keni lejuar që dituria juaj t’ju ndajë si me perde prej Atij Që është Agimi i kësaj Drite, falë të Cilit çdo gjë e fshehur është reveluar. Sikur vetëm të zbulonit burimin nga përhapet shkëlqimi i kësaj fjale, ju do të braktisnit popujt e tokës e çdo gjë që ata zotërojnë dhe do t’i qaseshit pranë kësaj Selie kaq të bekuar të lavdisë.

Thuaj: Ky, me të vërtetë, është qielli në të cilin Libri Mëmë është ruajtur, veç ta kuptonit këtë. Është Ai që e ka bërë shkëmbin të thërrasë dhe Drizën e Përflakur të ngrejë zërin në Malin që ngrihet mbi Tokën

LIBRI MË I SHËNJTË

e Shenjtë për të shpallur: “Mbretëria është e Perëndisë, Zotit Sovran të gjithçkaje, Fuqiplotit, Dashuruesit!”

Ne nuk kemi ndjekur ndonjë shkollë, as kemi lexuar ndonjë prej disertacioneve tuaja. Veruni veshin fjalëve të këtij të Pashkolluari, tek ju thërret te Perëndia, i Përherëpranishmi. Kjo është më e mirë për ju sesa të gjitha thesaret e tokës, veç të mund ta kuptonit këtë.

Kush interpreton atë që është dërguar nga qielli i Revelacionit dhe ndryshon domethënien e qartë të saj, ai me të vërtetë është ndër ata që kanë shtrembëruar Fjalën Sublime të Perëndisë dhe në Librin e Qartë renditet ndër të humburit.

Ju është urdhëruar të prisni thonjtë, të laheni çdo javë në ujë që të mbulojë trupin dhe të pastroheni me atë që keni përdorur më parë. Kini kujdes që, për shkak të shkujdesjes të mos lini pa zbatuar atë që ju ka urdhëruar Ai Që është i Pakrahasueshmi, Mëshiruesi. Zhytuni në ujë të pastër; nuk është e lejueshme të laheni në ujë të përdorur. Kini mendjen mos u futni në hurdhmat publike të banjave persiane; kush shkon në banja të tilla thith erën e tyre të qelbur sapo futet atje. Shmangini ato, o njerëz, dhe mos jini ndër ata që në mënyrë të shëmtuar pranojnë një ndyrësi të tillë. Me të vërtetë, ato janë fole ndotjeje e infektimi, në qofshi ndër ata që kuptojnë. Shmangiuni gjithashtu hurdhave me erë të keqe në oborret e shtëpive persiane dhe jini të dëlirë e të pastër. Me të vërtetë, Ne duam t’ju shohim ju si manifestime të parajsës mbi tokë, që prej jush të përhapet një erë e mirë që të gëzojë zemrat e të zgjedhurve të Perëndisë. Në qoftë se ai që lahet, në vend

KITÁB-I-AQDAS

që të hyjë në ujë, lahet duke e derdhur atë mbi trupin e tij, kjo është më mirë dhe e çliron atë nga nevoja e zhytjes së trupit në ujë. Zoti, me të vërtetë, dëshiron, si një dhunti të pranisë së Tij, t'jua bëjë jetën më të lehtë, që të jeni ndër ata që janë vërtet mirënjohës.

Ju ndalohej të martoheni me gratë e atit tuaj. Ne i bëjmë bisht, nga turpi, të shtjellojmë çështjen e djemve. Druajuni të Mëshirshmit, o popuj të botës! Mos kryeni atë që ju është ndaluar në Tabelën Tonë të Shenjtë dhe mos jini ndër ata që enden të hutuar në shkretëtirën e dëshirave të tyre.

Askujt nuk i lejohet të mërmërisë vargje të shenjta para njerëzve duke ecur në rrugë ose në pazar; përkundrazi, në rast se dëshiron të madhërojë Zotin, është e përshtatshme ta bëjë këtë në vende që janë ngritur për këtë qëllim ose në shtëpinë e vet. Kjo pajtohet më shumë me sinqeritetin e përsheptshmërinë. Kështu ka ndritur në horizontin e fjalës Sonë dielli i porosisë Sonë. Bekuar qofshin, pra, ata që zbatojnë urdhërin Tonë.

Secili e ka për detyrë të shkruajë një testament. Trashëgimlënësi duhet ta fillojë këtë dokument me stolinë e Emrit Më të Madh, të dëshmojë aty njëshmërinë e Perëndisë në Agimin e Revelacionit të Tij dhe të përmendë, ashtu si dëshiron, atë që është e lavdërueshme, që kjo të jetë një dëshmi për të në mbretëritë e Revelacionit e të Krijimit dhe një thesar pranë Zotit të tij, Mbrojtësit Suprem, Besnikut.

Të gjitha Festat kanë arritur përmbushjen e tyre në dy Festat Më të Mëdha, si dhe në dy Festa të tjera që

LIBRI MË I SHËNJTË

bien në ditët binjake – duke qenë e para ndër dy Festat Më të Mëdha ato ditë kur Mëshirëploti shtriu mbi të gjithë krijimin lavdinë e ndritshme të Emrave të Tij më të përsosur dhe Atributet e tij më të lartësuar, dhe e dyta ajo ditë në të cilën Ne nxorrëm Atë Që i njoftoi mbarë njerëzimit lajmin e gëzuar të këtij Emri, falë të cilit u ringjallën të vdekurit dhe u mblodhën së bashku të gjithë ata që janë në qiejt e mbi tokë. Kështu ka dekretuar Ai Që është Urdhëruesi, i Gjithëdijshmi.

Lum ai që hyn në ditën e parë të muajit të Bahá-it, ditën që Perëndia ia ka kushtuar këtij Emri të Madh. Dhe bekuar qoftë ai që në këtë ditë tregon bujaritë që Perëndia i ka dhuruar atij; ai, me të vërtetë, është ndër ata që shfaqin mirënjohje ndaj Perëndisë përmes veprimesh që tregojnë bujarinë e Zotit, e cila ka përfshirë të gjitha botët. Thuaj: Kjo ditë është, me të vërtetë, kurora e burimi i të gjithë muajve, dita në të cilën fryma e jetës është përhapur mbi të gjitha gjërat e krijuara. I madh është bekimi i atij që e përshëndet atë fytyrëçelur e me gëzim. Ne dëshmojmë se ai është, me të vërtetë, ndër ata që janë të lumtur.

Thuaj: Festa Më e Madhe është, me të vërtetë, Mbretëresha e Festave. Sillni ndërmend, o njerëz, bujarinë që ju ka dhuruar Perëndia. Ju keni qenë të zhytur në gjumë dhe, ja! Ai ju zgjoi me flladet gjallëruese të Revelacionit të Tij dhe ju bëri të njohur Shtegun e Tij të dukshëm e të pagabueshëm.

Në kohë sëmundjeje, drejtojuuni mjekëve të aftë; Ne nuk e kemi lënë mënjane përdorimin e mjeteve materiale, përkundrazi e kemi pohuar atë me anë të

KITÁB-I-AQDAS

kësaj Pende, që Perëndia e ka bërë të jetë Vendagimi i Kauzës së Tij të shndritshme e të lavdishme.

Më parë Perëndia i kishte ngarkuar secilit besimtar detyrën për të blatur para fronit Tonë dhurata të paçmuara nga zotërimet e tij. Tani, në shenjë dashamirësie nga ana Jonë, Ne i kemi liruar ata nga ky detyrim. Ai, me të vërtetë, është Më Fisniku, Bujariploti.

I bekuar është ai që në agim, me mendimim të ngulitur te Perëndia, i përqëndruar në kujtimin e Tij dhe duke iu lutur për ndjesë, i drejton hapat për në Mashriqu'l-Adhkár dhe, pasi hyn atje, ulet në heshtje për të dëgjuar vargjet e Perëndisë, Sovranit, të Fuqishmit, të Gjithëlavdëruarit. Thuaj: Mashrikul Azkar është çdo ndërtesë e ngritur në qytete e fshatra për të më thurur lavde Mua. Ky është emri me të cilin është quajtur ai para fronit të lavdisë, në qofshi ndër ata që kuptojnë.

Ata që recitojnë vargjet e Mëshirëplotit me zërat më të melodishëm, do të shquajnë në to gjëra me të cilat toka e qielli kurrë nuk mund të krahasohen. Prej tyre ai do të thithë aromën hyjnore të botëve të Mia, botë që sot askush nuk mund t'i shohë, veç atyre që u është dhuruar vizioni falë këtij Revelacioni sublim e të mrekulleshëm. Thuaj: Këto vargje tërheqin zemrat e dëlira në ato botë shpirtërore, të cilat nuk mund të shprehen me fjalë e as të nënkuptohen me aluzione. Bekuar qofshin ata që vënë vesh.

Ndihmoni, o njerëzit e Mi, shërbëtorët e Mi të zgjedhur që janë ngritur për të më përmendur Mua midis krijesave të Mia dhe për të lartësuar Fjalën Time anembanë mbretërisë Sime. Këta janë, me të vërtetë,

LIBRI MË I SHËNJTË

yjet e qiellit të provanisë Sime dashamirëse dhe llambat e udhërrëfimit Tim për gjithë njerëzimin. Por ai, fjalët e të cilit vinë në kundërshtim me atë që është dërguar në Tabelat e Mia të Shenjta, nuk është nga të Mitë. Kini mendjen mos shkoni pas ndonjë pretendenti të pafe. Këto Tabela janë zbuluar me vulën e Atij Që bën të agojë dita, Që ngre zërin midis qiejve dhe tokës. Kapuni pas kësaj Dorëze të Sigurt dhe pas Litarit të Kauzës Sime të fuqishme e të pamposhtur.

Zoti ka lejuar cilindo që ka dëshirë, të mësojë gjuhët e ndryshme të botës, që të çojë mesazhin e Kauzës së Perëndisë kudo në Lindje e Perëndim, që ta përmendë Atë midis fiseve e popujve të botës, në mënyrë që zemrat të ringjallen dhe eshtrat e mykura të gjallërohen.

Është e papranueshme që njeriu, të cilit i është dhuruar arsyeja, të kryejë diçka që ia rrëmben atë. Jo, përkundrazi, ai duhet të sillet në mënyrë të denjë për pozitën e tij si njeri, e jo sipas veprimeve të gabuara të çdo shpirti të pamatur e të lëkundur.

Stoliseni kokën me kurorat e besueshmërisë e të besnikërisë, zemrën me rrobën e druajtjes së Perëndisë, gjuhën me vërtetësi absolute, trupat me veshjen e mirësjelljes. Këto janë me të vërtetë stoli të hijshme në ballin e njeriut, në qofshi ndër ata që mendojnë. Mbahuni, o ju njerëz të Bahá-it, pas litarit të nënshtrimit ndaj Perëndisë së Vërtetë Që është Një i Vetëm, sepse kështu pozita juaj do të bëhet e dukshme, emri juaj do të shkruhet e ruhet, rangi juaj do të ngrihet dhe kujtimi juaj do të lartësohet në Tabelën e Ruajtur. Kini mendjen

KITÁB-I-AQDAS

që banorët e tokës të mos ju bëhen pengesë në këtë pozitë të lavdishme e sublime. Kështu ju kemi këshilluar në shumë prej Letrave Tona dhe tani në këtë Tabelën Tonë të Shenjtë, mbi të cilën ka ndritur Dielli i Ligjeve të Zotit, Perëndisë suaj, të Fuqishmit, Urtiplotit.

Kur oqeani i pranisë Sime të jetë në zbatim dhe Libri i Revelacionit Tim të ketë mbaruar, kthejeni fytyrën nga Ai që Perëndia ka caktuar dhe që është degë prej kësaj Rrënje të Lashtë.

Shikoni meskitetin e mendjes së njerëzve. Ata kërkojnë atë që i dëmton dhe refuzojnë atë që u sjell përfitim. Ata janë me të vërtetë prej atyre që enden në rrugë të gabuar. Gjejmë njerëz që dëshirojnë lirinë dhe që mburren se e kanë këtë. Njerëz të tillë janë të zhytur në mosdijen më të thellë.

Liria, në fund të fundit, çon medoemos në rebelim, flakët e të cilit askush nuk mund t'i shuajë. Kështu ju paralajmëron Ai Që është Vlerësuesi, i Gjithëdijshmi. Dijeni se mishërimi i lirisë e simboli i saj është kafsha. Ajo që i ka hije njeriut është t'u nënshtrohet kufizimeve të tilla që ta mbrojnë atë nga mosdija e vet dhe ta ruajnë nga kurthet e ngatërrestarëve. Liria e bën njeriun të kalojë kufijtë e mirësjelljes dhe të shkelë dinjitetin e pozitës së tij. Ajo e ul atë deri në nivelin e shthurjes e të ligësisë së skajshme.

Shikojini njerëzit si një kope dhensh, që kanë nevojë për një bari që t'i mbrojnë. Kjo është, në fakt, e vërteta, e vërteta e padiskutueshme. Ne e miratojmë lirinë në rrethana të caktuara dhe refuzojmë ta

LIBRI MË I SHËNJTË

mbështesim atë në disa të tjera. Ne jemi, me të vërtetë, i Gjithëdijshmi.

Thuaj: liria e vërtetë qëndron në nënshtrimin e njeriut ndaj urdhërave të Mi, edhe pse ju e kuptoni aq pak këtë. Sikur njerëzit të zbatonin atë që Ne kemi dërguar nga Qielli i revelacionit, ata, me siguri, do të arrinin liri të plotë. Lum kush ka parë Qëllimin e Perëndisë në çdo gjë që ka zbuluar Ai nga Qielli i Vullnetit të Tij, që përshkon të gjitha gjërat e krijuara. Thuaj: Liria që ju sjell përfitim nuk gjendet askund, veçse në nënshtrimin e plotë ndaj Perëndisë, të Vërtetës së Përrjetshme. Kush ka shijuar ëmbëlsinë e kësaj, nuk do të pranojë ta shkëmbejë atë me tërë sundimin e tokës e të qiellit.

Në Bayán ju është ndaluar të Na bëni pyetje. Tani Zoti ju ka liruar nga ky ndalim, në mënyrë që ju të jeni të lirë të pyesni për atë që keni nevojë, por jo të bëni pyetje të kota si ato për të cilat kishin dëshirë të flisnin njerëzit e kohëve të mëparshme. Druajuni Perëndisë dhe jini ndër të drejtët! Pyesni për atë që do t'ju sjellë dobi në kauzën e Perëndisë e në mbretërinë e Tij, sepse portat e mëshirës së Tij dashamirëse janë hapur para të gjithë atyre që banojnë në qiell e mbi tokë.

Numri i muajve në një vit, i caktuar në Librin e Perëndisë, është nëntëmbëdhjetë. Prej tyre, i pari është stolisur me këtë Emër që ka mbuluar tërë krijimin.

Zoti ka urdhëruar që të vdekurit të shtihen në dhe në arkivole prej kristali, prej guri të fortë, rezistent ose prej druri që të jetë edhe i bukur edhe i qëndrueshëm, dhe që në gishtat e tyre të vihen unaza të gdhendura. Ai,

me të vërtetë, është Urdhëruesi Suprem, Ai që di gjithçka.

Mbishkrimi në këto unaza për burrat duhej të ishte: “Perëndisë i përket çdo gjë që është në qiell e mbi tokë dhe çdo gjë që ndodhet midis tyre, dhe Ai, me të vërtetë, ka dijëni për të gjitha gjërat”; kurse për gratë duhej të ishte: “Perëndisë i përket sundimi i qiejve e i tokës dhe çdo gjë që ndodhet midis tyre, dhe Ai, me të vërtetë, është i pushtetshëm mbi të gjitha gjërat”. Këto janë vargje të reveluara qëmoti, por ja, tani Pika e Bayán it shpall duke thirrur “O i Shumëdashuri i botëve! Revelo në vend të tyre të tilla fjalë, që të përhapin mbi gjithë njerëzimin aromën e favoreve Tuaja dashamirëse. Ne i kemi njoftuar gjithsecilit se edhe një fjalë e vetme nga Ti ia kalon të gjitha atyre që janë dërguar përmes Bayán it. Ti, me të vërtetë, ke pushtet të bësh atë që Të pëlqen. Mos u moho shërbëtorëve të Tu vërshimin e bujarive të oqeanit të mëshirës Sate! Ti, me të vërtetë, je Ai mëshira e të Cilit është e pafund”. Shikoni, Ne ia kemi vënë veshin thirrjes së Tij dhe tani po e plotësojmë dëshirën e Tij. Ai, me të vërtetë, është i Shumëdashuri, Përmbushësi i lutjeve. Në qoftë se në unazat e varrimit, si të burrave dhe të grave, do të gdhendet vargu i mëposhtëm, i dërguar nga Perëndia në këtë moment, kjo do të jetë më mirë për ta; Ne, sigurisht, jemi Urdhëruesi Suprem: “Unë kam ardhur nga Perëndia dhe tek Ai do të kthehem, i shkëputur nga gjithçka veç Tij, duke u mbajtur fort pas Emrit të Tij, të Mëshirshmit, Zemërdhembshurit”. Kështu Zoti zgjedh cilindo që dëshiron, si shenjë bujarie e pranisë së Tij. Ai është, me të vërtetë, Perëndia i fuqisë e i pushtetit.

LIBRI MË I SHËNJTË

Zoti ka dekretuar, veç kësaj, se të vdekurit duhet të mbështillen me pesë copë pëlhura mëndafshi ose pambuku. Për ata që kanë mjete të kufizuara është e mjaftueshme një copë e vetme e njërës prej këtyre pëlhurave. Kështu ka urdhëruar Ai Që është i Gjithëdijshmi, i Gjithëinformuari. Ju ndalohet ta transportoni trupin e të vdekurit në një largësi më të madhe se një orë rrugë nga qyteti; përkundrazi, ai duhet varrosur me madhështi e qetësi në një vend afër.

Perëndia i ka hequr kufizimet për udhëtim që ishin vendosur në Bayán. Ai, me të vërtetë, është i Padetyruari; Ai bën ç'i pëlqen dhe urdhëron atë që dëshiron.

O popuj të botës! Vëri veshin thirrjes së Atij Që është Zoti i Emrave, Që nga banesa e Tij në Burgun Më të Madh ju shpalli: “Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, të Pushtetshmit, të Fuqishmit, Gjithë-nënshtuesit, të Shumëlavdëruarit, të Gjithëdijshmit, Urtiplotit”. Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Atij, Sundimtarit të Gjithëfuqishëm të botëve. Po të ishte ky Vullneti i Tij, Ai me një fjalë të vetme që rrjedh nga prania e Tij mund të nënshtonte gjithë njerëzimin. Kini mendjen mos ngurroni të pranoni Kauzën e Tij, një Kauzë para së cilës janë përrulur Tubimi qiellor dhe banorët e Qyteteve të Emrave. Druajuni Perëndisë dhe mos jini ndër ata që janë të ndarë si me perde. Digjini perdet me zjarrin e dashurisë Sime dhe shpërndajini mjegullat e imagjinatave të kota me fuqinë e këtij Emri, përmes të cilit ne kemi nënshtuar gjithë krijimin.

Lartësoni e nderoni dy Shtëpitë në Vendet e Shenjta Binjake dhe vendndodhjet e tjera ku fronit i Zotit tuaj, Mëshirëplotit, është vendosur. Kështu ju porosit Zoti i çdo zemre që kupton.

Hapni sytë që hallet e shqetësimet e kësaj bote të mos ju pengojnë të shihni atë që ju ka urdhëruar Ai Që është i Fuqishmi, Besniku. Jini mishërime të një vendosmërie të tillë midis njerëzimit, saqë dyshimet e atyre që nuk besuan tek Ai kur u shfaq, i veshur me një sovranitet të fuqishëm, të mos ju largojnë nga Perëndia. Kini mendjen që asgjë e shkruar në Librin të mos ju pengojë t'i vini veshin këtij që është Libri i Gjallë, Që shpall të vërtetën: “Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, Më të Përsosurit, të Shumëlëvduarit”. Shiheni me syrin e drejtësisë Atë Që ka zbritur nga qielli i vullnetit e i fuqisë së Shenjtë dhe mos jini ndër ata që veprojnë në mënyrë të padrejtë.

Sillni ndërmend pastaj ato fjalë që kanë rrjedhur, si nderim për këtë Revelacion, nga Penda e Atij Që qe Lajmëtari Im dhe shihni se ç'kanë punuar gjatë tërë jetës Sime duart e shtypësve. Me të vërtetë ata numërohen ndër të humburit. Ai ka thënë: “Po të arrini në praninë e Atij Që Ne do ta shfaqim, lutjuni Perëndisë që, me bujarinë e Tij, ta lejojë Atë që të denjojë të ulet në minderët tuaj, sepse edhe vetëm ky veprim do t'ju dhuronte një nder të pakrahasueshëm e të pashoq. Sikur Ai të pinte një kupë ujë në shtëpitë tuaja, kjo do të ishte për ju e një rëndësie më të madhe sesa t'i jepnit çdo shpirti, madje çdo gjëje të krijuar, ujin e vetë jetës së saj. Dijeni këtë, o ju shërbëtorë të Mi!”

LIBRI MË I SHËNJTË

Të tilla janë fjalët me të cilat Pararendësi Im ka lëvduar Qenien Time, veç ta kuptonit këtë. Ai që reflekton për këto vargje dhe e kupton se ç'margaritarë të fshehur ruhen në to, do të ndiejë, falë drejtësisë së Perëndisë, aromën e Mëshirëplotit që përhapet nga drejtimi i këtij Burgu dhe me gjithë zemër do të nxitojë për tek Ai me një dëshirë të tillë të zjarrtë saqë ushtritë e tokës e të qiellit do të ishin të pafuqishme ta pengonin. Thuaj: Ky është një Revelacion rreth të cilit vërtitet çdo provë e dëshmi. Kështu ju është dërguar ai nga Zoti juaj, Perëndia i Mëshirës, në qofshi ndër ata që gjykojnë drejt. Thuaj: Ky është vetë shpirti i të gjitha Shkrimeve, që është fryrë në Pendën e Më të Lartit, duke lënë gojëhapur të gjitha qeniet e krijuara, me përjashtim vetëm të atyre që janë magjepsur nga flladet e lehta të dashamirësisë Sime dhe nga shijet e ëmbla të bujarive të Mia, të cilat kanë përshkuar gjithë krijimin.

O njerëz të Bayán it! Druajuni Mëshirëplotit dhe shihni ç'ka reveluar Ai në një pasazh tjetër. Ai ka thënë: “Kibla është me të vërtetë Ai Që Perëndia do Ta shfaqë; sa herë që Ai lëviz, ajo lëviz, derisa Ai të arrijë në prehje”. Kështu është dërguar nga Urdhëruesi Suprem kur deshi të përmendë këtë Bukuri Më të Madhe. Mendoni për këtë, o njerëz, dhe mos jini ndër ata që enden mendjehumbur në shkretëtirën e gabimit. Në qoftë se e refuzoni Atë, duke iu nënshtruar fantazive tuaja të kota, atëherë ku është Kibla ndaj së cilës ju do të ktheni fytyrat, o turmë e shkujdesur? Peshojeni këtë varg dhe gjykoni me drejtësi para Perëndisë, që ndoshta të mund të qëmtoni margaritarët e mistereve nga ai

KITÁB-I-AQDAS

oqean që dallgëzohet në Emrin T'im, Lavdiplotit, Më të Lartit.

Askush, në këtë Ditë, të mos mbahet fort pas asgjëje, veç asaj që është shfaqur në këtë Revelacion. I tillë është urdhëri i Perëndisë, qëmoti e paskëtaj, urdhër me të cilin janë stolisur Shkrimet e Lajmëtarëve të së kaluarës. I tillë është paralajmërimi i Zotit, qëmoti e paskëtaj, paralajmërim me të cilin është zbukuruar hyrja në Librin e Jetës, veç ta kuptonit këtë. E tillë është porosia e Zotit, qëmoti e paskëtaj; kini mendjen që në vend të kësaj të mos zgjidhni pjesën e turpit e të poshtërit. Asgjë nuk do t'ju sjellë dobi në këtë Ditë, veç Perëndisë, dhe as ka strehë ku të fshihesh, veç Atij, të Gjithëdijshmit, Urtiplotit. Kush më ka njohur Mua ka njohur Synimin e çdo dëshire, dhe kush është kthyer ndaj Meje është kthyer ndaj Objektit të çdo adhurimi. Kështu është shkruar në Librin dhe kështu ka urdhëruar Perëndia, Zoti i të gjitha botëve. Të lexosh qoftë edhe një prej vargjeve të Revelacionit T'im është më mirë sesa të shqyrtosh Shkrimet si të brezave të mëparshëm dhe të mëvonshëm. Kjo është Fjala e Mëshirëplotit, po të keni veshë për ta dëgjuar! Thuaj: Ky është thelbi i dijes, veç ta kuptonit këtë.

Dhe tani shihni se ç'është reveluar edhe në një pasazh tjetër, se ndoshta hiqni dorë nga konceptet tuaja dhe i ktheni fytyrat ndaj Perëndisë, Zotit të genies. Ai⁵ ka thënë: "Është e paligjshme të lidhësh martesë, veçse me ndonjë që beson në Bayán in. Po që se vetëm njëra palë e martesës e përqafton këtë Kauzë, zotërimet e tij

⁵ Báb-i.

LIBRI MË I SHËNJTË

ose të saj bëhen të paligjshme për palën tjetër, derisa kjo e fundit të jetë kthyer në këtë fe. Por ky ligj do të hyjë në fuqi vetëm pas lartësimit të Kauzës së Atij Që Ne me të vërtetë do ta shfaqim, ose të asaj që me të drejtë është shfaqur tashmë. Deri atëherë jeni të lirë të lidhni martesë si të dëshironi, që të mund të lartësoni Kauzën e Perëndisë”. Kështu ka kënduar Bilbili me zë të ëmbël mbi degën qiellore, duke lëvduar Zotin e tij, Mëshirëplotin. Lum ata që i venë veshin.

O njerëz të Bayán it, ju përgjërohëm për Zotin tuaj, Perëndinë e mëshirës, të shikoni me syrin e drejtësisë këtë thënie që është dërguar përmes fuqisë së të vërtetës dhe të mos jini ndër ata që e shohin dëshminë e Perëndisë por e refuzojnë dhe e mohojnë atë. Ata, me të vërtetë, janë prej atyre që me siguri do të mbarojnë. Pika e Bayán it e ka përmendur shprehimisht në këtë varg lartësimin e Kauzës Sime mbi vetë Kauzën e Tij; për këtë do të dëshmojë çdo mendje e drejtë e që kupton. Siç mund ta shihni sot, lartësimi i saj është i tillë që askush nuk mund ta mohojë, veç atyre sytë e të cilëve janë të dehur në këtë jetë të vdekshme dhe që i pret një ndëshkim poshtërues në jetën e ardhshme.

Thuaj: Për drejtësinë e Perëndisë! Unë jam, me të vërtetë, i Shumëdashuri i Tij⁶; dhe në këtë çast Ai i dëgjon këto vargje që zbresin nga Qielli i Revelacionit dhe vajton për të këqiat që ju keni bërë në këtë ditë. Druajuni Perëndisë dhe mos u bashkoni me agresorin. Thuaj: O njerëz, po të vendosni të mos besoni tek Ai⁷,

⁶ Bahá'u'lláh·u.

⁷ Bahá'u'lláh·u.

të paktën mos u ngrini kundër Tij. Për Perëndi! Mjaftojnë hordhitë e tiranisë që janë lidhur kundër Tij!

Me të vërtetë, Ai⁸ reveloi disa ligje, kështu që në këtë Dispensacion Penda e Më të Lartit mund të mos kishte nevojë të lëvizte për asgjë veçse për t'i thurur lavde vetë Pozitës së Vet të lartësuar dhe Bukurisë së Vet më të ndritshme. Por, duke qenë se kemi dashur të tregojmë bujarinë Tonë ndaj jush, me fuqinë e së vërtetës kemi formuluar qartë këto ligje dhe kemi zbutur atë që Ne dëshirojmë që ju të zbatoni. Ai, me të vërtetë, është Dorëhapuri, Fisniku.

Ai⁹ ju ka bërë të njohur që më parë atë që do të thuhej nga ky Agim i urtisë Hyjnore. Ai ka thënë, dhe ka folur të vërtetën: “Ai¹⁰ është Personi Që në të gjitha rrethanat do të shpallë: ‘Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, të Vetmit, të Pakrahasueshmit, të Gjithëdijshmit, të Gjithinformuarit’”. Kjo është një pozitë që Perëndia ia ka caktuar vetëm këtij Revelacioni sublim, unik e të mahnitshëm. Kjo është një shenjë e mirësisë së Tij bujare, në qofshi ndër ata që kuptojnë, dhe një provë e urdhërit të Tij të pakundërshtueshëm. Ky është Emri i Tij Më i Madh, Fjala e Tij Më e Lartësuar dhe Agimi i Titujve të Tij Më të Përsosur, veç po ta kuptonit. Madje për më tepër, përmes Tij shfaqet çdo Burim, çdo Vendagim udhërrëfimi hyjnor. Mendoni, o njerëz, për atë që me të vërtetë është dërguar; peshojeni këtë dhe mos u bëni mëkatarë.

⁸ Báb·i.

⁹ Báb·i.

¹⁰ Bahá'·u'lláh·u.

LIBRI MË I SHËNJTË

Afrohuni me të gjitha fetë në miqësi e mirëkuptim, që ato të mund të thithin prej jush aromën erëmirë të Perëndisë. Kini mendjen që midis njerëzve të mos ju mposhtë flaka e injorancës së çmendur. Të gjitha gjërat vinë nga Perëndia dhe tek Ai kthehen. Ai është burimi i të gjitha gjërave dhe tek Ai përfundojnë të gjitha gjërat.

Kini kujdes mos hyni në asnjë shtëpi në mungesë të pronarit të saj, veçse me lejen e tij. Silluni në mënyrë të hijshme në të gjitha kushtet dhe mos jini ndër ata që numërohen midis të pabindurve.

Jeni urdhëruar të dëlirni mjetet tuaja të jetesës dhe gjëra të tjera si këto nëpërmjet pagimit të Zeqatit. Kështu porosit në këtë Tabelë të lavdëruar Ai Që është Reveluesi i vargjeve. Në qoftë dëshira e qëllimi i Perëndisë, Ne së shpejti do të caktojmë masën e këtij tatimi. Ai, me të vërtetë, falë vetë dijes së Tij, shtjellon çdo gjë që do dhe Ai, me të vërtetë, është i Gjithë-dijshëm e Urtoplote.

Është e paligjshme të lypësh dhe është e ndaluar t'i japësh atij që lyp. Të gjithë janë urdhëruar të fitojmë jetesën, dhe përsa u përket atyre që nuk janë të aftë ta bëjnë këtë, u takon të Dërguarve të Perëndisë dhe të pasurve të kujdesen në mënyrë të mjaftueshme për ta. Përmbajuni ligjeve e porosive të Perëndisë; madje ruajini ato si sytë tuaj dhe mos jini ndër ata që pësojnë humbje të rëndë.

Në Librin e Perëndisë ju është ndaluar të përzieheni në grindje e konflikte, të goditni tjetrin ose të kryeni veprime që mund të brengosin zemra e shpirtra. Një gjobë prej nëntëmbëdhjetë mithqalësh ar ka qenë

KITÁB-I-AQDAS

caktuar më parë nga Ai Që është Zoti i gjithë njerëzimit për cilindo që i shkaktonte hidhërim tjetrit; megjithatë, në këtë Dispensacion Ai ju ka liruar nga kjo dhe ju këshillon të tregoni ndershmëri e devotshmëri. E tillë është porosia që ju jep juve Ai në këtë Tabelë të ndritur. Mos dëshironi për të tjerët atë që nuk e dëshironi për veten tuaj; druajuni Perëndisë dhe mos u bëni mendjemëdhenj. Ju të gjithë jeni krijuar nga uji dhe në pluhur do të ktheheni. Mendoni për fundin që ju pret dhe mos ecni në shtigjet e shtypësit. Vëriuni veshin vargjeve të Perëndisë, që ju këndon Ai Që është Pema e shenjtë e Lotusit. Ato janë me siguri peshorja e pagabueshme, e vendosur nga Perëndia, Zoti i kësaj bote dhe i asaj të ardhshme. Përmes tyre shpirti i njeriut merr fluturimin drejt Agimit të Revelacionit dhe zemra e çdo besimtari të vërtetë mbushet me dritë. Të tilla janë ligjet të cilave Perëndia ju ka urdhëruar t'u përmbaheni, të tilla janë porositë që ju jepen në Tabelën e Tij të Shenjtë; bindjuni atyre me gëzim e hare, sepse kështu është më mirë për ju, veç ta dinit këtë.

Recitojini vargjet e Perëndisë çdo mëngjes e mbrëmje. Ai që nuk i reciton ato, me të vërtetë nuk i ka qëndruar besnik Besëlidhjes së Perëndisë e Testamentit të Tij, dhe kush largohet prej këtyre vargjeve në këtë Ditë, me të vërtetë është ndër ata që në përjetësi janë larguar prej Perëndisë. Druajuni Perëndisë, o shërbëtorë të Mi, secili e të gjithë bashkë. Mos u mburrni me leximin e tepërt të vargjeve dhe me kryerjen e shumë veprave të devotshme natë e ditë; sepse sikur njeriu të lexonte vetëm një varg me ngazëllim e fytyrëndritur, do të ishte më mirë sesa të lexonte me lodhje të gjithë

LIBRI MË I SHËNJTË

Librat e Shenjtë të Perëndisë, Ndhimës në Rrezik, të Vetëqenëshmit. Lexojini vargjet e shenjta aq sa të mos ju mposhtë këputja e shkurajimi. Mos i ngarkoni shpirtrat tuaj me atë që ju shkakton rraskapitje e rënie, por me atë që i ndriçon e i ngre ato, që të mund të fluturojnë mbi krahët e vargjeve Hyjnore drejt Vendagimit të shenjave të dukshme të Tij; kjo do t'ju çojë më pranë Perëndisë, veç ta kuptonit këtë.

Mësojuni fëmijëve tuaj vargjet e reveluara nga qielli i madhështisë e i pushtetit, që ata, me zërat më të melodishëm, të recitojnë Tabelat e Mëshirëplotit në mjediset e Mashrikul Azkarëve. Cilido që është rrëmbyer nga ekstaza e lindur prej adhurimit të Emrit Tim, Më Zemërdhembshurit, do të këndojë vargjet e Perëndisë në mënyrë të tillë që të pushtojë zemrat e atyre që ende janë të mbështjellë në dremitje. Lum ai që ka shijuar Verën Mistike të jetës së pasosur nga fjala e Zotit të tij të mëshirshëm në Emrin Tim, emër përmes të cilit çdo mal i lartë e madhështor është bërë pluhur.

Jeni urdhëruar të përtërinini orenditë e pajimet e shtëpive tuaja pas kalimit të nëntëmbëdhjetë viteve; kështu ka urdhëruar Ai Që është i Gjithëdijshtëm e Gjithëshikues. Ai, me të vërtetë, dëshiron sqimë si për vetë ju dhe për gjithçka zotëroni; mos lini pasdore druajtjen nga Perëndia dhe mos jini të shkujdesur. Kush sheh se mjetet e tij janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, është falur nga Perëndia, Gjithmonëfalësi, Më Bujari.

Lani këmbët çdo ditë në verë dhe një herë në tri ditë në dimër.

KITÁB-I-AQDAS

Nëse ndonjëri zemërohet me ju, përgjigjuni atij me mirësjellje; dhe nëse ndonjëri ju qorton, mos ia ktheni me qortime, por lëreni të qetë dhe kini besim te Perëndia, Shpagimtari i gjithëfuqishëm, Zoti i fuqisë e i drejtësisë.

Ju është ndaluar të përdorni amvona. Ai që dëshiron t'ju recitojë vargjet e Zotit të tij, le të ulet në një karrige të vendosur mbi një podium, që të përmendë Perëndinë, Zotin e tij dhe Zotin e gjithë njerëzimit. Perëndia kënaqet që ju të uleni në karrige e stola, si shenjë nderimi për dashurinë që keni për Të dhe për Manifestimin e Kauzës së Tij të lavdishme e të ndritshme.

Kumari dhe përdorimi i opiumit janë të ndaluara për ju. Ruhuni prej tyre, o njerëz, dhe mos jini ndër ata që mëkatojnë. Kini kujdes mos përdorni lëndë që shkaktojnë plogështi e topitje në tëmthat e njeriut dhe i bëjnë dëm trupit. Ne, me të vërtetë, nuk dëshirojmë për ju asgjë veç asaj që ju sjell dobi dhe për këtë dëshmojnë të gjitha gjërat e krijuara, në paçi veshë të dëgjoni.

Sa herë t'ju ftojnë në gosti ose në ndonjë rast feste, pranoni me gëzim e hare, dhe kushdo që përmbush premtimin e tij nuk do të qortohet. Kjo është një Ditë në të cilën është sqaruar secili prej vendimeve të urta të Perëndisë.

Shikoni, “misteri i Ndryshimit të Madh në Shenjën e Sovranit” tani është shfaqur. Lum ai që Perëndia e ka ndihmuar të njohë “Gjashtën” e ngritur falë këtij “Elifi të Drejtë”; ai vërtet është ndër ata, besa e të cilëve është e sinqertë. Sa të devotshëm nga jashtë kanë ndërruar

LIBRI MË I SHËNJTË

rrugë, dhe sa të paqëndrueshëm janë afruar pranë duke thirrur: “Gjithë lavdia qoftë mbi Ty, O Ti Dëshira e botëve!” Me të vërtetë, është në dorë të Perëndisë t’i japë atë që do cilitdo që Ai dëshiron dhe t’i mohojë atë që i pëlqen kujtdo që Ai dëshiron. Ai di të fshehtat e brendshme të zemrave dhe domethënien e fshehur në një lëvizje syri të tallësit. Sa mishërime të shkujdesjes, që kanë ardhur te Ne me zemër të dëlirë, i kemi vendosur në stolin e pranimit Tonë; dhe sa përfaqësues të urtisë Ne me plot të drejtë ia kemi dorëzuar zjarrit. Ne jemi, me të vërtetë, i Vetmi që gjykon. Ai Që është manifestimi i “Perëndia bën ç’i pëlqen” dhe qëndron mbi fronin e “Ai urdhëron çdo gjë që vendos”.

I bekuar është ai që zbulon aromën e domethënieve të brendshme nga gjurmët e kësaj Pende, përmes lëvizjes së të cilës filladet e Perëndisë përhapen mbi gjithë krijimin dhe përmes palëvizshmërisë së të cilës vetë thelbi i qetësisë shfaqet në botën e qenies. Lëvduar qoftë Mëshirëploti, Reveluesi i një bujarie kaq të paçmuar. Thuaj: Meqenëse Ai mbante mbi shpatulla padrejtësinë, mbi tokë u shfaq drejtësia, dhe meqenëse Ai pranoi poshtërimin, madhështia e Perëndisë shkëlqeu midis njerëzimit.

Ju ndalohet të mbani armë, veçse kur është e domosdoshme, dhe ju lejohet të visheni me mëndafsh. Zoti ju ka liruar, si shenjë e bujarisë së Tij, nga kufizimet që zbatoheshin më parë për veshjen dhe për prerjen e mjekrës. Ai, me të vërtetë, është Urdhëruesi, i Gjithëdijshmi. Le të mos ketë në sjelljen tuaj asgjë që mendjet e shëndosha e të drejta nuk do ta pëlqenin, dhe mos e bëni veten lojë të injorantit. Lum ai që e ka

KITÁB-I-AQDAS

stolisur veten me rrobën e sjelljes së hijshme e me karakter të lavdërueshëm. Ai me siguri numërohet ndër ata që e ndihmojnë Zotin e tyre përmes veprash të shquara e të rëndësishme.

Mbështetni zhvillimin e qyteteve të Perëndisë e të vendeve të Tij dhe lavdërojeni në to Atë me fjalët e gëzueshme të të shumëdashurve të Tij. Me të vërtetë, zemrat e njerëzve ndërtohen me fuqinë e gjuhës, ashtu si shtëpitë e qytetet ndërtohen me duar e me mjete të tjera. Ne kemi caktuar për çdo synim një mjet për përmbushjen e tij; përfitoni nga kjo dhe mbështeteni besimin te Perëndia, i Gjithëdijshmi, Urtiploti.

I bekuar është njeriu që shpall besimin e tij te Perëndia e shenjat e Tij dhe e di se “Atij nuk do t’i kërkohet llogari për bëmat e Tij”. Një njohje të tillë Perëndia e ka bërë stolinë e çdo besimi dhe vetë themelin e tij. Nga kjo varet pranimi i çdo vepre të mirë. Mbërthejini sytë në këtë, se ndoshta kështu nuk shkisni në rrugë të gabuar nga pëshpëritjet e rebelëve.

Edhe sikur Ai të shpallte si të ligjshme atë që prej kohësh që s’mbahen mend ka qenë e ndaluar dhe të ndalonte atë që në çdo kohë ka qenë konsideruar si e ligjshme, askush nuk ka të drejtë të vërë në dyshim autoritetin e Tij. Kush do të ngurronte, qoftë edhe për më pak se një çast, do të shihej si shkelës.

Kushdo që nuk e ka njohur këtë të vërtetë sublime e themelore dhe nuk e ka arritur këtë pozitë kaq të lartësuar, do të rrëmbehet nga erërat e dyshimit dhe thëniet e të pabesëve do t’i tronditin shpirtin. Kush e ka njohur këtë parim, do të marrë dhuntinë e qëndruesh-

LIBRI MË I SHËNJTË

mërisë më të përsosur. Nder kësaj pozite lavdiplote, përmendja e së cilës stolis çdo Tabelë të lartësuar. Ky është mësimi që ju jep Perëndia, një mësim që do t'ju çlirojë prej çdo lloj dyshimi e mëdyshjeje dhe do t'ju japë mundësi të arrini shpëtimin si në këtë botë dhe në tjetrën. Ai, me të vërtetë, është Gjithmonëfalësi, Më Zemërgjeri. Është Ai Që ka çuar Lajmëtarët dhe ka dërguar Librat për të shpallur “Nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, të Gjithëfuqishmit, Urplotit”.

O Tokë e Káf-it dhe e Rá-së!¹¹ Ne, me të vërtetë, të vërejmë ty në një gjendje të papëlqyeshme për Perëndinë dhe shohim se nga ti buron ajo që është e padepërtueshme për cilindo, veç Atij, të Gjithëdijshtit, të Gjithinformuarit; dhe dallojmë atë që përhapet prej teje fshehurazi e tinëzisht. Me Ne është dija e të gjitha gjërave, e shkruar në një Tabelë të kthjellët. Mos u hidhëro për atë që të ka ndodhur. Së shpejti Perëndia do të nxjerrë brenda teje njerëz të pajisur me guxim të madh, të cilët do të madhërojnë Emrin Tëm me aq qëndrueshmëri saqë as do të zbrapsen nga këshillat e liga të teologëve dhe as do të pengohen nga insinuatat e mbjellësve të dyshimit. Ata do të soditin me sytë e vet Perëndinë dhe me vetë jetët e tyre do ta bëjnë Atë fitimtar. Këta, me të vërtetë, janë ndër të vendosurit.

O turmë teologësh! Kur vargjet e Mia u dërguan këtu dhe shenjat e Mia u reveluan, Ne ju gjetëm pas perdeve. Kjo është, me të vërtetë, një gjë e çuditshme. Ju lëvdoheni me emrin Tëm e megjithatë nuk më njihni Mua në një kohë që Zoti juaj, Mëshirëploti, është

¹¹ Kirman-i.

KITÁB-I-AQDAS

shfaqur midis jush me prova e dëshmi. Ne i kemi çarë perdet. Kini mendjen mos i ndani njerëzit me një perde tjetër. Këputni zinxhirët e imagjinatave të kota, në emër të Zotit të të gjithë njerëzve, dhe mos jini mashtrues. Po qe se ktheheni ndaj Perëndisë dhe përqafoji Kauzën e Tij, mos përhapni çrregullime brenda saj dhe mos e matni Librin e Perëndisë me dëshirat tuaja egoiste. Kjo është, me të vërtetë, këshilla e Perëndisë në të shkuarën e në të ardhmen dhe për këtë dëshmojnë solemnisht dëshmitarët e të zgjedhurit e Perëndisë, po, të gjithë e secili prej Nesh.

Sillni ndërmend sheikun që e kishte emrin Muḥammad-Ḥasan], i cili radhitej ndër teologët më të ditur të kohës së tij. Kur i Vërteti u shfaq, ky sheik, bashkë me të tjerë të zanatit të tij, E refuzoi Atë, ndërsa një sitës gruri e elbi E pranoi dhe u kthye ndaj Zotit. Edhe pse merrej ditë e natë me shtjellimin e atyre që i konceptonte si ligje e porosi të Perëndisë, por kur Ai Që është i Padetyruari u shfaq, asnjë garmë e tyre nuk i vlejti, ndryshe ai nuk do t'i kish kthyer shpinën një Fytyre që ka ndriçuar zemrat e të shumëdashurve të Zotit. Po të kishit besuar në Perëndinë kur Ai e shfaqti Vetën, njerëzit nuk do t'i kishin kthyer shpinën Atij dhe as gjërat që shohim sot nuk do të Na kishin ndodhur. Druajuni Perëndisë dhe mos jini ndër të shkujdesurit.

Kini mendjen që ndonjë emër të mos ju mbajë larg Atij Që është Zotëruesi i të gjithë emrave, ose që ndonjë fjalë t'ju ndajë prej kësaj Kujtese të Perëndisë, këtij Burimi Urtie midis jush. Kthehuni ndaj Perëndisë dhe kërkoni mbrojtjen e Tij, o turmë teologësh, dhe mos e bëni veten tuaj një perde në mes Meje dhe krijesave të

Mia. Kështu ju këshillon Zoti juaj dhe ju porosit të jeni të drejtë, që bëmat tuaja të mos shkojnë kot dhe ju vetë të mos harroni premtimin tuaj. A do të jetë në gjendje ai që e mohon këtë Kauzë të provojë të vërtetën e çfarëdo kauze në gjithë krijimin? Jo, për Atë Që është Artuesi i gjithësisë! E megjithatë njerëzit janë të mbështjellë me një perde të prekshme. Thuaj: Përmes kësaj Kauze ka aguar dielli i dëshmisë dhe ylli i provës ka përhapur rrezatimin e tij mbi të gjithë ata që banojnë mbi tokë. Druajuni Perëndisë, o njerëz me intuitë, dhe mos jini ndër ata që nuk besojnë tek Unë. Kini mendjen që fjala “Profet” të mos ju largojë nga ky Lajm Më i Madh, ose që çdo referim ndaj “Mëkëmbësisë” të mos ju ndalojë të njihni sovranitetin e Atij Që është Mëkëmbësi i Perëndisë, sovranitet që përfshin të gjitha botët. Çdo emër është krijuar nga Fjala e Tij dhe çdo kauzë varet prej Kauzës së Tij të pamposhtur, të fuqishme e të mahnitshme. Thuaj: Kjo është Dita e Perëndisë, Dita në të cilën asgjë nuk do të përmendet veç Vetes së Tij, Mbrojtësit të gjithëfuqishëm të të gjitha botëve. Kjo është Kauza që ka bërë të dridhen të gjitha bestytnitë e idhujt tuaj.

Me të vërtetë, shohim midis jush atë që është kapur pas Librit të Perëndisë dhe citon prej tij prova e argumente për të mohuar Zotin e tij, po ashtu si pasuesit e çdo Besimi tjetër kanë kërkuar arsye në Librat e Shenjtë të tyre për të mohuar Atë Që është Ndihma në Rrezik, i Vetëqenëshmi. Thuaj: Perëndia i Vërtetë Që është Një i Vetëm, më është dëshmitar se, në këtë Ditë, as Shkrimet e botës, as të gjithë librat e shkrimet që ekzistojnë, nuk do t’ju sjellin ndonjë dobi pa këtë, që

KITÁB-I-AQDAS

është Libri i Gjallë, Që mu në vetë zemrën e krijimit shpall: “Me të vërtetë, s’ka Perëndi tjetër veç Meje, të Gjithëdijshmit, Urtoplótit”.

O turmë teologësh! Kini mendjen që të mos jeni shkak grindjesh mbi tokë, ashtu siç ishit shkak i refuzimit të Besimit në kohët e tij të hershme. Mblidhini njerëzit rreth kësaj Fjale, që i ka bërë gurët të thërrasin: “Mbretëria është e Perëndisë, Vendagim i të gjitha shenjave!” Kështu ju paralajmëron Zoti juaj, si shenjë zemërgjerësie nga ana e Tij; Ai, me të vërtetë, është Gjithmonëfalësi, Më Fisniku.

Sillni ndërmend Karím in dhe sesi, kur Ne e thirrëm atë para Perëndisë, ai, i shtyrë nga dëshirat e tij, u bë mospërfillës; e pra, Ne i patëm dërguar atij atë që ishte një ngushëllim për syrin e provës në botën e qenies dhe përbushje e dëshmisë së Perëndisë për të gjithë banorët e tokës e të qiellit. Në shenjë mëshire të Atij Që është Zotëruesi i Gjithçkaje, Më i Larti, Ne e urdhëruam atë të përqafonte të Vërtetën. Por ai u largua derisa, si një akt drejtësie nga ana e Perëndisë, engjëjt e zemërimit e pushtuan. Për këtë Ne ishim me të vërtetë dëshmitar.

Grisini perdet në mënyrë të tillë që banorët e Mbretërisë t’i dëgjojnë të çahen. Ky është urdhëri i Perëndisë, në kohët e shkuara dhe për ato që do të vinë. Lum njeriu që i përmbahet asaj që i është urdhëruar dhe mjerë moskokëçarësi.

Ne, të jeni të sigurt, nuk kemi pasur ndonjë synim në këtë mbretëri tokësore, veçse të shfaqnim Perëndinë dhe të revelonim sovranitetin e Tij; Mua më mjafton që Perëndia më është dëshmitar. Ne, të jeni të sigurt, nuk

LIBRI MË I SHËNJTË

kemi pasur ndonjë synim në Mbretërinë qiellore, veçse të lartësonim Kauzën e Tij dhe t'i thurnim lavdi Atij; Mua më mjafton që kam mbrojtjen e Perëndisë. Ne, të jeni të sigurt, nuk kemi pasur ndonjë dëshirë në Zotërimin qiellor, veçse të lëvdonim Perëndinë dhe atë që Ai ka dërguar këtu; Mua më mjafton që kam ndihmën e Perëndisë.

Lum ju, o njerëz të ditur të Bahá-it. Për Zotin! Ju jeni tallazet e Oqeanit Më të Fuqishëm, yjet e qiellit të Lavdisë, flamujt e triumfit, që valëviten midis tokës e qiellit. Ju jeni manifestimet e vendosmërisë midis njerëzve dhe Agimet e Fjalës Hyjnore për të gjithë ata që banojnë mbi tokë. Lum ai që e kthen fytyrën ndaj jush dhe mjerë kokëfortët. Në këtë ditë i takon atij që ka shijuar Verën Mistike të jetës së pasosur nga Duart e dashamirësisë së Zotit Perëndisë së tij, të Mëshirshmit, të pulsojë ashtu si arteria në trupin e njerëzimit, që përmes tij të gjallërohet bota dhe çdo eshtër e thërrmuar.

O popuj të botës! Kur Pëllumbi Mistik të ketë nisur fluturimin e tij nga Altari i Lavdisë dhe të ketë arritur synimin e tij të largët, banesën e tij të fshehtë, për çdo gjë që nuk kuptoni në Librin drejtojuari Atij Që është degëzuar nga ky Trung i fuqishëm.

O Pendë e Më të Lartit! Lëviz Ti mbi Tabelë me urdhër të Zotit Tënd, Krijues i Qiejve, dhe trego për kohën kur Ai Që është Agimi i Unitetit Hyjnor vuri si qëllim të drejtë hapat e Tij ndaj Shkollës së Njëshmërisë së Përkryer; ndoshta ata që kanë zemër të dëlirë mund të hedhin falë kësaj një vështrim, qoftë

KITÁB-I-AQDAS

edhe sa një vrimë gjilpëre, në misteret e Zotit Tënd, Fuqplotit, të Gjithëdijshmit, që rrinë të fshehura pas perdeve. Thuj: Ne, me të vërtetë, hymë në Shkollën e domethënies së brendshme e të shpjegimit, kur të gjitha gjërat e krijuara ishin të pavetëdijshme. Ne pamë fjalët e dërguara prej Atij Që është Mëshirëploti, dhe i pranuan vargjet e Perëndisë, të Ndihmës në Rrezik, të Vetëqenëshmit, që Ai¹² Na parashtroi, dhe i vumë veshin asaj që Ai kishte pohuar solemnisht në Tabelë. Këtë ne me siguri e pamë. Dhe e miratuam dëshirën e Tij përmes urdhërit Tonë, sepse Ne me të vërtetë kemi pushtet të urdhërojmë.

O njerëz të Bayán it! Ne, me të vërtetë, hymë në Shkollën e Perëndisë kur ju dremitnit; dhe e studiuam Tabelën ndërkohë që ju ishit në gjumë të rëndë. Për Perëndinë e vërtetë Që është Një! Ne e lexuam Tabelën para se ajo të revelohej, në një kohë që ju nuk dinit gjë për këtë, dhe kishim dijeni të plotë për Librin kur ju ende nuk kishit lindur. Këto fjalë janë për përmasat tuaja, jo të Perëndisë. Për këtë dëshmon ajo që ruhet në thesarin e dijes së Tij, në qofshi ndër ata që kuptojnë; dhe për këtë dëshmon gjuha e Fuqplotit, në qofshi ndër ata që marrin vesh. Betohem për Perëndi, sikur Ne ta ngrinim perden, ju do të mbeteshit të befashuar.

Kini mendjen, mos u hani më kot lidhur me Fuqplotin e Kauzën e Tij, sepse ja! Ai është shfaqur midis jush i veshur me një Revelacion aq të madh sa që përfshin të gjitha gjërat, të së kaluarës e të së ardhmes qofshin. Sikur Ne ta shtjellonim temën Tonë duke folur

¹² Báb-i.

LIBRI MË I SHËNJTË

në gjuhën e banorëve të Mbretërisë, do të thoshnim: “Në të vërtetë, Perëndia e krijoi atë Shkollë para se Ai të krijonte qiellin e tokën, dhe Ne kemi hyrë në të para se shkronjat L, T dhe B të bashkoheshin e të gërshetoheshin”. E tillë është gjuha e shërbëtorëve Tanë në Mbretërinë Tonë; kini parasysh se çfarë do të fliste gjuha e banorëve të Zotërimit Tonë të lavdëruar, sepse Ne u kemi mësuar atyre dijen Tonë dhe u kemi reveluar çdo gjë që rrinte e fshehur në urtinë e Perëndisë. Pa mendoni, pra, çfarë do të fliste Gjuha e Fuqisë dhe e Madhësisë në Banesën e Tij Lavdiplotë!

Kjo nuk është një Kauzë që mund të bëhet lojë e fantazive tuaja të kota, dhe as është një fushë për të marrët e frikamanët. Për Perëndi, kjo është arena e intuitës dhe e shkëputjes, e vizionit dhe e ndërtimit, ku askush nuk mund ta lëshojë kalin revan, veç kalorësve të guximshëm të të Mëshirshmit, që kanë prerë çdo lidhje me botën e qenies. Me të vërtetë janë këta që e bëjnë Perëndinë fitimtar mbi tokë, ata janë vendagimet e fuqisë së Tij sovrane midis njerëzimit.

Kini mendjen se mos ajo që është reveluar në Bayán in ju largon nga Zoti juaj, Më Zemërdhembshuri. Perëndia më është dëshmitar se Bayán i është dërguar për të vetmin qëllim që të më thurë lavde Mua, veç ta dinit! Zemërdëlirët do të gjejnë në të vetëm aromën e dashurisë Sime, vetëm Emrin Tim që mbulon me hijen e tij çdo gjë që sheh e shihet. Thuaj: Kthejeni, o njerëz, fytyrën ndaj asaj që ka buruar prej Pendës Sime të Shumëlavdëruar. Po të thithni që andej aromën e Perëndisë, mos e vini veten kundër Tij, as mos i mohoni vetvetes një pjesë të favorit të Tij dashamirës e të

KITÁB-I-AQDAS

dhuratave të Tij të shumta. Kështu ju paralajmëron Zoti tuaj; Ai, me të vërtetë, është Këshilluesi, i Gjithëdijshmi.

Për çdo gjë që nuk kuptoni në Bayán in, pyetni Perëndinë, Zotin tuaj dhe Zotin e stërgjyshërve tuaj. Në dashtë, Ai do t'ju shpjegojë atë që është zbuluar në të, dhe do t'ju zbulojë margaritarët e dijes e të urtisë Hyjnore që fshihen në oqeanin e fjalëve të tij. Ai, me të vërtetë, është më i larti ndër të gjithë emrat; nuk ka Perëndi tjetër veç Tij, Ndihmës në Rrezik, të Vetëqenëshmit.

Drejttrashimi botëror është tronditur nga ndikimi drithërues i këtij Rendi Botëror madhështor e të ri. Jeta e organizuar e gjinisë njerëzore është revolucionarizuar nga veprimi i këtij Sistemi të pashoq, të mahnitshëm, të ngjashëm me të cilin sy të vdekshëm kurrë s'kanë parë.

Zhytuni në oqeanin e fjalëve të Mia, që të gjeni sekretet e tij dhe të zbuloni të gjithë margaritarët e urtisë që fshihen në thellësitë e tij. Kujdes të mos ngurroni në vendosmërinë tuaj për të përqafuar të vërtetën e kësaj Kauze, një Kauzë përmes së cilës potencialet e fuqisë së Perëndisë janë zbuluar e është vendosur sovraniteti i Tij. Me fytyrat që ju shkëlqejnë nga gëzimi, nxitoni tek Ai. Ky është Besimi i pandryshueshëm i Perëndisë, i përjetshëm në të shkuarën, i përjetshëm në të ardhmen. Bëj që kush e kërkon ta arrijë atë; dhe sa për atë që ka refuzuar ta kërkojë, Perëndia është me të vërtetë i Vetëmjaftueshëm, mbi çdo nevojë të krijesave të Tij.

Thuaj: Kjo është Peshorja e pagabueshme që e mban Dora e Perëndisë, me të cilën të gjithë ata që janë në qiell dhe të gjithë ata që janë mbi tokë peshohen e

LIBRI MË I SHËNJTË

përcaktohet fati i tyre, në qofshi ndër ata që e besojnë dhe e njohin këtë të vërtetë. Thuaj: Kjo është Dëshmia Më e Madhe, përmes së cilës është treguar në të gjitha kohët vlera e çdo prove, sikur të ishit të sigurt për këtë. Thuaj: përmes saj të varfërit janë pasuruar, të diturit janë ndriçuar dhe kërkuesit kanë mundur të ngjiten në prani të Perëndisë. Kini mendjen mos e bëni atë shkak mosmarrëveshjeje në mes jush. Qëndroni të patundur, si male të palëvizshme, në kauzën e Zotit tuaj, të Fuqishmit, Dashuruesit.

Thuaj: O burim zvetërimi! Hiq dorë nga verbëria jote kryeneçe dhe fol të vërtetën midis njerëzve. Betohem për Perëndi se kam qarë për ty, duke të parë të rendësh pas pasioneve të tua egoiste dhe të mohosh Atë Që të ka artuar e të ka sjellë në jetë. Sill ndërmend mëshirën e dhembshur të Zotit tënd dhe kujto sesi të kemi ushqyer ditë e natë për t'i shërbyer Kauzës. Druaju Perëndisë dhe ji ndër të penduarit e vërtetë. Duke pranuar se njerëzit ishin të çoroditur lidhur me pozitën tënde, a mund të mendohet se edhe ti vetë ke qënë po ashtu i çoroditur? Dridhu para Zotit tënd dhe kujto ditët kur ti qëndroje para fronit Tonë dhe shkruaje vargjet që Ne të diktonim, vargje të dërguara nga Perëndia, Mbrojtësi i Gjithëfuqishëm, Zoti i fuqisë e i pushtetit. Ki mendjen se mos zjarri i fodullëkut tënd të ndalon të hysh në Oborrin e Shenjtë të Perëndisë. Ktheje fytyrën ndaj Tij dhe mos ki frikë për shkak të bëmave tuaja. Ai, me të vërtetë, fal cilindo që dëshiron, si shenjë zemërgjerësie nga ana e Tij; nuk ka Perëndi tjetër veç Tij, Gjithmonëfalësit, Bujariplotit. Ne të qortojmë vetëm për hir të Perëndisë. Po ta pranosh këtë këshillë,

KITÁB-I-AQDAS

do të veprosh për të mirën tënde; po ta refuzosh atë, Zoti yt, në të vërtetë, mund të bëjë fare mirë pa ty dhe pa të gjithë ata që, krejt të mashtruar, të kanë ndjekur ty. Shiko! Perëndia e ka mbërthyer atë që të çoi ty në rrugë të shtrembër. Kthehu te Perëndia, i përvuajtur, i nënshtruar e kokëulur; me të vërtetë, Ai do të t'i falë mëkatet, sepse Zoti yt, me siguri, është Falësi, i Fuqishmi, Mëshirëploti.

Kjo është këshilla e Perëndisë; veç të mund t'i vije veshin asaj! Kjo është bujaria e Perëndisë; veç të mund ta merrje atë! Kjo është fjala e Perëndisë; veç të mund ta kapje atë! Ky është thesari i Perëndisë; sikur ti të mund të kuptoje!

Ky është një Libër që është bërë Llamba e të Përjetshmit për botën dhe Shtegu i drejtë, i pagabueshëm midis popujve të tokës. Thuaj: Ky është Agimi i dijes Hyjnore, në qofshi ndër ata që kuptojnë, dhe Vendagimi i porosive të Perëndisë, në qofshi ndër ata që marrin vesh.

Mos e ngarko kafshën më shumë nga ç' mund të mbajë. Ne, me të vërtetë, e kemi ndaluar në Libër një trajtim të tillë me anë të një ndalimi tepër detyrues. Jini mishërime të drejtësisë e të ndershmërisë midis gjithë krijesave.

Sikur dikush pa dashje t'i marrë jetën një tjetri, ai duhet t'i paguajë familjes së të ndjerit një dëmshpërblim prej njëqind mithqálësh ar. Zbatojeni atë që ju është ngarkuar në këtë Tabelë dhe mos jini ndër ata që i kapërcejnë kufijt e saj.

LIBRI MË I SHËNJTË

O anëtarë të parlamenteve në mbarë botën! Zgjidhni një gjuhë të vetme për përdorim në mbarë botën dhe adoptoni gjithashtu një shkrim të përbashkët. Perëndia, me të vërtetë, jua bën të qartë atë që ju sjell dobi dhe ju bën të aftë të jeni të pavarur nga të tjerët. Ai, me të vërtetë, është Më Zemërgjeri, i Gjithëdijshmi, i Gjithinformuari. Kjo do të sjellë unitet, veç ta kuptonit këtë, dhe do të jetë mjeti më i madh për të zhvilluar harmoninë e qytetërimin, veç të mund ta merrnit vesh. Ne kemi caktuar dy shenja të arritjes së moshës së pjekurisë të gjinisë njerëzore: të parën, që është themeli më i shëndoshë, e kemi shkruar në një tjetër prej Tabelave Tona, ndërsa e dyta është reveluar në këtë Libër të mrekullueshëm.

Ju ndalohet të pini opium. Ne, me të vërtetë, e kemi ndaluar këtë në Libër me anë të një ndalimi tepër detyrues. Nëse ndonjëri e përdor atë, ai sigurisht nuk është nga të Mitë. Druajuni Perëndisë, o ju që jeni të pajisur me arsye!

DISA TEKSTE TË REVELUARA NGA BAHÁ'U'LLÁH ·U SI SHTOJCË E KITÁB-I-AQDAS ·IT

Një numër tabelash të reveluara nga Bahá'u'lláh u pas Kitáb-i-Aqdas it përmbajnë pasazhe shtojcë të dispozitave të Librit Më të Shenjtë. Më të rëndësishmet prej tyre janë botuar në *Tabelat e Bahá'u'lláh ut të reveluara pas Kitáb-i-Aqdas it*. Në këtë seksion është përfshirë një pasazh i nxjerrë nga Tabela e *Ishráqát* it. Këtu është përfshirë gjithashtu teksti i tri Lutjeve të Detyrueshme, që përmenden në Pyetje dhe Përgjigje, si dhe Lutja për të Vdekurit, që përmendet në Tekst.

TABELA E ISHRAKATIT ISHRAKU I TETË

KY pasazh, sapo i shkruar nga Penda e Lavdisë, konsiderohet pjesë e Librit Më të Shenjtë: Njerëzit e Shtëpisë së Drejtësisë së Perëndisë janë ngarkuar me punët e njerëzve. Ata, në të vërtetë, janë të Besuarit e Perëndisë midis shërbëtorëve të Tij dhe vendagimet e autoritetit në vendet e Tij.

O njerëz të Perëndisë! Ajo që stërvit botën është Drejtësia, sepse ajo mbështetet mbi dy shtylla, shpërblimin dhe ndëshkimin. Këto dy shtylla janë burimet e jetës për botën. Duke qenë se për çdo ditë ka një problem të ri dhe për çdo problem një zgjidhje të përshtatshme, çështje të tilla duhet t'i referohen Shtëpisë së Drejtësisë, që anëtarët e saj të veprojnë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e kohës. Ata që, për hir të Perëndisë, ngrihen për të shërbyer Kauzën e Tij, janë marrësit e frymëzimit hyjnor nga Mbretëria e padukshme. Është detyrë e të gjithëve t'u binden atyre. Të gjitha punët e shtetit i duhen referuar Shtëpisë së Drejtësisë, por aktet e adhurimit duhen zbatuar në pajtim me atë që Perëndia ka reveluar në Librin e Tij.

O njerëz të Bahá-it! Ju jeni vendagimet e dashurisë së Perëndisë dhe agimet e dashamirësisë së Tij. Mos i ndyni gjuhët tuaja me shpifje e sharje për cilindo shpirt, dhe ruani sytë tuaj nga ajo që nuk është e hijshme. Tregoni atë që zotëroni. Po u prit në mënyrë të favorshme, e keni arritur qëllimin; në qoftë se jo, çdo

protestë është e kotë. Lëreni të qetë atë shpirt dhe kthejeni fytyrën ndaj Zotit, Mbrojtësit, të Vetëqenëshmit. Mos u bëni shkak hidhërimi, aq më pak shkak përçarjeje e grindjeje. Ushqejmë shpresën që ju të merrni edukim të vërtetë nën strehën e pemës së mëshirës së Tij të dhembshur dhe të veproni në përputhje me atë që dëshiron Perëndia. Ju të gjithë jeni fletë të një peme dhe pika uji të një oqeani.

(Tabela të Bahá'u'lláh ut të reveluara pas Kitáb-i-Aqdas-it)

LUTJA E GJATË E DETYRUESHME
TË THUHET NJË HERË
NË NJËZET E KATËR ORË

Cilido që dëshiron ta thotë këtë lutje, të qëndrojë në këmbë e t'i drejtohet Perëndisë dhe, ndërsa qëndron në vendin e vet, të vështrojë nga e djathta e nga e majta, sikur pret mëshirën e Zotit të tij, Mëshirëplotit, Zemërdhembshurit. Pastaj të thotë:

O Ti Që je Zoti i të gjithë emrave dhe Artuesi i qiejve! Të kërkoj përunjësisht, për ata Që janë Agimet e Thelbit Tënd të padukshëm, Më të Lartësuar, Lavdiplotë, ta bësh lutjen time një zjarr që të djegë perdet që më fshehin bukurinë Tënde dhe një dritë që të më udhëheqë në oqeanin e Pranisë Sate.

Pastaj, në lutje të përunjur, të ngrejë duart ndaj Perëndisë – bekuar e lartësuar qoftë Ai – dhe të thotë:

O Ti Dëshira e botës dhe i Shumëdashuri i kombeve! Ti më sheh sesi e kthej fytyrën ndaj Teje, i shkëputur nga çdo lidhje me cilindo qoftë veç Teje, dhe mbahem pas fillit Tënd, lëvizja e të cilit ka tronditur gjithë krijimin. Unë jam shërbëtori Yt, O Zoti im, dhe bir i shërbëtorit Tënd. Shihmë, jam i gatshëm të përmbush vullnetin Tënd e dëshirën Tënde, pa dëshiruar asgjë tjetër veç pëlqimit Tënd. Të përgjërohem, për Oqeanin e mëshirës Sate dhe për Yllin e Ditës të mirësisë Sate, të bësh me shërbëtorin Tënd si të duash e si të të pëlqejë Ty. Për fuqinë Tënde, që qëndron shumë më lart se çdo fjalë e lavdërim! Çdo gjë që të revelosh Ti është dëshira e zemrës sime dhe e shumëdashura e shpirtit tim. O Perëndi, Perëndia im! Mos u vër veshin shpresave të mia e bëmave të mia, por shih, përkundrazi, vullnetin Tënd, që ka përfshirë qiejt e tokën. Për Emrin Tënd Më të Madh, O Ti Zoti i të gjitha kombeve! Unë kam dëshiruar vetëm atë që Ti dëshiron dhe kam dashur vetëm atë që Ti do.

Pastaj të bjerë në gjunjë dhe duke e ulur ballin në tokë të thotë:

Lëvduar je Ti tej përshkrimit të cilitdo qoftë, veç Vetes Sate, dhe kuptimit të çdo gjëje tjetër, veç Teje.

Pastaj të ngrihet e të thotë.

Bëje lutjen time, O Zoti im, burim ujërash jetëdhënëse, falë të cilave unë të mund të jetoj aq sa zgjat sovraniteti yt dhe të të përmend Ty në çdo botë të botëve të Tua.

T'i ngrejë përsëri duart në lutje dhe të thotë:

O Ti, në ndarje nga i Cili zemrat e shpirtrat janë shkrië dhe që me zjarrin e dashurisë Sate ke ndezur flakë tërë botën. Të përgjerohem për Emrin Tënd, përmes të cilit ke nënshtruar gjithë krijimin, të mos më mohosh atë që është në Ty, O Ti Që sundon mbi të gjithë njerëzit. Ti e sheh, O Zoti im, këtë të huaj që nxiton për në shtëpinë e tij më të lëvduar nën tendën e madhërisë Sate e brenda vathës së mëshirës Sate; dhe këtë mëkatar që kërkon oqeanin e ndjesës Sate; dhe këtë të përvuajtur që kërkon oborrin e Lavdisë Sate; dhe këtë krijesë të varfër që kërkon margaritarin e pasurisë Sate. Ty të përket pushteti për të urdhëruar çdo gjë që dëshiron. Dëshmoj se Ti duhet të lavdërohesh në bëmat e Tua, porosive të Tua u duhet bindur, dhe Ti mbetesh i padetyruar në urdhërat që jep.

Pastaj të ngrejë duart dhe të përsërisë tri herë Emrin Më të Madh. Pastaj të përkeulet me duart mbi gjunjë para Perëndisë – bekuar e lëvduar qoftë Ai – dhe të thotë:

Ti e sheh, O Perëndia im, sesi shpirti më është gjallëruar në gjymtyrët e organet e mia nga dëshira e zjarrtë që të të adhurojë Ty dhe nga etja që të të kujtojë e lartësojë Ty; sesi ai dëshmon për atë që Gjuha e Urdhërit Tënd ka dëshmuar në mbretërinë e fjalës Sate dhe në qiellin e dijes Sate. Më pëlqen, në këtë gjendje, O Zoti im, të të lyp çdo gjë që është në Ty, për të treguar varfërinë time dhe për të lartësuar bujarinë Tënde e pasuritë e Tua, për të shpallur pafuqinë time e për të shfaqur pushtetin Tënd e fuqinë Tënde.

Pastaj të çohet e t'i ngrëjë dy herë duart në lutje dhe të thotë:

Nuk ka Perëndi tjetër veç Teje, të Gjithëfuqishmit, Bujariplotit. Nuk ka Perëndi tjetër veç Teje, Urdhëruetit, si në fillim dhe në mbarim. O Perëndi, Perëndia im! Ndjesa Jote më ka dhënë zemër, dhe mëshira Jote më ka forcuar, dhe thirrja Jote më ka zgjuar, dhe dashamirësia Jote më ka ngritur e më ka sjellë tek Ti. Ndryshe, cili jam unë që të guxoj të qëndroj në portat e qytetit të afrisë Sate, ose ta kthej fytyrën nga dritat që shkëlqejnë prej qiellit të vullnetit Tënd? Ti e sheh O Zoti im, këtë krijesë të mjerë që troket në derën e dashamirësisë Sate, dhe këtë shpirt jetëshkurtër që kërkon lumin e jetës së pasosur nga duart e bujarisë Sate. Jotja është në çdo kohë komanda, O Ti Që je Zoti i të gjithë emrave; dhe imja është bindja e dëshira për t'iu nënshtruar vullnetit Tënd, O Krijues i qiejve.

Pastaj të ngrëjë tri herë duart e të thotë:

Perëndia është më i madh se çdo i madh!

Pastaj të bjerë në gjuhë dhe, duke e ulur ballin në tokë, të thotë:

Ti je tepër lart që lëvdimi i atyre që ndodhen pranë Teje të mund të ngjitet në qiellin e afrisë Sate, ose që zogjtë e zemrave të atyre që të janë përkushtuar Ty të arrinë pragun e portës Sate. Unë dëshmoj se Ti je shenjtëruar mbi të gjitha atributet dhe je i shenjtë mbi të gjithë emrat. Nuk ka Perëndi veç Teje, të Shumëlartësuarit, Lavdiplotit.

Pastaj të ulet e të thotë:

Unë dëshmoj për atë që kanë dëshmuar të gjitha krijesat, dhe Tubimi qiellor, dhe banorët e Parajsës më të lartë, dhe veç tyre për atë që vetë Gjuha e Madhështisë dëshmon nga Horizonti lavdiplotë, se Ti je Perëndia, se nuk ka Perëndi veç Teje, dhe se Ai Që u shfaq është Misteri i Fshehur, Simboli i Ruajtur, përmes të Cilit shkronjat T dhe B (Të bëhet) u lidhën e u bashkuan. Unë dëshmoj se është Ai, emri i të Cilit është shkruar nga Penda e Më të Lartit dhe Që është përmendur në Librat e Perëndisë, Zotit të Fronit atje lart dhe të tokës këtu poshtë.

Pastaj të ngrihet në këmbë dhe të thotë:

O Zot i të gjitha qenieve dhe Zotërues i të gjitha gjërave të dukshme e të padukshme! Ti i sheh lotët e mi dhe i dëgjon psherëtimat që nxjerr, rënkimet e mia, vajtimin tim dhe ankesat e zemrës sime. Për fuqinë Tëndel! Fajet që kam bërë më kanë penguar të afrohem pranë Teje; dhe mëkatet e mia më kanë mbajtur larg oborrit të shenjtërisë Sate. Dashuria Jote, O Zoti im, më ka pasuruar dhe ndarja prej Teje më ka shkatërruar e largësia nga Ti më ka cflitur. Të përgjërohem Ty, për gjurmët e Tua në këtë vend të shkretë, dhe për fjalët “Ja ku jam, ja ku jam”, që të Zgjedhurit e Tu kanë shqiptuar në këtë pamatësi, dhe për fërfërimat e Revelacionit Tënd, dhe për flladet e lehta të Agimit të Manifestimit Tënd, të urdhërosh që unë të mund të sodis bukurinë Tënde dhe të vërej çdo gjë që ka në Librin Tënd.

Pastaj të përsërisë tri herë Emrin Më të Madh dhe të përkulet me duart mbi gjunjë e të thotë:

Lëvduar qofsh Ti, O Perëndia im, që më ke ndihmuar të të kujtoj e të të lëvdoj Ty, dhe që më ke bërë të njohur Atë Që është Agimi i shenjave të Tua, dhe që më ke lejuar të përkulem para Zotërisë Sate, dhe të përunjem para Hyjnisë Sate, dhe të njoh atë që ka folur Gjuha e madhëstisë Sate.

Pastaj të ngrihet e të thotë:

O Perëndi, Perëndia im! Shpina më është kërrusur nga pesha e mëkateve të mia dhe shkujdesja ime më ka shkatërruar. Sa herë peshoj bëmat e mia të liga dhe dashamirësinë Tënde, zemra ime shkrin brenda meje dhe gjaku më vlon në vena. Për Bukurinë Tënde, O Ti Dëshira e botës! Më skuqet faqja ta ngre fytyrën ndaj Teje dhe duarve të mia që përgjërohen u vjen turp të zgjaten ndaj qiellit të zemërgjerësisë Sate. Ti e sheh, O Perëndia im, sesi lotët nuk më lënë të të kujtoj Ty dhe të lëvdoj virtytet e Tua, O Ti Zoti i Fronit atje lart dhe i tokës këtu poshtë! Të lutem, për shenjat e Mbretërisë Sate dhe për misteret e Sundimit Tënd, të bësh me të dashurit e Tu siç i përshtatet Bujarisë Sate, O Zoti i të gjitha qenieve, dhe siç i ka hije mirësisë Sate, O Mbret i së dukshmes e i së padukshmes!

Të përsërisë pastaj tri herë Emrin Më të Madh dhe të bjerë në gjunjë, me ballin të ulur në tokë, e të thotë:

Lëvduar qofsh Ti, O Perëndia ynë, që na ke dërguar atë që na afron pranë Teje dhe që na jep çdo gjë të mirë

që Ti na ke sjellë me anë të Librave të Tu e të Shkrimeve të Tua. Mbrona, Të lutemi, O Zoti im, nga barra e fantazive boshe dhe e imagjinatave të kota. Ti je, me të vërtetë, i Fuqishmi, i Gjithëdijshmi.

Pastaj ta ngrejë kokën, të ulet dhe të thotë:

Unë dëshmoj, O Perëndia im, për atë që kanë dëshmuar të Zgjedhurit e Tu dhe njoh atë që kanë njohur banorët e Parajsës më të lartë dhe ata që janë mbledhur rreth Fronit Tënd të fuqishëm. Mbretëritë e tokës e të qiellit janë të Tuat, O Zot i botëve!

(Lutje e Përsiatje nga Babá'u'lláh u, CLXXXIII)

LUTJA E MESME E DETYRUESHME
TË THUHET ÇDO DITË,
NË MËNGJES, NË MESDITË
E NË MBRËMJE

Cilido që dëshiron të thotë këtë lutje, të lajë duart, dhe duke u larë të thotë:

Forcoje dorën time, O Perëndia im, që ajo të mund të mbajë Librin Tënd me një qëndrueshmëri të tillë që ushtritë e botës të mos kenë pushtet mbi të. Ruaje, pra, atë që të mos përziehet me asgjë që s'i përket atij. Ti je, me të vërtetë, Fuqiploti, Më i Pushtetshmi.

Dhe duke larë fytyrën, të thotë:

E kam kthyer fytyrën ndaj Teje, O Zoti im! Ndriçoje atë me dritën e pamjes Sate. Mbroje, pra, atë

që të mos kthehet ndaj askujt veç Teje.

Pastaj të ngrihet dhe, i kthyer ndaj Kiblës (Pikës së Adhurimit, dmth Bahxhi-së, 'Akká), të thotë:

Perëndia dëshmon se nuk ka Perëndi tjetër veç Tij. Të Tijat janë mbretëritë e Revelacionit e të krijimit. Ai, me të vërtetë, ka shfaqur Atë Që është agimi i Revelacionit, Atë që bisedoi në Sinai, Atë përmes të Cilit Horizonti Suprem është ndriçuar dhe Pema e Lotosit, tej së cilës nuk ka kalim, ka folur, Atë me anën e të Cilit të gjithë atyre që janë në qiell e mbi tokë u është shpallur: “Ja, Gjithëzotëruesi ka ardhur. Tokë e qiell, lavdi e sundim i përkasin Perëndisë, Zotit të gjithë njerëzve, Zotëruesit të Fronit atje lart e të tokës këtu poshtë!”

Pastaj të përkaulet, me duart të mbështetura mbi gjunjë, dhe të thotë:

I lartësuar je Ti mbi lëvdatat e mia e mbi lëvdatat e cilitdo tjetër veç meje, mbi përfytyrimin tim dhe mbi përfytyrimin e të gjithë atyre që janë në qiell e mbi tokë!

Pastaj, duke qëndruar në këmbë me duart të hapura, me pëllëmbët lart ndaj fytirës, të thotë:

Mos e zhgënjje, O Perëndia im, atë që me gishta lutës kapet pas rrobës së mëshirës Sate e të mirësisë Sate, O Ti Që je Më i Mëshirshmi ndër ata që tregojnë mëshirë!

Pastaj të ulet dhe të thotë:

Unë dëshmoj për unitetin Tënd e për njëshmërinë Tënde, dëshmoj se Ti je Perëndia dhe se nuk ka Perëndi tjetër veç Teje. Ti, me të vërtetë, ke reveluar Kauzën, ke përmbushur Besëlidhjen Tënde dhe ua ke hapur gjerësisht portën e mirësisë Sate të gjithë atyre që janë në qiell e mbi tokë. Bekimi e paqja, përshëndetja e lavdia zbritshin mbi të dashurit e Tu, mbi ata që ndryshimet e rastet e botës nuk i kanë penguar ta kthejnë fytyrën ndaj Teje dhe që kanë dhënë gjithçka kishin, me shpresën për të fituar atë që është në Ty. Ti je, me të vërtetë, Gjithmonëfalësi, Bujariploti.

(Në rast se ndonjëri, në vend të vargut të gjatë, preferon të recitojë këto fjalë: “Perëndia dëshmon se nuk ka Perëndi tjetër veç Tij, Ndihmës në Rrezik, të Vetëqenëshmit”, kjo do të ishte e mjaftueshme. Dhe po kështu, do të ishte e mjaftueshme që ai, ndërsa qëndron ndenjor, të recitonte këto fjalë: “Unë dëshmoj për unitetin Tënd e për njëshmërinë Tënde, dëshmoj se Ti je Perëndia dhe se nuk ka Perëndi tjetër veç Teje”.)

(Lutje e Përsiatje nga Babá'u'lláh u, CLXXXII)

LUTJA E SHKURTËR E DETYRUESHME
TË THUHET NJË HERË
NË NJËZET E KATËR ORË, NË MESDITË

Unë dëshmoj, O Perëndia im, se Ti më ke krijuar që të të njoh e të të adhuroj Ty. Unë dëshmoj në këtë çast

pafuqinë time dhe fuqinë Tënde, varfërinë time dhe begatinë Tënde.

Nuk ka Perëndi tjetër veç Teje, Ndhimës në Rrezik, të Vetëqenëshmit.

(Lutje e Përsiatje nga Bahá'u'lláh u, CLXXXI)

LUTJA PËR TË VDEKURIT

O Perëndia im! Ky është shërbëtori yt e bir i shërbëtorit Tënd, që ka besuar në Ty e në shenjat e Tua dhe e ka kthyer fytyrën ndaj Teje, krejt i shkëputur nga gjithçka veç Teje. Ti je, me të vërtetë, më i mëshirshmi ndër ata që tregojnë mëshirë.

Merru me të, O Ti Që i fal mëkatet e njerëzve dhe i fsheh gabimet e tyre, siç i ka hije qiellit të bujarisë Sate dhe oqeanit të mirësisë Sate. Lejoje atë të hyjë brenda kufijve të mëshirës Sate të lartë, që ka qenë para themelimit të tokës e të qiellit. Nuk ka Perëndi tjetër veç Teje, Gjithmonëfalësit, Më Fisnikut.

Pastaj le të përsërisë gjashtë herë përsëritjen “Alláh-u-Abhá”, dhe pastaj të përsërisë nëntëmbëdhjetë herë secilin prej vargjeve që vijojnë:

Ne të gjithë, me të vërtetë, adhurojmë Perëndinë.

Ne të gjithë, me të vërtetë, përulemi para Perëndisë.

Ne të gjithë, me të vërtetë, jemi të përkushtuar te Perëndia.

Ne të gjithë, me të vërtetë, i thurim lavde Perëndisë.

Ne të gjithë, me të vërtetë, falënderojmë Perëndinë.

Ne të gjithë, me të vërtetë, jemi të duruar në
Perëndinë.

*(Në goftë se e ndjera është grua, ai të thotë: Kjo është
shërbëtorja jotë dhe bijë e shërbëtores Sate, etj...)*

(Lutje e Përsiatje nga Bahá'u'lláh u, CLXVII)

PYETJE DHE PËRGJIGJE

1. PYETJE: *Lidhur me Festën Më të Madhe.*

PËRGJIGJE: Festa Më e Madhe fillon pasdite vonë të ditës së trembëdhjetë të muajit të dytë të vitit sipas Bayán it. Në ditën e parë, të nëntë e të dymbëdhjetë të kësaj feste, puna është e ndaluar.

2. PYETJE: *Lidhur me Festën e Ditëlindjeve Binjake.*

PËRGJIGJE: Lindja e Bukurisë Abhá¹³ ndodhi në agim të ditës së dytë të muajit të Muḥarram,¹⁴ dita e parë e të cilit shënon Lindjen e Lajmëtarit të Tij. Në sytë e Perëndisë këto dy ditë shihen si një e vetme.

3. PYETJE: *Lidhur me Vargjet e Martesës.*

PËRGJIGJE: Për burrat: “Ne të gjithë, me të vërtetë, do t’i bindemi vullnetit të Perëndisë”. Për gratë: “Ne të gjitha, me të vërtetë, do t’i bindemi vullnetit të Perëndisë”.¹⁵

4. PYETJE: *Po qe se një burrë niset për udhëtim pa caktuar ndonjë kohë për kthimin e tij, me fjalë të tjera për periudhën që parashikohet të mungojë – dhe po qe se pas kësaj nuk dëgjohet*

¹³ Bahá’u’lláh-u.

¹⁴ Muaji i parë i kalendarit hënor islamik.

¹⁵ Në gjuhën shqipe, si dhe në arabisht, këto dy vargje ndryshojnë nga pikëpamja e gjinisë.

ndonjë fjalë për të e humbet çdo gjurmë e tij, si duhet të veprojë e shoqja?

PËRGJIGJE: Po qe se ai ka lënë pa caktuar ndonjë datë për kthimin e tij, edhe duke qenë në dijeni të kushtit që vihet në Kitáb-i-Aqdas për këtë çështje, e shoqja duhet të presë plot një vit dhe pas kësaj do të jetë e lirë ose të mbajë qëndrimin e lavdërueshëm ose të marrë një burrë tjetër. Por në qoftë se ai nuk ka qenë në dijeni të këtij kushti, ajo duhet të presë me durim derisa Perëndisë t’i pëlqejë të zbulojë para saj fatin e të shoqit. Me qëndrim të lavdërueshëm për këtë nënkuptohet të pasurit durim.

5. PYETJE: *Lidhur me vargun e shenjtë: “Kur dëgjuam britmën e fëmijëve ende të palindur, Ne e dyfishuam pjesën e tyre dhe e pakësuam atë të të tjerëve”.*

PËRGJIGJE: Sipas Librit të Perëndisë, pasuria e të ndjerit ndahet në 2.520 njësi, numër që është shumëfishi më i vogël i përbashkët i të gjithë numrave të plotë deri në nëntë, dhe këto njësi ndahen pastaj në shtatë pjesë, çdonjëra prej të cilave i caktohet, siç përmendet në Librin, një kategori të veçantë trashëgimtarësh. Fëmijëve, për shembull, u janë caktuar nëntë bloqe prej 60 njësisish, që bëjnë gjithsej 540 njësi. Domethënia e frazës “Ne e dyfishuam pjesën e tyre” është, pra, që fëmijët marrin edhe nëntë bloqe të tjera prej 60 njësisish, duke u dhënë të drejtën të marrin gjithsej 18 bloqe. Njësitë shtesë që ata marrin zbriten nga pjesët e kategorive të tjera të trashëgimtarëve, kështu që, edhe pse thuhet,

për shembull, se së shoqes i jepen “tetë pjesë që përbëjnë katërqind e tetëdhjetë njësi”, që është e barabartë me tetë bloqe prej 60 njësish gjithsej, tani, falë këtij regullimi të ri, një blok e gjysmë njësish, gjithsej 90 njësi, janë zbritur nga pjesa e së shoqes dhe u janë dhënë fëmijëve, dhe po kështu për gjithë të tjerët. Përfundimi është se shuma e përgjithshme e zbritur është e barabartë me nëntë bloqet shtesë të njësive që u jepen fëmijëve.

6. PYETJE: *A është e nevojshme që vëllai, për të pasur pjesë në trashëgim, të rrjedhë edhe nga babai edhe nga nëna e të ndjerit, apo është e mjaftueshme të ketë të përbashkët vetëm njërin prej prindërve?*

PËRGJIGJE: Në qoftë se ai rrjedh nga babai, do të marrë pjesën e tij të trashëgimit në përmasën që përmbahet në Librin; por në qoftë se ai rrjedh nga nëna, do të marrë vetëm dy të tretat e asaj që përcaktohet, ndërsa një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë. Ky rregull është i zbatueshëm edhe për motrën.

7. PYETJE: *Ndër ato që thuhet për trashëgiminë, është shkëruar që po qe se i ndjeri nuk lë fëmijë, pjesa e pasurisë që do t'u takonte atyre i kalon Shtëpisë së Drejtësisë. Në rastin që edhe kategoritë e tjera të trashëgimtarëve, si babai, nëna, vëllai, motra e mësuesi, gjithashtu mungojnë, pjesët e tyre të trashëgimit i kalojnë edhe ato Shtëpisë së Drejtësisë, apo shpërndahen në ndonjë mënyrë tjetër?*

PËRGJIGJE: Vargu i shenjtë e përmbush kërkesën. Ai thotë, lëvduar qoftë Fjala e Tij: “Poqe se i ndjeri nuk lë fëmijë, pjesa që do t’u takonte atyre i kalon Shtëpisë së Drejtësisë” etj. dhe “Po qe se i ndjeri lë fëmijë, por nuk lë asnjë nga të kategorive të tjera të trashëgimtarëve që janë specifikuar në Librin, ata (fëmijët) do të marrin dy të tretat e trashëgimit, ndërsa një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë” etj. Me fjalë të tjera, kur nuk ka fëmijë, pjesa e trashëgimisë që do t’u takonte atyre i kalon Shtëpisë së Drejtësisë; dhe kur ka fëmijë por mungojnë kategoritë e tjera të trashëgimtarëve, dy të tretat e trashëgimit u kalojnë fëmijëve, ndërsa një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë. Ky rregull ka si zbatime të përgjithshme dhe të posaçme, domethënë se kurdoherë që ndonjë kategori e kësaj klase të fundit trashëgimtarësh mungon, dy të tretat e trashëgimit të tyre u kalojnë fëmijëve dhe një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë.

8. PYETJE: *Lidhur me shumën bazë për të cilën paguhet Huqúqu’lláh.*

PËRGJIGJE: Shuma bazë për të cilën paguhet Huqúqu’lláh është nëntëmbëdhjetë mithqálë ar. Me fjalë të tjera, kur është fituar një shumë parash që i përgjigjet kësaj vlere, duhet paguar Huqúqu’lláh. Po kështu, Hukuk paguhet kur vlera, jo numri, i formave të tjera të pronës arrin shumën e caktuar. Huqúqu’lláh-u paguhet jo më shumë se një herë. Një person, për shembull, që fiton njëmijë mithqálë ar

dhe paguan Hukuk-un nuk është i detyruar të bëjë më tej një pagesë të tillë për këtë shumë, por vetëm për atë që i shtohet asaj përmes tregtisë, zejeve e të tjera si këto. Kur kjo shtesë, pra fitimi që realizohet, arrin shumën e caktuar, njeriu duhet të bëjë atë që ka urdhëruar Perëndia. Vetëm kur krerët kalojnë në duar të tjera, i nënshtrohen edhe një herë pagimit të Hukuk-ut, si për herë të parë. Pika Parësore ka urdhëruar që *Huqúqu'lláh-u* duhet paguar për çdo lloj pasurie që zotëron njeriu; por, në këtë Dispensacion Shumë të Fuqishëm, Ne i kemi përjashtuar orenditë shtëpiake, dmth ato orendi që janë të nevojshme, dhe vetë banesën.

9. PYETJE: *Çfarë duhet të ketë përparësi: Huqúqu'lláh-u, borxhet e të ndjerit apo shpenzimet e funeralit e të varrimit?*

PËRGJIGJE: Funerali dhe varrimi kanë përparësi, pastaj vjen rregullimi i borxheve, dhe pastaj pagimi i *Huqúqu'lláh-ut*. Po që se pasuria e të ndjerit është e pamjaftueshme të mbulojë borxhet e tij, pjesa që mbetet nga prona e tij duhet të ndahet midis këtyre borxheve në përpjesëtim me madhësinë e tyre.

10. PYETJE: *Rruarja e kokës është e ndaluar në Kitáb-i-Aqdas in, por është urdhëruar në Súriy-i-Hajj.*

PËRGJIGJE: Të gjithë e kanë për detyrë t'i binden Kitáb-i-Aqdas it; çdo gjë e reveluar aty është Ligji i Perëndisë midis shërbëtorëve të Tij. Detyrimi që haxhilerët që shkojnë te Shtëpia e shenjtë duhet të rruajnë kokën është hequr.

11. PYETJE: *Në rast se midis një çifti kryhen marrëdhënie intime gjatë vitit të tyre të durimit dhe pastaj ata përsëri largohen nga njëri-tjetri, a duhet ata ta rifillojnë vitin e tyre të durimit, apo ditët para këtyre marrëdhënieve intime përfshihen në llogaritjen e vitit? Dhe pasi është bërë shkurorëzimi, a është e nevojshme të ketë një periudhë të mëtejshme pritjeje?*

PËRGJIGJE: Po qe se dashuria midis çiftit përtërihet gjatë vitit të tyre të durimit, lidhja martesore është në fuqi dhe duhet zbatuar ajo që urdhërohet në Librin e Perëndisë; por pasi është mbushur viti i durimit dhe ka ndodhur ajo që është dekretuar nga Perëndia, nuk kërkohet një periudhë e mëtejshme pritjeje. Gjatë vitit të durimit marrëdhëniet seksuale midis burrit e së shoqes janë të ndaluara dhe ai që e kryen këtë akt duhet të kërkojë ndjesë nga Perëndia e, si dënim, t'i paguajë Shtëpisë së Drejtësisë një gjobë prej nëntëmbëdhjetë mithqálësh ar.

12. PYETJE: *Në rast se midis një çifti lind antipati pasi janë lexuar Vargjet e Martesës dhe është paguar prika, a mund të bëhet shkurorëzimi pa zbatimin e vitit të durimit?*

PËRGJIGJE: Shkurorëzimi mund të kërkohet në mënyrë të ligjshme pas leximit të Vargjeve të Martesës dhe pagimit të prikës, por para se martesë të jetë konsumuar. Në këto rrethana nuk është nevoja të zbatohet viti i durimit, por rikthimi i pagesës së prikës nuk lejohet.

13. PYETJE: *A është pëlqimi i prindërve nga të dyja palët një kërkesë e domosdoshme për martesën, apo është i mjaftueshëm*

pëlqimi i prindërve vetëm nga njëra palë? Ky ligj është i zbatueshëm vetëm për virgjëreshat apo edhe për të tjerat?

PËRGJIGJE: Martesa është e kushtëzuar nga pëlqimi për martesën i prindërve nga të dyja palët dhe lidhur me këtë nuk bëhet dallim nëse nusja është e virgjër ose jo.

14. PYETJE: *Besimtarëve u është urdhëruar ta kthejnë fytyrën ndaj Kiblës kur thonë Lutjet e Detyrueshme; nga dubet të kthehen ata kur bëjnë lutje e devocione të tjera?*

PËRGJIGJE: Kthimi i fytyrës ndaj Kiblës është një kërkesë e posaçme për thënien e lutjes së detyrueshme, ndërsa për lutje e devocione të tjera njeriu mund të ndjekë atë që Zoti i mëshirshëm ka reveluar në Kuran: “Ngado që të ktheheni, është fytyra e Perëndisë”.

15. PYETJE: *Lidhur me kujtimin e Perëndisë në Mashrikul Azkar “në agim”.*

PËRGJIGJE: Edhe pse fjalët “në agim” përdoren në Librin e Perëndisë, për Perëndinë është e pranueshme në zbardhjen e agimit, midis agimit dhe lindjes së diellit, ose edhe deri në dy orë pas lindjes së diellit.

16. PYETJE: *A është porosia që trupi i të vdekurit të mos çohet më larg se një orë rrugë si për bartjen në tokë dhe në det?*

PËRGJIGJE: Kjo porosi ka të bëjë si me distancat në det dhe në tokë, qoftë kjo një orë larg me avullore ose me tren; synimi është një orë kohë, cilido qoftë mjeti i

transportit. Sidoqoftë, sa më parë të bëhet varrimi, aq më e përshtatshme dhe e pranueshme është kjo.

17. PYETJE: *Çfarë procedure duhet ndjekur kur gjenden sende të humbura?*

PËRGJIGJE: Në qoftë se një send i tillë gjendet në qytet, gjetja e tij duhet lajmëruar një herë nga tellalli i qytetit. Në qoftë se pas kësaj pronari i sendit gjendet, sendi duhet t'i kthehet atij. Përndryshe, ai që e ka gjetur sendin duhet të presë një vit dhe, në qoftë se gjatë kësaj periudhe del në dritë pronari, gjetësi duhet të marrë prej tij pagesën e tellallit dhe t'i kthejë sendin e gjetur; vetëm në qoftë se kalon viti pa u gjendur pronari i sendit, ai që e ka gjetur atë mund ta mbajë për vete. Në qoftë se vlera e sendit të gjetur është më pak ose e barabartë me pagesën e tellallit, ai që e ka gjetur duhet të presë vetëm një ditë nga koha e gjetjes së sendit dhe pasi kalon ky afat, në qoftë se pronari nuk zbulohet, ta mbajë për vete sendin e gjetur; kurse në rastin e një sendi të gjetur në një zonë të pabanuar, gjetësi duhet të presë tri ditë dhe me kalimin e kësaj kohe, në qoftë se pronari mbetet i panjohur, është i lirë ta mbajë për vete atë që ka gjetur.

18. PYETJE: *Përsa i përket avdesit: në qoftë se, për shembull, një person sapo ka larë gjithë trupin, a duhet ai megjithatë të marrë avdes?*

PËRGJIGJE: Porosia përse i përket avdesit duhet gjithsesi të zbatohet.

19. PYETJE: *Në qoftë se një person ka në plan të emigrojë nga vendi i tij dhe e shoqja është kundër e mospajtimi përfundon në shkukurëzim, dhe në qoftë se përgatitjet për udhëtimin zgjasin më shumë se një vit, a mund të llogaritet kjo periudhë si një vit durimi, apo si fillim i këtij viti durimi duhet marrë dita që çifti ndahet?*

PËRGJIGJE: Pikënisja për llogaritjen është dita që çifti ndahet, dhe në qoftë se ata janë ndarë një vit para nisjes së burrit dhe midis tyre nuk ka rilindur aroma e dashurisë, shkukurëzimi mund të bëhet. Përndryshe viti duhet llogaritur nga dita e nisjes së tij dhe kushtet e shpallura në Kitáb-i-Aqdas duhen zbatuar.

20. PYETJE: *Për moshën e pjekurisë ndaj detyrimeve fetare.*

PËRGJIGJE: Moshë e pjekurisë është pesëmbëdhjetë vjeç si për burrat dhe për gratë.

21. PYETJE: *Lidhur me vargun e shenjtë “Kur jeni në udhëtim, në qoftë se ndaleni e pushoni në ndonjë vend të sigurt, bëni ... një përkulje deri në tokë në vend të çdo Lutjeje të Detyrueshme të pathënë...”*

PËRGJIGJE: Kjo përkulje është si shpërblim për lutjen e detyrueshme të pabërë gjatë udhëtimit dhe për shkak rrethanash të pasigurta. Në rast se në kohën e lutjes udhëtari gjendet i qetë në një vend të sigurt, ai duhet ta bëjë lutjen. Kjo porosi lidhur me përkuljen si shpërblim për lutjen vlen qoftë në shtëpi dhe në një udhëtim.

22. PYETJE: *Lidhur me përkufizimin e udhëtimit.*¹⁶

PËRGJIGJE: Përkufizimi i një udhëtimi është nëntë orë sipas sahatit. Në qoftë se udhëtari ndalet në ndonjë vend, duke parashikuar të qëndrojë aty jo më pak se një muaj sipas llogaritjes së Bayán it, ai është i detyruar ta mbajë Agjërimin; por në qoftë se qëndron më pak se një muaj, nuk është i detyruar të agjërojë. Në qoftë se në kohën e Agjërimit ai arrin në një vend ku do të qëndrojë një muaj sipas Bayán it, atij nuk do t'i duhet të mbajë Agjërimin derisa të kalojnë tri ditë, duke e zbatuar atë pastaj gjatë gjithë kohës që ky vazhdon; por në qoftë se arrin në shtëpinë e vet, ku kishte pasur vendbanimin e tij të përhershëm, ai duhet ta fillojë agjërimin që të nesërmen e arritjes.

23. PYETJE: *Lidhur me ndëshkimin për ata ose ato që kryejnë marrëdhënie intime jashtë kurore.*

PËRGJIGJE: Për shkeljen e parë duhen paguar nëntë mithqálë, për të dytën tetëmbëdhjetë, për të tretën tridhjetë e gjashtë e kështu me radhë, duke qenë çdo gjobë dyfishi i së mëparshmes. Pesha e një mithqáli është e barabartë me nëntëmbëdhjetë nakhud ë në pajtim me përcaktimin e Bayán it.

24. PYETJE: *Lidhur me gjuetinë.*

PËRGJIGJE: Ai thotë, lëvduar qoftë Ai: “Në qoftë se gjuani me kafshë ose shpendë grabitqarë” etj.

¹⁶ Nënkuptohej zgjatja minimale e një udhëtimi që e përjashton udhëtarin nga të agjëruarit.

Përfshihen edhe mjete të tjera, si harqe e shigjeta, pushkë dhe pajisje të ngjashme që përdoren për gjueti. Por po qe se përdoren çarqe e leqe, është e paligjshme të hahet gjahu që ngordh para se të kapet.

25. PYETJE: *Lidhur me haxhillëkun.*

PËRGJIGJE: Është një detyrim të shkosh në haxhillëk në njërën prej dy Shtëpive të shenjta; por në cilën prej tyre, i takon atij që bën haxhillëk të vendosë.

26. PYETJE: *Lidhur me prikën.*

PËRGJIGJE: Përsa i përket prikës, domethënia që të kënaqet me shifrën më të ulët është nëntëmbëdhjetë mithqalë argjend.

27. PYETJE: *Lidhur me vargun e shenjtë: “Por, në rast se i vjen lajm për vdekjen ... e të shoqit” etj.*

PËRGJIGJE: Përsa i përket të presë sa “të jetë plotësuar numri i caktuar i muajve”, me këtë kuptohet një periudhë prej nëntë muajsh.

28. PYETJE: *Është bërë një pyetje tjetër lidhur me pjesën e trashëgimit që i takon mësuesit.*

PËRGJIGJE: Po qe se mësuesi ka ndërruar jetë, një e treta e pjesës së tij të trashëgimit i kalon Shtëpisë së Drejtësisë dhe dy të tretat që mbeten i kalojnë fëmijëve të të ndjerit e jo fëmijëve të mësuesit.

29. PYETJE: *Është bërë një pyetje tjetër lidhur me haxhillëkun.*

PËRGJIGJE: Me haxhillëk në Shtëpinë e shenjtë, që u është vënë si detyrim njerëzve, nënkuptohet qoftë Shtëpia Më e Madhe në Bagdad, ashtu dhe Shtëpia e Pikës Parësore në Shiraz; një haxhillëk në njërin prej dy Shtëpive është i mjaftueshëm. Ata mund të shkojnë në haxhillëk në atë prej tyre që është më afër vendit ku jetojnë.

30. PYETJE: *Lidhur me vargun: “dhe kush dëshiron të marrë në shërbim një shërbëtorë, mund ta bëjë këtë në mënyrë të përshtatshme”.*

PËRGJIGJE: Kjo vlen vetëm për shërbimet e kryera në shkëmbim të një page, si për çdo lloj tjetër shërbëtorësh, të rinj a të vjetër qofshin; një shërbëtorë e tillë është e lirë të zgjedhë një bashkëshort kurdo që t’i pëlqejë, sepse është e ndaluar si që gratë të blihen dhe që një burrë të ketë më shumë se dy gra.

31. PYETJE: *Lidhur me vargun e shenjtë: “Zoti... e ka ndaluar zakonin që ju ndiqnit më parë kur e ndanit tri herë një grua”.*

PËRGJIGJE: Kjo i referohet ligjit që në të kaluarën kërkonte që një burrë tjetër të martohej me atë grua para se ajo të mund të rimartohej me burrin e mëparshëm; ky zakon është ndaluar në Kitáb-i-Aqdas.

32. PYETJE: *Lidhur me restaurimin dhe ruajtjen e të dy Shtëpive në dy vendet binjake, si dhe në vendet e tjera ku është vendosur fronti.*

PËRGJIGJE: Me dy Shtëpitë nënkuptohen Shtëpia Më e Madhe dhe Shtëpia e Pikës Parësore. Përsa u përket vendndodhjeve të tjera, njerëzit e zonës ku janë këto mund të zgjedhin që të ruajnë çdo shtëpi në të cilën është vendosur fronti ose vetëm njërën prej tyre.

33. PYETJE: *Është bërë edhe një pyetje tjetër për trashëgiminë e mësuesit.*

PËRGJIGJE: Po që se mësuesi nuk është nga njerëzit e Bahá-it, ai nuk trashëgon. Në qoftë se ka disa mësues, kuota e tyre duhet ndarë në pjesë të barabarta. Në rast se mësuesi ka vdekur, fëmijët e tij nuk e trashëgojnë pjesën e tij, madje dy të tretat e kësaj pjese u kalojnë fëmijëve të pronarit të pasurisë dhe një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë.

34. PYETJE: *Lidhur me banesën që u është caktuar vetëm pasardhësve meshkuj.*

PËRGJIGJE: Në qoftë se ka disa banesa, nënkuptohet ajo më e bukura e më fisnikja, të tjerat ndahen midis të gjithë trashëgimtarëve, si dhe çdo lloj tjetër prone. Çdo trashëgimtar, i cilëso kategorie trashëgimtarësh qoftë, që është jashtë Besimit të Perëndisë, konsiderohet se nuk ekziston dhe nuk trashëgon.

35. PYETJE: *Lidhur me Novruzin.*

PËRGJIGJE: Festa e Novruzit bie në ditën kur dielli hyn në shenjën e Dashit,¹⁷ edhe sikur kjo të ndodhë

¹⁷ Sanatadita pranverore në hemisferën veriore.

vetëm për jo më shumë se një minutë para perëndimit të diellit.

36. PYETJE: *Në qoftë se përvjetori i dy Ditëlindjeve Binjake ose i Deklarimit të Báb-it bie gjatë muajit të agjërimit, ç'duhet bërë?*

PËRGJIGJE: Në rast se festat e kremtimit të dy Ditëlindjeve Binjake ose të Deklarimit të Báb-it bien gjatë muajit të agjërimit, porosia për të agjëruar nuk zbatohet atë ditë.

37. PYETJE: *Në urdhërat e shenjtë që qeverisin trashëgiminë, banesa dhe rrobat vetjake të të ndjerit u janë caktuar pasardhësve meshkuj. Kjo i referohet vetëm pronës së babait apo edhe asaj të nënës?*

PËRGJIGJE: Rrobat e përdorura të nënës duhet të ndahen në pjesë të barabarta midis të bijave, por ajo që mbetet nga trashëgimia e saj, duke përfshirë prona, arturina dhe rroba të papërdorura, duhet ndarë midis të gjithë trashëgimtarëve të saj sipas mënyrës së reveluar në Kitáb-i-Aqdas. Por në rast se e ndjera nuk ka lënë bija, gjithë trashëgimia e saj duhet ndarë sipas mënyrës së caktuar për meshkujt në Tekstin e shenjtë.

38. PYETJE: *Lidhur me shkuroreëzimin, të cilit duhet t'i paraprijë një vit durimi: po qe se vetëm njëra prej të dy palëve është e prirur për pajtim, ç'duhet bërë?*

PËRGJIGJE: Në pajtim me porosinë e reveluar në Kitáb-i-Aqdas, duhen kënaqur të dyja palët; në qoftë

se nuk janë të gatshme të dyja palët, ribashkimi nuk mund të bëhet.

39. PYETJE: *Lidhur me prikën, ç'duhet bërë në qoftë se dhëndri nuk mund ta paguajë gjithë shumën dhe në vend të kësaj, në kohën e ceremonisë së martesës i dorëzon formalisht nuses një zotim të shkruar, në kuptimin që ai do ta paguajë atë kur të jetë në gjendje?*

PËRGJIGJE: Leja për të zbatuar këtë praktikë është dhënë nga Burimi i Pushtetit.

40. PYETJE: *Në rast se gjatë vitit të durimit aroma e dashurisë përtërihet, por vetëm që të pasohet nga antipatia dhe çifti gjatë tërë vitit lëkundet midis dashurisë e neverisë, dhe viti përfundon me antipati, mund të bëhet apo jo shkurorezimi?*

PËRGJIGJE: Në çdo rast e në çdo kohë që lind antipatia, atë ditë fillon viti i durimit dhe ai duhet të kryhet tërësisht.

41. PYETJE: *Banesa dhe rrobat vetjake të të ndjerit u janë caktuar fëmijëve meshkuj, jo femra, dhe as trashëgimtarëve të tjerë; po sikur i ndjeri të mos ketë lënë fëmijë meshkuj, ç'duhet bërë?*

PËRGJIGJE: Ai, lëvduar qoftë, thotë: “Po qe se i ndjeri nuk lë fëmijë, pjesa që do t’u takonte atyre i kalon Shtëpisë së Drejtësisë...”. Në pajtim me këtë varg të shenjtë, banesa dhe rrobat vetjake të të ndjerit i kalojnë Shtëpisë së Drejtësisë.

42. PYETJE: *Në Kitáb-i-Aqdas është reveluar urdhëresa për Huqúqu'lláh-un. Banesa, me pajisjet përkatëse dhe orenditë e nevojshme, a përfshihet në pronën për të cilën paguhet Huqúqu'lláh, apo jo?*

PËRGJIGJE: Në ligjet e reveluara në gjuhën persishte Ne kemi urdhëruar që në këtë Dispensacion Shumë të Fuqishëm banesa dhe pajisjet shtëpiake të përjashtohen, domethënë ato pajisje që janë të nevojshme.

43. PYETJE: *Lidhur me fejesën e një vajze para moshës së pjekurisë.*

PËRGJIGJE: Ky zakon është shpallur i paligjshëm nga Burimi i Pushtetit, dhe është e paligjshme të lajmërohet një martesë më shumë se nëntëdhjetë e pesë ditë para dasmës.

44. PYETJE: *Në qoftë se një person ka, për shembull, njëqind tumanë¹⁸, paguan Hukuk-un për këtë shumë, humbet gjysmën e kësaj shume në transaksione të pafat dhe pastaj, përmes tregtisë, shuma që disponon barazohet me shumën për të cilën paguhet Hukuk, a duhet që ky person të paguajë Hukuk, apo jo?*

PËRGJIGJE: Në një rast të tillë nuk duhet paguar Hukuk.

45. PYETJE: *Në qoftë se pas pagimit të Hukuk-ut, po kjo shumë prej njëqind tumanësh humbet tërësisht dhe më pas rifitohet me*

¹⁸ Tuman: njësi monetare persiane. – Shën. i përkth.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

tregti ose me punë afarizmi, a duhet paguar Hukuk-u për së dyti apo jo?

PËRGJIGJE: Edhe në këtë rast nuk kërkohet të paguhet Hukuk.

46. PYETJE: *Në lidhje me vargun e shenjtë: “Perëndia ju ka porositur të martoheni”, është kjo një porosi e detyrueshme apo jo?*

PËRGJIGJE: Nuk është e detyrueshme.

47. PYETJE: *Të supozojmë se një burrë është martuar me një grua, duke menduar se ajo është e virgjër, dhe i ka paguar asaj prikën, por gjatë kryerjes së aktit bëhet e qartë se ajo nuk është e virgjër, a duhen kthyer shpenzimet dhe prika, apo jo? Dhe në qoftë se martesë është bërë e kushtëzuar me virgjërinë, mospërmbushja e kushtit a e shfuqizon atë që ishte kushtëzuar me të?*

PËRGJIGJE: Në një rast të tillë shpenzimet dhe prika mund të kthehen. Mospërmbushja e kushtit e shfuqizon atë që është e kushtëzuar me të. Por, në sytë e Perëndisë, mbulimi i kësaj gjëje dhe ndjesa për të meriton një shpërblim bujar.

48. PYETJE: *“Juve ju është kërkuar të bëni një festë...”. Është kjo e detyrueshme apo jo?*

PËRGJIGJE: Nuk është e detyrueshme.

49. PYETJE: *Lidhur me ndëshkimet për marrëdhënie intime jashtë kurore, pederastí e vjedhje dhe me shkallët e këtyre ndëshkimeve.*

PËRGJIGJE: Përcaktimi i shkallëve të këtyre ndëshkimeve i takon Shtëpisë së Drejtësisë.

50. PYETJE: *Lidhur me ligjshmërinë ose jo për t'u martuar me farefisin e vet.*

PËRGJIGJE: Edhe këto çështje u takojnë të Besuarve të Shtëpisë së Drejtësisë.

51. PYETJE: *Lidhur me avdesin, është reveluar: “Ai që nuk gjen ujë për avdes le të përsërisë pesë herë fjalët “Në emër të Perëndisë, Më të Kulluarit, Më të Kulluarit”: a është e lejuar të thuhet ky varg në rast të ftohti të madh, ose në qoftë se duart e fytyra janë të plagosura?*

PËRGJIGJE: Në rast të ftohti të madh mund të përdoret ujë i ngrohtë. Në qoftë se fytyra dhe duart janë me plagë, ose ka arsye të tjera si dhimbje e vuajtje, për shkak të të cilave përdorimi i ujit mund të jetë i dëmshëm, në vend të avdesit mund të thuhet vargu përkatës.

52. PYETJE: *A është e detyrueshme të thuhet vargu i reveluar për të zëvendësuar Lutjen e Shenjave?*

PËRGJIGJE: Nuk është e detyrueshme.

53. PYETJE: *Lidhur me trashëgiminë, kur ka vëllezër e motra nga babai e nga nëna, edhe vëllezërit e motrat vetëm nga nëna marrin gjithashtu pjesë?*

PËRGJIGJE: Këta nuk marrin asnjë pjesë.

54. PYETJE: *Ai, lëvduar qoftë, thotë: “Në rast se i biri i të ndjerit ka ndërruar jetë gjatë kohës që i ati jetonte dhe ka lënë fëmijë, ata trashëgojnë pjesën e atit të tyre...”. Ç’duhet bërë, në qoftë se e bija ka ndërruar jetë gjatë kohës që i ati jetonte?*

PËRGJIGJE: Pjesa e saj e trashëgimit duhet ndarë midis të shtatë kategorive të trashëgimtarëve sipas porosisë së Librit.

55. PYETJE: *Në qoftë se e ndjera është grua, kujt i jepet pjesa e trashëgimit “e së shoqes”?*

PËRGJIGJE: Pjesa e trashëgimit “e së shoqes” i jepet të shoqit.

56. PYETJE: *Lidhur me qefinin e trupit të të ndjerit, i cili është dekretuar të ketë pesë fletë: pesë fletët duan të thonë pesë copë pëlburat që janë përdorur zakonisht deri atëherë, apo pesë qefinë të plotë të mbështjellë njëri mbi tjetrin?*

PËRGJIGJE: Nënkuptohe përdorimi i pesë copë pëlhurave.

57. PYETJE: *Lidhur me mospërputhjet midis disa vargjeve të reveluara.*

PËRGJIGJE: Shumë Tabela janë reveluar e dërguar në formën e tyre fillestare, pa i kontrolluar e rishikuar. Rrjedhimisht, sipas urdhërave të dhënë, ato janë rilexuar në Praninë e Shenjtë dhe janë sjellë në përputhje me rregullat gramatikore konvencionale të njerëzve, për t’u dalë përpara kleçkave të kundërshtarëve të Kauzës. Një shkak tjetër i kësaj praktike është konstatimi se stili i ri i futur nga

Lajmëtari, u bëfshin fli për hir të Tij të gjithë shpirtrat veç të Vetit, karakterizohej nga një liri e theksuar në respektimin e rregullave gramatikore; prandaj, për të lehtësuar të kuptuarit dhe për saktësi në të shprehur, janë reveluar pastaj vargje në një stil që në një pjesë të madhe është në pajtim me përdorimin e zakonshëm.

58. PYETJE: *Lidhur me vargun e bekuar: “Kur jeni në udhëtim, në qoftë se ndaleni e pushoni në ndonjë vend të sigurt, bëni ... një përkulje deri në tokë në vend të çdo Lutjeje të Detyrueshme të pathënë”: a është kjo një zëvendësim për Lutjen e Detyrueshme të pabërë për shkak të rrethanave të pasigurta, apo gjatë udhëtimeve Lutja e Detyrueshme pezullohet krejtësisht dhe zëvendësohet me përkuljen?*

PËRGJIGJE: Në qoftë se kur vjen ora e lutjes së detyrueshme nuk ka siguri, sapo arrin në një mjedis të sigurt duhet bërë një përkulje deri në tokë në vend të çdo Lutjeje të Detyrueshme që ka mbetur pa bërë dhe, pas përkuljes së fundit, duhet ulur këmbëkryq dhe të lexohet vargu përkatës. Por në qoftë se ka vend të sigurt, lutja e detyrueshme nuk është pezulluar gjatë udhëtimeve.

59. PYETJE: *Po qe se, kur një udhëtar është ndalur e po çlodhet, është koha e lutjes së detyrueshme, ai duhet të bëjë lutjen apo në vend të saj të bëjë përkuljen?*

PËRGJIGJE: Me përjashtim të rrethanave të pasigurta, mosbërja e Lutjes së Detyrueshme nuk lejohet.

60. PYETJE: *Në qoftë se, duke lënë pa bërë disa Lutje të Detyrueshme, janë të nevojshme disa përkulje, a duhet përsëritur vargu pas çdo përkuljeje zëvendësuese, apo jo?*

PËRGJIGJE: Është e mjaftueshme të thuhet vargu përkatës pas përkuljes së fundit. Kryerja e disa përkuljeve nuk kërkon përsëritje të veçantë të vargut për çdo përkulje.

61. PYETJE: *Në qoftë se libet pa bërë një Lutje e Detyrueshme në shtëpi, a duhet kompensuar ajo me një përkulje, apo jo?*

PËRGJIGJE: Në përgjigje të pyetjeve të mëparshme, është shkruar: “Kjo porosi lidhur me përkuljen zëvendësuese për lutjen vlen qoftë në shtëpi dhe në një udhëtim”.

62. PYETJE: *Në qoftë se avdesi është kryer për qëllime të tjera dhe vjen ora e lutjes së detyrueshme, a është ky avdes i mjaftueshëm apo duhet përsëritur?*

PËRGJIGJE: Ky avdes është i mjaftueshëm dhe nuk ka nevojë që ai të përsëritet.

63. PYETJE: *Në Kitáb-i-Aqdas është urdhëruar një lutje e detyrueshme me nëntë rakabë, që duhet bërë në mesditë, në mëngjes e në mbrëmje, por duket se Tabela e Lutjeve të Detyrueshme¹⁹ ndryshon nga kjo.*

PËRGJIGJE: Ajo që është reveluar në Kitáb-i-Aqdas ka të bëjë me një tjetër Lutje të Detyrueshme. Disa

¹⁹ Tabela që përmban tri Lutjet e Detyrueshme, e cila është tani në përdorim.

vite më parë, disa porosi të Kitáb-i-Aqdas it, duke përfshirë atë Lutje të Detyrueshme, për arsye urtie u regjistruan më vete dhe u dërguan bashkë me shkrime të tjera të shenjta, me qëllim për t'i ruajtur e mbrojtur. Më pas u reveluan këto tri Lutje të Detyrueshme.

64. PYETJE: *Në llogaritjen e kohës, a është e lejueshme të mbështetesh në orë e kohëmatës?*

PËRGJIGJE: Është e lejueshme të mbështetesh në orë e kohëmatës.

65. PYETJE: *Në Tabelën e Lutjeve të Detyrueshme janë reveluar tri lutje; a kërkohet që ato të bëhen të tria, apo jo?*

PËRGJIGJE: Është urdhëruar të bëhet njëra prej këtyre tri lutjeve; cilado që të bëhet mjafton.

66. PYETJE: *A është avdesi i lutjes së mëngjesit i vlefshëm edhe për atë të mesditës? Dhe po kështu, a është avdesi i kryer në mesditë i vlefshëm edhe në mbrëmje?*

PËRGJIGJE: Avdesi lidhet me Lutjen e Detyrueshme për të cilën kryhet dhe duhet përsëritur për çdo lutje.

67. PYETJE: *Lidhur me Lutjen e Gjatë të Detyrueshme, kërkohet të qëndrosh në këmbë dhe “të kthehesh ndaj Perëndisë”. Kjo duket se tregon që nuk është e nevojshme ta kthesh fytyrën drejt Kiblës; a është kështu apo jo?*

PËRGJIGJE: Nënkuptohe Kibla.

68. PYETJE: *Lidhur me vargun e shenjtë: “Thuajini vargjet e Perëndisë çdo mëngjes e mbrëmje”.*

PËRGJIGJE: Nënkuptohej gjithçka që është dërguar nga Qielli i Fjalës Hyjnore. Kërkesa e parë është etja dhe dashuria e shpirttrave të shenjtëruar për të lexuar Fjalën e Perëndisë. Është e parapëlqyer të lexohet vetëm një varg, ose edhe një fjalë e vetme, në një frymë gëzimi e rrëzëllimi, sesa të studiohen shumë Libra.

69. PYETJE: *A mundet një person, kur bën testamentin, të japë për vepra bamirësie një pjesë të pasurisë së tij, tej asaj që duhet për pagimin e Huqúqu'lláh-ut dhe për rregullimin e borxheve, apo ka të drejtë vetëm të caktojë një shumë për të mbuluar shpenzimet e funeralit e të varrimit, në mënyrë që pjesa tjetër e trashëgimit të ndahet midis kategorive të caktuara të trashëgimtarëve, siç është përcaktuar nga Perëndia?*

PËRGJIGJE: Secili gëzon të drejta të plota mbi pasurinë e vet. Në qoftë se ai është në gjendje ta përballojë Huqúqu'lláh-un dhe nuk ka borxhe, atëherë çdo gjë e shkruar në testamentin e tij dhe çdo deklaram ose pohim që përmbahet aty është i pranueshëm. Me të vërtetë, Perëndia e ka lejuar të bëjë çfarë të dojë me atë që i ka dhuruar atij.

70. PYETJE: *Përdorimi i unazës së varrimit është urdhëruar vetëm për të rriturit apo edhe për të miturit?*

PËRGJIGJE: Është vetëm për të rriturit. Edhe Lutja për të Vdekurit është për të rriturit.

71. PYETJE: *Në qoftë se një njeri dëshiron të agjërojë në një kohë tjetër nga muaji i 'Alá', a është e lejuar kejo, apo jo; dhe në*

qoftë se ai është kushtuar ose zotuar për një agjërime të tillë, a është kejo e vlefshme dhe e pranueshme?

PËRGJIGJE: Porosia për agjërimin është ashtu siç ka qenë reveluar tashmë. Por në qoftë se një njeri kushtohet t'i ofrojë Perëndisë një agjërim, duke kërkuar kështu plotësimin e një dëshire, ose për të realizuar ndonjë qëllim tjetër, kjo është e lejuar tani, siç ka qenë edhe më parë. Është, sidoqoftë, dëshira e Perëndisë, lartësuar qoftë lavdia e Tij, që kushtimet e zotimet të synojnë drejt objektivash që i sjellin dobi njerëzimit.

72. PYETJE: *Është bërë edhe një pyetje tjetër lidhur me banesën dhe rrobat vetjake: në mungesë të fëmijëve meshkuj, a duhet t'i kalojnë këto Shtëpisë së Drejtësisë, apo duhen ndarë si pjesa tjetër e trashëgimit?*

PËRGJIGJE: Dy të tretat e banesës e të rrobave vetjake u kalojnë fëmijëve femra dhe një e treta Shtëpisë së Drejtësisë, të cilën Perëndia e ka bërë arkën e popullit.

73. PYETJE: *Në qoftë se pas plotësimit të vitit të durimit burri refuzon të lejojë shkurorezimin, ç'rrugë duhet të ndjekë gruaaja?*

PËRGJIGJE: Kur periudha ka përfunduar, shkurorezimi kryhet. Por është e nevojshme të ketë dëshmitarë të fillimit e të përfundimit të kësaj periudhe, që mund të thirren për të dëshmuar në rast se lind nevoja.

74. PYETJE: *Lidhur me përcaktimin e pleqërisë.*

PYETJE DHE PËRGJIGJE

PËRGJIGJE: Për arabët kjo nënkupton kufirin e skajshëm të pleqërisë, por për njerëzit e Bahá-it ajo nis nga mosha shtatëdhjetë vjeç.

75. PYETJE: *Lidhur me kufirin e agjërimit për atë që udhëton në këmbë.*

PËRGJIGJE: Kufiri është caktuar dy orë. Në qoftë se kjo tejkalohet, është e lejuar të ndërpritet Agjërimi.

76. PYETJE: *Lidhur me mbajtjen e Agjërimit nga njerëz që bëjnë punë të rëndë gjatë muajit të agjërimit.*

PËRGJIGJE: Këta njerëz janë të shkarkuar nga të agjëruarit; por, në shenjë respekti ndaj ligjit të Perëndisë dhe për arsye të karakterit të lartësuar të Agjërimit, është shumë e lavdërueshme dhe e përshtatshme të hanë me përkore dhe jo në sy të të tjerëve.

77. PYETJE: *Avdesi që merret për Lutjen e Detyrueshme a mjafton edhe për përsëritjen nëntëdhjetë e pesë herë të Emrit Më të Madh?*

PËRGJIGJE: Nuk është e nevojshme që avdesi të përsëritet.

78. PYETJE: *Lidhur me rrobat dhe arturinat që burri mund të ketë blerë për të shoqen: pas vdekjes së tij, a duhen ndarë ato midis trashëgimtarëve të tij, apo janë të rezervuara për të shoqen?*

PËRGJIGJE: Me përjashtim të rrobave të përdorura, çdo gjë që mund të ketë, si arturina e të tjera, i

takojnë burrit, veç atyre që është provuar se kanë qenë dhurata për të shoqen.

79. PYETJE: *Lidhur me kriterin e drejtësisë kur duhet provuar ndonjë gjë në bazë të dëshmisë së dy dëshmitarëve të drejtë.*

PËRGJIGJE: Kriteri i drejtësisë është nami i mirë që gëzon midis njerëzve. Dëshmia e të gjithë shërbëtorëve të Perëndisë, të çdo besimi a bindjeje qoftë, është e pranueshme para Fronit të Tij.

80. PYETJE: *Në qoftë se i ndjeri nuk ka përmbushur detyrimin e tij për Huqúqu'lláh-un, as ka paguar borxhet, a duhen zgjidhur këto duke zbritur përpjesëtimisht nga banesa, rrobat vetjake dhe nga pjesa tjetër e trashëgimit, apo banesa dhe rrobat vetjake duhen lënë mënjanë për fëmijët meshkuj dhe pastaj borxhet të paguhen nga pjesa tjetër e pasurisë? Dhe në qoftë se pjesa tjetër e pasurisë nuk është e mjaftueshme për këtë qëllim, si do të paguhen borxhet?*

PËRGJIGJE: Borxhet dhe pagesat e papaguara të Hukuk-ut duhet të paguhen nga ajo pjesë e pasurisë që mbetet, por në qoftë se kjo është e pamjaftueshme për këtë qëllim, ajo që mungon duhet të plotësohet duke marrë nga banesa dhe rrobat vetjake.

81. PYETJE: *Lutja e tretë e Detyrueshme duhet thënë duke qëndruar në këmbë apo ulur?*

PËRGJIGJE: Është e parapëlqyer e më e përshtatshme të qëndrohet në këmbë në një pozë nderimi të përunjur.

82. PYETJE: *Lidhur me Lutjen e parë të Detyrueshme është urdhëruar: “dubet bërë në çastin që njeriu e ndien veten në një gjendje përunjësie e adhurimi të ethshëm”: a dubet bërë kjo një herë në njëzet e katër orë, apo më shpesh?*

PËRGJIGJE: Një herë në njëzet e katër orë është e mjaftueshme; kjo është thënia e shqiptuar nga Gjuha e Urdhërit Hyjnor.

83. PYETJE: *Lidhur me përcaktimin e “mëngjesit”, “mesditës” dhe “mbrëmjes”.*

PËRGJIGJE: Këto janë lindja e diellit, mesdita dhe perëndimi. Kohët e lejuara për Lutjet e Detyrueshme janë nga mëngjesi deri në mesditë, nga mesdita deri në perëndim të diellit dhe nga perëndimi i diellit deri dy orë pas tij. Pushteti është në dorë të Perëndisë, Bartësit të Dy Emrave.

84. PYETJE: *A është e lejuar për një besimtar të martohet me një jobesimtare?*

PËRGJIGJE: Është e lejuar qoftë të japësh qoftë të marrësh kurorë; kështu ka dekretuar Zoti kur u ngjit në fronin e bujarisë e të dashamirësisë.

85. PYETJE: *Lidhur me Lutjen për të Vdekurit: dubet bërë para apo pas varrimit? Dhe a është e detyrueshme të kthehet fytyra ndaj Kiblës?*

PËRGJIGJE: Kjo lutje duhet bërë para varrimit; përsa i përket Kiblës: “ngado që të ktheheni, është fytyra e Perëndisë”.²⁰

86. PYETJE: *Në mesditë, që është koha e dy prej Lutjeve të Detyrueshme – e asaj të shkurtër të mesditës dhe e asaj që duhet bërë në mëngjes, mesditë e mbrëmje – a është e nevojshme në këtë rast që të merret dy herë avdes, apo mjafton një herë?*

PËRGJIGJE: Përsëritja e marrjes avdes nuk është e nevojshme.

87. PYETJE: *Lidhur me prikën për banorët e fshatrave, që duhet të jetë në argjend: me këtë nënkuptohet dhëndri, nusja, apo të dy? Dhe ç'duhet bërë nëse njëri prej tyre banon në qytet e tjetri në fshat?*

PËRGJIGJE: Prika përcaktohet nga vendbanimi i dhëndrit; në qoftë se ai banon në qytet, prika është në ar, në qoftë se banon në fshat, është në argjend.

88. PYETJE: *Cili është kriteri për të përcaktuar kush banon në qytet e kush në fshat? Në qoftë se një banor i qytetit merr shtëpi në një fshat, ose një që banon në fshat merr shtëpi në qytet, duke pasur ndërmend të vendoset atje përgjithmonë, cili rregull zbatohet? A është vendlindja faktori përcaktues?*

PËRGJIGJE: Kriteri është vendbanimi i përhershëm dhe, në varësi se ku ndodhet ai, urdhëri i Librit duhet zbatuar në pajtim me këtë.

²⁰ Kurani 2:115.

89. PYETJE: *Në Tabelat e shenjta është reveluar se kur një person fiton një shumë të barabartë me nëntëmbëdhjetë mithqâlë ar, ai duhet të paguajë të Drejtën e Perëndisë për këtë shumë. A mund të shpjegohet se ç'shumë prej këtyre nëntëmbëdhjetëve duhet të paguajë ai?*

PËRGJIGJE: Porosia e Perëndisë është nëntëmbëdhjetë mbi njëqind. Llogaritja duhet bërë mbi këtë bazë. Kështu mund të përcaktohet çfarë shume detyrohet mbi nëntëmbëdhjetë.

90. PYETJE: *Kur pasuria e ndonjërit i kalon nëntëmbëdhjetë, a është e nevojshme që ajo të shtohet në nëntëmbëdhjetë të tjera para se Hukuk-u të duhet të paguhet përsëri, apo ai duhet paguar për çdo shtesë?*

PËRGJIGJE: Çdo shumë që i shtohet nëntëmbëdhjetës përjashtohet nga Hukuk-u derisa të arrijë në nëntëmbëdhjetë të tjera.

91. PYETJE: *Lidhur me ujin e pastër dhe me kufirin në të cilin ai konsiderohet i përdorur.*

PËRGJIGJE: Sasi të vogla uji, si një tas, ose edhe dy a tre, duhen konsideruar të përdorura pas një larje të vetme të fytyrës e të duarve. Por një kurr²¹ ose më shumë ujë mbetet i pandryshuar pas një ose dy larjesh të fytyrës dhe nuk ka kundërshtim për ta përdorur, veçse po të ketë pësuar ndryshim në njërin prej tri

²¹ Është i barabartë me rreth gjysmë metër kub.

mënyrave,²² për shembull të ketë ndryshuar ngjyrë, dhe në këtë rast duhet konsideruar i përdorur.

92. PYETJE: *Në një traktat në gjuhën persishte për çështje të ndryshme, mosha e pjekurisë është caktuar pesëmbëdhjetë vjeç; a kushtëzohet edhe martesë me arritjen e pjekurisë, apo lejohet edhe më parë?*

PËRGJIGJE: Duke qenë se në Librin e Perëndisë kërkohet pëlqimi i të dyja palëve dhe duke qenë se para pjekurisë pëlqimi ose mungesa e tij nuk mund të jenë të sigurtë, martesë kushtëzohet, pra, me arritjen e moshës së pjekurisë dhe para kësaj kohe nuk lejohet.

93. PYETJE: *Lidhur me agjërimin dhe lutjen e detyrueshme nga ana e të sëmurëve.*

PËRGJIGJE: Në të vërtetë, Unë them se në sytë e Perëndisë lutja e detyrueshme dhe agjërimi zenë një vend të lartësuar. Por vlera e tyre mund të shprehet në një gjendje shëndetësore të mirë. Në kohë sëmundjeje nuk është e lejueshme të zbatohen këto detyrime; ky ka qenë gjithmonë urdhëri i Zotit, u madhëroftë lavdia e Tij. Lum burrat e gratë që u vënë veshin e i zbatojnë porositë e Tij. Lëvduar qoftë Perëndia, Ai që ka dërguar vargjet dhe është Reveluesi i provave të padyshimta.

94. PYETJE: *Lidhur me xhamitë, kishëzat e tempujt.*

²² Në ngjyrë, në shije e në erë.

PËRGJIGJE: Çdo gjë që është ndërtuar për adhurimin e Perëndisë së vërtetë Që është Një, siç janë xhamitë, kishëzat e tempujt, nuk duhet përdorur për ndonjë qëllim tjetër veç përkujtimit të Emrit të Tij. Ky është urdhër i Perëndisë dhe ai që e shkel atë është ndër ata që kanë bërë mëkat. Asgjë e keqe nuk do t'i ndodhë atij që e ka ndërtuar, sepse ai e ka kryer këtë vepër për hir të Perëndisë dhe ka marrë e do të vazhdojë të marrë shpërblimin e duhur.

95. PYETJE: *Lidhur me pajisjet e një vendi pune, të nevojshme për të ushtruar një veprimtari ose profesion: a i nënshtrohen ato pagimit të Huqúqu'lláb-ut, apo i përfshin i njëjti rregull si dhe pajisjet shtëpiake?*

PËRGJIGJE: Ato i përfshin i njëjti rregull si dhe pajisjet shtëpiake.

96. PYETJE: *Lidhur me pronat e ruajtura nën kujdestari që shkëmbehen me para ose me forma të tjera prone, për t'i mbrojtur nga shvlerësimi ose humbja.*

PËRGJIGJE: Përsa i përket pyetjes me shkrim lidhur me pronat e ruajtura nën kujdestari për t'i mbrojtur ato nga shvlerësimi e humbja, një shkëmbim i tillë është i lejuar me kusht që zëvendësimi të jetë i barabartë në vlerë. Zoti yt është, me të vërtetë, Shpjeguesi, i Gjithëdijshmi, dhe Ai është vërtet Urdhëruesi, i Lashti i Kohëve.

97. PYETJE: *Lidhur me larjen e këmbëve në dimër dhe në verë.*

PËRGJIGJE: Është njëloj në të dy rastet; është i parapëlqyer uji i ngrohtë, por nuk ka kundërshtim edhe për të ftohtin.

98. PYETJE: *Një pyetje tjetër për shkurorëzimin.*

PËRGJIGJE: Duke qenë se Perëndia, u madhëroftë lavdia e Tij, nuk e përkrah shkurorëzimin, asgjë nuk është reveluar për këtë çështje. Por që nga fillimi i ndarjes deri në përfundim të një viti, dy ose më shumë persona duhet të mbahen të informuar si dëshmitarë; në qoftë se, deri në fund, nuk ka pajtim, bëhet shkurorëzimi. Kjo duhet shënuar në regjistër nga nëpunësi legal fetar i qytetit, i caktuar nga të Besuarit e Shtëpisë së Drejtësisë. Zbatimi i kësaj procedure është thelbësor, në mënyrë që të mos hidhërohen ata që kanë zemër që kupton.

99. PYETJE: *Lidhur me konsultimin.*

PËRGJIGJE: Në qoftë se konsultimi midis grupit të parë të njerëzve të mbledhur përfundon me mospajtim, duhen shtuar njerëz të tjerë, dhe pas kësaj zgjidhen me short një numër personash që është i barabartë me numrin e Emrit Më të Madh, ose më pak a më shumë. Pastaj konsultimi përsëritet dhe përfundimi, cilido qoftë ai, duhet respektuar. Por në qoftë se ka ende mospajtim, e njëjta procedurë duhet përsëritur edhe një herë dhe vendimi i shumicës fiton. Ai, me të vërtetë, çon në rrugë të drejtë cilindo që i pëlqen.

100. PYETJE: *Lidhur me trashëgiminë.*

PËRGJIGJE: Lidhur me trashëgiminë, ajo që ka urdhëruar Pika Parësore – u bëfshin fli për hir të Tij shpirtrat e të gjithëve veç Atij – është e pëlqyeshme. Trashëgimtarët ekzistues duhet të marrin pjesët e trashëgimit që u janë caktuar, ndërsa një deklaram për atë që mbetet i duhet paraqitur Gjyqit të Më të Lartit. Në dorë të Tij është burimi i pushtetit; Ai urdhëron ashtu si i pëlqen. Lidhur me këtë, në Tokën e Misterit²³ është zbuluar një ligj që ua jep për-kohësisht trashëgiminë e trashëgimtarëve që mungojnë trashëgimtarëve ekzistues, derisa të krijohet Shtëpia e Drejtësisë dhe atëherë do të shpallet dekreti për këtë çështje. Por trashëgimi i atyre që kanë emigruar në të njëjtin vit që emigroi Bukuria e Lashtë u është caktuar trashëgimtarëve të tyre dhe kjo është një bujari e Perëndisë që u dhurohet.

101. PYETJE: *Lidhur me ligjin për thesarët e gjetur.*

PËRGJIGJE: Në qoftë se gjendet një thesar, një e treta i takon me të drejtë zbuluesit dhe dy të tretat duhet të shpenzohen nga njerëzit e Shtëpisë së Drejtësisë për mirëqenien e të gjithëve. Kjo do të bëhet pas krijimit të Shtëpisë së Drejtësisë dhe deri në atë kohë thesaret e gjetura do t'u besohen për t'i ruajtur personave të besuar në çdo lokalitet e territor. Me të vërtetë, Ai është Sundimtari, Urdhëruesi, i Gjithëdijshmi, i Gjithinformuari.

²³ Adrianopojë

102. PYETJE: *Lidhur me Hukuk-un mbi pasuri të patundshme që nuk sjellin fitim.*

PËRGJIGJE: Urdhëri i Perëndisë është që pasuria e patundshme që nuk sjell më të ardhura, domethënë nga e cila nuk merret fitim, nuk i nënshtrohet pagimit të Hukuk-ut. Ai, me të vërtetë, është Sundimtari, Dorëhapuri.

103. PYETJE: *Lidhur me vargun e shenjtë: “Në rajone ku dita dhe nata zgjaten, le të maten kohët e lutjes me sabatë...”*

PËRGJIGJE: Nënkuptohen territore të thella. Por në këto klima zgjatja ndryshon vetëm pak orë, prandaj ky rregull nuk zbatohet.

104. Në Tabelën drejtuar Abá Badí‘-ut, është reveluar ky varg i shenjtë: “Me të vërtetë, ne i kemi urdhëruar çdo biri t’i shërbejë të atit”. Ky është dekreti që Ne kemi formuluar në Librin.

105. *Dhe në një Tabelë tjetër janë reveluar këto fjalë të lartësuara:* O Muhamet! I Lashti i Kohëve e ka kthyer fytyrën ndaj teje, duke të përmendur ty dhe duke i nxitur njerëzit e Perëndisë të edukojnë fëmijët e tyre. Në qoftë se një at lë pasdore këtë porosi tepër të rëndësishme të formuluar në Kitáb-i-Aqdas nga Penda e Sovranit të Përjetshëm, ai do të humbasë të drejtën e atësisë dhe do të konsiderohet fajtor para Perëndisë. Lum ai që i gdhend në zemrën e vet këshillat e Zotit dhe u përmbahet fort atyre. Perëndia, me të vërtetë, u urdhëron shërbëtorëve të Vet atë që

do t'i ndihmojë e do t'u sjellë dobi dhe do t'u lejojë atyre të afrohen pranë Tij. Ai është Urdhëruesi, i Pavdekshmi.

106. Ai është Perëndia, lëvduar qoftë, Zoti i madhërisë e i pushtetit! Profetët dhe të Zgjedhurit kanë qenë ngarkuar të gjithë nga i Vetmi Perëndi i Vërtetë, u madhëroftë lavdia e Tij, të ushqejnë pemët e ekzistencës njerëzore me ujërat e gjalla të ndershmerisë e të kuptimit, që të shfaqet ajo që Perëndia ka depozituar në qeniet e tyre më intime. Siç mund të shihet lehtë, çdo pemë prodhon një fryt dhe një pemë shterpë vlen vetëm për zjarr. Qëllimi i këtyre Edukatorëve, në çdo gjë që ata kanë thënë e mësuar, ka qenë të ruajnë pozitën e lartë të njeriut. Lum ai që në Ditën e Perëndisë është mbajtur fort pas porosive të Tij dhe nuk është shmangur nga Ligji i Tij i vërtetë e themelor. Frytet që më shumë i kanë hije pemës së jetës njerëzore janë besueshmëria e përshpirtshmëria, vërtetësia e sinqeriteti; por më e madhja nga çdo gjë, pas njohjes së unitetit të Perëndisë, lëvduar e madhëruar qoftë Ai, është vëmendja për të drejtat që u detyrohemi prindërve. Ky mësim është përmendur në të gjithë Librat e Perëndisë dhe është ripohuar nga Penda Më e Lartësuar. Vëreni atë që Zoti i Mëshirshëm ka reveluar në Kuran, lëvduar qofshin fjalët e Tij: “Adhuron Perëndinë, mos barazoni me Të as shok e as ngjasim; dhe tregoni përzemërsi e dhembshuri për prindërit tuaj...”. Shihni sesi dashamirësia për

prindërit është lidhur me njohjen e të vetmit Perëndi të vërtetë! Lum ata që kanë dhuntinë e urtisë e të të kuptuarit, që shohin e dallojnë, që lexojnë e kuptojnë dhe që vënë re atë që Perëndia ka reveluar në Librat e Shenjtë të së kaluarës e në këtë Tabelë të pashoqe e të mrekullueshme.

107. *Në një prej Tabelave Ai, lënduar qofshin fjalët e Tij, ka reveluar: Dhe për çështjen e Zeqatit Ne kemi dekretuar po kështu që ju të ndiqni atë që është reveluar në Kuran.*

**PASQYRA PËRMBLEDHËSE
E KODIFIKIMI
I LIGJEVE DHE I POROSIVE
TË KITÁB-I-AQDAS·IT**

PASQYRA E LËNDËS

- I. CAKTIMI I ‘ABDU’L-BAHÁ·ÍT SI PASARDHËSI I
BAHÁ’U’LLÁH·UT DHE INTERPRETUESI I MËSIMEVE
TË TIJ
 - A. Drejtohuni tek Ai
 - B. Referojuni Atij
- II. PARASHIKIMI I INSTITUCIONIT TË RUAJTËSISË
- III. INSTITUCIONI I SHTËPISË SË DREJTËSISË
- IV. LIGJE, URDHËRESA DHE KËSHILLA
 - A. Lutja
 - B. Agjërimi
 - C. Ligje për statusin vetjak
 - D. Ligje, urdhëresa e këshilla të ndryshme
- V. QORTIME, VËREJTJE E PARALAJMËRIME TË
POSAÇME
- VI. ÇËSHTJE TË NDRYSHME

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E KODIFIKIMI

- I. CAKTIMI I ‘ABDU’L-BAHÁ·IT SI PASARDHËSI I BAHÁ’U’LLÁH·UT DHE INTERPRETUESI I MËSIMEVE TË TIJ
 - A. Besimtarët urdhërohen ta kthejnë fytyrën ndaj Atij “*Që Perëndia ka caktuar, Atij Që ka mbirë nga kjo Rrënjë e Lashtë*”.
 - B. Besimtarët urdhërohen t’i drejtohen për çdo gjë që nuk kuptojnë në shkrimet Bahá’í “*Atij që ka mbirë nga ky Trung i Fuqishëm*”.
- II. PARASHIKIMI I INSTITUCIONIT TË RUAJTËSISË
- III. INSTITUCIONI I SHTËPISË SË DREJTËSISË
 - A. Shtëpia e Drejtësisë është urdhëruar shprehimisht.
 - B. Funksionet e saj janë përcaktuar.
 - C. Të ardhurat e saj janë caktuar.
- IV. LIGJE, URDHËRESA E KËSHILLA
 - A. **Lutja**
 1. Pozita sublime e Lutjeve të Detyrueshme në Revelacionin Bahá’í.
 2. Kibla:
 - a. E njejtësuar nga Báb·i me “*Atë Që Perëndia do Ta shfaqë*”.
 - b. Zgjidhja e dhënë nga Báb·i konfirmohet nga Bahá’u’lláh·u.
 - c. Bahá’u’lláh·u urdhëron që, pasi Ai të ndërrojë jetë, Kibla të jetë vendprehja e Tij.

- d. Gjatë thënies së Lutjeve të Detyrueshme është urdhër kthimi ndaj Kiblës.
3. Lutjet e Detyrueshme janë detyrë për burrat dhe gratë që nga çasti që arrijnë moshën e pjekurisë, të caktuar në 15 vjeç.
4. Lirohen nga thënia e Lutjeve të Detyrueshme:
 - a. Ata që janë të sëmurë.
 - b. Ata që janë mbi 70 vjeç.
 - c. Gratë gjatë zakoneve të përmuajshme, por të kryejnë marrjen avdes dhe të përsërisin 95 herë në ditë një varg të reveluar posaçërisht.
5. Lutjet e Detyrueshme duhen thënë individualisht.
6. Është e lejuar të zgjidhet njëra prej tri Lutjeve të Detyrueshme.
7. Termat “mëngjes”, “mesditë” e “mbrëmje”, që përmendën në lidhje me Lutjet e Detyrueshme, nënkuptojnë përkatësisht intervalet e kohës midis lindjes së diellit e mesditës, midis mesditës e perëndimit të diellit, dhe nga perëndimi i diellit deri në dy orë pas perëndimit.
8. Është e mjaftueshme të thuhet Lutja e parë (e gjatë) e Detyrueshme një herë në njëzet e katër orë.
9. Është e parapëlqyeshme që Lutja e tretë (e shkurtër) e Detyrueshme të thuhet duke qëndruar në këmbë.
10. Avdesi:
 - a. Avdesi duhet t’i paraprijë thënies së Lutjeve të Detyrueshme.
 - b. Avdesi duhet përsëritur para çdo Lutjeje të Detyrueshme.

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E KODIFIKIMI

- c. Në qoftë se në mesditë thuhet dy Lutje të Detyrueshme, mjafton marrja avdes vetëm një herë për të dyja lutjet.
 - d. Në qoftë se nuk ka ujë ose përdorimi i tij është i dëmshëm për fytyrën ose duart, porositet të përsëritet pesë herë një varg i reveluar posaçërisht.
 - e. Në qoftë se koha është tepër e ftohtë, këshillohet përdorimi i ujit të ngrohtë.
 - f. Në qoftë se është marrë avdes për qëllime të tjera, nuk ka nevojë të përsëritet kjo para thënies së Lutjes së Detyrueshme.
 - g. Marrja avdes është e domosdoshme pavarësisht nëse para kësaj është bërë ose jo banjë.
11. Si të përcaktohet koha e fiksuar për Lutjen:
 - a. Lejohet përdorimi i sahatëve për të llogaritur kohën e thënies së Lutjeve të Detyrueshme.
 - b. Në vendet që ndodhen në veriun ose jugun ekstrem, ku kohëzgjatja e ditës dhe e natës ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, duhet mbështetur në orë e kohëmatës, pa marrë parasysh lindjen ose perëndimin e diellit.
 12. Në rast rreziku, gjatë një udhëtimi ose jo, për çdo Lutje të Detyrueshme që mbetet pa thënë urdhërohet të bëhet një përlulje e të recitohet një varg i posaçëm dhe pastaj të përsëritet tetëmbëdhjetë herë një tjetër varg i posaçëm.
 13. Lutja në grup është e ndaluar, me përjashtim të Lutjes për të Vdekurit.
 14. Është porositur që Lutja për të Vdekurit të thuhet e plotë, me përjashtim të atyre që nuk dinë të lexojnë,

për të cilët është porosia që të përsërisin gjashtë pasazhet specifike të kësaj lutjeje.

15. Lutja e Detyrueshme që duhej përsëritur tri herë në ditë, në mëngjes, në mesditë e në mbrëmje, është zëvendësuar nga tri Lutjet e Detyrueshme të reveluara më pas.
16. Lutja e Shenjave është hequr dhe është zëvendësuar me një varg të reveluar posaçërisht. Recitimi i këtij vargu, sidoqoftë, nuk është i detyrueshëm.
17. Flokët (qimet), gëzofët, kockat e të tjera si këto nuk e zhvleftësojnë lutjen.

B. Agjërimi

1. Pozita sublime e agjërimin në Revelacionin Bahá'í.
2. Periudha e agjërimin fillon me mbarimin e Ditëve të Shtuara dhe përfundon me Festën e Novruzit.
3. Shmangia nga ushqimi e pija nga lindja deri në perëndim të diellit është e detyrueshme.
4. Agjërimi është detyrim për burrat dhe gratë që nga çasti që arrijnë moshën e pjekurisë, të caktuar në pesëmbëdhjetë vjeç.
5. Përrjashtohen nga agjërimi:
 - a. Udhëtarët
 - i. Me kusht që udhëtimi të zgjasë mbi 9 orë.
 - ii. Ata që udhëtojnë në këmbë, me kusht që udhëtimi të zgjasë mbi 2 orë.
 - iii. Ata që e ndërpresin një udhëtim për më pak se 19 ditë.
 - iv. Ata që e ndërpresin udhëtimin gjatë Agjërimin në një vend ku do të qëndrojnë 19 ditë përrjashtohen nga agjërimi vetëm për tri ditët e para pas arritjes.

- v. Ata që kthehen në shtëpi gjatë Agjërimit duhet të fillojnë të agjërojnë që nga dita e arritjes.
 - b. Ata që janë të sëmurë.
 - c. Ata që janë mbi 70 vjeç.
 - d. Gratë shtatzëna.
 - e. Gratë me fëmijë gjiri.
 - f. Gratë gjatë zakoneve të përmuajshme, me kusht që të kryejnë marrjen avdes dhe të përsërisin 95 herë në ditë një varg të reveluar posaçërisht.
 - g. Ata që bëjnë punë të rëndë, të cilët këshillohen të tregojnë respekt për këtë ligj, duke shfaqur pjekuri e vetëpërmbytje ndërsa përfitojnë nga përjashtimi.
6. Lejohet të kushtohesh për një agjërim (në një muaj tjetër nga ai i caktuari). Por në sytë e Perëndisë janë të parapëlqyera ato kushtime që i sjellin dobi njerëzimit.

C. Ligje që kanë të bëjnë me statusin vetjak

1. Martesa:
- a. Martesa është shumë e këshillueshme, por jo e detyrueshme.
 - b. Është e ndaluar të kesh shumë gra.
 - c. Kusht i domosdoshëm për martesën është që të dyja palët të kenë arritur moshën e pjekurisë, të caktuar 15 vjeç.
 - d. Martesa është e kushtëzuar nga pëlqimi i të dyja palëve dhe i prindërve të tyre, qoftë kur gruaja është e virgjër ose jo.

- e. Të dyja palët duhet të thonë një varg të reveluar posaçërisht, që tregon se janë të kënaqura me vullnetin e Perëndisë.
- f. Martesa me njerikën e vet është e ndaluar.
- g. Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën midis të farefisit duhet t'i paraqiten Shtëpisë së Drejtësisë.
- h. Martesa me jobesimtarë është e lejuar.
- i. Fejesa:
 - i. Periudha e fejesës nuk duhet të vazhdojë më shumë se 95 ditë.
 - ii. Është e paligjshme të fejojesh me një vajzë para se ajo të ketë arritur moshën e pjekurisë.
- j. Prika:
 - i. Martesa është e kushtëzuar me pagesën e një prike.
 - ii. Prika është caktuar 19 mithqálë ar i pastër për banorët e qyteteve dhe 19 mithqálë argjend për banorët e fshatrave, në varësi të vendbanimit të përhershëm të burrit e jo të gruas.
 - iii. Është e ndaluar të paguhet më tepër se 95 mithqálë.
 - iv. Është e parapëlqyer që një burrë të kënaqet me pagesën e 19 mithqálëve argjend.
 - v. Në qoftë se nuk është e mundur të paguhet e plotë prika, lejohet të nënshkruhet një zotim pagese.
- k. Po qe se, pasi është thënë vargu i reveluar posaçërisht dhe është paguar prika, ndonjëra prej

palëve krijon antipati për palën tjetër para se të jetë konsumuar martesë, nuk është e nevojshme periudha e pritjes para shkurorezimit. Por nuk është e lejuar të kthehet prika.

- l. Kur burri ka ndërmend të bëjë një udhëtim, duhet t'i përcaktojë së shoqes kohën kur do të kthehet. Në qoftë se, për një arsye të ligjshme, nuk është në gjendje të kthehet në kohën e caktuar, ai duhet ta lajmërojë të shoqen dhe të përpiqet të kthehet tek ajo. Në qoftë se ai nuk përmbush asnjërin prej këtyre kushteve, e shoqja duhet të presë 9 muaj dhe pas kësaj mund të rimartohet, megjithëse është e parapëlqyeshme që ajo të presë më gjatë. Po qe se ajo merr lajm për vdekjen ose vrasjen e tij, dhe ky lajm konfirmohet nga opinionimi publik ose nga 2 dëshmitarë të besueshëm, ajo mund të rimartohet pas kalimit të 9 muajve.
- m. Në qoftë se burri, edhe duke qenë në dijeni të ligjit të shkruar në Kitáb-i-Aqdas, niset pa e njoftuar të shoqen për kohën e kthimit, e shoqja mund të rimartohet pasi të ketë pritur plot një vit. Në qoftë se burri nuk është në dijeni të këtij ligji, e shoqja duhet të presë derisa t'i vinë lajme për burrin e saj.
- n. Po qe se burri, pasi ka paguar prikën, zbulon se e shoqja nuk është e virgjër, mund të kërkojë t'i kthehen prika dhe shpenzimet e bëra.
- o. Në qoftë se martesë është kushtëzuar me virgjërinë, mund të kërkohet kthimi i prikës e i shpenzimeve të bëra dhe martesë të zhvleftësohet. Por mbajtja fshehur e kësaj çështjeje është shumë e lavdërueshme në sytë e Perëndisë.

2. Shkurorëzimi:

- a. Shkurorëzimi dënohet ashpër.
- b. Në qoftë se nga ana e burrit ose e gruas lind antipati ose neveri, shkurorëzimi lejohet, por vetëm pasi të ketë kaluar plot një vit. Fillimi dhe mbarimi i vitit të pritjes duhet të dëshmojen nga dy ose më shumë dëshmitarë. Akti i shkurorëzimit duhet të regjistrohet nga nëpunësi legal që përfaqëson Shtëpinë e Drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe pritjeje marrëdhëniet seksuale janë të ndaluara dhe kush e shkel këtë ligj duhet të pendohet dhe t'i paguajë Shtëpisë së Drejtësisë 19 mithqalë ar.
- c. Kur shkurorëzimi është bërë, nuk kërkohet një tjetër periudhë pritjeje.
- d. Në qoftë se shkurorëzimi ndodh për shkak të pabesisë së saj, gruaja humbet të drejtën e pagesës për shpenzimet gjatë periudhës së pritjes.
- e. Është e lejuar rimartesa me gruan e ndarë, me kusht që ajo të mos jetë martuar me një tjetër. Në qoftë se kjo ka ndodhur, ajo duhet të ndahet prej tij para se burri i mëparshëm të mund të rimartohet me të.
- f. Në qoftë se në çfarëdo kohe gjatë periudhës së pritjes rishfaqet dashuria, lidhja martesore është e vlefshme. Në qoftë se ky ripajtım pasohet nga ftohja dhe përsëri është dëshira për shkurorëzim, duhet filluar një vit tjetër pritjeje.
- g. Po qe se gjatë një udhëtimi lindin mosmarrëveshje midis burrit e gruas, burri duhet ta kthejë të shoqen në shtëpi, ose t'ia besojë një personi të besuar që ta shoqërojë atë deri atje, dhe t'i

paguajë asaj udhëtimitin e shpenzimet për një vit të tërë.

- h. Në qoftë se një grua ngul këmbë që të ndahet nga burri për të mos emigruar në ndonjë vend tjetër, viti i pritjes llogaritet që nga dita që ata ndahen, qoftë kjo gjatë përgatitjeve të tij për t'u nisur ose në momentin e nisjes.
- i. Ligji islamik për rimartesën me gruan nga e cila burri është ndarë më parë shfuqizohet.

3. Trashëgimi:²⁴

a. Trashëgimi përfshihet në kategoritë që vijojnë:

1. fëmijët	1,080	nga	2,520	pjesë
2. burri				
ose gruaja	390	“	2,520	“
3. babai	330	“	2,520	“
4. nëna	270	“	2,520	“
5. vëllai	210	“	2,520	“
6. motra	150	“	2,520	“
7. mësuesi	90	“	2,520	“

- b. Pjesa e caktuar nga Báb-i për fëmijët është dyfishuar nga Bahá'u'lláh-u dhe një pjesë e barabartë i është hequr përkatësisht secilit prej përfituesve të tjerë.
- c.
 - i. Në rastet kur nuk ka fëmijë, pjesa e tyre i kalon Shtëpisë së Drejtësisë për t'u shpenzuar për jetimët e për të vejat dhe për çdo gjë që i sjell dobi njerëzimit.
 - ii. Në qoftë se i biri i të ndjerit ka vdekur dhe ka lënë fëmijë, këta trashëgojnë pjesën e atit të

²⁴ Kjo metodë e ndarjes së pasurisë zbatohet në rastet kur nuk ka testament. Shih pikën o të këtij seksioni.

tyre. Në qoftë se e bija e të ndjerit ka vdekur dhe ka lënë fëmijë, pjesa e saj duhet ndarë midis të shtatë kategorive të përcaktuara në Librin Më të Shenjtë.

- d. Në qoftë se një person lë fëmijë, por mungojnë disa ose të gjithë trashëgimtarët që hyjnë në kategoritë e tjera, dy të tretat e pjesës së tyre u kalojnë fëmijëve dhe një e treta Shtëpisë së Drejtësisë.
- e. Në qoftë se nuk ekziston asnjë prej përfituesve të përcaktuar, dy të tretat e trashëgimit u shkojnë nipave e mbesave të të ndjerit. Në qoftë se këta nuk ekzistojnë, e njëjta pjesë u kalon tetove e ungjërve; në mungesë të këtyre, u kalon bijve e bijave të tyre. Në çdo rast, një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë.
- f. Në qoftë se një person nuk lë asnjë prej trashëgimtarëve të lartpërmendur, gjithë trashëgimi i kalon Shtëpisë së Drejtësisë.
- g. Banesa dhe rrobat vetjake të babait që ka vdekur u kalojnë fëmijëve meshkuj, e jo femra. Në qoftë se ka disa banesa, kryesorja e më e rëndësishmja u kalon fëmijëve meshkuj. Banesat e tjera duhet të ndahen midis trashëgimtarëve bashkë me pronat e tjera të të ndjerit. Po nuk pati fëmijë meshkuj, dy të tretat a banesës kryesore dhe të rrobave vetjake të babait të vdekur u takojnë fëmijëve femra dhe një e treta Shtëpisë së Drejtësisë. Në rast se vdes një nënë, të gjitha rrobat e saj të përdorura duhet të ndahen në pjesë të barabarta midis të bijave. Në qoftë se ajo (e ndjera) nuk lë vajza, rrobat e reja, arturinat, pronat, si dhe rrobat e përdorura, duhet të ndahen midis trashëgimtarëve.

- h. Në qoftë se fëmijët e të ndjerit janë të mitur, pjesa e tyre duhet t'i besohet një personi të besuar ose një shoqërie për ta investuar, derisa ata të arrijnë moshën e pjekurisë. Një pjesë e interesit të shtuar i duhet caktuar të besuarit.
- i. Trashëgimi duhet ndarë vetëm pasi janë paguar Ғuququ'lláh-u (e Drejta e Perëndisë), borxhet e marra përsipër nga i ndjeri dhe shpenzimet e duhura për një funeral e varrim të përshtatshëm.
- j. Vëllai i të ndjerit trashëgon të gjithë pjesën që i është caktuar, në qoftë se është i biri i të njëjtit baba. Në qoftë se është vëlla me baba tjetër, trashëgon vetëm dy të tretat e pjesës dhe një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë. Po ky ligj është i zbatueshëm edhe për motrën e të ndjerit.
- k. Në qoftë se ka vëllezër e motra nga të njëjtët baba e nënë, vëllezërit e motrat vetëm nga nëna nuk trashëgojnë gjë.
- l. Mësuesi jo Bahá'í nuk trashëgon gjë. Në qoftë se ka më shumë se një mësues, pjesa e caktuar mësuesit duhet ndarë midis tyre në mënyrë të barabartë.
- m. Trashëgimtarët jo Bahá'í nuk trashëgojnë gjë.
- n. Me përjashtim të rrobave të përdorura të bashkëshortes dhe të arturinave e të gjërave të tjera që është vërtetuar se burri ia ka dhuruar asaj, çdo gjë që burri ka blerë për të shoqen duhet konsideruar pronë e burrit që duhet ndarë midis trashëgimtarëve të tij.
- o. Secili është i lirë ta lerë me testament pasurinë e tij siç e quan të udhës, me kusht që të lerë porosi

për pagimin e Ғuqúqu'lláh-ut dhe për shlyerjen e borxheve.

D. Ligje, urdhëresa e këshilla të ndryshme

1. Ligje dhe urdhëresa të ndryshme:
 - a. Haxhillëku
 - b. Ғuqúqu'lláh-u
 - c. Dhurimet
 - d. Mashrikul Azkar-i
 - e. Kohëzgjatja e Dispensacionit Bahá'í
 - f. Festat Bahá'í
 - g. Festa e Nëntëmbëdhjetë Ditëve
 - h. Viti Bahá'í
 - i. Ditët e Shtuara
 - j. Mosha e pjekurisë
 - k. Varrimi i të vdekurve
 - l. Është e detyrueshme t'i kushtohesh tregtisë ose ndonjë profesioni, që janë lartësuar në rangun e adhurimit të Perëndisë
 - m. Bindja ndaj qeverisë
 - n. Edukimi i fëmijëve
 - o. Shkruarja e një testamenti
 - p. Të dhjetat (Zeqati)
 - q. Përsëritja e Emrit Më të Madh 95 herë në ditë
 - r. Gjuetia e kafshëve
 - s. Trajtimi i shërbëtoreve
 - t. Gjetja e sendeve të humbura
 - u. Rregulli për thesaret e gjetura
 - v. Disponimi objekteve të ruajtura nën kujdestari

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E KODIFIKIMI

- w. Vrasja pa dashje nga pakujdesia
- x. Përkufizimi i termit dëshmitar i ndershëm
- y. Ndalime:
 - i. Interpretimi i Shkrimeve të Shenjta
 - ii. Tregtia e sklleverve
 - iii. Asketizmi
 - iv. Murgëria
 - v. Lypësia
 - vi. Priftëria
 - vii. Përdorimi i amvonave
 - viii. Puthja e dorës
 - ix. Rrëfimi i mëkateve
 - x. Pasja e shumë grave
 - xi. Pijet dehëse
 - xii. Opiumi
 - xiii. Kumari
 - xiv. Zjarrvënia
 - xv. Marrëdhëniet intime jashtë kurore
 - xvi. Vrasja
 - xvii. Vjedhja
 - xviii. Homoseksualizmi
 - xix. Lutja në grup, me përjashtim të asaj për të vdekurit
 - xx. Sjellja e pashpirt ndaj kafshëve
 - xxi. Përtacia dhe plogështia
 - xxii. Përgojimi
 - xxiii. Shpifja

- xxiv. Mbajtja e armëve pa qenë e domosdoshme
 - xxv. Përdorimi i hurdhave publike në banjat persiane
 - xxvi. Hyrja në një shtëpi pa lejen e të zotit
 - xxvii. Goditja ose plagosja e një personi
 - xxviii. Grindjet e konfliktet
 - xxix. Mërmëritja e vargjeve të shenjta në rrugë
 - xxx. Futja e duarve në ushqim
 - xxxí. Rruarja e kokës
 - xxxii. Rritja e flokëve të burrave tej bulës së veshit
2. Shfuqizimi i ligjeve dhe urdhëresave të posaçme të Manifestimeve të mëparshme, që parashikonin:
- a. Zhdukje të librave
 - b. Ndalimin e të veshurit me mëndafsh
 - c. Ndalimin e përdorimit të orendive të arta e të argjendta
 - d. Kufizimin e udhëtimeve
 - e. Blatimin e dhuratave të paçmuara Themeluesit të Besimit
 - f. Ndalimin për t'i bërë pyetje Themeluesit të Besimit
 - g. Ndalimin për t'u rimartuar me gruan e ndarë më parë
 - h. Dënimin e cilitdo që bëhej shkak hidhërimi për të afërmin
 - i. Ndalimin e muzikës

- j. Kufizime për veshjen e për mjekrën
 - k. Papastërtinë e sendeve e të njerëzve të ndryshëm
 - l. Papastërtinë e farës
 - m. Papastërtinë e disa objekteve për t'u gjunjzuar në to
3. Këshilla të ndryshme:
- a. Të shoqërohem miqësisht me pasuesit e të gjitha feve.
 - b. Të nderohen prindërit
 - c. Të mos dëshirosh për të tjerët atë që nuk dëshiron për veten tënde
 - d. Të mësohet e përhapet Besimi pas ngjitjes në qiell të Themeluesit të tij
 - e. Të ndihmohen ata që ngrihen për të çuar përpara Kauzën
 - f. Të mos largohemi nga Shkrimet dhe as të mos lejojmë të na çojnë në rrugë të shtrembër ata që e bëjnë këtë
 - g. T'u referohemi Shkrimeve të Shenjta kur lindin mosmarrëveshje
 - h. Të zhytemi në studimin e Mësimeve
 - i. Të mos tërhiqemi nga fantazitë tona të kota dhe nga imagjinatat boshe
 - j. Të recitohen vargjet e shenjta në mëngjes e mbrëmje
 - k. Të recitohen vargjet në mënyrë melodioze
 - l. Të mësojmë fëmijët tanë të këndojnë vargjet e shenjta në Mashrikul Azkar
 - m. Të studiohen ato arte e shkenca që i sjellin dobi njerëzimit

KITÁB-I-AQDAS

- n. Të konsultohemi së bashku
- o. Të mos bëjmë lëshime në zbatimin e dekreteve të Perëndisë
- p. Të pendohemi para Perëndisë për mëkatet tona
- q. Të dallohemi për vepra të mira:
 - i. Të jemi të çiltër
 - ii. Të jemi të besueshëm
 - iii. Të jemi besnikë
 - iv. Të jemi të virtytshëm dhe t'i druhami Perëndisë
 - v. Të jemi të drejtë e të paanshëm
 - vi. Të jemi me takt e të matur
 - vii. Të jemi të sjellshëm
 - viii. Të jemi mikpritës
 - ix. Të jemi ngulmues
 - x. Të jemi të shkëputur
 - xi. Të jemi plotësisht të nënshtruar ndaj vullnetit të Perëndisë
 - xii. Të mos shkaktojmë ngatërresa
 - xiii. Të mos jemi hipokritë
 - xiv. Të mos jemi mendjemëdhenj
 - xv. Të mos jemi fanatikë
 - xvi. Të mos parapëlqejmë veten ndaj të afërmit
 - xvii. Të mos grindemi me të afërmin
 - xviii. Të mos jepemi pas pasioneve tona
 - xix. Të mos qahemi në fatkeqësi

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E KODIFIKIMI

- xx. Të mos u kundërvihemi atyre që janë në pushtet
- xxi. Të mos humbasim gjakftohtësinë
- xxii. Të mos zemërojmë të afërmin
- r. Të jemi të bashkuar ngushtë
- s. Të këshillohemi me mjekë të zotë në rast sëmundjeje
- t. T'u përgjigjemi ftesave
- u. Të tregohemi të njerëzishëm ndaj të afërmëve të Themeluesit të Besimit
- v. Të studiojmë gjuhët për të çuar përpara Besimin
- w. Të mbështesim zhvillimin e qyteteve e të vendeve për madhërimin e Besimit
- x. Të rimëkëmbim e të ruajmë vendet që janë të lidhura me Themeluesit e Besimit
- y. Të jemi thelbi i pastërtisë:
 - i. Të lajmë këmbët
 - ii. Të parfumohemi
 - iii. Të lahemi në ujë të pastër
 - iv. Të presim thonjtë
 - v. Të lajmë gjërat e pista në ujë të pastër
 - vi. Të mos kemi njolla në rrobat
 - vii. Të përtërijmë pajisjet e shtëpisë

V. QORTIME, VËREJTJE E PARALAJMËRIME TË POSAÇME

Drejtuar:

1. Mbarë gjinisë njerëzore
2. Kokave të kurorëzuara të botës

KITÁB-I-AQDAS

3. Gjithë klerit
4. Sundimtarëve dhe Presidentëve të Republikave Amerikane
5. Vilhelmit I, Mbret i Prusisë
6. Franc Jozefit, Perandor i Austrisë
7. Njerëzve të Bayán-it
8. Anëtarëve të parlamenteve në gjithë botën

VI. TEMA TË NDRYSHME

1. Karakteri transhendent i Revelacionit Bahá'í
2. Pozita e lartësuar e Autorit të Besimit
3. Rëndësia supreme e Kitáb-i-Aqdas-it, “Librit Më të Shenjtë”.
4. Doktrina e “*Pagabueshmërisë Më të Madhe*”
5. Detyrat binjake të njohjes së Manifestimit e të zbatimit të Ligjeve të Tij dhe pandashmëria e tyre
6. Qëllimi i çdo diturie është njohja e Atij Që është objekti i çdo dije
7. Bekimi i atyre që kanë njohur të vërtetën themelore “*Atij nuk do t’I kërkohet llogari për bëmat e Tij*”
8. Efekti revolucionarizues i “*Rendit Më të Madh*”
9. Zgjedhja e një gjuhe të vetme dhe pranimi i një shkrimi të përbashkët që të përdoren nga të gjithë njerëzit mbi tokë: një prej dy shenjave të pjekurisë së gjinisë njerëzore
10. Profecitë e Báb-it lidhur me “*Atë Që Perëndia do Ta shfaqë*”
11. Parashikimi lidhur me kundërvënien ndaj Besimit

12. Lavdërim i mbretit që do të ushtrojë Besimin dhe do të ngrihet për t'i shërbyer
13. Paqëndrueshmëria e punëve njerëzore
14. Domethënia e lirisë së vërtetë
15. Merita e të gjitha veprimeve varet nga miratimi i Perëndisë
16. Rëndësia e dashurisë për Perëndinë si motivi i bindjes ndaj Ligjeve të Tij
17. Rëndësia e përdorimit të mjeteve materiale
18. Lavdërim i të diturve midis njerëzve të Bahá'it
19. Sigurimi i ndjesës për Mírzá Yahyá-në në rast se do të pendohet
20. Mesazh Tíhránit
21. Mesazh Konstantinopojës dhe popullsisë së saj
22. Mesazh *“Brigjeve të Rinit”*
23. Dënim i atyre që paraqesin pretendime të rreme për dije të fshehta
24. Dënim i atyre që e lejojnë mëndjemadhësinë në dijet e veta t'i përjashtojë ata nga Perëndia
25. Profeci lidhur me Horasanin
26. Profeci lidhur me Kirmán-in
27. Aluzion për Shaykh Aḥmad-i-Aḥsá'í-në
28. Aluzion për Sitësin e Grurit
29. Dënim i Hájí Muḥammad-Karím Khán-it
30. Dënim i Shaykh Muḥammad-Ḥasan-it
31. Aluzion për Napoleonin III
32. Aluzion për Siyyid Muḥammad-i-Iṣfáhání-n

33. Sigurimi i ndihmës për të gjithë ata që ngrihen për t'i shërbyer Besimit

SHËNIME

[Shënimet janë të numëruara nga 1 deri në 194. Secili shënim fillon me një frazë ose fjali nga Kitáb-i-Aqdas, të shtypur me gërma të zeza, që pasohet nga numri i paragrafit në të cilin përmbahet.]

1. aroma e këndshme e rrobës Sime ¶4

Ky është një aluzion për historinë e Josifit në Kuran dhe në Dhiatën e Vjetër, në të cilën rroba e Josifit, që të vëllezërit ia çuan Jakovit, i dha mundësi këtij të njihte djalin e tij të shumëdashur që kishte humbur. Metafora e “rrobës” erëmirë përdoret shpesh në Shkrimet Bahá’í për t’iu referuar njohjes së Manifestimit të Perëndisë e të Revelacionit të Tij.

Në një prej Tabelave të Tij, Bahá’u’lláh u e cilëson Veten si “*Josifi Hyjnor*” Që është “*shitur*” nga të shkujdesurit me “*çmimin më të përbufzur*”. Báb i, në Qayyúmu’l-Asmá’, e cilëson Bahá’u’lláh un si “*Josifi i vërtetë*” dhe parashikon vuajtjet që Ai do të pësojë nga duart e vëllait të Tij të pabesë (shih shënimin 190). Po kështu, Shoghi Effendi u e krahason xhelozinë e madhe që shquarsia e ‘Abdu’l-Bahá it kishte ngjallur te vëllai i Tij nga i ati, Mírzá Muḥammad-‘Alí u, me zilinë për vdekje “që epërsia e Josifit kishte ndezur në zemrat e vëllezërve të tij”.

2. Me gishtat e fuqisë e të pushtetit, Ne kemi hapur Verën e zgjedhur. ¶5

Përdorimi i verës dhe i pijeve të tjera dehëse është i ndaluar në Kitáb-i-Aqdas (shih shënimet 144 dhe 170).

Referenca për përdorimin e “verës” në kuptimin alegorik, si shkak i ekstazës shpirtërore, gjendet jo vetëm në Revelacionin e

Bahá'u'lláh ut, por edhe në Biblën, në Kuran dhe në traditat e lashta hindu.

Për shembull, në Kuran u premtohet të drejtëve se do t'u jepet për të pirë *“vera e zgjedhur dhe e vulosur”*. Në Tabelat e Tij, Bahá'u'lláh u e njëjtëson *“Verën e zgjedhur”* me Revelacionin e Tij, *“aroma erë mysbku”* e të cilit është përhapur *“mbi të gjitha gjërat e krijuara”*. Ai thotë se ka *“hapur”* këtë *“Verë”*, duke zbuluar kështu të vërteta shpirtërore që deri atëherë ishin të panjohura dhe duke u dhënë mundësinë atyre që do të pinin prej saj të *“shohin shkëlqimet e dritës së unitetit hyjnor”* dhe *“të kuptojnë qëllimin thelbësor që qëndron në themel të Shkrimeve të Perëndisë”*.

Në një prej përsiatjeve të Tij, Bahá'u'lláh u i lutet Perëndisë t'u japë besimtarëve *“Verën e zgjedhur të mëshirës Sate, që t'i harrojnë të gjithë veç Teje dhe të ngrihen për t'i shërbyer Kauzës Sate dhe të qëndrojnë në patundur në dashurinë e tyre për Ty”*.

3. Ne ju kemi urdhëruar lutjen e detyrueshme ¶6

Në gjuhën arabe ka disa fjalë me kuptimin lutje. Fjala *“şalát”*, e cila përdoret këtu në origjinal, i referohet një kategorie të veçantë lutjesh, recitimi i të cilave në kohë të caktuara të ditës u urdhërohet besimtarëve. Për ta dalluar këtë kategori lutjesh nga llojet e tjera, kjo fjalë është përkthyer *“lutje e detyrueshme”*.

Bahá'u'lláh u thotë se *“në sytë e Perëndisë lutja e detyrueshme dhe agjërimi zenë një vend të lartësuar”* (Py&Pë 93). ‘Abdu’l-Bahá i thotë se këto lutje *“çojnë në përunjësi e nënshtrim, bëjnë që ta kthesh fytyrën ndaj Perëndisë e të shprehësh devotshmëri ndaj Tij”* dhe se me anë të këtyre lutjeve *“njeriu mban lidhje me Perëndinë, përpigjet t’I qaset pranë, bisedon me të Shumëdashurin e vërtetë të zemrës së tij dhe arrin shkallë shpirtërore”*.

Lutja e Detyrueshme (shih shënimin 9), së cilës i referohet ky varg, është zëvendësuar nga tri Lutjet e Detyrueshme të reveluara nga Bahá'u'lláh u (Py&Pë 63) Tekstet e tri lutjeve që janë tani në përdorim, bashkë me udhëzimet për recitimin e tyre, gjendet në këtë vëllim në kreun Disa Tekste Shtojcë të Kitáb-i-Aqdas it.

Një numër zërash në Pyetje dhe Përgjigje trajtojnë aspekte të tri Lutjeve të reja të Detyrueshme. Bahá'u'lláh u sqaron se gjithkush lejohet të zgjedhë cilëndo prej tri Lutjeve të Detyrueshme (Py&Pë 65). Porosi të tjera ndriçohen në Pyetje dhe Përgjigje numër 66, 67, 81 dhe 82.

Hollësitë e ligjit për lutjen e detyrueshme janë përmbledhur në seksionin IV.A. 1.-17 të Pasqyrës Përmbledhëse e Kodifikimit.

4. nëntë rakahë ¶6

Një rak'ah është recitimi i vargjeve të reveluara posaçërisht, i shoqëruar nga një seri e caktuar gjunjëzimesh e lëvizjesh të tjera.

Lutja e Detyruar që Bahá'u'lláh u u urdhëronte fillimisht pasuesve të Tij përbëhej prej nëntë rakahësh. Natyra e saktë e kësaj lutjeje dhe e udhëzimeve të posaçme për recitimin e saj janë të panjohura, duke qenë se kjo lutje ka humbur (shih shënimin 9).

Në një Tabelë që komenton Lutjet e Detyrueshme aktualisht në veprim, 'Abdu'l-Bahá i vë në dukje se *“në çdo fjalë e lëvizje të Lutjes së Detyrueshme ka aluzione, mistere e një urti që njeriu nuk është në gjendje t'i kuptojë dhe që as letra e pergamena nuk mund t'i mbajnë”*.

Shoghi Effendi u shpjegon se ato pak udhëzime të thjeshta që ka dhënë Bahá'u'lláh u për recitimin e disa lutjeve jo vetëm kanë një domethënie shpirtërore, por edhe e ndihmojnë individin *“të përqëndrohet plotësisht gjatë lutjes e përsiatjes”*.

5. në mesditë dhe në mëngjes e mbrëmje ¶6

Lidhur me përkufizimin e fjalëve *“mëngjes”*, *“mesditë”* dhe *“mbrëmje”*, kohë në të cilat duhet të recitohet Lutja e mesme e Detyruar që është në veprim sot, Bahá'u'lláh u ka thënë se ato përkojnë me *“lindjen e diellit, mesditën dhe perëndimin e diellit”* (Py&Pë 83). Ai specifikon se *“kohët e lejuara për Lutjet e Detyrueshme janë nga mëngjesi deri në mesditë, nga mesdita deri në perëndim të diellit dhe nga perëndimi i diellit deri dy orë pas tij”*. Më tej, 'Abdu'l-Bahá i ka thënë se Lutja e Detyrueshme e mëngjesit mund të thuhet që në agim.

Përkufizimi i *“mesditës”* si periudha *“nga mesdita deri në*

perëndim të diellit” vlen për recitim të Lutjes së Detyrueshme të shkurtër, si dhe të asaj të mesme.

6. Ne ju kemi liruar nga një numër më i madh ¶6

Kërkesat për lutjen e detyrueshme për të cilat bëhet thirrje në Dispensacionet Bábí e Islamik ishin shumë më të mëdha sesa ato për kryerjen e Lutjes së Detyrueshme të përbërë nga nëntë rakahë, që urdhërohet në Kitáb-i-Aqdas (shih shënimin 4).

Në Bayán, Báb i urdhëron një Lutje të Detyrueshme të përbërë prej nëntëmbëdhjetë rakahësh, që duhej kryer në çdo njëzet e katër orë, nga mesdita e një dite deri në mesditën e ditës së nesërme.

Lutja islamike recitohet pesë herë në ditë, konkretisht në mëngjes herët, në mesditë, pasdite, në mbrëmje dhe natën. Ndërsa numri i rakahëve ndryshon sipas kohës së recitimit, gjatë një dite bëhen gjithsej shtatëmbëdhjetë rakahë.

7. Kur doni të thoni këtë lutje, kthejeni fytyrën ndaj Oborrit të Pranisë Sime Më të Shenjtë, këtij Vendi të Shenjtëruar që Perëndia ... e ka caktuar të jetë Pika e Adhurimit për banorët e Qyteteve të Përjetësisë ¶6

“Pika e Adhurimit”, domethënë pika drejt së cilës duhet të kthehet adhuruesi kur bën lutjen e detyrueshme, quhet Kibla. Koncepti i Kiblës ka ekzistuar edhe në fetë e mëparshme. Në të kaluarën për këtë qëllim ishte caktuar Jerusalemi. Muhameti e ndryshoi Kiblën dhe caktoi Mekën. Udhëzimet e Báb it në Bayán in Arab ishin:

Në të vërtetë, Kibla është Ai që Perëndia do Ta shfaqë; ngado që të lëvizë Ai edhe ajo lëviz, derisa Ai të arrijë në prehje.

Ky pasazh është cituar nga Bahá’u’lláh u në Kitáb-i-Aqdas (¶137) dhe është konfirmuar prej Tij në vargun e lartpërmendur. Ai ka treguar gjithashtu se kthimi i fytyrës në drejtim të Kiblës është një *“kërkesë e posaçme për thënien e lutjes së detyrueshme”* (Py&Pë 14 e 67). Kurse për lutje e adhurime të tjera secili mund ta kthejë fytyrën

në çfarëdo drejtimi.

8. dhe kur Dielli i së Vërtetës e i Fjalës të ketë perënduar, kthejeni fytyrën ndaj Vendit që Ne ju kemi urdhëruar ¶6

Bahá'u'lláh u urdhëron që pas vdekjes së Tij Kibla të jetë varri i Tij. Varri Më i Shenjtë është në Bahxhi, 'Akká. 'Abdu'l-Bahá i e quan atë "*Mauzole i shndritshëm*", "*vendi rreth të cilit sillet Tubimi Qiellor*".

Në një letër të shkruar në emër të tij, Shoghi Effendi u përdor analogjinë e bimës që kthehet drejt diellit, për të shpjeguar domethënien shpirtërore të kthimit të fytyrës ndaj Kiblës.

... ashtu si bima kthehet drejt dritës së diellit, nga e cila merr jetë e zhvillim, edhe ne, gjatë lutjes, i kthejmë zemrat tona ndaj Manifestimit të Perëndisë, Bahá'u'lláh ut; ... ne e kthejmë fytyrën ... drejt vendit ku hiri i Tij prehet në këtë tokë, si një simbol të veprimit të brendshëm.

9. I kemi shtjelluar hollësitë e lutjes së detyrueshme në një Tabelë tjetër. ¶8

Lutja e Detyrueshme fillestare, "*për arsye urtie*", është reveluar nga Bahá'u'lláh u në një Tabelë më vete (Py&Pë 63). Ajo nuk iu dha besimtarëve gjatë jetës së Tij, duke qenë se u zëvendësua nga tri Lutjet e Detyrueshme që janë tani në përdorim.

Pak kohë pasi Bahá'u'lláh u ndërroi jetë, teksti i kësaj lutjeje u vodh nga Muhamet Aliu, Kryeshkelësi i Besëlidhjes së Tij.

10. Lutja për të Vdekurit ¶8

Lutja për të Vdekurit (shih Disa Tekste Shtojcë të Kitáb-i-Aqdas it) është e vetmja lutje e Detyrueshme Bahá'í që duhet thënë në grup; ajo duhet recituar nga një besimtar, ndërkohë që gjithë të pranishmit qëndrojnë në këmbë në heshtje (shih shënimin 19). Bahá'u'lláh u ka sqaruar se Lutja për të Vdekurit kërkohet vetëm kur i ndjeri është një i rritur (Py&Pë 70), se thënia e saj duhet bërë para varrimit të të ndjerit dhe se gjatë recitimit të

kësaj lutjeje nuk kërkohet të kthehet fytyra ndaj Kiblës (Py&Pë 85).

Hollësi të tjera lidhur me Lutjen për të Vdekurit janë përmbledhur në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.A. 13.-14.

11. ju janë dërguar gjashtë pasazhe të posaçme nga Perëndia, Reveluesi i Vargjeve ¶8

Pasazhet që janë pjesë e Lutjes për të Vdekurit përfshijnë përsëritjen e përhëndetjes “Alláh-u-Abhá” (Perëndia është Lavdiploti) gjashtë herë, të pasuar çdo herë nga nëntëmbëdhjetë përsëritje të njërit prej gjashtë vargjeve të reveluara posaçërisht. Këto vargje janë të njëjta me ato të Lutjes për të Vdekurit të reveluar nga Báb i në Bayán. Bahá’u’lláh u ka shtuar një të lutur që u paraprin këtyre pasazheve.

12. Flokët (qimet) nuk e shvleftësojnë lutjen tuaj, as ndonjë gjë tjetër nga e cila shpirti është larguar, siç janë kockat e të tjera si këto. Jeni të lirë të mbani lëkurë kunadheje, si dhe kastori, ketri ose kafshësh të tjera ¶9

Në disa Dispensacione fetare të mëparshme, veshja e gëzofit të disa kafshëve ose mbajtja e disa sendeve të tjera konsiderohej se e shvleftëson lutjen. Këtu Bahá’u’lláh u mbështet thënien e Báb it në Bayán in Arab se gjëra të tilla nuk e shvleftësojnë lutjen.

13. Ju kemi porositur të luteni e të agjëroni që kur fillon moshë e pjekurisë ¶10

Bahá’u’lláh u e përcakton “moshën e pjekurisë ndaj detyrimeve fetare” *“pësëmbëdhjetë vjeç si për burrat dhe për gratë”* (Py&Pë 20). Për hollësi lidhur me periudhën e agjëritimit shih shënimin 25.

14. Ai ka përjashtuar nga kjo ata që janë të dobët për shkak sëmundjeje ose moshe ¶10

Përjashtimi nga thënia e Lutjeve të Detyrueshme dhe nga

Agjërimi i atyre që janë të dobët për shkak sëmundjeje ose moshe të kaluar shpjegohet në Pyetje dhe Përgjigje. Bahá'u'lláh u vë në dukje se në *“kohë sëmundjeje nuk është e lejueshme të zbatohen këto detyrime”* (Py&Pë 93). Në këtë kontekst, Ai e përcakton kohën e pleqërisë nga shtatëdhjetë vjeç e lart (Py&Pë 74). Në përgjigje të një pyetjeje, Shoghi Effendi u ka shpjeguar se personat që arrijnë moshën 70 vjeç përjashtohen, qofshin të dobët ose jo.

Përjashtimi nga agjërimi bëhet gjithashtu për kategoritë e tjera të posaçme të personave, që renditen në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.B.5. Për diskutim të mëtejshëm shih shënimet 20, 30 dhe 31.

15. Perëndia ju ka lejuar të përkuleni deri në tokë mbi çdo sipërfaqe të pastër, sepse Ne kemi hequr lidhur me këtë kufizimet e shënuara në Librin ¶10

Në Dispensacione të mëparshme, kërkesat e lutjes përfshinin shpesh herë përkuljen deri në tokë. Në Bayán in Arab, Báb i i ftonte besimtarët ta mbështetnin ballin mbi sipërfaqe kristali kur përkuleshin deri në tokë. Edhe në Islamin janë vendosur disa kufizime lidhur me sipërfaqen mbi të cilën myslimanëve u lejohet të përkulen. Bahá'u'lláh u i shfuqizon këto kufizime dhe përcakton thjesht *“çdo sipërfaqe të pastër”*.

16. Ai që nuk gjen ujë për avdes le të përsërisë pesë herë fjalët “Në emër të Perëndisë, Më të Dëlirit, Më të Dëlirit” dhe pastaj të bëjë lutjen. ¶10

Duke u përgatitur të thotë lutjen e detyrueshme, besimtari duhet të marrë avdes, që përfshin larjen e duarve e të fytyrës. Në qoftë se nuk gjendet ujë, të përsërisë pesë herë vargun e reveluar posaçërisht. Për një diskutim të përgjithshëm mbi avdesin shih shënimin 34.

Midis Dispensacioneve të mëparshme, në Kuran dhe në Bayán in Arab ka praktika pararendëse lidhur me procedurat zëvendësuese që duhen ndjekur kur nuk gjendet ujë.

17. Në rajone ku dita dhe nata zgjaten, le të maten kohët e lutjes me sahatë e me mjete të tjera që tregojnë kalimin e orëve. ¶10

Kjo ka parasysh territoret që ndodhen në ekstremin verior ose jugor, ku kohëzgjatja e ditëve dhe e netëve ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. (Py&Pë 64 dhe 103). Kjo porosi zbatohet edhe për agjërimin.

18. Ne ju kemi liruar nga kërkesa e kryerjes së Lutjes së Shenjave. ¶11

Lutja e Shenjave është një formë e posaçme e lutjes së detyrueshme myslimane që ka qenë urdhëruar të thuhej në kohë ngjarjesh natyrore, si tërmete, eklipse dhe dukuri të tjera si këto, të cilat mund të shkaktojnë frikë dhe merren si shenja ose veprime të Perëndisë. Kërkesa për thënien e kësaj lutjeje është shfuqizuar. Në vend të saj Bahá'í të mund të thonë *“Sundimi i përket Perëndisë, Zotit të së dukshmes e të së padukshmes, Zotit të Krijimit”*, por kjo nuk është e detyrueshme (Py&Pë 52).

19. Me përjashtim të Lutjes për të Vdekurit, praktika e lutjes kolektive është hequr. ¶12

Lutja në grup, në kuptimin e lutjes së detyrueshme të rregullt që duhet thënë sipas një rituali të caktuar, siç është zakon, për shembull, në Islamin, ku lutja e së premtes në xhami drejtohet nga një imam, në Dispensacionin Bahá'í është hequr. Lutja për të Vdekurit (shih shënimin 10) është e vetmja lutje në grup e urdhëruar nga ligji Bahá'í. Ajo duhet të recitohet nga njëri prej të pranishmëve ndërsa të tjerët qëndrojnë në këmbë në heshtje; recituesi nuk ka ndonjë pozitë të veçantë. Njerëzit e mbledhur nuk janë të detyruar ta kthejnë fytyrën drejt Kiblës (Py&Pë 85).

Tri Lutjet e Detyrueshme të përditshme duhen thënë individualisht, jo në grup.

Nuk ka rregulla të caktuara për thënien e lutjeve të tjera të

shumta Bahá'í dhe secili është i lirë të përdorë ato lutje jo të detyrueshme që dëshiron, në grumbullime ose individualisht. Lidhur me këtë, Shoghi Effendi u thotë që

...edhe pse miqtë lihen të lirë të ndjekin prirjen e vet, ...ata duhet të shmangin me kujdesin më të madh që mënyra e sjelljes së tyre të marrë një karakter tepër të ngurtë dhe të shndërrohet kështu në një institut. Kjo është një pikë që miqtë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh, për të mos u larguar nga rruga që tregohet qartë në Mësimet.

20. Perëndia i ka përjashtuar nga lutja e detyrueshme dhe agjërimi gratë që janë me zakonet e përmuajshme. ¶13

Gratë që janë me zakonet e përmuajshme përjashtohen nga lutja e detyrueshme dhe nga agjërimi; por ato duhet të marrin avdes (shih shënimin 34) dhe të përsërisin nëntëdhjetë e pesë herë në ditë, nga njëra mesditë në tjetrën, vargun *“Lëvduar qoftë Perëndia, Zoti i Shkëlqimit e i Bukurisë”*. Kjo porosi ka një praktikë para-rendëse në Bayán in Arab, ku bëhet një përjashtim i ngjashëm.

Në disa Dispensacione të mëparshme fetare, gratë në kohën e zakoneve të përmuajshme konsideroheshin ritualisht të papastra dhe u ndalohej të kryenin detyrimet e lutjes e të agjërimin. Koncepti i papastërtisë rituale u anulua nga Bahá'u'lláh u (shih shënimin 106).

Shtëpia Universale e Drejtësisë ka sqaruar se porositë e Kitáb-i-Aqdas it që përjashtojnë nga disa detyrime e përgjegjësi janë, siç e tregon vetë fjala, përjashtime e jo ndalime. Pra, çdo besimtar është i lirë të përfitojë nga një përjashtim i zbatueshëm në qoftë se dëshiron. Por Shtëpia e Drejtësisë këshillon që, duke vendosur ta bëjë ose jo këtë, besimtari duhet të përdorë urtinë dhe të ketë parasysh se Bahá'u'lláh u i ka lejuar këto përjashtime për arsye të shëndosha.

Përjashtimi i këshilluar nga lutja e detyrueshme, që fillimisht i referohej Lutjes së Detyrueshme prej nëntë rakahësh, është tani e zbatueshme për tri Lutjet e Detyrueshme që e kanë zëvendësuar

atë.

21. Kur jeni në udhëtim, në qoftë se ndaleni e pushoni në ndonjë vend të sigurt, bëni – gra e burra njëlloj – një përkulje deri në tokë në vend të çdo Lutjeje të Detyrueshme të pathënë ¶14

Përrjashtimi nga lutja e detyrueshme bëhet për ata që ndodhen në kushte pasigurie të tilla saqë thënia e Lutjes së Detyrueshme nuk është e mundur. Përrjashtimi është i zbatueshëm qoftë gjatë udhëtimit ose në shtëpi dhe jep një mjet falë të cilit Lutjet e Detyrueshme që kanë mbetur pa thënë për shkak të këtyre rrethanave të pasigurta të mund të kompensohen.

Bahá'u'lláh u e ka bërë të qartë se lutja e detyrueshme “*nuk është pezulluar gjatë udhëtimeve*” sakohë është e mundur të gjendet “*një vend i sigurt*” ku ajo të kryhet (Py&Pë 58).

Numrat 21, 58, 59, 60 dhe 61 në Pyetje dhe Përgjigje i zgjerojnë këto porosi.

22. Pasi t'i plotësoni përkuljet, uluni këmbëkryq ¶14

Shprehja arabisht “haykalu't tawhíd”, e përkthyer këtu “*këmbëkryq*”, do të thotë “poza e unitetit”. Tradicionalisht ka pasur gjithmonë kuptimin e një poze me këmbë të kryqëzuara.

23. Thuaj: Perëndia e ka bërë dashurinë Time të fshehur çelësin e Thesarit ¶15

Ka një hadith të mirënjohur islamik lidhur me Perëndinë e krijimin e Tij, që thotë:

Isha një Thesar i Fshehur. Desha të bëhesha i njohur, prandaj thirra në jetë krijimin, në mënyrë që të njihesha.

Në Shkrimet Bahá'í gjenden referenca e aluzione për këtë hadith. Për shembull, në një prej lutjeve të Tij, Bahá'u'lláh u revelon:

Lëvduar qoftë Emri Yt, O Zot Perëndia im! Dëshmoj se Ti ishe një Thesar i fshehur, i mbështjellë në Qënien Tënde që kur s'mbabet

mend, dhe një Mister i padepërtueshëm i mbyllur në vetë Thelbin Tënd. Duke dasbur të revelohesh, Ti thirre në jetë Botën Më të Madhe dhe Botën Më të Vogël, dhe zgjodhe Njeriun mbi të gjitha krijesat e Tua, dhe e bëre Atë një shenjë të të dyja këtyre botëve. O Ti Që je Zoti ynë, Më Zemërdhembshuri!

Ti e ngrite Atë që të zërrë fronin Tënd para gjithë popujve të krijimit Tënd. E bëre Atë të aftë të shpalosë misteret e Tua dhe të shkëlqejë me dritat e frymëzimit Tënd e të Revelacionit Tënd, dhe të shfaqë emrat e Tu e atributet e Tua. Përmes Tij stolise hyrjen e librit të krijimit Tënd, O Ti Që je Sundimtari i gjithësisë që ke artuar! (Lutje e Përsiatje të Bahá'u'lláh ut, XXXVIII).

Po kështu, në Fjalët e Fshehura Ai thotë:

O Bir i Njeriut! Unë e doja krijimin tënd, pra të krijova ty. Prandaj të më duash Mua, që Unë të të jap emrin tënd dhe ta mbush shpirtin tënd me Frymën e jetës.

Në komentin e Tij për hadithin e lartpërmendur, ‘Abdu’l-Bahá i shkruante:

O shtegtar në shtegun e të Shumëdashurit! Dije se synimi kryesor i këtij hadithi të shenjtë është të përmendë fazat e fshehjes e të shfaqjes së Perëndisë në Mishërimet e së Vërtetës, të Atyre që janë Vendagimet e Qenies së Tij Lavdiplote. Për shembull, para se flaka e zjarrit të pashuar të ndizet e të shfaqet, ajo ekziston vetvetiu brenda vetes së saj në identitetin e fshehur të Manifestimeve universale, dhe kjo është faza e “Thesarit të Fshehur”. Dhe kur Pema e bekuar merr flakë vetvetiu brenda vetvetes dhe ai zjarr Hyjnor digjet nga thelbi i vet brenda thelbit të vet, kjo është faza e “Desha të bëhesha i njohur”. Dhe kur ajo ndriçon nga Horizonti i gjithësisë mbi botët e rastësishme e që s’kanë vend me Emra e Atribute Hyjnore të panumërta, kjo përbën lindjen e një krijimi të ri e të mahnitshëm, i cili i korrespondon fazës “Prandaj thirra në jetë krijimin”. Dhe kur shpirtrat e shenjtëruar çajnë mëdysh perdet e të gjitha lidhjeve tokësore e të kushteve të kësaj bote dhe nxitojnë drejt fazës nga ku sodisin bukurinë e Pranisë Hyjnore, dhe nderohen duke njohur Manifestimin e janë në gjendje të shohin

shkëlqimin e Shenjës Më të Madhe të Perëndisë në zemrat e tyre, atëherë synimi i krijimit, që është njohja e Atij Që është e Vërteta e Përvetshme, do të bëhet i dukshëm.

24. O Pendë e Më të Lartit! ¶16

“Penda e Më të Lartit”, “Penda Supreme” dhe “Penda Më e Lartësuar” janë referenca për Bahá’u’lláh un, të cilat theksojnë funksionin e Tij si Revelues i Fjalës së Perëndisë.

25. Ne jua kemi bërë të detyrueshëm agjërimin për një periudhë të shkurtër ¶16

Agjërimi dhe lutja e detyrueshme përbëjnë dy shtyllat që mbajnë Ligjin e reveluar të Perëndisë. Në një prej Tabelave të Tij, Bahá’u’lláh u thotë se i ka reveluar ligjet e lutjes së detyrueshme e të agjërimin në mënyrë që përmes tyre besimtarët të mund të afrohen pranë Perëndisë.

Shoghi Effendi u vë në dukje se periudha e agjërimin, që kërkon vetëpërmbytjen e plotë nga ushqimi e pija që nga lindja deri në perëndim të diellit, është

...në thelb një periudhë përsiatjeje e lutjeje, riaftësimi shpirtëror, gjatë së cilës besimtari duhet të përpiqet të bëjë rregullimet e nevojshme në jetën e tij të brendshme dhe të përtërijë e fuqizojë forcat shpirtërore të fshehura në shpirtin e tij. Domethënia dhe qëllimi i saj janë, pra, në themel shpirtërore për nga karakteri. Agjërimi është simbolik dhe një kujtesë për t’u përmbajtur nga dëshirat egoiste e epshore.

Agjërimi është i detyrueshëm për të gjithë besimtarët kur kanë mbushur 15 vjeç e derisa arrijnë moshën 70 vjeç.

Një pasqyrë e përmbledhur e porosive që kanë të bëjnë me ligjin e agjërimin dhe me përjashtimet që janë lejuar për disa kategori personash përmbahen në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.B.1.-6. Për një diskutim të përjashtimeve nga agjërimi shih shënimet 14, 20, 30 e 31.

Periodha nëntëmbëdhjetëditëshe e agjërimit përkon me muajin Bahá'í të 'Alá', zakonisht 2-20 mars, menjëherë pas përfundimit të Ditëve të Shtuara (shih shënimet 27 dhe 147), dhe pasohet nga festa e Novruzit (shih shënimin 26).

26. dhe në përfundim të tij ju kemi caktuar Novruzin si festë ¶16

Báb i futi një kalendar të ri, të njohur edhe si kalendar i Badí' ose Bahá'í (shih shënimet 27 dhe 147). Sipas këtij kalendar, një ditë është periodha midis një perëndimi dhe tjetrit. Në Bayán in, Báb i urdhëroi që muaji i 'Alá' të ishte muaji i agjërimit, dekretoi që dita e Novruzit duhej të shënonte përfundimin e asaj periudhe dhe e quajti Novruzin Ditën e Perëndisë. Bahá'u'lláh u e mbështeti kalendarin Badí', në të cilin Novruzi është caktuar si festë.

Novruzi është dita e parë e vitit të ri. Ai përkon me sanataditën pranverore në Hemisferën Veriore, që zakonisht bie më 21 mars. Bahá'u'lláh u shpjegon se kjo ditë feste duhet kremtuar në çdo ditë që dielli hyn në yjësinë e Dashit (dmth në sanataditën pranverore), edhe sikur kjo të ndodhë vetëm një minutë para perëndimit (Py&Pë 35). Pra, Novruzi mund të bjerë më 20, 21 ose 22 mars, në varësi nga koha e sanataditës.

Bahá'u'lláh u ia ka lënë Shtëpisë Universale të Drejtësisë detyrën për të përcaktuar hollësitë e shumë ligjeve. Ndër to ka një numër çështjesh që kanë të bëjnë me kalendarin Bahá'í. Ruajtësi ka deklaruar se zbatimi mbarëbotëror i ligjit për llogaritjen e datës së Novruzit do të kërkojë zgjedhjen e një vendi të posaçëm mbi tokë që të shërbejë si pikë referimi për caktimin e kohës së sanataditës pranverore. Ai ka vënë gjithashtu në dukje se zgjedhja e këtij vendi i është lënë për vendim Shtëpisë Universale të Drejtësisë.

27. Le të vendosen ditët e tepërta të muajve para muajit të agjërimit. ¶16

Kalendar i Badí' bazohet në vitin diellor prej 365 ditësh, 5 orësh e 50 minutash e pak. Viti përbëhet prej 19 muajsh nga 19 ditë secili

(dmth 361 ditë), duke u shtuar katër ditë plotësuese (pesë në vitet e brishtë). Báb i nuk ka përcaktuar në mënyrë të posaçme vendosjen e ditëve të shtuara në kalendarin e ri. Kitáb-i-Aqdas i e zgjidh këtë çështje duke i vendosur ditët “e tepërta” në një kohë të caktuar në kalendar menjëherë para muajit të ‘Alá’, periudhës së agjërimit. Për hollësi të mëtejshme shih seksionin për kalendarin Bahá’í në *The Bahá’í World* [Bota Bahá’í], vëllimi XVIII.

28. Ne kemi urdhëruar që këto ... të jenë manifestimet e shkronjës Há ¶16

Të njohura si Ayyám-i-Há (Ditët e Há), Ditët e Shtuara kanë veçorinë që shoqërohen me “*shkronjën Há*”. Vlera numerike abjad e kësaj shkronje arabe është pesë, që i korrespondon numrit të mundshëm të ditëve të shtuara.

Në Shkrimet e Shenjta shkronjës “Há” i janë dhënë disa domethënie shpirtërore, ndër të cilat që ajo është një simbol i Thelbit të Perëndisë.

29. ditët e dhurimit që i paraprijnë stinës së kufizimit ¶16

Bahá’u’lláh u i ka urdhëruar pasuesit e Tij që t’ua kushtojnë këto ditë festimeve, gëzimit e bamirësisë. Në një letër të shkruar në emër të Shoghi Effendi ut shpjegohet se “ditët e shtuara janë ditë të caktuara posaçërisht për mikpritje, dhënie dhuratash etj.”.

30. Udhëtarët ... nuk e kanë të detyruar Agjërimin ¶16

Kohëzgjatja minimale e një udhëtimit që e përjashton besimtarin nga agjërimi është përcaktuar nga Bahá’u’lláh u (Py&Pë 22 dhe 75). Hollësitë e kësaj porosie janë përmbledhur në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.B.5.a.i.-v.

Shoghi Effendi u ka sqaruar që, edhe pse udhëtarët përjashtohen nga agjërimi, ata janë të lirë të agjërojnë në qoftë se dëshirojnë. Ai ka vënë në dukje gjithashtu se përjashtimi mbetet në fuqi gjatë gjithë periudhës së udhëtimit, e jo vetëm gjatë orëve që njeriu është në tren ose në automobil, etj.

31. Udhëtarët, të sëmuret, gratë shtatzëna ose me foshnje gjiri, nuk e kanë të detyruar Agjërimin; ata janë përjashtuar nga Perëndia, si shenjë e hirit të Tij. ¶16

Përjashtimi nga agjërimi bëhet për ata që janë të sëmure ose në moshë të kaluar (shih shënimin 14), për gratë gjatë zakoneve të përmuajshme (shih shënimin 20), për udhëtarët (shih shënimin 30) dhe për gratë shtatzëna e me foshnje gjiri. Ky përjashtim shtrihet gjithashtu mbi personat që bëjnë punë të rëndë, të cilëve ndërkohë u këshillohet që *“në shenjë respekti ndaj ligjit të Perëndisë dhe për arsye të karakterit të lartësuar të Agjërimit”*, të hanë *“me përkore dhe jo në sy të tjerëve”* (Py&Pë 76). Shoghi Effendi u ka vënë në dukje se llojet e punës që i përjashtojnë njerëzit nga Agjërimi do të përcaktohen nga Shtëpia Universale e Drejtësisë.

32. Përmbahuni nga ushqimi e të pirët që nga lindja deri në perëndim të diellit ¶17

Kjo i referohet periudhës së agjërimit. Në një prej Tabelave të Tij, ‘Abdu’l-Bahá i, pasi thotë se agjërimi është të përmbajturit nga ushqimi e të pirët, vë në dukje se edhe tymi është një formë “pije”. Në gjuhën arabe²⁵ folja “pi” përdoret edhe për duhanin.

33. Është urdhëruar që çdo besimtar në Perëndinë ... duhet çdo ditë ... të përsërisë nëntëdhjetë e pesë herë “Alláh-u-Abhá”. ¶18

“Alláh-u-Abhá” është një frazë arabisht që do të thotë “Perëndia Lavdiploti”. Është një formë e Emrit Më të Madh të Perëndisë (shih shënimin 137). Në Islamin ka një hadith sipas të cilit ndër emrat e shumtë të Perëndisë njëri ishte më i madhi; por identiteti i këtij Emri Më të Madh ishte i fshehur. Bahá’u’lláh u ka pohuar se Emri Më i Madh është “Bahá”.

²⁵ Edhe në gjuhën shqipe, ashtu si dhe në arabisht, folja “pi” përdoret edhe për duhanin. –Shën. i përkth.

Edhe derivatet e ndryshme të fjalës “Bahá” konsiderohen si Emri Më i Madh. Sekretari i Shoghi Effendi ut, duke shkruar në emër të tij, shpjegon se

Emri Më i Madh është Emri i Bahá'u'lláh ut. “Já Bahá'u'l-Abhá” është një lutje që do të thotë “O Ti Lavdi e Lavdive!”. “Alláh-u-Abhá” është një përshëndetje që do të thotë “Perëndia Lavdiploti”. Që të dyja i referohen Bahá'u'lláh ut. Duke thënë Emri Më i Madh, nënkuptohet që Bahá'u'lláh u është shfaqur në Emrin Më të Madh të Perëndisë, me fjalë të tjera që Ai është Manifestimi suprem i Perëndisë.

Përshëndetja “Alláh-u-Abhá” është adoptuar gjatë periudhës së syrgjynosjes së Bahá'u'lláh ut në Adrianopojë.

Përsëritja e “Alláh-u-Abhá” nëntëdhjetë e pesë herë duhet të paraprihet nga marrja avdes (shih shënimin 34).

34. Merrni ... avdes për Lutjen e Detyrueshme ¶18

Marrja avdes është e shoqëruar në mënyrë të posaçme me disa lutje. Ajo duhet të paraprijë thënien e të tria Lutjeve të Detyrueshme, përsëritjen nëntëdhjetë e pesë herë të “Alláh-u-Abhá” dhe recitimin e vargut që këshillohet për të zëvendësuar lutjen e detyrueshme dhe agjërimin për gratë që janë me zakonet e përmuajshme (shih shënimin 20).

Marrja avdes që këshillohet përfshin larjen e duarve e të fytyrës si parapërgatitje për lutjen. Në rastin e Lutjes së mesme të Detyrueshme, ajo shoqërohet me recitimin e disa vargjeve (shih Disa tekste të reveluara nga Bahá'u'lláh u si Shtojcë e Kitáb-i-Aqdas it).

Që marrja avdes ka një domethënie tej larjes, kjo mund të shihet nga fakti që edhe sikur njeriu të jetë larë menjëherë para recitimit të Lutjes së Detyrueshme, është e nevojshme që ai të marrë avdes (Py&Pë 18).

Kur nuk ka ujë për të marrë avdes, duhet përsëritur pesë herë një varg që këshillohet (shih shënimin 16), dhe kjo porosi shtrihet edhe mbi ata për të cilët përdorimi i ujit është fizikisht i

dëmshëm (Py&Pë 51).

Porositë e hollësishme për ligjin që ka të bëjë me marrjen avdes janë shtjelluar në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.A.10.a.-g., si edhe në Pyetje dhe Përgjigje numër 51, 62, 66, 77 dhe 86.

35. Ju është ndaluar të kryeni vrasje ¶19

Ndalimi për të marrë jetën e tjetrit përsëritet nga Bahá'u'lláh u në paragrafin 73 të Kitáb-i-Aqdas it. Për vrasjen me paramendim urdhërohen disa ndëshkime (shih shënimin 86). Në rastin e vrasjes pa dashje nga pakujdesia, është e nevojshme t'i paguhet familjes së të ndjerit një dëmshpërblim (shih Kitáb-i-Aqdas, ¶188).

36. ose marrëdhënie intime jashtë kurore ¶19

Fjala arabe “ziná”, e përkthyer këtu si “*marrëdhënie intime jashtë kurore*”, ka kuptimin qoftë marrëdhënie intime para dhe jashtë kurorës dhe shkelje kurore. Ajo përdoret jo vetëm për marrëdhënie seksuale midis një personi të martuar dhe dikujt që nuk është bashkëshorti ose bashkëshortja e tij, por edhe për marrëdhëniet seksuale jashtë martesë në përgjithësi. Një formë e “ziná” është përdhunimi. I vetmi ndëshkim që urdhëron Bahá'u'lláh u është për ata që kryejnë marrëdhënie intime para dhe jashtë kurorës (shih shënimin 77); ndëshkimet për llojet e tjera të shkeljeve seksuale i janë lënë t'i përcaktojë Shtëpia Universale e Drejtësisë.

37. përgojim ose shpifje ¶19

Bahá'u'lláh u ka dënuar në mënyrë të përsëritur përgojimin, shpifjen dhe marrjen me gabimet e të tjerëve. Në Fjalët e Fshehura, Ai e thotë qartë: “*O Bir i Qenies! Si munde të barrosh gabimet e tua dhe u more me gabimet e të tjerëve? Kush e bën këtë, është i mallkuar prej Meje*”. Dhe më tej: “*O Bir i Njeriut! Mos pëshpërit për mëkatet e të tjerëve sakohë ti je vetë mëkatar. Po e shkele këtë porosi, do të*

jesb i mallkuar dhe Unë dëshmoj për këtë". Ky qortim i ashpër përsëritet më pas në veprën e Tij të fundit "Libri i Besëlidhjes Sime": "Me të vërtetë ju them, gjuba shërben për të përmendur atë që është e mirë, mos e përlyeni atë me fjalë të pahijshme. Perëndia e ka falur atë që ka kaluar. Tani e tutje të gjithë duhet të thonin atë që është e përshtatshme dhe e hijshme, dhe duhet të përmbaheni nga shpifjet e fyerjet dhe nga çdo gjë që shkakton hidhërim në njerëzit".

38. Ne e kemi ndarë trashëgiminë në shtatë kategori ¶20

Ligjet Bahá'í të trashëgimit zbatohen vetëm në rastet kur nuk ka testament, dmth kur një person vdes pa lënë testament. Në Kitáb-i-Aqdas (¶109), Bahá'u'lláh u udhëzon që çdo besimtar të shkruajë testament. Në vende të tjera Ai e thotë qartë se çdo person gëzon të drejta të plota mbi pasurinë e vet dhe është i lirë të vendosë se në ç'mënyrë do të ndahet trashëgimi që lë e cilët do të jenë ata që do të trashëgojnë, Bahá'í ose jo qofshin (Py&Pë 69). Lidhur me këtë, një letër e shkruar në emër të Shoghi Effendi ut shpjegon që

...edhe pse Bahá'í lejohet që në testamentin e tij të disponojë për pasurinë e vet ashtu si dëshiron, megjithatë, kur shkruan testamentin, është moralisht e ndershëmërisht i detyruar të mbajë gjithmonë parasysh nevojën për të mbështetur parimin e Bahá'u'lláh ut lidhur me funksionin shoqëror të pasurisë dhe nevojën që rrjedh prej kësaj për të shmangur grumbullimin e tepruar të saj në pak persona ose grupe personash.

Ky varg i Aqdas it i paraprin një pasazhi të gjatë, në të cilin Bahá'u'lláh u shtjellon ligjin Bahá'í të trashëgimit. Duke lexuar këtë pasazh, duhet mbajtur parasysh që ligji është formuluar nisur nga supozimi se i ndjeri është burrë; porositë e tij janë të zbatueshme, *mutatis mutandis*, edhe kur e ndjera është grua.

Sistemi i trashëgimit që parashikon ndarjen e pasurisë së të ndjerit midis shtatë kategorive trashëgimtarësh (fëmijët,

SHËNIME

bashkëshortja, babai, nëna, vëllezërit, motrat dhe mësuesit) bazohet në porositë e shtjelluara nga Báb i në Bayán. Elementet kryesore të ligjeve Bahá'í të trashëgimit në rast mungese të testamentet janë:

1. Në qoftë se i ndjeri është baba dhe pasuria e tij përfshin një banesë personale, kjo banesë i kalon djalit të madh (Py&Pë 34).
2. Në qoftë se i ndjeri nuk ka pasardhës meshkuj, dy të tretat e banesës i kalojnë pasardhëseve femra dhe një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë (Py&Pë 41, 72). Shih shënimin 42 lidhur me nivelet e institucionit të Shtëpisë së Drejtësisë të cilave u referohet ky ligj (shih gjithashtu shënimin 44).
3. Ajo që mbetet nga pasuria ndahet midis shtatë kategorive të trashëgimtarëve. Për hollësi lidhur me numrin e pjesëve që duhet të marrë çdo grup, shih Pyetje dhe Përgjigje, numër 5, dhe Pasqyra Përmbledhëse e Kodifikimi, seksioni IV.C.3.a.
4. Në rast se në një kategori ka më shumë se një trashëgimtar, pjesa e caktuar kësaj klase duhet ndarë midis tyre në mënyrë të barabartë, meshkuj a femra qofshin.
5. Në rastet kur nuk ka pasardhës, pjesa e fëmijëve i kalon Shtëpisë së Drejtësisë (Py&Pë 7, 41).
6. Në qoftë se një person lë fëmijë, por kategoritë e tjera të trashëgimtarëve mungojnë tërësisht ose pjesërisht, dy të tretat e pjesëve të tyre u kalojnë fëmijëve dhe një e treta Shtëpisë së Drejtësisë (Py&Pë 7).
7. Në qoftë se nuk ekziston asnjë prej kategorive të specifikuar, dy të tretat e pasurisë u kalojnë nipave dhe mbesave të të ndjerit. Në qoftë se as këta nuk ekzistojnë, të njëjtat pjesë u kalojnë tetove e ungjërve; në mungesë të këtyre, u kalojnë bijve e bijave të tyre. Në çdo rast, një e

treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë.

8. Në qoftë se një person nuk lë asnjë prej trashëgimtarëve të lartpërmendur, gjithë pasuria i kalon Shtëpisë së Drejtësisë.
9. Bahá'u'lláh u thotë se jo-Bahá'í të nuk kanë të drejtë të trashëgojnë nga prindërit ose të afërmit e tyre Bahá'í (Py&Pë 34). Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, vë në dukje se ky ngushtim është i vlefshëm “vetëm në rastet kur një Bahá'í vdes pa lënë testament dhe, pra, kur pasuria e tij duhet të ndahet në pajtim me rregullat e shtjelluara në Kitáb-i-Aqdas. Përndryshe, çdo Bahá'í është i lirë t'ia lerë pasurinë e vet çdo personi, pavarësisht nga feja, mjafton që ai të lerë një testament që përcakton dëshirat e tij”. Pra, çdo Bahá'í ka gjithmonë mundësinë të kujdeset për bashkëshorten ose bashkëshortin, fëmijët ose të afërmit e vet jo-Bahá'í, duke lënë testament.

Hollësi të mëtejshme për ligjet e trashëgimit janë përmbledhur në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.C.3.a-o.

39. vëllezërve pesë pjesë ... motrave katër pjesë ¶20

Pyetje dhe Përgjigje i zgjeron porositë e ligjit përsa u përket pjesëve të trashëgimit që u caktohen vëllezërve dhe motrave të të ndjerit. Në qoftë i vëllai ose e motra me të njëjtin baba si i ndjeri, ai ose ajo trashëgon pjesën e plotë që i është caktuar. Por në qoftë vëllai ose motra është me baba tjetër, trashëgon vetëm dy të tretat e pjesës së caktuar, kurse një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë (Py&Pë 6). Më tej, në rastin kur i ndjeri ka midis trashëgimtarëve të vet vëllezër e motra me të njëjtët baba e nënë, atëherë vëllezërit e motrat nga nëna nuk trashëgojnë (Py&Pë 53). Këta, sigurisht, kanë të drejtë të trashëgojnë nga pasuria e të atit të tyre.

40. mësuesve ¶20

Në një Tabelë, ‘Abdu’l-Bahá i i krahason mësuesit që janë marrë me edukimin shpirtëror të fëmijës me *“atin shpirtëror”* që *“i jep fëmijës së tij jetën e pasosur”*. Ai shpjegon se kjo është arsyeja përse në *“ligjin e Perëndisë mësuesit renditen midis trashëgimtarëve”*.

Bahá’u’lláh u specifikon kushtet në të cilat mësuesi trashëgon dhe pjesën që ai merr (Py&Pë 33).

41. Kur dëgjuam britmën e fëmijëve ende të palindur, Ne e dyfishuam pjesën e tyre dhe e pakësuam atë të tjerëve. ¶20

Në ligjet e Báb it për trashëgiminë, fëmijëve të të ndjerit u caktoheshin nëntë pjesë të përbëra prej 540 njësisë. Kjo përfaqësonte më pak se një të katërtën e gjithë pasurisë. Bahá’u’lláh u e dyfishoi pjesën e tyre në 1.080 njësi dhe pakësoi pjesët e caktuara gjashtë kategorive të tjera të trashëgimtarëve. Ai gjithashtu shtjellon qëllimin e saktë të kësaj porosie dhe rrjedhojat e saj për shpërndarjen e trashëgimit (Py&Pë 5).

42. Shtëpisë së Drejtësisë ¶21

Duke iu referuar në Kitáb-i-Aqdas Shtëpisë së Drejtësisë, Bahá’u’lláh u jo gjithmonë bën shprehimisht dallimin midis Shtëpisë Universale të Drejtësisë dhe Shtëpisë Lokale të Drejtësisë, të vendosura që të dyja në atë Libër. Zakonisht Ai i referohet thjesht *“Shtëpisë së Drejtësisë”*, duke lënë hapësirë për sqarim të mëtejshëm lidhur me nivelin ose nivelet e institucionit, në të cilat duhet të zbatohet çdo ligj.

Në një Tabelë që numëron të ardhurat e arkës lokale, ‘Abdu’l-Bahá i përfshin ato trashëgime për të cilat nuk ka trashëgimtarë, duke treguar kështu se Shtëpia e Drejtësisë së cilës i referohen këto pasazhe të Aqdas it lidhur me trashëgiminë është ajo lokale.

43. Po qe se i ndjeri lë fëmijë, por nuk lë asnjë nga të kategorive të tjera të trashëgimtarëve ¶22

Bahá'u'lláh u sqaron se *“Ky rregull ka si zbatime të përgjithshme ashtu edhe të posaçme, domethënë se kurdoherë që ndonjë kategori e kësaj klase të fundit trashëgimtarësh mungon, dy të tretat e trashëgimit të tyre u kalojnë fëmijëve dhe një e treta që mbetet i kalon Shtëpisë së Drejtësisë”* (Py&Pë 7).

44. Ne ua kemi caktuar banesën dhe rrobat personale të të ndjerit trashëgimtarëve meshkuj, e jo femra, dhe as trashëgimtarëve të tjerë. ¶25

Në një Tabelë, ‘Abdu’l-Bahá i vë në dukje se banesa dhe rrobat personale të të ndjerit mbeten në linjën mashkullore. Ato i kalojnë djalit të madh dhe në mungesë të djalit të madh i kalojnë djalit të dytë e kështu me radhë. Ai shpjegon se kjo porosi është një shprehje e ligjit të parëlindjes, që gjithmonë është mbështetur nga Ligji i Perëndisë. Në një Tabelë drejtuar një pasuesi të Besimit në Persi Ai ka shkruar: *“Në të gjitha Dispensacionet Hyjnore djalit të madh i janë dhënë shquarsi të jashtëzakonshme. Madje edhe pozita e profetësisë ka genë e drejta e tij e parëlindjes”*. Por shquarsive të dhëna djalit të madh i shtohen detyra bashkëshoqëruese. Për shembull, ai ka përgjegjësinë morale, për hir të Perëndisë, të kujdeset për nënën e tij dhe gjithashtu të shohë nevojat e trashëgimtarëve të tjerë.

Bahá'u'lláh u shpjegon aspekte të ndryshme të kësaj pjese të ligjit të trashëgimit. Ai përcakton që në rast se ka më shumë se një banesë, ajo kryesorja e më e rëndësishmja u kalon fëmijëve meshkuj. Banesat që mbeten, bashkë me zotërimet e tjera të të ndjerit, duhet të ndahen midis trashëgimtarëve (Py&Pë 34). Ai, veç kësaj, vë në dukje që, në mungesë të fëmijëve meshkuj, dy të tretat e banesës kryesore dhe të rrobave personale të babait të ndjerë u kalojnë pasardhëseve femra dhe një e treta Shtëpisë së Drejtësisë (Py&Pë 72). Më tej, kur e ndjera është grua, Bahá'u'lláh u thotë se të gjitha rrobat e saj të përdorura duhet të ndahen në mënyrë të barabartë midis vajzave të saj. Rrobat e reja,

arturinat dhe pronat duhet të ndahen midis trashëgimtarëve të saj, si dhe rrobat e përdorura në rast se ajo nuk lë pas vajza (Py&Pë 37).

45. Në rast se i biri i të ndjerit ka ndërruar jetë gjatë kohës që i ati jetonte dhe ka lënë fëmijë, ata trashëgojnë pjesën e atit të tyre ¶26

Ky aspekt i ligjit zbatohet vetëm në rastin e një biri që ka vdekur para babait e nënës së tij. Në qoftë se e bija e të ndjerit ka vdekur e ka lënë fëmijë, pjesa e saj duhet të ndahet sipas shtatë kategorive të përcaktuar në Librin Më të Shenjtë (Py&Pë 54).

46. Në qoftë se i ndjeri lë fëmijë që janë të mitur, pjesa e tyre e trashëgimit duhet t'i lihet në kujdestari një personi të besueshëm ¶27

Fjala “amin”, e përkthyer në këtë paragraf si “*person i besueshëm*” dhe “*i besuar*”, përçon në arabisht një varg kuptimesh të lidhura kryesisht me idenë e besueshmërisë, por nënkupton gjithashtu edhe cilësi të tilla si besimi, besnikëria, besa, drejtësia, ndershmëria e kështu me radhë. E përdorur në kuptimin legal, fjala “emin” do të thotë, ndër të tjera, njeri i besuar, garant, ruajtës, mbikqyrës dhe kujdestar.

47. Ndarja e pronës duhet bërë vetëm pasi të jetë paguar Huqúqu’lláh u, të jenë rregulluar borxhet, të jenë paguar shpenzimet e funeralit e të varrimit ¶28

Bahá’u’lláh u përcakton që në renditjen e përparësisë së pagimit të këtyre shpenzimeve në vend të parë janë shpenzimet për funeralin e varrimin, pastaj vijnë borxhet e të ndjerit, pastaj Huqúqu’lláh-u (shih shënimin 125) (Py&Pë 9). Ai përcakton gjithashtu se kur për këto përdoret prona, pagesa duhet bërë duke marrë në fillim nga ajo që mbetet prej pronës dhe pastaj, në qoftë se kjo është e pamjaftueshme, nga banesa e nga rrobat personale të të ndjerit (Py&Pë 80).

48. Kjo është ajo dije e fshehur e cila kurrë nuk do të ndryshojë, sepse fillon me nëntën ¶29

Në Bayán in Arab Báb i thotë se ligji i Tij i trashëgimit “është në përputhje me një dije të fshehur në Librin e Perëndisë, dije që kurrë nuk do të ndryshojë ose të zëvendësohet”. Ai thotë gjithashtu se numrat në bazë të të cilave bëhej ndarja e trashëgimit ishin të veshura me një domethënie që kishte për qëllim të ndihmonte për të njohur Atë Që Perëndia do Ta shfaqë.

“Nënta” që përmendet këtu përfaqësohet në tekstin arabisht nga shkronja “□á”, e cila është barasvlera e saj në numërimin abxhad (shih Glosarin). Ajo është elementi i parë i ndarjes së trashëgimit që urdhëron Báb i, i Cili përcakton se kuota e fëmijëve përbëhet prej “nëntë pjesësh”. Domethënia e shifrës nëntë qëndron në qenien barasvlera numerike e Emrit Më të Madh “Bahá”, për të cilin aludohet në pjesën tjetër të këtij vargu si “Emri i lartësuar i fshehur e i dukshëm, i pacenueshën e i paarritshëm”. (Shih gjithashtu shënimin 33.)

49. Zoti ka urdhëruar që në çdo qytet të ngrihet një Shtëpi e Drejtësisë ¶30

Institucioni i Shtëpisë së Drejtësisë përbëhet prej këshillash të zgjedhura që veprojnë në nivelin lokal, kombëtar e ndërkombëtar të shoqërisë. Në Kitáb-i-Aqdas, Bahá’u’lláh u parashikon si Shtëpinë Universale të Drejtësisë dhe Shtëpitë Lokale të Drejtësisë. ‘Abdu’l-Bahá i, në Vullnetin e Testamentin e Tij, parashikon Shtëpitë Dytësore (Kombëtare ose Rajonale) të Drejtësisë dhe ravijëzon metodën që duhet ndjekur për zgjedhjen e Shtëpisë Universale të Drejtësisë.

Vargu i lartpërmendur i referohet Shtëpisë Lokale të Drejtësisë, një institucion që duhet zgjedhur në çdo lokalitet ku ka nëntë ose më shumë Bahá’í të rritur. Për këtë qëllim, përkufizimi i të rriturit është caktuar përkohësisht 21 vjeç nga Ruajtësi, i cili ka vënë në dukje se ai mund të ndryshohet në të ardhmen nga

Shtëpia Universale e Drejtësisë.

Tani për tani Shtëpitë Lokale e Dytësore të Drejtësisë janë të njohura si Asamble Shpirtërore Lokale dhe Asamble Shpirtërore Kombëtare. Shoghi Effendi u ka vënë në dukje se ky është një “emërtim i përkohshëm”, i cili,

...kur pozita dhe qëllimet e Besimit Bahá’í të kuptohen më mirë e të njihen në mënyrë më të plotë, do të zëvendësohet hap pas hapi nga emri i përhershëm e më i përshtatshëm Shtëpi e Drejtësisë. Në të ardhmen, Asambletë Shpirtërore të sotme jo vetëm do të quhen ndryshe, por gjithashtu do të jenë në gjendje t’u shtojnë funksioneve të tyre të sotme ato pushtete, detyra e prerogativa që do të bëhen të nevojshme nga njohja e Besimit të Bahá’u’lláh ut jo thjesht si një prej sistemeve fetare të njohura të botës, por si Feja Shtetërore e një Fuqie të pavarur e Sovrane.

50. numrit të Bahá-it ¶30

Barasvlera numerike e “Bahá” është nëntë. Shtëpia Universale e Drejtësisë dhe Asambletë Shpirtërore Kombëtare e Lokale kanë aktualisht nga nëntë anëtarë secila, numrin minimal të urdhëruar nga Bahá’u’lláh u.

51. Ata duhet të jenë të besuarit e të Mëshirshmit midis njerëzve ¶30

Pushtetet e detyrat e përgjithshme të Shtëpisë Universale të Drejtësisë, të Asambleve Shpirtërore Kombëtare e të Asambleve Shpirtërore Lokale dhe cilësitë për të qenë anëtar i tyre janë shtjelluar në Shkrimet e Bahá’u’lláh ut e të ‘Abdu’l-Bahá it, në letrat e Shoghi Effendi ut dhe në sqarimet e Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Funksionet kryesore të këtyre institucioneve janë përvijuar në Kushtetutën e Shtëpisë Universale të Drejtësisë dhe në ato të Asambleve Shpirtërore Kombëtare e Lokale.

52. të këshillohen së bashku ¶30

Bahá'u'lláh u ka vendosur konsultimin si njërin prej parimeve themelore të Besimit të Tij dhe i ka porositur besimtarët *“të këshillohen së bashku për të gjitha çështjet”*. Ai e ka cilësuar konsultimin si *“llambën e udhërrëfimit që tregon rrugën”* dhe si *“dhurues të të kuptuarit”*. Shoghi Effendi u thotë se *“parimi i konsultimit ... përbën një prej ligjeve bazë”* të Rëndit Administrativ Bahá'í.

Në Pyetje dhe Përgjigje, numër 99, Bahá'u'lláh u shtjellon një mënyrë të përdorimit të konsultimit dhe thekson rëndësinë e arritjes së njëzëshmërisë në marrjen e vendimeve, e kur kjo nuk arrihet duhet të mbizotërojë vendimi i shumicës. Shtëpia Universale e Drejtësisë ka sqaruar se këto udhëzime për konsultimin janë reveluar para se të krijoheshin Asambletë Shpirtërore dhe ishin përgjigje për një pyetje lidhur me mësimet Bahá'í për konsultimin. Shtëpia e Drejtësisë thotë se lindja e Asambleve Shpirtërore, të cilave miqtë kurdoherë mund t'u drejtohen për ndihmë, kurrsesi nuk u ndalon atyre që të ndjekin procedurën e shtjelluar në Pyetje dhe Përgjigje. Kjo metodë mund të përdoret nga miqtë, po qe se dëshirojnë, kur kanë ndërmend të konsultohen për problemet e tyre vetjake.

53. Ndërtoni shtëpi adhurimi në të gjitha vendet ¶31

Shtëpia e Adhurimit Bahá'í i kushtohet lëvdimit të Perëndisë. Shtëpia e Adhurimit përbën godinën qendrore të Mashriq'l-Adhkár-it (Vendagimit të Lëvdimit të Perëndisë), një kompleks që, duke u zhvilluar në të ardhmen, do të përfshijë veç Shtëpisë së Adhurimit një numër aneksesh për qëllime shoqërore, humanitare, edukative e shkencore. 'Abdu'l-Bahá i e cilëson Mashrikul Azkar-in si *“një prej institucioneve më jetësore të botës”* dhe Shoghi Effendi u vë në dukje se ai mishëron në një formë të prekshme integrimin e *“adhurimit e të shërbimit Bahá'í”*. Duke i dalë përpara zhvillimit të ardhshëm të këtij institucioni, Shoghi Effendi u parashikon se Shtëpia e Adhurimit dhe anekset e saj *“do t'u japin përkrahje atyre që vuajnë, ndihmë të varfërve, strehë shtegtarëve, ngushëllim nevojtarëve dhe arsim të paditurve”*. Në

të ardhmen, Shtëpi të Adhurimit Bahá'í do të ngrihen në çdo qytet e fshat.

54. Zoti ka porositur që ata ndër ju që janë në gjendje le të bëjnë haxhillëk në Shtëpinë e Shenjtë ¶32

Dy Shtëpi të shenjta janë objekt i këtij urdhëri, Shtëpia e Báb it në Shiraz dhe ajo e Bahá'u'lláh ut në Bagdad. Bahá'u'lláh u e ka përcaktuar se haxhillëku në secilën prej këtyre dy Shtëpive i përmbush kërkesat e këtij pasazhi (Py&Pë 25, 29). Në dy Tabela të veçanta, të njohura si Sureja e Haxhiut (Py&Pë 10), Bahá'u'lláh u ka dhënë porosi lidhur me ritet e posaçme për secilin prej këtyre haxhillëqeve. Nga kjo pikëpamje, kryerja e një haxhillëku është më tepër se një vizitë e thjeshtë në këto dy shtëpi.

Pas vdekjes së Bahá'u'lláh ut, ‘Abdu'l-Bahá i caktoi Mauzoleun e Bahá'u'lláh ut në Bahxhi si vend haxhillëku. Në një Tabelë, Ai vë në dukje se *“Mauzoleu Më i Shenjtë, Shtëpia e Bekuar në Bagdad dhe Shëpia shumë e nderuar e Báb it në Shiraz” “i kushtohen haxhillëkut”* dhe se është *“e detyrueshme”* të vizitohen këto vende *“në qoftë se njeriu mund ta përballojë e është në gjendje ta bëjë këtë dhe në qoftë se nuk ndesh pengesa në rrugën e tij”*. Për haxhillëkun në Mauzoleun Më të Shenjtë nuk është urdhëruar ndonjë rit.

55. dhe nga kjo ka përjashtuar gratë si shenjë mëshire nga ana e Tij ¶32

Në Bayán, Báb i pat dhënë porosinë për të kryer haxhillëk një herë gjatë jetës ata prej pasuesve të tij që ishin financiarisht në gjendje të ndërmerrnin këtë udhëtim. Ai vinte në dukje se kjo nuk ishte e detyrueshme për gratë, për t'i ruajtur kështu ato nga vështirësitë e udhëtimit.

Edhe Bahá'u'lláh u i përjashtoi gratë nga kërkesat e Tij për haxhillëk. Shtëpia Universale e Drejtësisë ka sqaruar se ky përjashtim nuk është ndalim dhe se gratë janë të lira të bëjnë haxhillëk.

56. të merret me ndonjë punë ¶33

Për gratë dhe burrat është e detyrueshme të merren me ndonjë tregti ose zanat. Bahá'u'lláh u e lartëson *“marrjen me një punë të tillë”* në *“rangun e adhurimit”* të Perëndisë. Domethënia shpirtërore e praktike e këtij ligji dhe përgjegjësia e ndërsjellë e individit dhe e shoqërisë për zbatimin e tij shpjegohen në një letër të shkruar në emër të Shoghi Effendi ut:

Lidhur me porosinë e Bahá'u'lláh ut që besimtarët të merren me ndonjë zanat: Mësimet për këtë çështje janë shumë të sakta, sidomos thënia në Aqdas, e cila e bën fare të qartë se në Rendin e ri Botëror nuk ka vend për njerëzit përtacë që nuk kanë dëshirë të punojnë. Si pasojë e pashmangshme e këtij parimi, Bahá'u'lláh u thotë më tej se lypësia jo vetëm duhet të shkurajohet, por edhe të zhduket krejtësisht nga faqja e shoqërisë. Ata që janë të ngarkuar me organizimin e shoqërisë e kanë për detyrë t'i japin çdo individ mundësinë për të fituar zotësi në ndonjë lloj zanati, si dhe mjetet për ta ushtruar këtë zotësi, qoftë në vetvete ashtu dhe për të fituar mjetet e jetesës. Çdo individ, sado i metë e i kufizuar që të jetë, ka për detyrë të merret me ndonjë punë a zanat, sepse puna, veçanërisht kur kryhet në frymën e shërbimit, është sipas Bahá'u'lláh ut një formë e adhurimit. Ajo nuk ka vetëm qëllim utilitar, por ka edhe vlerë në vetvete, sepse na çon më pranë Perëndisë dhe na ndihmon të kapim më mirë qëllimin e Tij ndaj nesh në këtë botë. Është, pra, e qartë se trashëgimi i pasurive nuk përjashton askënd nga puna e përditshme.

Në një prej Tabelave të Tij, ‘Abdu'l-Bahá i thotë që *“në qoftë se një person nuk është në gjendje të sigurojë jetesën, ndodhet në varfëri të thellë ose bëhet i paafte për punë, atëherë është detyrë e të kamurve ose e Përfaqësuesve t'i sigurojnë atij një pagë mujore për të jetuar... Me “Përfaqësues” nënkuptohen përfaqësuesit e popullit, domethënë anëtarët e Shtëpisë së Drejtësisë”*. (Shih gjithashtu shënimin 162 për lypësinë.)

Në përgjigje të një pyetjeje nëse urdhëri i Bahá'u'lláh ut i detyron gratë ose nënat të punojnë si burrat për të siguruar jetesën, Shtëpia Universale e Drejtësisë ka shpjeguar se direktiva e Bahá'u'lláh ut është që miqtë të merren me një punë të dobishme për ata vetë e për të tjerët dhe se punët e shtëpisë janë një punë shumë e nderuar e me përgjegjësi, që ka rëndësi të dorës së parë për shoqërinë.

Përsa i përket tërheqjes nga puna të njerëzve që kanë arritur një moshë të caktuar, Shoghi Effendi u në një letër të shkruar në emër të tij thotë se “kjo është një çështje për të cilën Shtëpia Universale e Drejtësisë duhet të nxjerrë ligje përderisa në Kitáb-i-Aqdas nuk ka porosi lidhur me këtë”.

57. Puthja e dorës është e ndaluar në Librin. ¶34

Në një numër Dispensacionesh fetare të mëparshme e në disa kultura puthja e dorës së një figure fetare ose të një personaliteti të shquar shihej si shenjë nderimi e respekti dhe si dëshmi nënshtrimi ndaj autoritetit të tyre. Bahá'u'lláh u e ndalon puthjen e dorës dhe, në Tabelat e Tij, dënon gjithashtu zakonet e përkuljes deri në tokë ndaj të tjerëve, si dhe forma të tjera sjelljeje që poshtërojnë njeriun kundrejt një tjetri. (Shih shënimin 58.)

58. Askujt nuk i lejohet të kërkojë falje të mëkateve nga një shpirt tjetër ¶34

Bahá'u'lláh u e ndalon rrëfimin dhe kërkimin e faljes së mëkateve të një personi nga një qenie njerëzore. Përkundrazi, njeriu duhet të kërkojë ndjesë nga Perëndia. Në Tabelën e Bishárát-it, Ai thotë se “*rrëfimi para njerëzve shkakton poshtërim e turpërim të personit*” dhe se Perëndia “*nuk dëshiron poshtërimin e shërbëtorëve të Tij*”.

Shoghi Effendi u shpjegon kontekstin e këtij ndalimi. Sekretari i tij ka shkruar në emër të tij se

...është e ndaluar t'i rrëfëhemi ndonjë personi për mëkatet e të metat tona, siç bëjnë katolikët me priftërinjtë e tyre, ose ta bësh këtë publikisht, siç bëjnë disa sekte fetare. Por në qoftë

se ndiejmë spontanisht dëshirën për të pranuar se e kemi pasur gabim në diçka, ose se kemi ndonjë të metë në karakter, dhe t'i kërkojmë të falur ose ndjesë një personi tjetër, jemi krejt të lirë ta bëjmë këtë.

Shtëpia Universale e Drejtësisë ka sqaruar gjithashtu se ndalimi i Bahá'u'lláh ut lidhur me rrëfimin e mëkateve nuk e pengon personin të pranojë shkeljet gjatë një konsultimi që zhvillohet nën patronazhin e institucioneve Bahá'í. Po kështu, nuk përjashton as mundësinë e të kërkuarit këshillë një miku të ngushtë ose një këshilltari profesionist për çështje të kësaj natyre.

59. Midis njerëzve është ai që ulet midis sandaleve te dera, ndërsa në zemër fsheh zilinë për vendin e nderit. ¶36

Tradicionalisht në Lindje ka qenë praktika për të hequr sandalet e këpucët para se të hyhet në një mbledhje. Pjesa e një dhome që ndodhet më larg hyrjes konsiderohet si kryet e dhomës dhe si vend nderi ku rrinë personat më të shquar ndër të pranishmit. Të tjerët zenë vend në radhë gjithnjë e më të ulët në drejtim të portës, pranë së cilës janë lënë sandalet e këpucët dhe ku ulen personat më të thjeshtë.

60. Dhe midis njerëzve është ai që pretendon për dije të brendshme ¶36

Kjo u referohet njerëzve që pretendojnë se kanë rrugëhyrje për në dije të brendshme dhe të cilët lidhja me dije të tilla i ndan si me perde nga Revelacioni i Manifestimit të Perëndisë. Gjetkë Bahá'u'lláh u thotë: *“Ata që janë adhurues të idhullit që ka gdbendur imagjinata e tyre dhe që e quajnë atë Realitet të Brendshëm, këta në të vërtetë numërohen ndër të pabesët”*.

61. Sa njerëz e kanë mbyllur veten në klimat e Indisë, i kanë mohuar vetes gjërat që Perëndia i ka dekretuar si të ligjshme, i kanë imponuar vetes një regjim të rreptë e mundime trupore ¶36

Këto vargje përbëjnë një ndalim të murgërisë e të asketizmit. Shih Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.D.1.y.iii.-iv. Në Fjalët e Parajsës Bahá'u'lláh u i zgjeron këto porosi. Ai thotë: *“Të jetosh i mbyllur ose të praktikosh asketizmin nuk është e pranueshme në praninë e Perëndisë”* dhe i fton ata që kanë të bëjnë me këtë t'i *“përmabën asaj që sjell gëzim e rrëzëllim”*. Ai i urdhëron ata që *“e kanë bërë banesën e tyre në shpellat e maleve”* ose që *“strehoben natën në varreza”* të heqin dorë nga këto praktika dhe i porosit të mos e privojnë veten nga *“të mirat”* e kësaj bote që janë krijuar nga Perëndia për gjininë njerëzore. Dhe në Tabelën e Bishárát-it, ndërsa njih *“bëmat e devotsbme”* të murgjve e të priftërinjve, Bahá'u'lláh u i u bën thirrje atyre *“të heqin dorë nga jeta e mbyllur, t'i drejtojnë hapat drejt botës së hapur dhe të merren me atë që do t'u sjellë dobi atyre e të tjerëve”*. Ai gjithashtu u jep lejë atyre *“të lidhin martesë, që të mund të lindin një që do të përmendë Perëndinë”*.

62. Kushdo që del me pretendimin për një Revelacion të drejtpërdrejtë nga Perëndia para se të kenë kaluar plot një mijë vjet ¶37

Dispensacioni i Bahá'u'lláh ut do të vazhdojë deri në ardhjen e Manifestimit tjetër të Perëndisë, ardhja e të Cilit nuk do të ndodhë para se të kenë kaluar të paktën *“plot një mijë vjet”*. Bahá'u'lláh u paralajmëron që të mos i atribuohet *“këtij vargu”* asgjë veç *“domethënies së qartë”* të tij dhe, në një prej Tabelave të Veta, përcakton se *“çdo vit”* i kësaj periudhe një mijëvjeçare përbëhet prej *“dymbëdhjetë muajsh sipas Kuranit dhe prej nëntëmbëdhjetë muajsh nëntëmbëdhjetëditësh secili sipas Bayán it”*.

Njoftimi bërë Bahá'u'lláh ut për Revelacionin e Tij në Sýáh-Chál in e Tíhrán-it, në tetor 1852, shënon lindjen e Misionit të Tij Profetik e, pra, fillimin e një mijë vjetëve a më shumë që duhet të kalojnë para shfaqjes së Manifestimit tjetër të Perëndisë.

63. Për këtë ju kemi paralajmëruar kur ishim në Irak, dhe më pas, kur ndodheshim në Vëndin e Misterit, dhe tani nga

ky Vend i Shndritshëm. ¶37

“Vendi i Misterit” i referohet Adrianopojës dhe “ky Vend i Shndritshëm” është një referencë për ‘Akká-në.

64. Midis njerëzve është ai që dituria i ka rritur mendjen ... ai që kur dëgjon pas shpine hapin e sandaleve e ndien veten e tij më të madh ¶41

Në Lindje ka qenë zakon që pasuesit e një prijësi fetar ecnin një ose dy hapa prapa tij, në shenjë nderimi.

65. Nimrodi ¶65

Sipas traditës si hebraike dhe islamike, Nimrodi për të cilin bëhet referencë në këtë varg është një Mbret që ka përndjekur Abrahamin dhe emri i të cilit është bërë simboli i një krenarie të madhe.

66. Aghşán ¶42

“Aghşán” (shumësi i Ghuşn) është një fjalë arabisht që do të thotë “Degët”. Ky term përdoret nga Bahá’u’lláh u për të treguar pasardhësit e Tij meshkuj. Kjo ka të bëjë në mënyrë të posaçme jo vetëm me disponimin e dhurimeve, por edhe me trashëgiminë e autoritetit pas ndërrimit jetë të Bahá’u’lláh ut (shih shënimin 145) dhe të ‘Abdu’l-Bahá it. Në Librin e Besëlidhjes së Tij, Bahá’u’lláh u caktoi ‘Abdu’l-Bahá in, djalin e Vet të madh, si Qendrën e Besëlidhjes së Tij dhe Kryetar të Besimit. ‘Abdu’l-Bahá i, në Vullnetin e Testamentin e Tij, caktoi Shoghi Effendi un, nipin e Vet të madh, si Ruajtës e Kryetar të Besimit.

Pra, ky pasazh i Aqdas it parashikon pasardhjen e Aghşán-ëve dhe krijimin kështu të institucionit të Ruajtësisë, si dhe mundësinë e ndërprerjes në linjën e tyre. Vdekja e Shoghi Effendi ut më 1957 solli pikërisht atë situatë që parashikohet në këtë pasazh, sepse linja e Aghşán-ëve u ndërpre para se të ngrihej Shtëpia Universale e Drejtësisë (shih shënimin 67).

67. t'u takojnë njerëzve të Bahá-it ¶42

Bahá'u'lláh u parashikon mundësinë që linja e Aghşán-ëve të ndërpritet para se të krijohet Shtëpia Universale e Drejtësisë. Ai vendosi që në një situatë të tillë *“dburimet do t'u takojnë njerëzve të Bahá-it”*. Në Shkrimet Bahá'í, termi *“njerëzit e Bahá-it”* përdoret në një numër kuptimesh të ndryshme. Në këtë rast me këtë term cilësohen ata *“të cilët nuk flasin veçse me lejen e Tij dhe nuk gjykojnë veçse në pajtim me atë që Perëndia ka urdhëruar në këtë Tabelë”*. Pas ndërrimit jetë të Shoghi Effendi ut më 1957, Duarte e Kauzës së Perëndisë drejtuan punët e Kauzës deri në zgjedhjen e Shtëpisë Universale të Drejtësisë në vitin 1963 (shih shënimin 183).

68. Mos e rruani kokën ¶44

Në disa tradita fetare konsiderohet e dëshirueshme të rruhet koka. Bahá'u'lláh u e ndalon këtë dhe shpjegon se porosia që përmbahet në Surenë e Haxhiut, sipas së cilës haxhilerët që shkojnë në Shtëpinë e Shenjtë në Shiraz duhet të rruajnë kokën është zëvendësuar nga ky varg i Kitáb-i-Aqdas it (Py&Pë 10).

69. nuk është e hijshme t'i lësh flokët të kalojnë kufirin e veshëve ¶44

Shoghi Effendi u e ka bërë të qartë se, në ndryshim nga ndalimi për të rruar kokën, ky ligj që ndalon rritjen e flokëve tej bulës së veshit ka të bëjë vetëm me burrat. Zbatimi i këtij ligji kërkon sqarime nga Shtëpia Universale e Drejtësisë.

70. Për hajdutët janë dekretuar syrgjynosja e burgimi ¶45

Bahá'u'lláh u thotë se përcaktimi i shkallës së ndëshkimit, sipas seriozitetit të fajit, i takon Shtëpisë së Drejtësisë (Py&Pë 49). Ndëshkimet për vjedhje janë të llogaritura për një gjendje të ardhshme të shoqërisë, kur ato do të trajtohen e vihen në zbatim nga Shtëpia Universale e Drejtësisë.

71. në shkeljen e tretë, i vini një shenjë në ballë, në mëyrë

që, duke e njohur, të mos e pranojnë në qytetet e në vendet e Perëndisë ¶45

Shenja që duhet t'i vihet në ballë hajdutit shërben për të paralajmëruar njerëzit për prirjet e tij. Të gjitha hollësitë lidhur me karakterin e shenjës, si duhet vënë shenja, sa gjatë do të mbahet, në ç'kushte mund të hiqet, si dhe shkallët e ndryshme të seriozitetit të vjedhjes, i janë lënë nga Bahá'u'lláh u Shtëpisë Universale të Drejtësisë që t'i përcaktojë në kohën që ligji do të vihet në zbatim.

72. Kush dëshiron të përdorë orendi argjendi e ari është i lirë ta bëjë. ¶46

Në Bayán in, Báb i lejon përdorimin e orendive të arta e të argjendta, duke shfuqizuar kështu dënimin islamik për përdorimin e tyre, që nuk rrjedh nga ndonjë porosi e dhënë shprehimisht në Kuran por nga hadithet myslimane. Bahá'u'lláh u mbështet këtu vendimin e Báb it.

73. Kini mendjen që kur hani të mos futni duart në tasa e tabaka. ¶46

Ky ndalim është përcaktuar nga Shoghi Effendi u si “zhytje e dorës në ushqim”. Në shumë pjesë të botës ka qenë zakon të ngrënit me duar nga një enë e përbashkët.

74. Merrni zakone sa më të hijshme. ¶46

Ky është i pari prej pasazheve të shumta që përmendin rëndësinë e sqimës e të pastërtisë. Fjala origjinale arabe “latáfah”, e përkthyer këtu “sqimë”, ka një numër të madh kuptimesh të karakterit shpirtëror e fizik, si elegancë, hijeshi, pastërti, sjellje e qytetëruar, mirësjellje, delikatesë e mirësi, si dhe të qëniet me shije të hollë, sqimatar, i dëlirë e i kulluar. Sipas kontekstit të pasazheve të ndryshme të Kitáb-i-Aqdas it ku ndeshet kjo fjalë, ajo është përkthyer ose “sqimë” ose “pastërti”.

75. Ai që është Agimi i Kauzës së Perëndisë nuk ka shoq në

Pagabueshmërinë Më të Madhe. ¶47

Në Tabelën e Ishrakatit, Bahá'u'lláh u thotë se Pagabueshmëria Më e Madhe kufizohet vetëm me Manifestimet e Perëndisë.

Kreu 45 në *Përgjigje për disa pyetje* i kushtohet një shpjegimi të ‘Abdu'l-Bahá it për këtë varg të Aqdas it. Në këtë kapitull Ai thekson, ndër të tjera, pandashmërinë e “*pagabueshmërisë*” thelbësore nga Manifestimet e Perëndisë dhe pohon se “*çdo gjë që del prej tyre është baras me të vërtetën e në përputhje me realitetin*”, se “*Ata nuk janë nën hijen e ligjeve të mëparshme*” dhe se “*Çdo gjë që thonë Ata është Fjalë e Perëndisë dhe çdo gjë që bëjnë është veprim i drejtë*”.

76. Çdo ati i është urdhëruar mësimi i djalit e i vajzës së tij në artin e shkrim-leximit ¶48

‘Abdu'l-Bahá i, në Tabelat e Tij, jo vetëm tërheq vëmendjen lidhur me përgjegjësinë e prindërve për të arsimuar fëmijët e tyre, por edhe përcakton qartë se “arsimi dhe kultura e vajzave janë më të nevojshme se ato të djemve”, sepse vajzat një ditë do të bëhen nëna, dhe nënat janë edukatoret e para të brezave të rinj. Por në qoftë se një familje nuk ka mundësi të arsimojë të gjithë fëmijët, u duhet dhënë përparësi vajzave, sepse përmes nënave të arsimuara të mirat e dijes mund të përhapen me shumë efektshmëri e shpejt në gjithë shoqërinë.

77. Perëndia ka ngarkuar çdo shkelës dhe çdo shkelëse të kurorës me një gjobë, e cila duhet t'i paguhet Shtëpisë së Drejtësisë ¶49

Megjithëse termi i përkthyer këtu si marrëdhënie intime jashtë kurore ka parasysh, në një kuptim të gjerë, marrëdhënie seksuale të paligjshme midis personash të martuar ose të pamartuar (për përkufizimin e këtij termi shih shënimin 36), ‘Abdu'l-Bahá i e ka përcaktuar se ndëshkimi i parashikuar këtu është për marrëdhënie seksuale midis personash të pamartuar. Ai vë në dukje se i takon Shtëpisë Universale të Drejtësisë të përcaktojë ndëshkimin për marrëdhënie intime jashtë kurore të kryer nga një person i

martuar. (shih gjithashtu Py&Pë 49).

Në një prej Tabelave të Tij, ‘Abdu’l-Bahá i përmend disa rrjedhoja shpirtërore të shkeljes së ligjeve të moralit dhe, lidhur me ndëshkimin e shtjelluar këtu, vë në dukje se synimi i këtij ligji është t’ua bëjë të qartë të gjithëve se një veprim i tillë është i turpshëm në sytë e Perëndisë dhe se, në rastet kur shkelja është provuar dhe gjoba është vënë, synimi kryesor është denoncimi i shkelësve, që ata të turpërohen e të humbasin nderin në sytë e shoqërisë. Ai thotë se një denoncim i tillë është në vetvete ndëshkimi më i madh.

Shtëpia e Drejtësisë që përmendet në këtë varg supozohet të jetë Shtëpia Lokale e Drejtësisë, e njohur tani për tani si Asamble Shpirtërore Lokale.

78. nëntë mithqálë ar, që dyfishohen në qoftë se faji përsëritet ¶49

Mithqáli është një masë peshe. Pesha e mithqálit tradicional të përdorur në Lindjen e Mesme është baras me 24 nakudë. Por mithqáli i përdorur nga Bahá’í të është prej 19 nakudësh, *“në pajtim me përcaktimin e Bayán-it”* (Py&Pë 23). Pesha e nëntë prej këtyre mithqálëve është baras me 32.775 gramë ose 1.05374 onsë troi.

Përsa i përket vënies së gjobës, Bahá’u’lláh u e përcakton qartë se çdo gjobë e mëtejshme është dyfishi i së mëparshmes (Py&Pë 23); kështu, gjoba e vënë rritet në progresion gjeometrik. Vënia e kësaj gjobe është llogaritur për një gjendje të ardhshme të shoqërisë, kur ligji do të trajtohet e vihet në zbatim nga Shtëpia Universale e Drejtësisë.

79. Ne jua kemi bërë të ligjshme të dëgjoni muzikë e këngë. ¶51

‘Abdu’l-Bahá i ka shkruar se *“Ndër disa kombe të Lindjes muzika konsiderohet e qortueshme”*. Megjithëse Kurani nuk përmban porosi të posaçme për këtë çështje, disa myslimanë e konsiderojnë të

paligjshme të dëgjosh muzikë, ndërsa të tjerë e tolerojnë muzikën brenda disa kufijsh e me disa kushte të caktuara.

Në Shkrimet Bahá'í ka një numër pasazhesh që lëvdojnë muzikën. ‘Abdu’l-Bahá i, për shembull, thotë se *“muzika, e kënduar ose e luajtur, është ushqim shpirtëror për shpirtin dhe zemrën”*.

80. O ju Njerëz të Drejtësisë! ¶52

Në shkrimet e ‘Abdu’l-Bahá it e të Shoghi Effendi ut është sqaruar që, ndërsa anëtarësia e Shtëpisë Universale të Drejtësisë është e kufizuar vetëm me burra, si gratë dhe burrat mund të zgjidhen në Shtëpitë Dytësore e Lokale të Drejtësisë (të quajtura tani për tani Asamble Shpirtërore Kombëtare e Lokale).

81. Ndëshkimet për plagosje ose goditje të një personi varen nga shkalla e dëmtimit; për çdo shkallë Zoti i Gjykimit ka caktuar njëfarë zhdëmtimi. ¶56

Ndërsa Bahá'u'lláh u ka përcaktuar se shkalla e ndëshkimit varet nga *“serioziteti i dëmtimit”*, nuk ka të dhëna që Ai të ketë përpunuar hollësitë për madhësinë e zhdëmtimit për shkallët e ndryshme të dëmit. Përgjegjësia për t'i përcaktuar këto i mbetet Shtëpisë Universale të Drejtësisë.

82. Me të vërtetë, juve ju është kërkuar të bëni një festë një herë në muaj ¶57

Ky urdhër është bërë baza për kremtimin e festave mujore Bahá'í dhe si i tillë përbën porosinë për Festën e Nëntëmbëdhjetë Ditëve. Në Bayán in Arab, Báb i u bënte thirrje pasuesve të Tij të mblidhen së bashku një herë në nëntëmbëdhjetë ditë për të treguar mikpritje e miqësi. Këtu Bahá'u'lláh u e mbështet këtë dhe vë në dukje rolin bashkues të rasteve të tilla.

Pas Tij, ‘Abdu’l-Bahá i dhe Shoghi Effendi u kanë zbërthyer hap pas hapi domethënien institucionale të kësaj

porosie. ‘Abdu’l-Bahá i ka nënvizuar rëndësinë e karakterit shpirtëror e lutësor të këtyre grumbullimeve. Shoghi Effendi u, veç që ka thelluar më tej aspektet lutësore e shoqërore të Festës, ka zhvilluar elementin administrativ të një mbledhjeje të tillë dhe, duke e ndërtuar sistematikisht Festën, ka parashikuar një kohë konsultimi për punët e komunitetit Bahá’í, e cila përfshin edhe shkëmbimin e të rejave e të mesazheve.

Në përgjigje të një pyetjeje nëse kjo porosi është e detyrueshme, Bahá’u’lláh u ka thënë se jo (Py&Pë 48). Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, komenton më tej:

Pjesëmarrja në Festën e Nëntëmbëdhjetë Ditëve nuk është e detyrueshme, por shumë e rëndësishme, dhe çdo besimtar duhet ta konsiderojë një detyrë e një privilegj të jetë i pranishëm në raste të tilla.

83. Në qoftë se gjuani me kafshë ose shpendë grabitqarë, përmendni Emrin e Perëndisë kur i lëshoni ato për të ndjekur gjahun; sepse atëherë çdo gjë që të kapin do të jetë e ligjshme për ju, edhe sikur ta gjeni të ngordhur. ¶60

Me këtë ligj Bahá’u’lláh u i thjeshton shumë praktikat e rregullat fetare të së kaluarës lidhur me gjuetinë. Ai ka thënë gjithashtu se gjuetia me armë të tilla si harqe e shigjeta, pushkë e të tjera si këto, përfshihet në këtë rregull, por se ngrënia e gjahut që gjendet i ngordhur në një çark ose rrjetë është e ndaluar. (Py&Pë 24).

84. mos e teproni në gjueti ¶60

Bahá’u’lláh u nuk e ndalon gjuetinë, por Ai këshillon që të mos tepronet në gjueti. Shtëpia Universale e Drejtësisë duhet ta shohë në kohën e duhur se ç’do të thotë ta teproni në gjueti.

85. Ai nuk u ka dhënë atyre të drejta mbi pronën e të tjerëve. ¶61

Porosia për të treguar përzemërsi ndaj të afërmëve të Bahá’u’lláh ut nuk u jep atyre pjesë në pronën e të tjerëve. Kjo është në kundërshtim me praktikën e myslimanizmit shiit, në të

cilën pasardhësit e Muhametit kanë të drejtë të marrin një pjesë të njëfarë takse.

86. Në qoftë se dikush në mënyrë të qëllimtë shkatërron një shtëpi duke i vënë zjarrin, ju edhe atë do ta digjini; në qoftë se dikush në mënyrë të qëllimtë i merr jetën një tjetri, ju edhe atë do ta vrisni. ¶62

Ligji i Bahá'u'lláh ut parashikon dënimin me vdekje për vrasje e zjarrvënie, me alternativën e burgimit të përjetshëm (shih shënimin 87).

Në Tabelat e Tij ‘Abdu’l-Bahá i shpjegon dallimin midis hakmarrjes e dënimit. Ai thotë se individët nuk kanë të drejtë të hakmerren, se hakmarrja është e përbuzur në sytë e Perëndisë dhe se qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja, por dhënia e një dënimi për fajin e kryer. Në *Përgjigje për disa pyetje*, Ai thotë se është e drejta e shoqërisë të dënojë kriminelët, me qëllim që të mbrojnë pjesëtarët e saj dhe ekzistencën e tyre.

Lidhur me këtë porosi, Shoghi Effendi u në një letër të shkruar në emër të tij jep shpjegimin që vijon:

Në Aqdas in, Bahá'u'lláh u ka vendosur vdekjen si dënim për vrasje. Por Ai ka lejuar burgimin e përjetshëm si alternativë. Të dyja këto praktika do të ishin në pajtim me Ligjet e Tij. Ndoshta disa prej nesh nuk janë në gjendje të kapin urtinë e kësaj, kur kjo nuk përputhet me shikimin tonë të kufizuar; por ne duhet ta pranojmë atë duke ditur se Urtia e Tij, Mëshira e Tij dhe Drejtësia e Tij janë të përsosura e për shpëtimin e mbarë botës. Po qe se një njeri do të dënohej me vdekje padrejtësisht, a nuk mund të besojmë ne se Perëndia Fuqiplotë do ta shpërblente atë njëmijë herë më shumë në botën tjetër për një padrejtësi të tillë njerëzore? Nuk mund të hiqet dorë nga një ligj i dobishëm vetëm për shkak se në raste të rralla mund të dënohet një i pafajshëm.

Hollësitë e ligjit Bahá'í të dënimit për vrasje e për zjarrvënie, një ligj i llogaritur për një gjendje të ardhshme të

shoqërisë, nuk janë përcaktuar nga Bahá'u'lláh u. Hollësitë e ndryshme të ligjit, si shkalla e fajit, nëse duhen mbajtur parasysh rrethana lehtësuese dhe se cili prej dy dënimeve të parashikuara duhet të jetë norma, i janë lënë Shtëpisë Universale të Drejtësisë që të vendosë në dritën e rrethanave mbizotëruese kur ligji të hyjë në veprim. Edhe mënyra sesi do të zbatohet dënimi i është lënë Shtëpisë Universale të Drejtësisë të vendosë.

Lidhur me zjarrvënien, kjo varet nga fakti se çfarë “*shtëpie*” është djegur. Është e qartë se ka një dallim shumë të madh në shkallën e fajit midis një personi që djeg një magazinë bosh dhe një njeriu që i vë zjarrin një shkolle plot me fëmijë.

87. Në qoftë se e dënoni zjarrvënësin e vrasësin me burgim të përjetshëm, kjo do të jetë e pranueshme sipas porosive të Librit. ¶62

Në përgjigje të një pyetjeje për këtë varg të Aqdas it, Shoghi Effendi u ka thënë se dënimi kapital është lejuar, por është parashikuar një alternativë, “burgimi i përjetshëm”, “që zbut në mënyrë të konsiderueshme ashpërsinë e një dënimi të tillë”. Ai vë në dukje se “Bahá'u'lláh u na ka dhënë rrugëzgjdhjen dhe prandaj na ka lënë të lirë të përdorim gjykimin tonë brenda disa kufizimeve që imponon ligji i Tij”. Në mungesë të udhëzimeve të posaçme për zbatimin e këtij aspekti të ligjit Bahá'í, i takon Shtëpisë Universale të Drejtësisë të nxjerrë ligje për këtë çështje në të ardhmen.

88. Perëndia ju ka porositur të martoheni. ¶63

Bahá'u'lláh u, në një prej Tabelave të Tij, thotë se Perëndia, duke vendosur këtë ligj, e ka bërë martesën “*një fortesë mirëqenieje e shëlbimi*”.

Pasqyra Përmbledhëse e Kodifikimi, seksioni IV.C.1.a.-o., përmbledh e sintetizon porositë e Kitáb-i-Aqdas it e të Pyetje dhe Përgjigje lidhur me martesën dhe kushtet në të cilat ajo lejohet (Py&Pë 3, 13, 46, 50, 84 dhe 92), ligjin e fejesës (Py&Pë 43),

pagimin e prikës (Py&Pë 12, 26, 39, 47, 87 dhe 88), procedurat që duhen zbatuar në rast mungese të gjatë të bashkëshortit (Py&Pë 4 dhe 27) dhe rrethana të tjera të ndryshme ((Py&Pë 12 dhe 47). (Shih gjithashtu shënimet 89-99.)

89. Kini mendjen mos merrni më shumë se dy gra. Kush kënaqet me një shoqe të vetme ndër shërbëtoret e Perëndisë, ai dhe ajo që të dy do të jetojnë në paqe. ¶63

Edhe pse duket sikur teksti i Kitáb-i-Aqdas it lejon bigaminë, Bahá'u'lláh u këshillon që paqja e kënaqësia rrjedhin nga monogamia. Në një Tabelë tjetër, Ai nënvizon sesa e rëndësishme është që njeriu të veprojë në mënyrë të tillë që *“t'i sjellë rehati vetes dhe shoqes së tij”*. ‘Abdu’l-Bahá i, Interpretuesi i autorizuar i Shkrimeve Bahá’í, thotë se në fakt në tekstin e Aqdas it urdhërohet monogamia. Ai e ka përpunuar këtë temë në një numër tabelash, duke përfshirë këtë që vijon:

Dije se poligamia nuk është e lejuar në ligjin e Perëndisë, sepse është porositur në mënyrë të qartë që duhet kënaqur me një grua të vetme. Marrja e një gruaje të dytë është kushtëzuar nga ruajtja e paanësisë dhe drejtësisë ndaj të dyja grave në të gjitha rrethanat. Por është absolutisht e pamundur të ruash paanësinë e drejtësinë ndaj dy grave. Fakti që bigamia është kushtëzuar me një kusht të pamundur është një provë e qartë e ndalimit absolut të saj. Pra, nuk lejohet që një burrë të ketë më shumë se një grua.

Poligamia është një zakon shumë i lashtë midis pjesës më të madhe të njerëzimit. Monogamia është futur vetëm gradualisht nga Manifestimet e Perëndisë. Jesui, për shembull, nuk e ndaloi poligaminë, por ndaloi shkurorëzimin me përjashtim të rasteve të marrëdhënieve intime jashtë kurorës; Muhamedi e kufizoi numrin e grave në katër, por e kushtëzoi marrjen e shumë grave me drejtësinë dhe rifuti lejimin e shkurorëzimit; Bahá'u'lláh u, i Cili i reveloi Mësimet e Tij në mjedisin e një shoqërie myslimane, e futi çështjen e monogamisë gradualisht, sipas parimeve të urtisë e të shpalosjes hap pas hapi të qëllimit të Tij. Fakti që Ai u la pasuesve

të Vet një Interpretues të pagabueshëm të Shkrimeve të Tij, i dha mundësi Atij që në pamje të jashtme të lejonte dy gra në Kitáb-i-Aqdas, por duke vënë një kusht që i dha mundësi ‘Abdu’l-Bahá it të sqaronte më pas se synimi i ligjit ishte të mbështeste monogaminë.

90. kush dëshiron të marrë në shërbim një shërbëtore, mund ta bëjë këtë në mënyrë të përshtatshme ¶63

Bahá’u’lláh u thotë se një burrë mund të marrë një shërbëtore për punët e shtëpisë. Kjo nuk ishte e lejueshme sipas zakonisht mysliiman shiit, veç në qoftë se punëdhënësi bënte me të një kontratë martesë. Bahá’u’lláh u thekson se *“shërbimet”* për të cilat bëhet fjalë në këtë varg janë vetëm *“të tilla që kryhen, për një pagë të caktuar, nga çdo kategori tjetër shërbyesish, të rinj a të vjetër qofshin”* (Py&Pë 30). Punëdhënësi nuk ka të drejta seksuale mbi shërbëtoren e tij. Ajo është *“e lirë të zgjedhë një bashkëshort kurdo që t’i pëlqejë”*, sepse nuk është e lejuar që gratë të blihen (Py&Pë 30).

91. Ky është urdhëri Im për ju; përmbajuni fort atij që të ndihmoni vetveten. ¶63

Edhe pse Kitáb-i-Aqdas urdhëron martesën, Bahá’u’lláh u e sqaron se kjo nuk është e detyrueshme (Py&Pë 46). Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, gjithashtu deklaroi se *“martesa nuk është kurrësi një detyrim”* dhe thotë se *“në fund të fundit i takon individit të vendosë nëse dëshiron të bëjë jetë familjare apo të jetojë beqar”*. Në qoftë se një personi i duhet të presë një periudhë të gjatë kohe për të gjetur një shok jete ose të mbetet përfundimisht i vetëm, kjo nuk do të thotë se ky individ nuk mund të realizojë për këtë arsye synimin e vet në jetë, që është thelbësisht shpirtëror.

92. Ne e kemi kushtëzuar martesën me lejën e prindërve të tyre ¶65

Në një letër të shkruar në emër të tij, Shoghi Effendi u ka

komentuar këtë parashikim të ligjit:

Bahá'u'lláh u e ka thënë qartë se për martesën Bahá'í kërkohet pëlqimi i të gjithë prindërve që janë gjallë. Kjo vlen si kur prindërit janë Bahá'í ose jo, të ndarë prej vitesh ose jo. Ai e ka formuluar këtë ligj të madh për të forcuar strukturën e shoqërisë, për të bërë sa më të ngushta lidhjet familjare, për të futur në zemrat e fëmijëve mirënjohje e respekt për ata që u kanë dhënë jetën dhe i kanë nisur shpirtrat e tyre në udhëtimin e përjetshëm drejt Krijuesit të tyre.

93. Asnjë martesë nuk mund të lidhet pa pagimin e një prike ¶66

Pasqyra Përmbledhëse e Kodifikimi, seksioni IV.C.1.j.i.-v., përmbledh porosinë kryesore lidhur me prikën. Këto porosi e kanë prejardhjen e tyre në Bayán.

Prika i duhet paguar nuses nga dhëndri. Ajo është caktuar 19 mithqálë ar i pastër për banorët e qyteteve dhe 19 mithqálë argjend për banorët e fshatrave (shih shënimin 94). Bahá'u'lláh u vë në dukje që në qoftë se në çastin e martesës dhëndri nuk është në gjendje ta paguajë të plotë prikën, atij i lejohet t'i dorëzojë nuses një zotim të shkruar (Py&Pë 39).

Me Revelacionin e Bahá'u'lláh ut shumë koncepte, zakone e institute të njohura janë ripërcaktuar dhe kanë marrë një kuptim të ri. Një prej tyre është edhe prika. Instituti i prikës është një zakon shumë i lashtë i mjaft kulturave dhe merr forma të ndryshme. Në disa vende prika është një pagesë që i bëhet dhëndrit nga prindërit e nuses; në vende të tjera është një pagesë që dhëndri u bën prindërve të nuses dhe që quhet “çmimi i nuses”. Në të dy rastet shuma që paguhet është shpesh mjaft e madhe. Ligji i Bahá'u'lláh ut i shfuqizon të gjitha këto variante dhe e shndërron prikën në një akt simbolik, me anën e të cilit dhëndri i jep nuses një dhuratë me vlerë të kufizuar.

94. në nëntëmbëdhjetë mithqálë ar të pastër për banorët e

qyteteve dhe në të njëjtën sasi argjendi për banorët e fshatrave ¶66

Bahá'u'lláh u e thotë qartë se kriteri për të caktuar pagesën e prikës është vendbanimi i përhershëm i dhëndrit, e jo ai i nuses (Py&Pë 87, 88).

95. Atij që dëshiron ta rrisë këtë shumë, i ndalohej të kapërcejë kufirin e nëntëdhjetë e pesë mithqálëve ... Por në qoftë se ai kënaqet me shifrën më të ulët, për të do të jetë më mirë t'i përmbahet asaj që thuhet në Librin. ¶66

Në përgjigje të një pyetjeje për prikën, Bahá'u'lláh u ka thënë:

Çdo gjë që është zbuluar në Bayán, për ata që banojnë në qytete e fshatra, është miratuar dhe duhet të zbatohet. Por në Kitáb-i-Aqdas përmendet shifra më e ulët. Me këtë nënkuptohet shifra nëntëmbëdhjetë mithqálë argjend, që në Bayán është caktuar për banorët e fshatrave. Kjo është më e pëlqyeshme për Perëndinë, me kusht që të dyja palët të bien në ujdi. Qëllimi është të mbështetet mirëqenia e të gjithëve dhe të krijohet harmoni e bashkëim midis njerëzve. Prandaj, sa më e madhe të jetë konsiderata që tregohet në këto raste aq më mirë është... Njerëzit e Bahá-it duhet të shoqërohen e të sillen ndaj njëri-tjetrit me dashurinë e sinqeritetin më të madh. Ata duhet të mos harrojnë interesat e të gjithëve, veçanërisht të miqve të Perëndisë.

‘Abdu’l-Bahá i, në një prej Tabelave të Tij, përmbledh disa prej porosive për përcaktimin e madhësisë së prikës. Njësia e pagesës që përmendet në ekstraktin që vijon është “vâhid-i”. Një vâhid është baras me nëntëmbëdhjetë mithqálë. Ai thotë:

Banorët e qyteteve duhet të paguajnë në ar dhe banorët e fshatrave në argjend. Kjo varet nga mjetet financiare që disponon dhëndri. Në qoftë se është i varfër, ai paguan një vâhid; në qoftë se ka mjete modeste, paguan dy vâhidë; në qoftë se është në gjendje të mirë, paguan tre vâhidë; në qoftë se është i pasur, paguan katër vâhidë; në qoftë se është shumë i pasur, jep pesë vâhidë. Në të vërtetë, kjo është çështje ujdje midis dhëndrit, nuses dhe prindërve të tyre. Çfarëdo ujdje të arrihet, ajo

dubet zbatuar.

Po në këtë Tabelë, ‘Abdu’l-Bahá i i shtyn besimtarët t’ia referojnë çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji Shtëpisë Universale të Drejtësisë, e cila është *“e autorizuar të nxjerrë ligje”*. Ai thekson se *“është ky organizëm që do të vërë në zbatim ligjet e do të hartojë legjislacion për çështje detyësore që nuk janë thënë shprehimisht në Tekstin e Shenjtë”*.

96. në qoftë se dikush prej shërbëtorëve të Tij ka ndërmend të bëjë një udhëtim, ai duhet të caktojë për të shoqen kohën se kur do të kthehet në shtëpi ¶67

Në rastin kur një burrë largohet pa i njoftuar së shoqes datën e kthimit dhe ajo nuk merr lajme nga ai e humbet çdo gjurmë të tij, Bahá’u’lláh u ka thënë që, po qe se burri ka qenë në dijeni të ligjit të shtjelluar në Kitáb-i-Aqdas, gruaja mund të martohet përsëri pasi të ketë pritur plot një vit. Por në qoftë se burri nuk ka qenë në dijeni të këtij ligji, gruaja duhet të presë derisa t’i vijë lajme për të shoqin (Py&Pë 4).

97. asaj i takon të presë për një periudhë prej nëntë muajsh, pas së cilës nuk ka ndonjë pengesë që ajo të marrë burrë tjetër ¶67

Në rastin që burri nuk kthehet në fund të kohës së caktuar ose nuk njofton të shoqen për ndonjë vonesë, gruaja duhet të presë nëntë muaj dhe pas kësaj është e lirë të martohet përsëri, megjithëse është e pëlqyeshme që ajo të presë më gjatë (shih shënimin 147 për kalendarin Bahá’í).

Bahá’u’lláh u thotë se në rrethana të tilla, në qoftë se gruas i vjen lajm për *“vdekjen ose vrasjen e të shoqit”*, para se të martohet përsëri ajo duhet gjithashtu të presë edhe nëntë muaj (Py&Pë 27). Në një prej Tabelave, ‘Abdu’l-Bahá i e ka sqaruar më tej se periudha e pritjes prej nëntë muajsh pas marrjes së lajmit të vdekjes së të shoqit është e vlefshme vetëm në qoftë se i shoqi ka qenë larg në kohën që ka vdekur, dhe jo në qoftë se ai vdes në

shtëpi.

98. ajo duhet të zgjedhë atë mënyrë veprimi që është e lavdërueshme ¶67

Bahá'u'lláh u e përkufizon “mënyrën e veprimit që është e lavdërueshme” si “të pasurit durim” (Py&Pë 4).

99. dy dëshmitarëve të drejtë ¶67

Bahá'u'lláh u e shpall “kriterin e drejtësisë” lidhur me dëshmitarët si “nami i mirë që gëzon midis njerëzve”. Ai thotë se nuk është e domosdoshme që dëshmitarët të jenë Bahá'í, përdërisa “Dëshmia e të gjithë shërbëtorëve të Perëndisë, të çdo besimi a bindjeje qoftë, është e pranueshme para Fronit të Tij” (Py&Pë 79).

100. Në qoftë se midis burrit e gruas lind mëri e antipati, ai nuk duhet ta ndajë atë, por të presë me durim plot një vit ¶68

Në Mësimet Bahá'í shkurorëzimi dënohet ashpër. Por në qoftë se midis bashkëshortëve lind mëri e antipati, shkurorëzimi lejohet pasi të ketë kaluar plot një vit. Gjatë këtij viti të durimit, burri është i detyruar të kujdeset për sigurimin e jetesës të gruas e të fëmijëve dhe çiftit i kërkohet të bëjë përpjekje për të sheshuar mosmarrëveshjet me njëri-tjetrin. Shoghi Effendi u thotë se si burri dhe gruaja “kanë njëlloj të drejtë të kërkojnë shkurorëzimin” sa herë që njëri prej tyre “e sheh absolutisht të nevojshme ta bëjë këtë”.

Në Pyetje dhe Përgjigje, Bahá'u'lláh u shtjellon disa çështje që kanë të bëjnë me vitin e durimit, zbatimin e tij (Py&Pë 12), duke përcaktuar datën e fillimit të tij (Py&Pë 19 dhe 40), kushtet për pajtimin (Py&Pë 38) dhe rolin e dëshmitarëve e të Shtëpisë Lokale të Drejtësisë (Py&Pë 73 dhe 98). Lidhur me dëshmitarët, Shtëpia Universale e Drejtësisë ka sqaruar se në kohën e tanishme detyrat e dëshmitarëve në rast shkurorëzimi kryhen nga Asambletë Shpirtërore.

Dispozitat e hollësishme të ligjeve Bahá'í për shkurorëzimin janë përmbledhur në Pasqyrën Përmbledhëse e Kodifikimin, seksioni IV.C.2.a.-i.

101. Zoti ... e ka ndaluar praktikën që ju ndiqnit më parë kur e ndanit tri herë një grua. ¶68

Kjo i referohet një ligji islamik të shpallur në Kuran, i cili dekretonte që në rrethana të caktuara një burrë mund të rimartohej me gruan që kishte ndarë, vetëm në rast se ajo ishte martuar më parë me një tjetër e pastaj ishte ndarë prej tij. Bahá'u'lláh u vë në dukje se ky është zakoni i ndaluar në Kitáb-i-Aqdas (Py&Pë 31).

102. Ai që ka ndarë gruan mund të vendosë, me kalimin e çdo muaji, të rimartohet me të kur ka dashuri e pëlqim të ndërsjellë, sakohë ajo nuk ka marrë një burrë tjetër ... veç po qe se gjendja e saj ndryshon në mënyrë të qartë. ¶68

Në një letër të shkruar në emër të tij, Shoghi Effendi u thotë se qëllimi i frazës “me kalimin e çdo muaji” nuk është të verë ndonjë kufizim dhe se një çift i shkurorëzuar mund të rimartohet në çdo moment pas shkurorëzimit, sakohë asnjëra nga dy palët nuk është martuar deri atëherë me një tjetër.

103. fara nuk është e papastër ¶74

Në disa tradita fetare dhe në zakonet mysliman shiit fara ishte shpallur ritualisht e papastër. Këtu Bahá'u'lláh u e flak këtë koncept. Shih gjithashtu shënimin 106 më poshtë.

104. Mbahuni pas litarit të sqimës ¶74

‘Abdu'l-Bahá i i referohet ndikimit të “*dëllirësisë e të shenjtërisë, të pastërtisë e të sqimës*” në lartësimin e “*gjendjes së njeriut*” dhe në “*zhvillimin e realitetit të brendshëm të njeriut*”. Ai thotë: “*Pasja e një trupi të dëllirë e të panjollë ushtron ndikim mbi shpirtin e njeriut*”. (Shih gjithashtu shënimin 74.)

105. Lajeni çdo gjë të ndotur me ujë që nuk ka pësuar ndryshime në asnjërin prej tre aspekteve ¶74

“*Tre aspektet*” që përmenden në këtë varg janë ndryshimet e ngjyrës, të shijës e të erës së ujit. Bahá’u’lláh u jep udhëzime shtesë lidhur me ujin e kulluar dhe pikën në të cilën ai konsiderohet i papërshtatshëm për ta përdorur (Py&Pë 91).

106. Perëndia po kështu ka anuluar ... konceptin e “papastërtisë”, për shkak të të cilit shumë gjëra e njerëz janë konsideruar si të papastër. ¶75

Koncepti i “papastërtisë” rituale, siç e kuptojnë dhe e praktikojnë atë disa shoqëri fisnore e bashkësi fetare të disa Dispensacioneve të lashta, është anuluar nga Bahá’u’lláh u. Ai thotë se përmes Revelacionit të Tij “*të gjitha gjërat e krijuara u zhytën në detin e dëlirjes*”. (Shih gjithashtu shënimet 12, 20 dhe 103).

107. atë ditë të parë të Ridvánit ¶75

Kjo është një referencë për arritjen e Bahá’u’lláh ut e të shokëve të Tij në Kopshtin e Najíbíyyih ut jashtë qytetit të Baghdád Mírzá Yahyá it, që më vonë u quajt prej Bahá’í-ve Kopshti i Ridvánit. Kjo ngjarje, që ndodhi tridhjetë e një ditë pas Novruzit, në prill 1863, shënoi fillimin e periudhës gjatë së cilës Bahá’u’lláh u u shpalli shokëve të Vet Misionin e Tij. Në një Tabelë, Ai i referohet Deklarimit të Tij si “*Dita e lumturisë supreme*” dhe e ciëson Kopshtin e Ridvánit si “*Vendin nga i cili Ai përbapi mbi gjithë krijimin shkëlqimet e Emrit të Tij, Mëshirëplotit*”. Bahá’u’lláh u qëndroi dymbëdhjetë ditë në këtë Kopsht para se të nisej për në Stamboll, në vendin ku ishte syrgjynosur.

Deklarimi i Bahá’u’lláh ut kremtohet çdo vit në dymbëdhjetë ditët e Festës së Ridvánit, të cilën Shoghi Effendi u e cilëson si “festën më të shenjtë e më të rëndësishme midis të gjitha festave Bahá’í” (shih shënimet 138 dhe 140).

108. Bayán i ¶77

Bayán i, Libri Mëmë i Dispensacionit Bábí, është titulli që i ka dhënë Báb i Librit të Tij të Ligjeve, por ky titull përdoret gjithashtu për tërësinë e Shkrimeve të Tij. Bayán i Persian është vepra doktrinare madhore dhe bartësi kryesor i ligjeve të urdhëruara nga Báb i. Bayán i Arab shkon paralel me të për nga përmbajtja, por është më i vogël e me më pak peshë. Duke cilësuar Bayán in Persian në *Perëndia kalon pranë*, Shoghi Effendi u vë në dukje se Bayán i duhet konsideruar “në radhë të parë si një panegjirik i të Premtuarit sesa si një kod ligjesh e porosish të destinuara të jenë një udhërrëfim i përhershëm për brezat e ardhshëm”.

‘Abdu’l-Bahá i ka shkruar: *“Bayán i është zëvendësuar nga Kitáb-i-Aqdas i, me përjashtim të atyre ligjeve që janë mbështetur e përmendur në Kitáb-i-Aqdas”*.

109. zhdukja e librave ¶77

Në Tabelën e Ishraqat it Bahá’u’lláh u, duke iu referuar faktit që Báb i i kishte vënë ligjet e Bayán it në varësi nga miratimi i Tij, deklaroi se i kishte futur në fuqi disa nga ligjet e Báb it *“duke i përfaqësuar ato në Kitáb-i-Aqdas me fjalë të tjera”*, ndërsa disa të tjera i ka lënë mënjanë.

Lidhur me zhdukjen e librave, Bayán i i urdhëronte pasuesit e Báb it të zhduknin të gjithë librat, me përjashtim të atyre që ishin shkruar në mbrojtje të Kauzës e të Fesë së Perëndisë. Bahá’u’lláh u e shfuqizon këtë ligj specifik të Bayán it.

Përsa i përket natyrës dhe ashpërsisë së ligjeve të Bayán it, Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, bën komentin që vijon:

Ligjet dhe urdhërat e ashpër të reveluar nga Báb i mund të çmohen e të kuptohen drejt vetëm të interpretuar në dritën e vetë deklaratave të Tij për natyrën, synimin e karakterin e vetë Dispensacionit të Tij. Siç e zbulojnë qartë këto

deklarata, Dispensacioni Bábí ishte thelbësisht i natyrës së një revolucioni fetar e me të vërtetë shoqëror, prandaj kohëzgjatja e tij do të ishte e shkurtër, por e mbushur plot ngjarje tragjike dhe reforma radikale e drastike. Báb i dhe pasuesit e Tij i morën këto masa drastike me synimin që të minonin vetë themelet e ortodoksisë shiite, duke hapur kështu rrugën për ardhjen e Bahá'u'lláh ut. Pra, për të shpallur pavarësinë e Dispensacionit të ri dhe për të përgatitur gjithashtu terrenin për afrimin e Revelacionit të Bahá'u'lláh ut, Báb i duhej të revelonte ligje tepër të ashpra, edhe pse shumë prej tyre kurrë nuk u zbatuan. Por vetë fakti që Ai i reveloi ato ishte në vetvete një provë e karakterit të pavarur të Dispensacionit të Tij dhe mjaftoi për të krijuar një tronditje aq të përhapur dhe për të nxitur një kundërvënie të tillë të klerikëve, që i shtyri ata të bëhen shkak i martirizimit të Tij.

110. Ne ju kemi lejuar të lexoni ato shkenca që janë të dobishme për ju, dhe jo të tilla që përfundojnë në polemika të kota ¶77

Shkrimet Bahá'í urdhërojnë fitimin e dijeve dhe studimin e arteve e të shkencave. Bahá'í të ftohen të respektojnë njerëzit e kulturuar e me talent dhe paralajmërohen të mos ndjekin studime pa bukë, që shkaktojnë vetëm grindje boshe.

Në Tabelat e Tij Bahá'u'lláh u i këshillon besimtarët të studiojnë shkenca e arte të tilla që janë *“të dobishme”* dhe i japin shtysë *“përparimit e përmirësimit”* të shoqërisë, ndërsa u tërheq vëmendjen kundër shkencave që *“fillojnë me fjalë dhe mbarojnë me fjalë”*, ndjekja e të cilave çon në *“polemika të kota”*. Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, i krahason shkencat që *“fillojnë me fjalë dhe mbarojnë me fjalë”* me *“ekskursione të pafrytshme në kleçka metafizike”*, ndërsa në një letër tjetër shpjegon se ajo që Bahá'u'lláh u kishte në radhë të parë parasysh me *“shkenca”* të tilla janë *“ato traktate e komente*

teologjike që rëndojnë mendjen njerëzore, në vend që ta ndihmojnë atë t'i përmbahet së vërtetës”.

111. Ai Që ka biseduar me Perëndinë ¶80

Ky është një titull tradicional hebraik e islamik i Moisiut. Bahá'u'lláh u thotë se me ardhjen e Revelacionit të Tij *“veshët njerëzorë kanë pasur privilegjin të dëgjojnë se çfarë dëgjoji mbi Sinain Ai Që bisedoi me Perëndinë”*.

112. Sinai ¶80

Mali në të cilin Perëndia i reveloi Ligjin Moisiut.

113. Fryma e Perëndisë ¶80

Është një prej titujve të përdorur në Shkrimet islamike e Bahá'í për të treguar Jesu Krishtin.

114. Karmeli ... Sioni ¶80

Karmeli, “Vreshti i Perëndisë”, është mali në Tokën e Shenjtë ku janë të vendosura Mauzoleu i Báb-it dhe selia e qendrës administrative botërore të Besimit.

Sioni është një kodër në Jerusalem, vendi tradicional i varrit të Mbretit David dhe simbol i Jerusalem-it si Qytet i Shenjtë.

115. Arka Kërmëz ¶84

“Arka Kërmëz” është një referencë për Kauzën e Bahá'u'lláh-ut. Pasuesit e Tij janë quajtur *“shokët e Arkës Kërmëz”*, të lëvdur nga Báb-i në Qayyumu'l-Asmá.

116. O Perandor i Austrisë! Ai Që është Agimi i Dritës së Perëndisë ndodhej në burgun e ‘Akká-së në kohën që ti u nise për të vizituar Xhaminë Al-Aqsá. ¶85

Franc Jozef i (Franz Josef, 1830-1916), Perandor i Austrisë e Mbret i Hungarisë, bëri haxhillëk në Jerusalem më 1869. Ndërsa

ndodhej në Tokën e Shenjtë, ai nuk shfrytëzoi mundësinë të hetonte për Bahá'u'lláh un, i Cili në atë kohë ishte i burgosur në 'Akká.

Xhamia Al-Aqsá, fjalë për fjalë Xhamia “Më e largët”, përmendet në Kuran dhe është njëjtësuar me Malin e Tempullit në Jerusalem.

117. O Mbret i Berlinit! ¶86

Kajzeri Wilhelm i I (Wilhelm Friedrich Ludwig, 1797-1888), mbreti i shtatë i Prusisë, u shpall Perandor i parë i Gjermanisë në janar 1871 në Versaj të Francës, pas fitores së Gjermanisë mbi Francën në Luftën Franko-Prusiane.

118. ai, pushteti i të cilit ia kalonte pushtetit tënd dhe pozita e të cilit ishte më e lartë se jotja ¶86

Kjo është një referencë për Napoleonin III (1808-1873), Perandor i Francezëve, që nga shumë historianë konsiderohej si monarku më i shquar i kohës së tij në Perëndim.

Bahá'u'lláh u i drejtoi Napoleonit III dy Tabela dhe në të dytën profetizonte qartë se mbretëria e Napoleonit do të “*zhytej në pësbthjellim*”, se “*perandoria do t'i ikte*” nga duart dhe se populli i tij do të përjetonte “*turbullira*” të mëdha.

Brenda një viti, Napoleoni III pësoi një disfatë të bujshme nga dora e Kajzerit Vilhelmi I në betejën e Sedanit më 1870. Ai shkoi syrgjyn në Angli, ku vdiq pas tre vjetësh.

119. O popull i Kostantinopojës! ¶89

Fjala e përkthyer këtu “*Kostantinopojë*” është në origjinal “Ar-Rúm” ose “Romë”. Në Lindjen e Mesme ky term është përdorur përgjithësisht për të treguar Kostantinopojën dhe Perandorinë Romane të Lindjes, më pas qytetin e Bizantit, ndërsa më vonë Perandorinë Otomane.

120. O vend që ndodhesh në brigjet e dy deteve! ¶89

Kjo është referencë për Kostantinopojën, të quajtur tani Stamboll. E vendosur në Bosfor, një ngushticë rreth 31 kilometra e gjatë që lidh Detin e Zi dhe Detin e Marmarasë, ajo është qyteti dhe porti më i madh i Turqisë.

Kostantinopoja ka qenë kryeqyteti i Perandorisë Otomane nga viti 1453 deri në vitin 1922. Gjatë qëndrimit të Bahá'u'lláh ut në këtë qytet, në fron ishte sulltani tiran Abdyl Hazizi. Sulltanët otomanë ishin gjithashtu Kalifë, autoriteti më i lartë i Islamit Sunit. Bahá'u'lláh u parashikoi rënien e Kalifatit, që u abrogua më 1924.

121. O brigje të Rinit! ¶90

Në një prej Tabelave të Tij të shkruar para Luftës së Parë Botërore (1914-1918), 'Abdu'l-Bahá i shpjegon se, kur thoshte që i ka parë brigjet e Rinit "*të mbuluara me gjak*", Bahá'u'lláh u i referohet Luftës Franko-Prusiane (1870-1871), dhe se vuajtje të tjera do të vinin.

Në *Perëndia kalon pranë*, Shoghi Effendi u vë në dukje se "traktati tmerrsisht i rëndë "që iu imponua Gjermanisë pas disfatës së saj në Luftën e Parë Botërore "shkaktoi '*vajtimin e Berlinit*', të profetizuar kobshëm një gjysmë shekulli më parë".

122. O tokë e □á-it ¶91

"□á" është germa e parë e Tíhránit, kryeqytetit të Iranit. Bahá'u'lláh u shpesh herë ka parapëlqyer t'i paraqiste disa emra vendesh duke përmendur germën e tyre të parë. Sipas sistemit abxhad të llogaritjes, vlera numerike e □á është nëntë, e barabartë me vlerën numerike të emrit Bahá.

123. brenda teje lindi Manifestimi i Lavdisë së Tij ¶92

Kjo është një referencë për lindjen e Bahá'u'lláh ut në Tíhrán më 12 nëntor 1817.

124. O tokë e Khá-së! ¶94

Referencë për provincën iraniane të Horasanit dhe zonat fqinjë, që përfshin qytetin e ‘Ishqábád (Ashkabad it).

125. Po qe se dikush fiton njëqind mithqálë ar, nëntëmbëdhjetë mithqálë prej tyre janë të Perëndisë dhe duhet t’i jepen Atij ¶97

Ky varg vendos Ҳуқуқу’lláh-un, të Drejtën e Perëndisë, dhënien e një pjese të caktuar të vlerës së zotërimeve të besimtarit. Kjo ofertë i bëhej Bahá’u’lláh ut, si Manifestimi i Perëndisë, dhe pas Ngjitjes së Tij ‘Abdu’l-Bahá it, si Qendra e Besëlidhjes. Në Vullnetin dhe Testamentin e Tij, ‘Abdu’l-Bahá i parashikoi që Ҳуқуқу’lláh-u duhej të jepej “përmes Ruajtësit të Kauzës së Perëndisë”. Tani që nuk ka Ruajtës, ai jepet përmes Shtëpisë Universale të Drejtësisë, si Koka e Besimit. Ky fond përdoret për të mbështetur Besimin e Perëndisë, si dhe për qëllime të ndryshme filantropike. Dhënia e Ҳуқуқу’lláh-ut është një detyrim shpirtëror, plotësimi i të cilit është lënë në ndërgjegjen e çdo Bahá’í. Ndërsa është e lejuar t’i kujtohet komunitetit për kërkesat e ligjit të Hukuk-ut, asnjë besimtari nuk i duhet drejtuar për ta paguar atë.

Ky ligj është pëpunuar më tej në një numër zërash të Pyetje dhe Përgjigje. Pagimi i Ҳуқуқу’lláh-ut bazohet në llogaritjen e vlerës së zotërimeve individuale. Në qoftë se një person ka zotërimi të një vlere të barabartë të paktën me nëntëmbëdhjetë mithqálë ar (Py&Pë 8), është një detyrim shpirtëror të paguhet si Ҳуқуқу’lláh, vetëm një herë, nëntëmbëdhjetë për qind të shumës së përgjithshme (Py&Pë 89). Më tej, sa herë që të ardhurat e personit, pasi janë paguar të gjitha shpenzimet, e rrisin vlerën e zotërimeve të tij të paktën me nëntëmbëdhjetë mithqálë ar, ai duhet të paguajë nëntëmbëdhjetë për qind të kësaj shtese, e kështu me radhë për çdo shtesë të mëtejshme (Py&Pë 8, 90).

Disa kategori zotërimesh, si banesa, përjashtohen nga pagimi i Ҳуқуқу’lláh-ut (Py&Pë 8, 42, 95), dhe janë formuluar zgjidhje të posaçme që parashikojnë rastin e humbjeve ekonomike (Py&Pë 44, 45), të investimeve të pafrytshme (Py&Pë

102) dhe të pagimit të Hukuk-ut kur personi vdes (Py&Pë 9, 69, 80). (Për këtë rast të fundit shih shënimin 47.)

Pjesë të gjera nga Tabelat, nga Pyetje dhe Përgjigje e nga Shkrime të tjera që kanë të bëjnë me domethënien shpirtërore të *Huqúqu'lláh*-ut, si dhe me hollësitë e zbatimit të tij, janë botuar në një përmbledhje me titull *Huqúqu'lláb-u*.

126. Peticione të ndryshme kanë ardhur para frontit Tonë nga besimtarët lidhur me ligje të Perëndisë ... Ne, për rrjedhojë, kemi reveluar këtë Tabelë të Shenjtë dhe e kemi stolitur atë me rrobën e Ligjit të Tij, që ndoshta njerëzit t'ua përmbahen porosive të Zotit të tyre. ¶198

“Për disa vite me radhë”, thotë Bahá'u'lláh u në një prej Tabelave të Tij, *“Pranisë Më të Shenjtë nga vende të ndryshme i kanë ardhur peticione që luteshin për ligjet e Perëndisë, por Ne e kemi përmbajtur Pendën derisa të vinte koha e caktuar”*. Vetëm 25 vjet pas lindjes së Misionit të Tij Profetik në Síyáh-Chál in e Tíhránit, Bahá'u'lláh u reveloi Kitáb-i-Aqdas in, Thesarin e ligjeve të Dispensacionit të Tij. Edhe pasi e reveloi Aqdas in, para se t'ua dërgonte atë miqve në Persi, Ai e mbajti me Vete për një kohë. Ky vonim me synim hyjnor në revelimin e ligjeve bazë të Perëndisë për këtë epokë dhe zbatimin i mëtejshëm gradual i përmbajtjes së tyre ilustronë parimin e revelacionit të shkallëzuar, i cili vlen edhe brenda për brenda misionit të çdo Profeti.

127. Vendi kërmëz ¶100

Kjo është një referencë për qytetin-burg të 'Akká-së. Në Shkrimet Bahá'í fjala “kërmëz” përdoret në disa kuptime alegorike e simbolike. (Shih edhe shënimin 115.)

128. Sadratu'l Muntahá ¶100

Fjalë për fjalë “Lulja më e largët e Lotusit”, e përkthyer nga Shoghi Effendi u si *“Pema tej së cilës nuk kalohet”*. Në Islamin, për shembull, kjo përdoret në rrëfenjat për Udhëtimin Natën të Muhametit, si simbol për të treguar atë pikë në qiell tej së cilës as

njerëz as engjëj nuk mund të kalojnë në afrimin pranë Perëndisë dhe për të përcaktuar kështu kufijt e dijes hyjnore që i revelohen njeriut. Kështu që në Shkrimet Bahá'í kjo përdoret shpesh herë për të treguar Vetë Manifestimin e Perëndisë. (Shih gjithashtu shënimin 164.)

129. Libri Mëmë ¶103

Termi “Libri Mëmë” përdoret përgjithësisht për të treguar Librin qendror të një Dispensacioni fetar. Në Kuranin dhe në Hadithet islamike ky term përdoret për të cilësuar vetë Kuranin. Në Dispensacionin Bábí Libri Mëmë është Bayán i, ndërsa në Dispensacionin e Bahá'u'lláh ut Libri Mëmë është Kitáb-i-Aqdas i. Për më tepër, Ruajtësi, në një letër të shkruar në emër të tij, ka vënë në dukje se ky koncept mund të përdoret edhe si “term kolektiv për të treguar kompleksin e Mësimeve të reveluara nga Bahá'u'lláh u”. Ky term përdoret gjithashtu në një kuptim më të gjerë për të treguar Thesarin Hyjnor të Revelacionit.

130. Kush interpreton atë që është dërguar nga qielli i Revelacionit dhe ndryshon domethënien e qartë të saj ¶105

Në disa prej Tabelave të Tij, Bahá'u'lláh u vë në dukje dallimin midis vargjeve alegorike, të cilat i nënshtrohen interpretimit, dhe atyre vargjeve që kanë të bëjnë me çështje të tilla si ligjet e urdhërat, adhurimi e ritet fetare, domethënia e të cilave është e qartë dhe që kërkojnë bindje nga ana e besimtarëve.

Siç është shpjeguar në shënimet 145 dhe 184, Bahá'u'lláh u caktoi Pasardhës dhe Interpretues të Mësimeve të Tij Djalit e Vet të madh ‘Abdu’l-Bahá in. Nga ana e Vet, ‘Abdu’l-Bahá i caktoi nipin e Tij më të madh, Shoghi Effendi un, që Ta pasonte si interpretues i Shkrimeve të Shenjta dhe si Ruajtës i Kauzës. Interpretimet e ‘Abdu’l-Bahá it e të Shoghi Effendi ut konsiderohen si hyjnisht të frymëzuara dhe janë detyruese për Bahá'í të.

Ekzistenca e interpretimeve të autoritetshme nuk përjashton që individë të ndryshëm t'i përkushtohen studimit të

Mësimeve dhe të arrijnë në interpretime ose kuptime personale. Por në Shkrimet Bahá'í bëhet një dallim i qartë midis interpretimeve të autoritetshme dhe kuptimit që arrin çdo individ nga studimi i Mësimeve. Interpretimet personale të bazuara në kuptimin individual të Mësimeve janë fryt i aftësisë së arsyes së njeriut dhe, sigurisht, mund të ndihmojnë për një kuptim më të madh të Besimit. Megjithatë, pikëpamjeve të tilla u mungon autoriteti. Duke paraqitur idetë e veta personale, individët janë të ftuar të mos lënë mënjanë autoritetin e fjalëve të reveluara, të mos mohojnë ose kundërshtojnë interpretimet e autoritetshme dhe të mos hyjnë në polemika; përkundrazi, ata duhet të ofrojnë mendimet e tyre si një ndihmesë për dijen, duke e bërë të qartë se pikëpamjet e tyre janë thjesht personale.

131. mos u futni në hurdhra publike të banjave persiane ¶106

Bahá'u'lláh u ndalon përdorimin e hurdhave që gjenden në banjat publike tradicionale të Persisë. Në këto banja ishte zakon që shumë veta të laheshin bashkë në të njëjtën hurdhë dhe që uji të ndërrohej jo shpesh. Për rrjedhojë, uji ishte i turbullt, i pistë e i dëmshëm për shëndetin dhe binte erë shumë të keqe.

132. Shmangiuni gjithashtu hurdhave me erë të keqe në oborret e shtëpive persiane ¶106

Shumë shtëpi në Persi kishin në oborrin e tyre një hurdhë, e cila shërbente si rezervuar uji që përdorej për pastrim, për të larë e për qëllime të tjera shtëpiake. Meqenëse uji i hurdhave ishte i ndenjtur dhe zakonisht nuk ndërrohej për javë të tëra, kishte prirjen të merrte një erë shumë të pakëndshme.

133. Ju ndalohet të martoheni me gratë e atit tuaj. ¶107

Martesa me njerikën ndalohet shprehimisht këtu. Ky ndalim vlen edhe për martesën me njerikun. Aty ku Bahá'u'lláh u formulon një ligj midis një burri e një gruaje, ai zbatohet *mutatis mutandis* edhe midis një gruaje e një burri, veç rasteve kur konteksti e bën këtë të

pamundur.

‘Abdu’l-Bahá i dhe Shoghi Effendi u konfirmojnë që edhe pse njerkat janë e vetmja kategori e familjarëve që përmendet në tekst, kjo nuk do të thotë se të gjitha bashkimet e tjera në gjirin e një familjeje janë të lejueshme. Bahá’u’lláh u thotë se i takon Shtëpisë së Drejtësisë të nxjerrë ligje “lidhur me ligjshmërinë ose jo për t’u martuar me farefisën e vet” (Py&Pë 50). ‘Abdu’l-Bahá ka shkruar se sa më e largët të jetë lidhja e gjakut midis çiftit aq më mirë është, duke qenë se martesë e tilla janë baza e mirëqenies fizike të njerëzimit dhe sjellin miqësi midis njerëzve.

134. çështja e djemve ¶107

Në origjinalin arabisht, fjala e përkthyer këtu si “djem” në këtë kontekst nënkupton pederastinë. Shoghi Effendi u e ka interpretuar këtë referencë si ndalim të të gjitha marrëdhënieve homoseksuale.

Mësimet Bahá’í për moralin seksual mbështeten mbi martesën dhe familjen, si themeli i shëndoshë i gjithë strukturës së shoqërisë njerëzore, dhe kanë për qëllim të mbrojnë e të forcojnë këtë institut hyjnor. Prandaj ligji Bahá’í i kufizon marrëdhëniet seksuale të lejuara në marrëdhëniet midis burrit dhe gruas me të cilën ai është martuar.

Në një letër të shkruar në emër të Shoghi Effendi ut, thuhet:

Është gabim të lejohet që dashuria midis personave të të njëjtit seks, sado e thellë dhe e bukur që të jetë, të gjejë shprehje në akte seksuale. Të thuash se kjo është ideale, ky nuk është justifikim. Bahá’u’lláh u ndalon me të vërtetë imoralitetin e çdo lloji, dhe si të tilla i shikon Ai marrëdhëniet homoseksuale, që veç kësaj janë kundër natyrës. Të jesh i sëmurë nga kjo është një barrë e rëndë për një shpirt të ndërgjegjshëm. Por me këshillën e ndihmën e mjekëve, me një përpjekje të fuqishme e të vendosur dhe me anë të lutjes, një shpirt mund ta kapërcejë këtë gjymtim.

Bahá'u'lláh u udhëzon që Shtëpia Universale e Drejtësisë të vendosë, sipas shkallës së fajit, ndëshkimet për marrëdhëniet intime jashtë kurore dhe për pederastinë (Py&Pë 49).

135. Askujt nuk i lejohet të mërmërisë vargje të shenjta para njerëzve duke ecur në rrugë ose në pazar ¶108

Kjo është një aluzion për zakonin e disa klerikëve e prijësve fetarë të Dispensacioneve të mëparshme, të cilët, për hipokrizi e për t'u shtirur dhe për të fituar lëvdatat e pasuesve të tyre, mërmërisnin sa për sy e faqe lutje në vende publike si shenjë të devotshmërisë së tyre. Bahá'u'lláh u e ndalon një sjellje të tillë dhe thekson rëndësinë e përvuajtësisë e të devotshmërisë së vërtetë ndaj Perëndisë.

136. Secili e ka për detyrë të shkruajë një testament. ¶109

Sipas Mësimeve të Bahá'u'lláh ut, çdo njeri ka për detyrë të shkruajë vullnetin e tij të fundit e një testament dhe është i lirë të disponojë pasurinë e vet ashtu si t'i pëlqejë (shih shënimin 38).

Bahá'u'lláh u thotë që, duke bërë testamentin, “*secili ka të drejta të plota mbi pasurinë e vet*”, derisa Perëndia e ka lejuar individin “*të bëjë çfarë të dojë me atë që i ka dhuruar atij*” (Py&Pë 69). Në Kitáb-i-Aqdas janë shpallur udhëzimet për shpërndarjen e trashëgimit në rast se nuk ka testament. (Shih shënimet 38-48.)

137. Emri Më i Madh ¶109

Siç është shpjeguar në shënimin 33, Emri Më i Madh i Perëndisë mund të marrë forma të ndryshme, të bazuara të gjitha në fjalën “Bahá”. Bahá'í-të në Lindje e kanë zbatuar këtë urdhër të Aqdas it duke i filluar testamentet e veta me fraza të tilla si “O Ti Lavdi e Lavdiplotit”, “Në emër të Perëndisë, Lavdiplotit” ose “Ai është Lavdiploti” e të tjera si këto.

138. Të gjitha Festat kanë arritur përmbushjen e tyre në dy Festat Më të Mëdha, si dhe në dy Festa të tjera që bien në

ditët binjake ¶110

Ky pasazh vendos katër festa të mëdha të vitit Bahá'í. Dy që janë caktuar nga Bahá'u'lláh u si “*Dy Festat Më të Mëdha*” janë, e para Festa e Ridvánit, e cila përkujton Deklarimin e Misionit të Tij Profetik në Kopshtin e Ridvánit në Bagdad gjatë dymbëdhjetë ditëve në prill-maj 1863, të cilësuar prej Tij si “Mbretëresha e Festave”, dhe e dyta Deklarimi i Báb it, që ndodhi në Shiraz në maj 1844. Dita e parë, e nëntë dhe e dymbëdhjetë e Festës së Ridvánit janë Ditë të Shenjta (Py&Pë 1), si dhe dita e Deklarimit të Báb it.

“*Dy Festat e tjera*” janë përvjetorët e lindjes të Bahá'u'lláh ut e të Báb it. Në kalendarin hënor mysliman këto bien në dy ditë njëra pas tjetrës, respektivisht ditëlindja e Bahá'u'lláh ut në ditën e dytë të muajit të Muharremit 1233 A.H. (12 nëntor 1817) dhe ditëlindja e Báb it në ditën e parë të po atij muaji 1235 A.H. (20 tetor 1819). Prandaj janë quajtur “Ditëlindje Binjake” dhe Bahá'u'lláh u thotë se në sytë e Perëndisë këto dy ditë shihen si një e vetme (Py&Pë 2). Ai thotë që, në qoftë se ato bien gjatë muajit të agjërimit, porosia për të agjëruar nuk zbatohet në ato ditë (Py&Pë 36). Duke qenë se kalendar i Bahá'í është kalendar diellor (shih shënimet 26 dhe 147), i takon Shtëpisë Universale të Drejtësisë të përcaktojë nëse Ditëlindjet e Shenjta Binjake duhen kremtuar mbi një bazë diellore apo hënore.

139. në ditën e parë të muajit të Bahá-it ¶111

Në kalendarin Bahá'í, muaji i parë i vitit dhe dita e parë e çdo muaji janë quajtur me emrin “Bahá”. Dita e Bahá-it e muajit të Bahá-it është kështu dita e Vitit të Ri Bahá'í, Novruzi, që është urdhëruar nga Báb i si festë dhe këtu është konfirmuar nga Bahá'u'lláh u (shih shënimet 26 dhe 147).

Veç shtatë Ditëve të Shenjta të urdhëruara në këto pasazhe të Kitáb-i-Aqdas it, në kohën e Bahá'u'lláh ut përkujtohej si Ditë e Shenjtë edhe përvjetori i Martirizimit të Báb it dhe, si rrjedhojë e domosdoshme e kësaj, ‘Abdu’l-Bahá i shtoi përkujtimin e

Ngjitjes së Bahá'u'lláh ut, duke u bërë gjithsej nëntë Ditë të Shenjta. Dy përvjetorë të tjerë që përkujtohen, por gjatë të cilëve puna nuk ndërpritet, janë Dita e Besëlidhjes dhe përvjetori i Vdekjes së ‘Abdu’l-Bahá it. Shih seksionin për kalendarin Bahá’í në *The Bahá’í World [Bota Bahá’í]*, vëllimi XVIII.

140. Festa Më e Madhe është, me të vërtetë, Mbretëresha e Festave ¶112

Kjo është një referencë për Festën e Ridvánit (shih shënimet 107 dhe 138).

141. Më parë Perëndia i kishte ngarkuar secilit besimtar detyrën për të blatur para fronit Tonë dhurata të paçmuara nga zotërimet e tij. Tani ... Ne i kemi liruar ata nga ky detyrim. ¶114

Ky pasazh shfuqizon një masë të Bayán it që dekretonte se të gjitha objektet unikale të llojit të vet duhej t’i jepeshin Atij Që Perëndia do Ta shfaqë, kur Ai të shfaqej. Báb i ka shpjeguar që, duke qenë se Manifestimi i Perëndisë është i pakrahasueshëm, çdo gjë e pashoqe në llojin e vet duhet me të drejtë t’i rezervohet Atij, në qoftë se Ai nuk dekreton ndryshe.

142. në agim ¶115

Përsa i përket pjesëmarrjes në lutjen e agimit në Mashrikul Azkar, Shtëpinë e Adhurimit Bahá’í, Bahá'u'lláh u ka shpjeguar që, megjithëse koha e specifikuar në Librin e Perëndisë është “*në agim*”, është e pranueshme çdo kohë që nga “*zbardhja e agimit, midis agimit dhe lindjes së diellit, ose edhe deri në dy orë pas lindjes së diellit*” (Py&Pë 15).

143. Këto Tabela janë zbukuruar me vulën e Atij Që bën të agojë dita, Që ngre zërin midis qiejve dhe tokës. ¶117

Bahá'u'lláh u pohon në mënyrë të përsëritur vërtetësinë absolute të Shkrimeve të Tij si Fjala e Perëndisë. Disa prej Tabelave të Tij gjithashtu kanë shenjën e njëjës prej vulave të Tij. *The Bahá’í*

World [Bota Bahá'í], vëllimi V, f. 4, ka një fotografi të disa prej vulave të Bahá'u'lláh ut.

144. Është e papranueshme që njeriu, të cilit i është dhuruar arsyeja, të kryejë diçka që ia rrëmben atë. ¶119

Në Shkrimet Bahá'í ka shumë pasazhe që ndalojnë përdorimin e verës e të pijeve të tjera dehëse dhe që tregojnë efektin shkatërrimtar të tyre mbi njeriun. Në një prej Tabelave të Tij, Bahá'u'lláh u thotë:

Kini mendjen të mos e shkëmbeni Verën e Perëndisë me verën tuaj, sepse ajo trulllos mendjen dhe e largon shikimin tuaj nga fytyra e Perëndisë, Lavdiplotit, të Pashoqit, të Paarritshmit. Mos iu avitni asaj, sepse ju është ndaluar me urdhër të Perëndisë, të Lartësuarit, Fuqiplotit.

‘Abdu’l-Bahá i shpjegon se Aqdas i ndalon “si pijet e lehta dhe të forta” dhe thotë se arsyeja e ndalimit të pijeve alkoolike është sepse “alkooli e çon mendjen në rrugë të gabuar dhe shkaktton dobësimin e trupit”.

Shoghi Effendi u, në disa letra të shkruara në emër të tij, thotë se ky ndalim përfshin jo vetëm konsumin e verës, por edhe të “çdo gjëje që turbullon mendjen”, dhe sqaron se përdorimi i alkoolit lejohet vetëm kur ai është pjesë e një trajtimi mjekësor që jepet “me këshillë të një mjeku kompetent e të ndërgjegjshëm, që mund të jetë i detyruar ta japë atë për kurimin e ndonjë sëmundjeje të veçantë”.

145. kthejeni fytyrën nga Ai që Perëndia ka caktuar dhe që është degë prej kësaj Rrënje të Lashtë ¶121

Bahá'u'lláh u bën aluzion këtu për ‘Abdu’l-Bahá in si Pasardhësi i Tij dhe i fton besimtarët të kthehen drejt Tij. Në Librin e Besëlidhjes, Vullnetin e Testamentin e Tij, Bahá'u'lláh u shpalos domethënien e këtij vargu. Ai thotë: “Objekti i këtij vargu të shenjtë s’është tjetër veçse Dega Më e Fuqishme”. “Dega Më e Fuqishme” është

një prej titujve që Bahá'u'lláh u i ka dhënë ‘Abdu'l-Bahá it. (Shih gjithashtu shënimet 66 dhe 184).

146. Në Bayán ju është ndaluar të Na bëni pyetje. ¶126

Báb i ua ndalonte pasuesve të Tij t'i bënin pyetje Atij Që Perëndia do Ta shfaqë (Bahá'u'lláh un), veçse po t'i bënin ato me shkrim dhe për çështje të denja për pozitën e Tij të lartë. Shih *Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e Báb it.*

Bahá'u'lláh u e heq këtë ndalim të Báb it. Ai i fton besimtarët të bëjnë pyetje për ato që *“kanë nevojë të pyesin”* dhe i këshillon të mos bëjnë *“pyetje të kota”* si ato që preokuponin *“njerëzit e kohëve të shkuara”*.

147. Numri i muajve në një vit, i caktuar në Librin e Perëndisë, është nëntëmbëdhjetë. ¶127

Viti Bahá'í, sipas kalendarit Badí', përbëhet nga nëntëmbëdhjetë muaj prej nëntëmbëdhjetë ditësh secili, duke shtuar disa ditë plotësuese (katër në një vit të zakonshëm dhe pesë në një vit të brishtë) midis muajit të tetëmbëdhjetë e të nëntëmbëdhjetë, për t'ia përshtatur kalendarin vitit diellor. Báb i u vuri muajve emra sipas disa attributeve të Perëndisë. Dita e Vitit të Ri Bahá'í, Novruzi, është e përcaktuar astronomikisht dhe përkon me sanataditën e marsit (shih shënimin 26). Për hollësi të mëtejshme, duke përfshirë emrat e ditëve të javës dhe të muajve, shih seksionin e kalendarit Bahá'í në *The Bahá'í World [Bota Bahá'í]*, vëllimi XVIII.

148. i pari është stolitur me këtë Emër që ka mbuluar tërë krijimin ¶127

Në Bayán in Persian, Báb i i dha emrin “Bahá” muajit të parë të vitit (shih shënimin 139).

149. Zoti ka urdhëruar që të vdekurit të shtihen në dhe në arkivole ¶128

Në Bayán, Báb i porosiste që të vdekurit të shtihen në dhe në arkivole prej kristali ose prej guri të lëmuar. Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, ka shpjeguar se domethënia e kësaj mase ishte të tregohet respekt për trupin njerëzor, i cili “një kohë ishte i fisnikëruar nga shpirti i pavdekshëm i njeriut”.

Me pak fjalë, ligji Bahá’í për varrimin e të vdekurve thotë se është e ndaluar të çohet trupi më larg se një orë rrugë nga vendi i vdekjes; se trupi duhet të mbështillet me një pëlhurë të hollë mëndafshi ose pambuku dhe në gisht t’i vihet një unazë me mbishkrimin “*Kam ardhur nga Perëndia dhe tek Ai kthehem, i shkëputur nga gjithçka veç Tij, duke u mbajtur fort pas Emrit të Tij, të Mëshirshmit, Zemërdembshurit*”; dhe se arkivoli duhet të jetë prej kristali, prej guri ose prej druri të fortë të një cilësie të mirë. Është vendosur një Lutje e posaçme për të Vdekurit (shih shënimin 10), e cila duhet thënë para shtirjes në dhe. Siç vënë në dukje ‘Abdu’l-Bahá i dhe Ruajtësi, lutja solemne dhe unaza duhen përdorur për ata që kanë arritur moshën e pjekurisë, dmth 15 vjeç (Py&Pë 70).

Përsa i përket materialit nga i cili duhet bërë arkivoli, thelbi i ligjit është se duhet bërë prej një materiali sa më rezistent. Kështu, Shtëpia Universale e Drejtësisë ka shpjeguar se, veç materialeve të specifikuara në Aqdas, nuk ka kundërshtim që për arkivolin të përdoret druri më i fortë që disponohet ose betoni. Tani për tani, Bahá’í të janë lënë të lirë të zgjedhin vetë lidhur me këtë.

150. Pika e Bayán it ¶129

“*Pika e Bayán it*” është një prej titujve me të cilin Báb i i referohej Vetvetes.

151. të vdekurit duhet të mbështillen me pesë copë pëlhura mëndafshi ose pambuku ¶130

Në Bayán in, Báb i e ka përcaktuar se trupi i të vdekurit duhet mbështjellë me pesë copë pëlhura mëndafshi ose pambuku. Bahá’u’lláh u e mbështet këtë masë dhe shton kushtin se për “*ata*

që kanë mjete të kufizuara është e mjaftueshme një copë e vetme e njëres prej këtyre pëllhurave”.

Kur e pyetën nëse “*pesë copë pëllhura*” që përmenden në ligji duan të thonë “*pesë qefinë të plotë*” apo “*pesë copë pëllhura që janë përdorur zakonisht deri atëherë*”, Bahá'u'lláh u u përgjigj se me këtë nënkuptohej “*përdorimi i pesë copë pëllhurave*” (Py&Pë 56).

Përsa i përket mënyrës sesi duhet mbështjellë trupi, në Shkrimet Bahá'í nuk ka asgjë që të përcaktojë sesi duhet bërë mbështjellja e trupit dhe as kur përdoren “*pesë copë pëllhura*” ose “*një pëllhurë e vetme*”. Tani për tani, Bahá'í të janë lënë të lirë të përdorin gjykimin e vet për këtë çështje.

152. Ju ndalohet ta transportoni trupin e të vdekurit në një largësi më të madhe se një orë rrugë nga qyteti ¶130

Qëllimi i kësaj porosie është të kufizohet kohëzgjatja e udhëtimit në një orë kohë, pavarësisht nga mjete i transportit që është zgjedhur për ta çuar trupin në vendin e varrimit. Bahá'u'lláh u thotë se sa më parë të bëhet varrimi “*aq më e përshtatshme dhe e pranueshme është kjo*” (Py&Pë 16).

Mund të kuptohet që vendi i vdekjes të përfshijë qytetin ose qytezën në të cilën personi ndërron jetë , prandaj një orë udhëtim mund të llogaritet nga kufiri i qytetit deri në vendin e varrimit. Thelbi i ligjit të Bahá'u'lláh ut është që i ndjeri të varroset afër vendit ku ai ose ajo vdes.

153. Perëndia i ka hequr kufizimet për udhëtim që ishin vendosur në Bayán. ¶131

Báb i kishte vendosur disa kufizime për udhëtimet, që mbetën në fuqi deri në ardhjen e të Premtuarit të Bayán it, kohë në të cilën besimtarët inkurajoheshin të niseshin, qoftë edhe në këmbë, për Ta takuar, duke qenë se arritja e Pranisë së Tij ishte fryti dhe qëllimi i vetë ekzistencës së tyre.

154. Lartësoni e nderoni dy Shtëpitë në Vendet e Shenjta

Binjake dhe vendndodhjet e tjera ku fronti i Zotit tuaj ... është vendosur. ¶133

Bahá'u'lláh u i njëjtëson “*dy Shtëpitë*” si Shtëpia e Tij në Bagdad, të quajtur prej Tij “*Shtëpia Më e Madhe*”, dhe Shtëpia e Báb it në Shiraz, të caktuara që të dyja prej Tij si vende haxhillëku. (Shih Py&Pë 29, 32 dhe shënimin 54).

Shoghi Effendi u ka shpjeguar se thënia “*vendndodhjet e tjera ku fronti i Zotit tuaj ... është vendosur*” u referohet atyre vendeve ku Personi i Manifestimit të Perëndisë ka banuar. Bahá'u'lláh u thotë se “*njerëzit e zonës ku këto ndodhen mund të zgjedhin që të ruajnë çdo shtëpi*” ku Ai ka banuar, ose “*njerën prej tyre*” (Py&Pë 32). Institucionet Bahá'í kanë gjetur, kanë dokumentuar dhe atje ku ka qenë e mundur kanë blerë e restauruar disa prej vendndodhjeve historike që lidhen me Manifestimet Binjake.

155. Kini mendjen që asgjë e shkruar në Librin të mos ju pengojë t'i vini veshin këtij që është Libri i Gjallë ¶134

“*Libri*” është regjistrimi i Fjalës së reveluar të Manifestimit të Perëndisë. “*Libri i Gjallë*” është një referencë për Personin e Manifestimit.

Këto fjalë përmbajnë një aluzion për një thënie të Báb it në Bayán in Persian lidhur me “*Librin e Gjallë*”, të cilin Ai e njëjtëson me Atë Që Perëndia do Ta shfaqë. Në një prej Tabelave të Tij Vetë Bahá'u'lláh u thotë: “*Libri i Perëndisë është dërguar në formën e këtij të Ri*”.

Në këtë varg të Aqdas it, dhe përsëri në paragrafin 168 të Aqdas it, Bahá'u'lláh u i referohet Vetes së Tij si “*Libri i Gjallë*”. Ai paralajmëron “*pasuesit e çdo Besimi tjetër*” të mos kërkojnë “*në Librat e tyre të Shenjtë arsye*” për të hedhur poshtë fjalët e “*Librit të Gjallë*”. Ai u tërheq vëmendjen njerëzve të mos lejojnë që ajo që është regjistruar në “*Librin*” t'i pengojë ata të njohin Pozitën e Tij dhe të mbahen fort pas asaj që gjendet në këtë Revelacion të ri.

156. nderim për këtë Revelacion, nga Penda e Atij Që qe

Lajmëtari Im ¶135

“*Nderimi*” që Bahá’u’lláh u citon në këtë pasazh është nga Bayán i Arab.

157. “Kibla është me të vërtetë Ai Që Perëndia do Ta shfaqë; sa herë që Ai lëviz, ajo lëviz, derisa Ai të arrijë në prehje.” ¶137

Për një diskutim të këtij vargu shih shënimet 7 dhe 8.

158. Është e paligjshme të lidhësh martesë, veçse me ndonjë që beson në Bayán in. Po qe se vetëm njëra palë e martesës e përqafton këtë Kauzë, zotërimet e tij ose të saj bëhen të paligjshme për palën tjetër ¶139

Pasazhi i Bayán it që Bahá’u’lláh u citon këtu tërheq vëmendjen e besimtarëve se është e afërt ardhja e “Atij Që Perëndia do Ta shfaqë”. Ndalimi për t’u martuar me një jo-Bábí dhe porosia, në bazë të së cilës pasuria e një personi, e burrit ose e gruas, që ka përqaftuar Besimin nuk mund t’i kalojë ligjërisht të shoqit ose të shoqes jo-Bábí, janë mbajtur pezull shprehimisht nga Báb i dhe më pas u hoqën nga Bahá’u’lláh u para se ato të hynin në fuqi. Kur citon këtë ligj, Bahá’u’lláh u vë në dukje se, duke e reveluar atë, Báb i kishte parashikuar qartë mundësinë që Kauza e Bahá’u’lláh ut të fitonte emër para asaj të Vetë Báb it.

Në *Perëndia kalon pranë* Shoghi Effendi u vë në dukje se Bayán i “duhet konsideruar parësisht si një hymnizim i të Premtuarit sesa si një kod ligjesh e porosish të destinuara të jenë një udhërrëfim i përhershëm për brezat e ardhshëm”. “I ashpër në mënyrë të qëllimtë në ligjet e rregullat që impononte”, vazhdon ai, “revolucionar në parimet që fuste, i llogaritur për të zgjuar nga letargjia mijërvjeçare klerin dhe popullin dhe për t’i dhënë një goditje vdekjeprurëse institucioneve të vjetëruara e të korruptuara, ai shpallte nëpërmjet masave të tij drastike ardhjen e Ditës së parashikuar, të Ditës kur “Thirrësi do të bëjë thirrje për një nevojë të rëndë”, kur Ai do të ‘shkatërrojë gjithçka ka qenë

para Tij, ashtu si Apostulli i Perëndisë rrëzoi zakonet e atyre që e kanë paraprirë” (shih gjithashtu shënimin 109).

159. Pika e Bayán it ¶140

Njëri prej titujve të Báb it.

160. Me të vërtetë, nuk ka Perëndi tjetër veç Meje ¶143

Shkrimet Bahá'í përmbajnë shumë pasazhe që sqarojnë natyrën e Manifestimit dhe raportin e Tij me Perëndinë. Bahá'u'lláh u nënvizon natyrën unike e të përkryer të Hyjnisë. Ai shpjegon se *“derisa nuk mund të ketë asnjë lidhje komunikimi të drejtpërdrejtë që të bashkojë Perëndinë e vërtetë që është Një me krijimin e Tij”*, Perëndia urdhëron që *“në çdo epokë e dispensacion një Shpirt i kalluar e i panjollë të shfaqet në mbretërinë e tokës e të qiellit”*. Kjo *“Qenie misterioze e qiellore”*, Manifestimi i Perëndisë, ka një natyrë njerëzore që i përket *“botës së materies”* dhe një natyrë shpirtërore *“të lindur nga thelbi i Vetë Perëndisë”*. Ai është gjithashtu i pajisur me një *“pozitë të dyfishtë”*:

Pozita e parë, e cila lidhet me realitetin e tij më të thellë, e paraqet atë si Një, zëri i të Cilit është zëri i Vetë Perëndisë ... Pozita e dytë është pozita njerëzore, që jepet në vargjet e mëposhtme: “Unë s’jam veçse një njeri si ju”. “Thuaj: lënduar qoftë Zoti im! A jam Unë më tepër se një njeri, një apostull?”

Bahá'u'lláh u thotë gjithashtu se në mbretërinë shpirtërore ka një *“unitet thelbësor”* midis të gjitha Manifestimeve të Perëndisë. Ato të gjitha revelojnë *“Bukurinë e Perëndisë”*, shfaqin emrat e atributet e Tij dhe i japin zë Revelacionit të Tij. Lidhur me këtë, Ai thotë:

Nëse ndonjëri prej Manifestimeve gjithpërfshirëse të Perëndisë do të deklaronte: “Unë jam Perëndia!”, në fakt Ai do të thoshte të vërtetën, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Sepse është provuar shumë herë që nëpërmjet Revelacionit të tyre, attributeve dhe emrave të tyre shfaqen në botë Revelacioni i Perëndisë, emri dhe atributet e Tij...

Ndërsa Manifestimet reulojnë emrat dhe atributet e Perëndisë dhe janë mjetet me anën e të cilave njerëzimi gjen rrugën për tek dija e Perëndisë dhe e Revelacionit të Tij, Shoghi Effendi u thotë se Manifestimet “kurrë ... nuk duhen njëjtësuar me atë Realitet të padukshëm, me Thelbin e vetë Hyjnisë”. Lidhur me Bahá'u'lláh un, Ruajtësi ka shkruar se “tempulli njerëzor që ka qenë bartësi i një Revelacioni kaq të fuqishëm” nuk duhet njëjtësuar me “Realitetin” e Perëndisë.

Përsa i përket karakterit unik të pozitës së Bahá'u'lláh ut dhe madhësisë së Revelacionit të Tij, Shoghi Effendi u thotë se thëniet profetike lidhur me “Ditën e Perëndisë” që gjenden në Shkrimet e Shenjta të Dispensacioneve të kaluara, janë përmbushur me ardhjen e Bahá'u'lláh ut:

Për Izraelin Ai ishte as më shumë e as më pak se mishërimi i “Atit të Përjetshëm”, “Zoti i Ushtrive” zbritur “me dhjetë mijë shenjtorë”; për Krishtërimin ishte Krishti i kthyer “në lavdinë e Atit”; për Islamin shiit ishte kthimi i Imam Hysenit; për Islamin sunit ishte zbritja e “Frymës së Perëndisë” (Jesu Krishti); për zoroastrianët ishte Sháh-Bahrám i i premtuar; për Hindutë ishte ritrupëzimi i Krishnës; për budistët ishte Buda i Pestë.

Bahá'u'lláh u cilëson pozitën e “Hyjnisë”, që Ai e ndan me të gjitha Manifestimet e Perëndisë, si

...pozita në të cilën ai vdes në veten e tij dhe jeton në Perëndinë. Hyjni, sa herë që Unë e përmend atë, do të thotë vetëfshirja Ime e plotë e absolute. Kjo është pozita në të cilën unë nuk kam kontroll as mbi vetë lumturinë time, as mbi fatkeqësinë time dhe as mbi jetën time ose rilindjen time.

Dhe përsa i përket raportit të vet me Perëndinë, Ai dëshmon:

Kur sodis, O Zoti im, raportin që më lidh mua me Ty, shtyhem t'u shpall të gjitha gjërave të krijuara “me të vërtetë, Unë jam Perëndia”; dhe kur unë shikoj vetë qenien time, ja, e gjej atë më të papunuar se balta!

161. pagimi i Zeqatit ¶146

Zeqati përmendet në Kuran si një detyrim i rregullt bamirësie për myslimanët. Me kalimin e kohës, koncepti mori formën e një takse lëmoshe, e cila impononte detyrimin që të derdhej për të ndihmuar të varfërit, për qëllime të ndryshme bamirësie dhe për të mbështetur Besimin e Perëndisë, një pjesë e përcaktuar e disa lloje të ardhurash tej kufijsh të caktuar. Kufiri i përjashtimit ndryshonte për artikuj të ndryshëm, po ashtu si dhe përçindja që duhej paguar për pjesën e tatueshme.

Bahá'u'lláh u thotë se ligji Bahá'í i Zeqatit ndjek *“atë që është zbuluar në Kuran”* (Py&Pë 107). Duke qenë se çështje të tilla si kufijt për përjashtimet, llojet e të ardhurave që kanë të bëjnë me këtë, shpeshësia e pagesave dhe shkalla e taksave për kategoritë e ndryshme të Zeqatit nuk përmenden në Kuran, këto çështje duhet të shtjellohen në të ardhmen nga Shtëpia Universale e Drejtësisë. Shoghi Effendi u ka vënë në dukje se, në pritje të një legjislacioni të tillë, besimtarët duhet të kontribuojnë rregullisht, sipas mjeteve e mundësive të tyre, në Fondin Bahá'í.

162. Është e paligjshme të lypësh dhe është e ndaluar t'i japish atij që lyp. ¶147

Në një Tabelë 'Abdu'l-Bahá i shpjegon domethënien e këtij vargu. Ai thotë se *“lypësia është e ndaluar dhe se t'i japish lëmoshë atyre që e kanë bërë zanat të lypurit gjithashtu është e ndaluar”*. Po në atë Tabelë Ai më tej vë në dukje se: *“Qëllimi është të çrrenjoset krejtësisht lypësia. Por në qoftë se një person nuk është në gjendje të sigurojë jetesën, ndodhet në varfëri të thellë ose bëhet i paafët për punë, atëherë është detyrë e të kamurve ose e Përfaqësuesve t'i sigurojnë atij një pagë mujore për të jetuar ... Me “Përfaqësues” nënkuptohen përfaqësuesit e popullit, domethënë anëtarët e Shtëpisë së Drejtësisë”*.

Ndalimi për t'u dhënë lëmoshë njerëzve që lypin nuk përjashton që individë të ndryshëm dhe Asamble Shpirtërore t'u japin ndihmë ekonomike të varfërve e nevojtarëve ose t'u krijojnë

atyre mundësi të fitojnë zhdërvjelltësi të tilla që t'i lejojnë të fitojnë jetesën (shih shënimin 56).

163. Një gjobë ... ka qenë caktuar më parë ... për cilindo që i shkaktonte hidhërim tjetrit ¶148

Bahá'u'lláh u shfuqizon ligjin e Bayán it Persian lidhur me pagimin e një gjobe zhdëmtimi nga ai që i shkakton hidhërim të afërmit.

164. Pema e shenjtë e Lotusit ¶148

“Pema e Shenjtë e Lotusit” është një referencë për Sadratul Muntaha, *“Pema tej së cilës nuk kalohet”* (shih shënimin 128). Këtu përdoret simbolikisht për të treguar Bahá'u'lláh un.

165. Thuajini vargjet e Perëndisë çdo mëngjes e mbrëmje. ¶149

Bahá'u'lláh u thotë se *“kërkesa”* thelbësore për të recituar *“vargjet e Perëndisë”* është *“etja dhe dashuria”* e besimtarëve për të *“lexuar Fjalën e Perëndisë”* (Py&Pë 68).

Përsa i përket përkufizimit *“vargje të Perëndisë”*, Bahá'u'lláh u thotë se ai nënkupton *“gjithçka që është dërguar nga Qielli i Fjalës Hyjnore”*. Shoghi Effendi u, në një letër shkruar një besimtar në Lindje, e ka sqaruar se termi *“vargje të Perëndisë”* nuk përfshin shkrimet e ‘Abdu’l-Bahá it; po kështu ai ka vënë në dukje se ky term nuk ka të bëjë me shkrimet e atij vetë.

166. Jeni urdhëruar të përtërinis orenditë e pajimet e shtëpive tuaja pas kalimit të nëntëmbëdhjetë viteve ¶151

Bahá'u'lláh u konfirmon urdhërin e Bayán it Arab lidhur me përtëritjen çdo nëntëmbëdhjetë vjet të orendive e pajimeve të shtëpisë, me kusht që njeriu të jetë në gjendje ta bëjë këtë. ‘Abdu’l-Bahá i e lidh këtë porosi me mbështetjen e sqimës e të pastërtisë. Ai shpjegon se qëllimi i këtij ligji është që të ndryshohen ato orendi e pajime që janë vjetëruar, që kanë

humbur lustrën dhe ngjallin neveri. Ligji nuk zbatohet për gjëra të tilla si sende të rralla e me vlerë, antika e arturina.

167. Lani këmbët ¶52

Në Kitáb-i-Aqdas besimtarët nxiten të bëjnë banjë rregullisht, të veshin rroba të pastra dhe në përgjithësi të jenë thelbi i pastërtisë e i sqimës. Pasqyra Përmbledhëse e Kodifikimi, seksioni IV.D.3. y.i.-vii., përmbledh porositë përkatëse. Lidhur me larjen e këmbëve, Bahá'u'lláh u thotë se është e parapëlqyer të përdoret ujë i ngrohtë; por edhe larja me ujë të ftohtë është gjithashtu e lejuar (Py&Pë 97).

168. Ju është ndaluar të përdorni amvona. Ai që dëshiron t'ju recitojë vargjet e Zotit të tij, le të ulët në një karrige të vendosur mbi një podium ¶154

Këto porosi kanë praktikat e tyre pararendëset në Bayán in Persian. Báb i e ka ndaluar përdorimin e amvonave për të bërë predikime e për të lexuar Tekstin. Ai, përkundrazi, e ka thënë posaçërisht që, për t'u dhënë mundësi të gjithëve të dëgjojnë qartë Fjalën e Perëndisë, duhej vendosur karrigia e folësit mbi një podium.

Duke komentuar këtë ligj, 'Abdu'l-Bahá i dhe Shoghi Effendi u e kanë bërë të qartë se në Mashrikul Azkar (ku predikimet janë të ndaluara dhe vetëm fjalët e Shkrimeve të Shenjta mund të lexohen) lexuesi mund të qëndrojë në këmbë ose i ulur, dhe po qe e nevojshme, që të dëgjohet më mirë, mund të përdorë një podium të ulët e të lëvizshëm, por se amvonat nuk lejohen. Në rast mbledhjesh në vende të ndryshme nga Mashrikul Azkar-i, lejohet gjithashtu që lexuesi ose folësi të qëndrojë ulur ose në këmbë dhe të përdorë një podium. Në një prej Tabelave të Tij, duke ripërsëritur ndalimin për të përdorur amvona, 'Abdu'l-Bahá i ka theksuar se kur Bahá'í të mbajnë fjalime në mbledhje, ata duhet ta bëjnë këtë duke mbajtur një qëndrim sa më të përunjur e vetmohues.

169. Kumari ¶155

Veprimtaritë që përfshihen në këtë ndalim nuk janë shtjelluar në Shkrimet e Bahá'u'lláh ut. Siç e kanë vënë në dukje si 'Abdu'l-Bahá i dhe Shoghi Effendi u, i është lënë Shtëpisë Universale të Drejtësisë të përcaktojë hollësitë e këtij ndalimi. Në përgjigje të pyetjeve nëse lotaritë, bastet për gjëra të tilla si garat e kuajve dhe lojrat e futbollit, bingot e të tjera si këto përfshihen në ndalimin për kumarin, Shtëpia Universale e Drejtësisë ka vënë në dukje se kjo është një çështje që do të shihet me hollësi në të ardhmen. Ndërkohë, Asambletë dhe individët këshillohen të mos e bëjnë problem këtë dhe të lihet në ndërgjegjen e besimtarëve individualë të vendosin.

Shtëpia e Drejtësisë ka udhëzuar se nuk është e përshtatshme të shtohen fondet për Besimin me anë lotarish, shortesh e lojrash të fatit.

170. përdorimi i opiumit ... lëndë që shkaktojnë plogështi e topitje ¶155

Ky ndalim i përdorimit të opiumit është ritheksuar nga Bahá'u'lláh u në paragrafin e fundit të Kitáb-i-Aqdas it. Lidhur me këtë, Shoghi Effendi u thotë se një nga kërkesat për “një jetë të dëlirë e të shenjtë” është “mospërdorimi i plotë ... i opiumit dhe i drogave të ngjashme që bëhen ves”. Heroina, hashashi dhe nënproduktet e tjera të kanabis si marijuana, si dhe lëndët halucinogjene si LSD, pejoti e lëndë të tilla të ngjashme, konsiderohet se i nënshtrohen këtij ndalimi.

'Abdu'l-Bahá i ka shkruar:

Përsa i përket opiumit, ai është i neveritsbëm e i nëmur. Perëndia na ruajtë nga ndëshkimi që Ai i jep atij që e përdor. Teksti i Librit Më të Shenjtë e thotë shprehimisht se ai është i ndaluar dhe se përdorimi i tij është kryekëput i dënuesbëm. Arsyeya tregon se të pish opium është një lloj çmendurie dhe përvoja dëshmon se ata që e përdorin janë kreqit të izoluar nga mbretëria njerëzore. I ruajtë Zoti të gjithë nga

kryerja e një veprimi kaq të shëmtuar si ky, që rrënon vetë themelet e çdo gjëje njerëzore dhe që e përmbys përjetë atë që e kryen. Sepse opiumi kapet fort pas shpirtit dhe kështu ndërjegja e atij që e përdor vdes, mendja e tij shkatërrohet, perceptimet e tij gërryhen. Ai e bën të gjallin të vdekur. Ai shuan zjarrin e natyrshëm. Nuk ka dëm më të madh se ai që shkakton opiumi. Të lumtur janë ata që kurrë nuk përmendin as emrin e tij; mendo, pra, sa fatkeq është ai që e përdor atë.

O ju që e doni Perëndinë! Në ciklin e Perëndisë Fuqiplotë dhuna dhe forca, shtrëngimi dhe shtypja të gjitha dënohen. Prandaj është e detyrueshme që përdorimi i opiumit të parandalohet me të gjitha mjetet, në mënyrë që gjinia njerëzore të shpëtojë ndoshta nga plaga më e tmerrshme. Përndryshe, mjerim e vuajtje atij që e lë mangut detyrimin e tij ndaj Zotit të vet.

Në një prej Tabelave të Tij, ‘Abdu’l-Bahá i ka thënë lidhur me opiumin: “*të gjithëve, atij që e përdor, atij që e blen dhe atij që e shet, u mohohet bujaria e hiri i Perëndisë*”.

Në një Tabelë tjetër, ‘Abdu’l-Bahá i ka shkruar gjithashtu:

Përsa i përket hashashit, ti ke vënë në dukje se disa persë janë mësuar ta përdorin. Perëndi i Mëshirshëm! Ky është më i keqi ndër lëndët debëse dhe ndalimi i tij është reveluar shprehimisht. Përdorimi i tij shkakton shpërbërjen e mendimit dhe topitjen e plotë të shpirtit. Si është e mundur që ndokush të kërkojë frytin e pemës djallëzore dhe, duke e ngrënë atë, të mishërojë vetitë e një përbindëshi? Si është e mundur që ndokush të përdorë këtë drogë të ndaluar dhe kështu t’i mohojë vetes bekimet e Mëshirëplotit?

Alkooli rraskapit mendjen dhe e shtyn njeriun të kryejë veprime të pakuptimta, por opiumi, ky fryt i neveritshëm i pemës djallëzore, dhe ky hashash i ndyrë shuajnë mendjen, ngurtësojnë shpirtin, shkatërrojnë trupin dhe e lënë njeriun të dështuar e të humbur.

Duhet vënë në dukje se ndalimi i mësipërm për të përdorur disa lloje drogash nuk ndalon përdorimin e tyre kur jepen nga mjekë të kualifikuar si pjesë e një kure mjekësore.

171. “misteri i Ndryshimit të Madh në shenjën e Sovranit” ¶157

Shaykh Aḥmad-i-Aḥsá’í (1753-1831), themeluesi i Shkollës së Shaykhí ve dhe i pari prej “yjeve binjakë që paralajmëruan ardhjen e Besimit të Báb it”, profetizoi se me shfaqjen e të Premtuarit të gjitha gjërat do të ndryshonin, të fundit do të ishin të parët, të parët do të ishin të fundit. Bahá’u’lláh u, në një prej Tabelave të Tij, i referohet “*simbolit e aluzjonit*” të “*misterit të Ndryshimit të Madh në Shenjën e Sovranit*”. Ai thotë: “*Me këtë ndryshim Ai ka bërë që të lartësuarit të përulen dhe të përulurit të lartësoben*”, dhe kujton se “*në ditët e Jesuit ata që ishin të shquar për dëturinë e tyre, njerëzit e letrave e të fesë, e mobuan Atë, ndërsa peshkatarët e përvuajtur nxituan të pranoheshin në Mbretërinë*” (shih gjithashtu shënimin 172). Për informacion të mëtejshëm lidhur me Sheik Ahmet Ahsai-n shih *Lajmëtarët e Agimit [The Dawn-Breakers]*, kreu 1 dhe 10.

172. “Gjashtën” e ngritur falë këtij “Elifi të Drejtë” ¶157

Në shkrimet e tij, Sheik Ahmet Ahsai e vinte shumë theksin te shkronja arabe “Váv”. Në *Lajmëtarët e Agimit*, Nabili thotë se kjo shkronjë “simbolizonte për Báb in ardhjen e një cikli të ri të Revelacionit Hyjnor dhe që nga ajo kohë është përmendur nga Bahá’u’lláh u në Kitáb-i-Aqdas në pasazhe të tilla si ‘*misteri i Ndryshimit të Madh*’ dhe ‘*Shenja e Sovranit*’”.

Emri i shkronjës “Váv” përbëhet prej tri shkronjash: Váv, Elif, Váv. Sipas llogaritjes abxhad, vlera numerike e secilës prej këtyre shkronjave është respektivisht 6, 1 dhe 6. Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij për një besimtar në Lindje jep një interpretim të këtij vargu të Aqdas it. Ai thotë se “*Elifi i Drejtë*” i referohet ardhjes së Báb it. Shkronja e parë, me vlerën gjashtë, që i paraprin Elifit, është një simbol i Dispensacioneve dhe Manifestimeve të mëparshme që i kanë paraprirë Báb it, ndërsa shkronja e tretë, e cila gjithashtu ka vlerën numerike 6, përfaqëson Revelacionin suprem të Bahá’u’lláh ut, që u shfaq pas Elifit.

173. Ju ndalohej të mbani armë, veçse kur është e domosdoshme ¶159

Bahá'u'lláh u mbështet urdhërin që përmbahet në Bayán, i cili shpall të paligjshme mbajtjen e armëve, veçse po qe e domosdoshme. Përsa u përket rrethanave se kur për një njeri mund të jetë “*e domosdoshme*” të mbajë armë, ‘Abdu’l-Bahá i ua lejon këtë besimtarëve për mbrojtje personale në një mjedis të rrezikshëm. Shoghi Effendi u, në një letër të shkruar në emër të tij, gjithashtu vë në dukje se në rast emergjence, kur nuk ka një forcë legale së cilës t’i drejtohesh, një Bahá’í është i justifikuar të mbrojë jetën e vet. Ka edhe një numër situatash të tjera, në të cilat armët janë të nevojshme dhe mund të përdoren në mënyrë të ligjshme; për shembull, në ato vende ku njerëzit gjuajnë për të siguruar ushqimin e veshmbathjen, si dhe në disa sporte si gjuajtja me hark, qitja në shenjë dhe skerma.

Në nivelin shoqëror, parimi i sigurimit kolektiv, i shpallur nga Bahá'u'lláh u (shih *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh ut*, 117) dhe i përpunuar nga Shoghi Effendi u (shih letrat e Ruajtësit të *Rendi Botëror i Bahá'u'lláh ut*), nuk nënkupton shfuqizimin e përdorimit të forcës, por parashtron “një sistem ku forca të bëhet shërbëtoare e Drejtësisë” e që parashikon ekzistencën e një force paqeruajtëse ndërkombëtare, e cila “të sigurojë unitetin organik të gjithë Konfederatës”. Në Tabelën e Bishárát-it, Bahá'u'lláh u shpreh shpresën se “*mjetet e luftës në gjithë botën do të kthehen në mjete rindërtimi dhe se grindjet e konfliktet midis njerëzve do të zhdruken*”.

Në një Tabelë tjetër, Bahá'u'lláh u thekson rëndësinë e miqësisë me pasuesit e të gjitha feve; Ai thotë gjithashtu se “*ligji i luftës së shenjtë është fshirë nga Libri*”.

174. ju lejohet të visheni me mëndafsh ¶159

Sipas zakonisht islamik, ishte përgjithësisht e ndaluar që burrat të visheshin me mëndafsh, veçse në kohë lufte të shenjtë. Ky ndalim, i cili nuk bazohej në vargjet e Kuranit, u shfuqizua nga

Báb i.

175. Zoti ju ka liruar ... nga kufizimet që zbatoheshin më parë për veshjen dhe për prerjen e mjekrës. ¶159

Shumë rregulla për veshjet e kanë prejardhjen në ligjet e zakonet tradicionale të feve botërore. Për shembull, kleri shiit adoptoi për vete përdorimin e mbulesave të kokës e të rrobave të posaçme dhe, ndërkohë, ua ndaloi njerëzve përdorimin e veshjeve evropiane. Zakoni mysliman, në dëshirën e tij për të ndjekur shembullin e rrobave të Profetit, futi gjithashtu një numër kufizimesh lidhur me rregullimin e mustaqeve dhe gjatësinë e mjekrës.

Bahá'u'lláh u i hoqi këto kufizime për veshjen dhe mjekrën. Ai ua lë çështje të tilla “*gjykimit*” vetjak dhe, në të njëjtën kohë, i fton besimtarët të mos i kalojnë kufijt e së hijshmes dhe të tregojnë përmbytje në çdo gjë që ka të bëjë me veshjen.

176. O Tokë e Káf-it dhe e Rá-së! ¶164

Káf dhe Rá janë dy bashkëtingëlloret e para të Kirmán, që është emri i një qyteti dhe i një province të Iranit.

177. dallojmë atë që përhapet prej teje fshehurazi e tinëzisht. ¶164

Ky pasazh është një referencë për intrigat e një grupi Azalish, pasues të Mírzá Yahyá it (shih shënimin 190), që kanë lidhje me qytetin e Kirmán-it. Midis tyre ishin Mullá Ja'far, djali i tij Shaykh Aḥmad-i-Rúhí e Mírzá Áqá Khán-i-Kirmání (që të dy dhëndurë të Mírzá Yahyá it, si dhe Mírzá Aḥmad-i-Kirmání. Ata jo vetëm kërkonin të dobësonin Besimin, por edhe u përzien në intriga politike që arritën kulmin me vrasjen e Násiri'd-Dín Sháh ut.

178. Sillni ndërmend sheikun që e kishte emrin Muḥammad-Ḥasan ¶166

Shaykh Muḥammad-Ḥasan, një prej eksponentëve kryesorë të

Islamit Shiit, nuk e pranoi Báb in. Autor i shkrimeve të vëllimshme të jurisprudencës shiite, thuhet se ka vdekur aty nga viti 1850.

Nabili, në *Lajmëtarët e Agimit*, përshkruan takimin që u bë në Najaf midis Mullá ‘Alí-y-i-Bastámí t, një prej Shkronjave të të Gjallit, dhe Shaykh Muḥammad-Ḥasan it. Gjatë takimit, Mullá ‘Alí u shpalli shfaqjen e Báb it dhe ngriti lart fuqinë e Revelacionit të Tij. Me nxitjen e sheikut, Mulla Aliu u deklarua menjëherë heretik dhe u dëbua nga mbledhja. Ai u gjykua, u çua në Stamboll dhe u dënua me punë të rëndë.

179. një sitës gruri e elbi ¶166

Ky është një aluzion për Mullá Muḥammad Ja‘far Gandum-Pák-Kun, personin e parë në Isfahan që pranoi Besimin e Báb it. Ai përmendet në Bayán in Persian dhe lëvdohet si një që “*veshi rrobën e dishëpulltarisë*”. Në *Lajmëtarët e Agimit*, Nabili përshkruan pranimin pa kushte të Mesazhit nga “sitësi i grurit” dhe mbrojtjen e zjarrtë të Revelacionit të ri nga ana e tij. Ai u bashkua me njësitin e mbrojtësve të Fortesës Shaykh Ṭabarsí dhe u vra gjatë rrethimit të saj.

180. Kini mendjen që fjala “Profet” të mos ju largojë nga ky Lajm Më i Madh ¶167

Bahá’u’lláh u u tërheq vëmendjen njerëzve “*me intuitë*” të mos lejojnë që interpretimet e tyre të Shkrimeve të Shenjta t’i pengojnë të njohin Manifestimin e Perëndisë. Pasuesit e çdo feje janë prirur të lejojnë që adhurimi i tyre për Themeluesin e saj t’i bëjë ta shohin Revelacionin e Tij si Fjalën e fundit të Perëndisë dhe të mohojnë mundësinë e shfaqjes së një Profeti të mëvonshëm. Kështu ka ndodhur me Hebraizmin, Krishtërimin dhe Islamin. Bahá’u’lláh u e mohon vlerën e këtij koncepti të karakterit përfundimtar qoftë për Dispensacionet e së kaluarës qoftë për atë të Vetin. Përsa u përket myslimanëve, Ai ka shkruar në Kitáb-i-

Íqán se “pasuesit e Kuranit ... kanë lejuar që fjalët ‘Vula e Profetëve’ t’u veshin sytë”, “të errësojnë të kuptuarit e tyre dhe t’i privojnë ata nga favoritë të gjitha dhuntive të Tij të shumëfishta”. Ai thotë se “kjo çështje ka qenë një provë e vështirë për gjithë njerëzimin” dhe vajton fatin e “atyre që, duke u kapur nga këto fjalë, nuk kanë besuar tek Ai Që është Reveluesi i tyre i vërtetë”. Báb i i referohet po kësaj çështjeje kur paralajmëron: “Mos lejoni që emrat t’ju ndajnë si me perde nga Ai Që është Zoti i tyre, qoftë edhe emri Profet, sepse ai emër s’është veçse një krijim i fjalës së Tij”.

181. çdo referim ndaj “Mëkëmbësisë” të mos ju ndalojë të njihni sovranitetin e Atij Që është Mëkëmbësi i Perëndisë ¶167

Fjala e përkthyer këtu “Mëkëmbësi” në origjinalin arab është “viláya”, e cila ka një varg kuptimesh, që përfshijnë “mëkëmbësi”, “ruajtësi”, “protektorat” dhe “pasardhësi”. Kjo fjalë përdoret në lidhje me Vetë Perëndinë, me Manifestimin e Tij ose lidhur me ata që janë Pasardhës të caktuar të një Manifestimi.

Në këtë varg të Aqdas it, Bahá’u’lláh u paralajmëron të mos lejohet që koncepte të tilla ta verbojnë njeriun ndaj “sovranitetit” të Manifestimit të ri Hyjnor, “Mëkëmbësit të vërtetë të Perëndisë”.

182. Sillni ndërmend Karímin ¶170

Hájí Mírzá Karím Khán-i-Kirmání (1810–rreth 1873) ishte kryetari i vetëquajtur i komunitetit të shaykhí ve pas vdekjes së Siyyid Kázim it, i cili ishte pasardhësi i caktuar i Sheik Ahmet Ahsai-t (shih shënimet 171 dhe 172). Ai ia kushtoi veten përhapjes së mësimëve të Sheik Ahmetit. Mendimet e shprehura prej tij u bënë objekt mosmarrëveshjes si midis përkrahësve dhe kundërshtarëve të tij.

I konsideruar si një prej dijetarëve kryesorë e një prej autorëve më prodhimtarë të kohës së tij, shkroi libra e letra të shumta në fusha të ndryshme të dijes që kultivoheshin në ato kohë. Ai iu kundërvu në mënyrë aktive si Báb it dhe Bahá’u’lláh ut dhe i përdori traktatat e veta për të sulmuar Báb in

e Mësimet e Tij. Në Kitáb-i-Íqán, Bahá'u'lláh u dënon tonin dhe brendinë e shkrimeve të tij dhe, për ta kritikuar, veçon një prej veprave të tij që përmban aluzione negative për Báb in. Shoghi Effendi u e përshkruan atë si “jashtë mase ambicioz e hipokrit” dhe tregon sesi ai “me kërkesë të posaçme të Shahut, kishte sulmuar poshtërsisht në një traktat Besimin e ri dhe doktrinën e tij”.

183. o njerëz të ditur të Bahá-it ¶173

Bahá'u'lláh u lavdëron të diturit midis pasuesve të Vet. Në Librin e Besëlidhjes së Tij, Ai ka shkruar: “*Të bekuar janë drejtuesit dhe të diturit midis njerëzve të Bahá-it*”. Duke iu referuar kësaj thënieje, Shoghi Effendi u ka shkruar:

Në këtë cikël të shenjtë të “diturit” janë, nga njëra anë, Duart e Kauzës së Perëndisë dhe, nga ana tjetër, mësuesit e përhapësit e Mësimeve të Tij që nuk kanë rangun e Duarve, por që kanë arritur një pozitë të shquar në punën e mësimt. Përsa u përket “drejtuesve”, ata janë anëtarët e Shtëpive Lokale, Kombëtare e Universale të Drejtësisë. Detyrat e secilit prej këtyre shpirtave do të përcaktohen në të ardhmen.

Duart e Kauzës së Perëndisë ishin persona të caktuar nga Bahá'u'lláh u dhe të ngarkuar me detyra të ndryshme, veçanërisht me atë të mbrojtjes e të përhapjes së Besimit të Tij. Në *Memorials of the Faithful [Kujtime për Besnikët]*, ‘Abdu'l-Bahá i ka përmendur besimtarë të tjerë të shquar si Duar të Kauzës dhe në Vullnetin e Testamentin e Tij ka përfshirë një porosi që e fton Ruajtësin e Besimit të caktojë Duar të Kauzës sipas gjykimit të tij. Shoghi Effendi u në fillim ngriti pas vdekjes një numër besimtarësh në rangun e Duarve të Kauzës dhe gjatë viteve të fundit të jetës së tij caktoi në këtë pozitë gjithsej 32 besimtarë nga të gjitha kontinentet. Në periudhën midis vdekjes së Shoghi Effendi ut më 1957 dhe zgjedhjes së Shtëpisë Universale të Drejtësisë më 1963, Duart e Kauzës drejtuan punët e Besimit në cilësinë e

Kryeadministratorëve të Konfederatës Botërore embrionale të Bahá'u'lláh ut (shih shënimin 67). Në nëntor 1964, Shtëpia Universale e Drejtësisë vendosi që ajo nuk mund të hartonte legjislacion për të bërë të mundur të caktonte Duar të Kauzës. Në vend të kësaj, me vendim të Shtëpisë së Drejtësisë më 1968, funksionet e Duarve të Kauzës për mbrojtjen dhe përhapjen e Besimit u shtrinë në të ardhmen me krijimin e Trupave Kontinentale të Këshilltarëve dhe më 1973 përmes ngritje së Qendrës Ndërkombëtare të Mësimimit, e cila e ka selinë në Tokën e Shenjtë.

Shtëpia Universale e Drejtësisë cakton Këshilltarët anëtarë të Qendrës Ndërkombëtare të Mësimimit dhe Këshilltarët Kontinentalë. Këshilltarët Kontinentalë caktojnë anëtarë të Trupave Ndhimëse. Të gjithë këta përfshihen në përkufizimin e të *“diturve”* të dhënë nga Shoghi Effendi u në thënien e cituar më sipër.

184. për çdo gjë që nuk kuptoni në Librin drejtojeni Atij Që është degëzuar nga ky Trung i fuqishëm ¶174

Bahá'u'lláh u e vesh ‘Abdu'l-Bahá in me të drejtën për të interpretuar Shkrimet e Tij të shenjta (shih gjithashtu shënimin 145).

185. Shkolla e Njëshmërisë Transhendente ¶175

Në këtë varg dhe në ata që vinë menjëherë pas tij, Bahá'u'lláh u përball njëren nga arsyet për të cilën disa prej Bábí-ve hodhën poshtë deklaratën e Tij se Ai është i Premtuari i Bayán it. Ky refuzim bazohej në një Tabelë që Báb i i drejtonte “Atij Që do të shfaqej”, prapa së cilës Báb i kishte shkruar: *“Ndriqofshin këtë letër në shkollën fillore shikimet e Atij Që Perëndia do Ta shfaqë”*. Kjo Tabelë është botuar në *Pjesë të Zgjedhura nga Shkrimet e Báb it*.

Këta Bábí thonin që, përderisa Bahá'u'lláh u ishte dy vjet më i madhe se Báb i, ishte e pamundur që Ai ta merrte këtë Tabelë *“në shkollën fillore”*.

Bahá'u'lláh u shpjegon këtu se kjo referencë është për

ngjarje që kanë ndodhur në botët shpirtërore tej këtij rrafshi të ekzistencës.

186. Ne i pranuar vargjet e Perëndisë ... që Ai Na para-shtroi ¶175

Në Tabelën e Tij drejtuar “Atij Që do të shfaqet”, Báb i e karakterizon Bayán in si një ofertë të Tij për Bahá’u’lláh un. Shih *Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e Báb it*.

187. O njerëz të Bayán it! ¶176

Kjo është një referencë për pasuesit e Báb it.

188. shkronjat L, T dhe B të bashkoheshin e të gërshetoheshin ¶177

Shoghi Effendi u, në disa letra të shkruara në emër të tij, ka shpjeguar domethënien e “shkronjave L, T dhe B”. Ato janë shkronjat e para të frazës “Le të bëhet”, e cila, thotë ai, “shpreh Fuqinë krijuese të Perëndisë, Që me anë të urdhërit të Tij bën që të gjitha gjërat të vinë në ekzistencë” dhe “fuqinë e Manifestimit të Perëndisë, forcën e Tij të madhe krijuese shpirtërore”.

Në origjinalin arabisht urdhërorja “Le të bëhet” është fjala “kun”, që përbëhet prej dy shkronjave “káf” dhe “nú”. Ato janë përkthyer nga Shoghi Effendi u në mënyrën e mësipërme.²⁶ Kjo fjalë është përdorur në Kuran si urdhëri i Perëndisë që thërret në ekzistencë krijimin.

189. ky Rend i ri Botëror ¶181

Në Bayán in Persian, Báb i thotë : *“Lum ai që e mbërthen shikimin mbi Rendin e Bahá’u’lláh ut dhe falënderon Zotin e tij. Sepse Ai me siguri*

²⁶ Në këtë përkthim shqip të Kitáb-i-Aqdas-it, shkronjat L, T dhe B (Le të bëhet) janë përshtatur në gjuhën shqipe, kurse në anglisht nga Shoghi Effendi u janë përdorur shkronjat B dhe E, që përbëjnë fjalën “Be”. – Shën. i përkth.

do të shfaqet. Perëndia me të vërtetë e ka urdhëruar këtë në mënyrë të pakundërshtueshme në Bayán in". Shoghi Effendi u e njëjtëson këtë "Rend" me sistemin që Bahá'u'lláh u parashikon në Aqdas, në të cilin Ai dëshmon ndikimin e tij revolucionarizues mbi jetën e njerëzimit dhe revelon ligjet e parimet që drejtojnë funksionimin e tij.

Tiparet e "Rendit të ri Botëror" janë përvijuar në Shkrimet e Bahá'u'lláh ut e të 'Abdu'l-Bahá it, si dhe në letrat e Shoghi Effendi ut e të Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Institucionet e Rendit Administrativ Bahá'í të sotëm, të cilat përbëjnë "bazën strukturore" të Rendit Botëror të Bahá'u'lláh ut, do të pihen dhe do të shndërrohen në Konfederatën Botërore Bahá'í. Lidhur me këtë, Shoghi Effendi u thotë se Rendi Administrativ "kur pjesët e tij përbërëse, institucionet e tij organike, të fillojnë të funksionojnë me efektshmëri e energjikisht, do të shpallë të drejtën e tij dhe do të tregojë aftësinë e tij që të shihet jo vetëm si bërthama, por si vetë modeli i Rendit të Ri Botëror, të destinuar të përfshijë, kur të vijë koha, mbarë njerëzimin".

Për informacion të mëtejshëm mbi evoluimin e këtij Rendi të ri Botëror shih, për shembull, letrat e Shoghi Effendi ut të botuara në *Rendi Botëror i Bahá'u'lláh ut*.

190. O burim zvetënimi! ¶184

Kjo është një referencë për Mírzá Yahjá-në, të njohur si Şubh-i-Azal (Mëngjesi i Përjetësisë), një gjysmëvëlla më i ri i Bahá'u'lláh ut, që u ngrit kundër Tij dhe iu kundërvu Kauzës së Tij. Mírzá Yahjá-i ishte emëruar nga Báb i të shërbente si kryetar nominal i komunitetit Bábí, në pritje të shfaqjes së shpejti të të Premtuarit. Me nxitjen e Siyyid Muḥammad-i-Işfahání t (shih shënimin 192), Mírzá Yahjá-i e tradhtoi besimin e Báb it, doli me pretendimin se është pasardhësi i Tij dhe intrigoj kundër Bahá'u'lláh ut, duke u përpjekur madje edhe ta vriste. Kur Bahá'u'lláh u i deklaroi atij shprehimisht Misionin e Tij në Adrianopojë, Mírzá Yahjá-i iu përgjigj duke arritur deri aty sa të

dilte me pretendimin se ai vetë ishte bartësi i një Revelacioni të pavarur. Pretendimet e tij më në fund u hodhën poshtë nga të gjithë me përjashtim të pak vetave, që u bënë të njohur si Azalí (shih shënimin 177). Shoghi Effendi u e quan atë “Kryeshkelësi i Besëlidhjes së Báb-it” (shih *Perëndia kalon pranë*, kreu X).

191. kujto sesi të kemi ushqyer ditë e natë për t'i shërbyer Kauzës ¶184

Në *Perëndia kalon pranë*, Shoghi Effendi u i referohet faktit që Bahá'u'lláh u, i Cili ishte trembëdhjetë vjet më i madh se Mírzá Yahjá-i, e kishte këshilluar dhe ishte kujdesur për të në periudhën e rinisë së hershme e të pjekurisë së këtij.

192. Perëndia e ka mbërthyer atë që të çoi ty në rrugë të shtrembër. ¶184

Kjo është një referencë për Siyyid Muḥammad-i-Işfáhání-n, të cilin Shoghi Effendi u e ka quajtur “Antikrishti i Revelacionit Bahá'í”. Ai ishte njeri i korruptuar nga karakteri e me ambicje të madhe vetjake, që e nxiti Mírzá Yahjá-në t'i kundërvihet Bahá'u'lláh ut dhe të pretendonte për veten e tij rangun e profetit (shih shënimin 190). Edhe pse ishte pasues i Mírzá Yahjá-it, Siyyid Muhamet Isfahani u syrgjynos bashkë me Bahá'u'lláh un në ‘Akká. Ai vazhdoi të nxiste e të komplotonte kundër Bahá'u'lláh ut. Duke përshkruar rrethanat e vdekjes së tij, Shoghi Effendi u ka shkruar në *Perëndia kalon pranë*:

Një rrezik i ri kërcënonte tani jetën e Bahá'u'lláh ut. Megjithëse Ai në mjaft raste ua kishte ndaluar rreptësisht pasuesve të Tij, si gojarisht dhe me shkrim, çdo akt hakmarrjeje kundër torturuesve të tyre dhe kishte kthyer në Bejrut një arab të pandërgjegjshëm të ardhur nga një fe tjetër, i cili bluante në kokë të kryente hakmarrje për paudhësitë që kishte pësuar Prijësi i tij i shumëdashur, shtatë prej shokëve u orvatën fshehurazi dhe vranë tre prej persekutuesve të tyre, ndër të cilët ishin edhe Siyyid

Muhamad e Aqá Ján.

Shtangia që përfshiu komunitetin edhe ashtu të shtypur ishte e papërshtueshme. Zemërimi i Bahá'u'lláh ut nuk kishte kufi. Ai i shpreh në këtë mënyrë, në një Tabelë të reveluar pak kohë pasi që kryer ky akt, emocionet e Tij: *“Sikur Ne të përmendnim atë që Na ndodbi, qiejt do të çaheshin më dysb dhe malet do të shembeshin”*. Në një rast tjetër Ai shkruajti: *“Burgimi Im nuk mund të Më dëmtojë. Ajo që mund të Më dëmtojë është sjellja e atyre që Më duan, që pretendojnë se janë të lidhur me Mua, e megjithatë kryejnë atë që i bën zemrën Time dhe Pendën Time të rënkojnë”*.

193. Zgjidhni një gjuhë të vetme ... adoptoni ... një shkrim të përbashkët. ¶189

Bahá'u'lláh u urdhëron të adoptohen një gjuhë e një shkrim botëror. Shkrimet e Tij parashikojnë dy faza në këtë proces. Faza e parë është zgjedhja e një gjuhe ekzistuese ose të shpikur, e cila duhet të mësohet pastaj në të gjitha shkollat e botës si gjuhë ndihmëse e gjuhëve amtare. Qeveritë e botës nëpërmjet parlamenteve të tyre ftohen ta vënë në jetë këtë vendim të rëndësishëm. Faza e dytë, në një të ardhme të largët, do të ishte adoptimi i një gjuhe të vetme dhe i një shkrimi të përbashkët për të gjithë mbi tokë.

194. Ne kemi caktuar dy shenja të arritjes së moshës së pjekurisë të gjinisë njerëzore ¶189

Shenja e parë e arritjes së moshës së pjekurisë të njerëzimit që përmendet në Shkrimet e Bahá'u'lláh ut është lindja e një shkence të cilësuar si ajo “filozofi hyjnore” që do të përfshijë zbulimin e një hapi rrënjësor drejt shndërrimit të elementeve. Ky është një tregues i shkëlqimeve të përhapjes së ardhshme të jashtëzakonshme të dijes.

Përsa i përket shenjës “së dytë” që Bahá'u'lláh u tregon se është reveluar në Kitáb-i-Aqdas, Shoghi Effendi u thotë se

Bahá'u'lláh u, “... në Librin e Tij Më të Shenjtë, ka urdhëruar zgjedhjen e një gjuhe të vetme dhe adpotimin e një shkrimi të përbashkët për të gjithë mbi tokë, urdhër që kur të vihet në zbatim do të ishte, siç thotë Ai Vetë në atë Libër, një prej shenjave të ‘arritjes së moshës së pjekurisë të gjinisë njerëzore’”.

Një shpjegim i mëtejshëm i këtij procesi të arritjes së moshës së pjekurisë të gjinisë njerëzore dhe të përparimit drejt pjekurisë jepet në thënien e mëposhtme të Bahá'u'lláh ut:

Një prej shenjave të pjekurisë së botës është se askush nuk do të pranojë peshën e kurorës mbretërore. Kurora mbretërore do të mbetet pa askënd që të dojë të mbajë i vetëm peshën e saj. Ajo do të jetë dita në të cilën urtia do të shfaqet në gjirin e njerëzimit.

Shoghi Effendi u e shoqëron arritjen e moshës së pjekurisë të gjinisë njerëzore me bashkimin e mbarë njerëzimit, me vendosjen e një konfederate botërore dhe me një stimulim të pashembullt të “jetës intelektuale, morale e shpirtërore të mbarë gjinisë njerëzore”.

GLOSARI

‘Abdu’l-Bahá

“Shërbëtori i Bahá-it”, ‘Abbás Effendi (1844-1921), djali i madh dhe Pasardhësi i caktuar i Bahá’u’lláh·ut, Qendra e Besëlidhjes së Tij.

Abjad

Sistemi i lashtë arab që u vë shkronjave të alfabetit një vlerë numerike, kështu që numrat mund të përfaqësohen nga shkronja dhe anasjelltas. Në këtë mënyrë çdo fjalë ka edhe një kuptim të mirëfilltë dhe një vlerë numerike.

Báb·i

Fjalë për fjalë “Porta”, titull i marrë nga Mírzá ‘Alí-Muhammad·i (1819-1850) pas Deklarimit të Misionit të Tij në Shiráz në maj 1844. Ai ishte Themeluesi i Besimit Bábí dhe Lajmëtari i Bahá’u’lláh·ut.

Bahá

Bahá do të thotë Lavdi. Ky është Emri Më i Madh i Perëndisë dhe një titull me të cilin thirret Bahá’u’lláh·u. Është gjithashtu emri i muajit të parë të vitit Bahá’í dhe i ditës së parë të çdo muaji Bahá’í.

Bahá’u’lláh

“Lavdia e Perëndisë”, titull i Mírzá Húsayn-‘Alí·ut (1817-1892), Themeluesi i Besimit Bahá’í.

Bayán

Bayán (“Shtjellim”) është titulli që Báb-i i ka dhënë Librit të Tij të Ligjeve; përdoret gjithashtu për të treguar tërësinë e Shkrimeve të Tij. Bayán-i Persian është vepra më e madhe doktrinale dhe thesari kryesor i ligjeve të urdhëruara nga Báb-i. Bayán-i Arab është i ngjashëm në përmbajtje, por më i vogël e me më pak peshë. Në shënimet, referencat për tema që gjenden si në Bayán-in Persian dhe në Bayán-in Arab jepen duke përdorur termin “Bayán” pa ndonjë specifikim tjetër.

Huqúqu’lláh

“E Drejta e Perëndisë”. E themeluar në Kitáb-i-Aqdas, ajo është një ofrim i bërë nga Bahá’í-të nëpërmjet Kryetarit të Besimit për qëllime që specifikohen në Shkrimet Bahá’í.

Qayyúmu’l-Asmá’

Komenti i Báb-it për Surenë e Josifit në Kuran. E reveluar më 1844, kjo vepër është karakterizuar nga Bahá’u’lláh-u si “i pari, më i madhi e më i fuqishmi i të gjithë librave” të Dispensacionit Bábí.

Mashriqu’l-Adhkár

Fjalë për fjalë “Agimi i lëvdimit të Perëndisë”, emri i Shtëpisë së Adhurimit Bahá’í dhe i anekseve të saj.

Mithqál

Njësi peshe e barabartë me pak më shumë se 3 gramë e gjysmë, e përdorur në Kitáb-i-Aqdas për të llogaritur sasi ari ose argjendi për qëllime të ndryshme, zakonisht në masat 9, 19 ose 95 mithqál-ë. Barasvlerat e tyre në sistemin metrik dhe në oncë troj (të cilat përdoren në matjen e metaleve të çmueshme) janë si vijon:

9 mithqálë =	32.775 gramë	=	1.05374 onsë troi
19 mithqálë =	69.192 gramë	=	2.22456 onsë troi
95 mithqálë =	345.958 gramë	=	11.12282 onsë troi

Kjo llogaritje bazohet në udhëzimet e Shoghi Effendi-ut, të përçuara në një letër të shkruar në emër të tij, që thotë: “një mithqál përbëhet prej nëntëmbëdhjetë nakudësh. Pesha e njëzet e katër nakudëve është baras me katër gramë e tri të pestat. Llogaritjet mund të bëhen mbi këtë bazë”. Mithqál-i i përdorur tradicionalisht në Lindjen e Mesme përbëhej prej 24 nakudësh, por në Bayán kjo u ndryshua në 19 nakudë dhe Bahá'u'lláh-u e konfirmoi këtë si vlerë të mithqálit sipas ligjeve Bahá'í (Py&Pë 23).

Nakhud

Njësi peshe. Shih “mithqál”.

Shoghi Effendi

Shoghi Effendi (1897-1957), Ruajtësi i Besimit Bahá'í nga 1921 deri më 1957. Ishte nipi i madh i ‘Abdu’l-Bahá-it dhe u caktua prej Tij si Kryetari i Besimit.

Síyáh-Chál

Fjalë për fjalë “Pusi i Zi”. Biruca e nëndheshme e errët, erëkeqe e Tihránit, ku u burgos Bahá'u'lláh-u për katër muaj vë vitin 1852.

ÇELËS PËR PASAZHET NGA KITÁB-I-AQDAS-I E PËRKTHYERA NË ANGLISHT NGA SHOGHI EFFENDI

Shkurtime e Burimeve

- BA Shoghi Effendi. *Bahá'í Administration: Selected Messages 1922-1932* [Administrimi Bahá'í: Mesazhe të Zgjedhura 1922-1932]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, rev. edn., 1968.
- BC National Spiritual Assembly of the Bahá'ís of the Unites States. *The Bahá'í Community: A Summarization of Its Organization and Laws* [Komuniteti Bahá'í: Një përmbledhje e organizimit dhe e ligjeve të tij]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, rev. edn., 1963.
- CF Shoghi Effendi. *Citadel of Faith: Messages to America, 1947-1957* [Kështjella e Besimit: Mesazhe për Amerikën, 1947-1957]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, 1965.
- ESW Bahá'u'lláh. *Epistle to the Son of the Wolf* [Letër për të Birin e Ujkut]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, 1979.
- GWB Bahá'u'lláh. *Gleanings from the Writings of Bahá'u'lláh* [Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh-ut]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, rev. edn., 1980.
- PDC Shoghi Effendi. *The Promised Day Is Come* [Dita e premtuar ka ardhur]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, rev. edn., 1980.
- SW *Star of the West: The Bahá'í Magazine* [Ylli i Perëndimit: Revista Bahá'í], vol. XIV, July 1923, nr. 4. Reprinted 1978. Oxford: George Ronald.
- UD Shoghi Effendi. *The Unfolding Destiny of the British Bahá'í Community* [Shpalosja e fatit të Komunitetit Bahá'í Britanik]. London: Bahá'í Publishing Trust, 1981.

WOB Shoghi Effendi. *The World Order of Bahá'u'lláh: Selected Letters* [Rendi Botëror i Bahá'u'lláh-ut: Letra të Zgjedhura]. Wilmette, Illinois: Bahá'í Publishing Trust, 1974.

Gjetja e Pasazheve

Paragrafi

- 1-5 “Detyra e parë ... o njerëz me intuitë!” (GWB CLV)
- 7 “Sa herë që ligjet e Mia ... urdhërit të Tij vendimtar”.
(GWB CLV)
- 10 “Ju kemi porositur të luteni e të agjëroni ... Zemërgjeri”
(BC f. 40)
- 16 “Ne jua kemi bërë të detyrueshëm agjërimin ... si festë”.
“Udhëtarët, të sëmurët ... Agjërimin...” (BC f. 40).
“Përmbahuni nga ushqimi ... e përcaktuar në Librin.
(BC f. 40)
- 30 “Zoti ka urdhëruar ... nuk ka rëndësi”. “Ata duhet të jenë
të besuarit ... o ju që kuptoni”. (BA, f. 21)
- 35 “O ju shërbëtorë të të Mëshirshmit! ... imagjinatat e veta
të kota” (SW f.112)
- 37 “Kushdo që del me pretendimin ... Urtiplotit”. (GWB CLXV)
- 38-40 “Mos u tronditni ... midis të vdekurve”. (GWB LXXI)
- 43 “Mos u qani në orët tuaja të sprovës ... Ai që është
i vetëdijshëm”. (SW f. 112)
- 48 “Çdo ati ... që kanë përfshirë botën”. (SW f. 112)
- 52 “O ju njerëz të drejtësisë ... Besniku”. (SW f. 112)
- 53-55 “Le të mos shqetësohen zemrat tuaja ... ndër mirënjohësit”.
(GWB LXXII)
- 58-59 “Kini mendjen që ... e që ka intuitë”. (GWB LXXII)
- 63 “Lidhni martesë ... të më përmendë Mua”. (UD f. 195)
- 78-84 “O mbretër të tokës! Ai Që është Zoti sovran ... për
ta ndihmuar”. (GWB CV)
- 85 “O Perandor i Austrisë! ... Horizont të ndritshëm”.
(PDC f. 37)
- 86 “Thuaj: O Mbret i Berlinit! ... ndër ata që përsiatin”.
(PDC f. 36-37)
- 87 “Ne nuk kemi kërkuar asgjë ... o turmë mbretërisht!”.
(PDC f. 26)
- 88 “O Sundimtarë të Amerikës ... Urdhëruesit, Urtiplotit”.

ÇELËS PËR PASAZHET

- (CF f. 18-19)
- 89 “O vend që ndodhesh ... i Gjithëdijshmi, Urtiploti”.
(PDC f. 40)
- 90 “O brigje të Rinit! ... lavdi të dukshme”. (PDC f. 37)
- 91-93 “Mos u brengos për asgjë ... librin e mrekulleshëm”.
(GWB LVI)
- 99-104 “Thuaj: O udhëheqës të fesë ... ta kuptonit këtë”.
(GWB XCVIII)
- 105 “Kush interpreton ... ndër të humburit”. (ESW f. 129-30)
- 118 “Zoti ka lejuar ... të gjallërohen”. (SW f. 113)
- 120 “Stoliseni kokën ... Urtiplotit”. (SW f. 113)
- 121 “Kur oqeani i pranisë Sime ... Rrënje të Lashtë”.
(WOB f. 134)
- 122-125 “Shikoni meskinitetin ... e tokës e të qiellit”. (GWB CLIX)
- 144 “Afrohuni me të gjitha fetë ... përfundojnë të gjitha gjërat”.
(SW f. 114)
- 161-163 “I bekuar është njeriu ... Bujariploti”. (GWB XXXVII)
- 165 “O turmë teologësh! Kur ... gjë e çuditshme”. (PDC f. 82)
- 165 “Ne i kemi çarë perdet ... në të ardhmen...”. (PDC f. 82)
- 166 “Po të kishit besuar ... moskokëçarësit”. (PDC f. 82)
- 167 “Kjo është Kauza ... idhujt tuaj”. (PDC f. 82)
- 169 “O turmë teologësh! Kini mendjen që të mos ... i të gjitha shenjave”. (PDC f. 82)
- 171 “Grisini perdet ... mospërfillësi”. (PDC f. 82)
- 173 “Lum ju ... është e thërrmuar”. (SW f. 114)
- 174 “Kur Pëllumbi Mistik ... ky Trung i fuqishëm”.
(WOB f. 134)
- 181-183 “Drejtpeshimi botëror ... të Fuqishmit, Dashuruesit”. (GWB LXX)

TREGUES ANALITIK

Referencat për tekstin e Kitáb-i-Aqdas-it janë sipas numrit të paragrafeve, ato të Pyetje dhe Përgjigje sipas numrit të pyetjeve, kurse ato të Shënimeve sipas numrit të çdo shënim. Referencat e tjera janë si zakonisht sipas numrit të faqes. Kështu p.sh.:

Q14	do të thotë paragrafi 14 i Kitáb-i-Aqdas-it
P10	do të thotë Pyetja (ose Përgjigja) nr. 10
sh14	do të thotë Shënimi nr. 14
102	tregon faqen 102

A

Abá Badí', P104

'Abdu'l-Bahá, 3, sh184, 252

caktimi si pasardhës i Bahá'u'lláh-ut, 3, 12, Q121, Q174, 145, sh1

Ai Që Perëndia ka caktuar, Q121, sh145

Dega Më e Fuqishme, sh145

Interpretuesi i Fjalës së Perëndisë, Q174, sh130, sh184

Qendra e Besëlidhjes, sh66, sh125

kakton Shoghi Effendi-un si Ruajtës, 3,

sh66, sh130

pasardhësit e, 3

Plani Hyjnor i, 4

Shembull, 3

Shkrimet (Tabelat)

vepra të veçanta

Kujtime për Besnikët, sh183

nuk konsiderohen "vargje të Perëndisë", sh165

Përgjigje për disa pyetje, sh75, sh86

Vullneti dhe Testamenti i, sh49, sh66, sh125, sh183

Abdyl Hazizi, Sulltan, sh120

Abhá. *Shih* Emri Më i Madh

Abxhad, shënim, sh28, sh50, sh122, sh 172, 252

Abrahami, sh65

Acarimi. *Shih* Polemika

Adrianopoja, Q37, P100, sh33, sh63, sh190

Adhurimi. *Shih gjithashtu* Agjërimi; Lutja(et) e Detyrueshme; Lutja detyrimi, Q78, Q184, 91, P106 i pranueshëm për Perëndinë, Q36, sh60

puna e lartësuar në rangun e. *Shih* Puna

recitimi i vargjeve, Q149. *Shih gjithashtu* Recitimi i Shkrimeve dhe i Vargjeve të shenjta

Shtëpia e Adhurimit. *Shih* Mashrikul Azkar-i

Adhurimi, Pika e, Q6, sh7. *Shih gjithashtu* Kibla

Afërmi (i), sjellja ndaj, 2, 159, 161, sh163

Aga Xhan, sh192

Aghsán, Q42, Q61, 161, sh66, sh67, sh85. *Shih gjithashtu* 'Abdu'l-Bahá-i; Shoghi Effendi

Agimi, lutja në, Q33, Q115, P15, sh5, sh142

Agjërimi, 4, 14, Q10, Q16, 148-149 domethënia, Q17, P76, P93, 148, sh25 gjatë ditëve të pacaktuara për, P71, 149

kohëzgjatja, Q16-17, 148, sh26-27 kushtet e, 148-149

- përfshijnë edhe pirjen e duhanit, sh32
- përmbajtja nga të ngrenët e të pirët, Q17, sh25, sh32
- mosha e pjekurisë për, Q10, 148, sh13, sh25
- orët e, Q17, sh17, sh25
- përrjashtimet nga, për arsye të Ditëve të Shenjta Bahá'í, P36, sh138
- moshës, Q10, 149, sh14, sh25, sh31
- punës së rëndë, P76, 149, sh31
- sëmundjes, Q10, Q16, P93, 149, sh14, sh31
- shtatzanisë ose të fëmijës së gjirit, Q16, 149, sh31
- udhëtimit, Q16, P22, P75, 148-149, sh30-31
- zakoneve të përmuajshme, Q13, 149, sh20, sh31, sh34
- Ahmet Ahsa, Sheik, Q157, sh171, sh172, sh182
- Ahmet Kirmáni, Mírzá, sh177
- Ahmet Ruhi, Sheik, sh177
- Ai Që Perëndia do Ta shfaqë. *Shih* Bahá'u'lláh-u
- bërja e pyetjeve Atij, Q126, 159, sh146
- blatimi i dhuratave të paçmuara Atij, 159, Q114, sh141
- thënie të Báb-it lidhur me. *Shih* Báb-i 'Akká, Q85, Q136, sh8, sh63, sh116, sh127, sh192
- Aktet seksuale. *Shih gjithashtu* Dëlirësia; Imoraliteti
- të ligjshme, sh134. *Shih gjithashtu* Martesa
- të paligjshme
- gjatë vitit të durimit, P11
- homoseksualizmi, sh134
- marrëdhëniet intime jashtë kurore, Q19, Q49, P23, P49, 157, sh36, sh36, sh77, sh90
- pasojat, Q49, sh36, sh77, sh134
- 'Alá', muaji i, P71, sh25, sh26, sh27
- Shih gjithashtu* Agjërimi
- Alegoria, sh2, sh121, sh127, sh13
- Alkooli, Q119, sh144, sh170. *Shih gjithashtu* Pijet dehëse; Vera
- Aluzion (e), 164
- Alláh-u-Abhá. *Shih* Emri Më i Madh
- Amvonat, ndalohej përdorimi i, 14, Q154, 157, sh168
- Antikat, sh166
- Antikrishti, sh192
- Apostujt e Perëndisë. *Shih* Muhameti
- Arab(ët), P74, sh192
- Arabishtja, vii, viii, sh28, sh172
- përkthimi i termave specifike, sh3, sh22, sh32, sh36, sh46, sh48, sh66, sh74, sh134, sh181, sh188
- e Kitáb-i-Aqdas-it, 9-10. *Shih gjithashtu* Kitáb-i-Aqdas
- zotërimi nga Bahá'u'lláh-u i, 9
- Ardhurat (të). *Shih* Huqúqu'lláh-u; Shtëpia(të) e Drejtësisë
- Argumentet. *Shih* Grindjet; Polemika
- Argjendi. *Shih gjithashtu* Prika
- orenditë prej, Q46, 158, sh72
- Ari, Q36. *Shih gjithashtu* Gjobat; Huqúqu'lláh-u; Prika; Zhdëmtimi
- orenditë prej, Q46, 158, sh72
- Arka. *Shih* Arka Kërmëz
- Arka Kërmëz, Q84, sh115
- Arkivoli. *Shih* Varrimi
- Armët, sh83, sh173
- Armët, mbajtja e, Q159, 158, sh173
- Ar-Rúm, sh119. *Shih gjithashtu* Kostantinopoja
- Arsimi. *Shih gjithashtu* Dijs dhe Mashrikul Azkar-i, sh53
- i fëmijëve, 14, Q48, Q150, 156, P105, sh40
- vajzat kanë përparësi, sh76
- fushat e studimit
- artet dhe shkencat, Q77, 160
- guhët, 161
- Arsyeja, fuqia e, Q119, sh130, sh144,

KITÁB-I-AQDAS

- sh170
- Arturinat, P37, P78, sh44, sh166. *Shih gjithashtu* Trashëgimi
- Arrija e moshës. *Shih* Gjinia njerëzore; Pjekuria, moshë e
- Arti (Artet),
